LIGJ
Nr.9312, datë 11.11.2004

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË KONCESIONARE "TIRANA AIRPORT PARTNERS", SHPK, PËR NDËRTIMIN, VËNIEN NË PUNË, OPERIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR "NËNË TEREZA", TIRANË DHE PËR DHËNIEN E DISA STIMUJVE KËSAJ SHOQËRIE KONCESIONARE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e koncesionit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare "Tirana Airport Partners", shpk, e cila i bashkëlidhet këtij ligji, për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar "Nënë Tereza", Tiranë dhe për dhënien e disa stimujve kësaj shoqërie koncesionare.

Neni 2

Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, si organe shtetërore të autorizuara, në mbështetje të legjislacionit në fuqi dhe të kushteve të kontratës së koncesionit, ngarkohen me zbatimin e kësaj kontrate, në emër dhe për llogari të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

1. Të gjitha pajisjet, automjetet dhe materialet e ndryshme, të importuara ose të blera në Republikën e Shqipërisë, në dobi të shoqërisë dhe për pajisjen, ndërtimin, administrimin e ndërtimit ose përmirësimin e terminalit ekzistues, të sheshit të terminalit ekzistues e të aktiveve përkatëse dhe për ndërtimet e reja, të përkufizuara në kontratën e koncesionit, gjatë periudhës së ndërtimit të fazës “A” të terminalit të ri, të fazës “B” të terminalit të ri, për zgjatimin e pistës dhe të rrugës së re hyrëse, të përkufizuara në kontratë:

a) përjashtatohen nga të gjitha taksat doganore dhe taksat e importit, të përcaktuara në ligjin nr.8449, datë 27.1.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar;

b) përjashtohen nga zbatimi i tatimit mbi vlerën e shtuar për importet, që përcaktohet në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar.

2. Shoqëria ka të drejtë të rimbursohet për TVSH-në e paguar për mallra dhe shërbime të blera e të marra në Republikën e Shqipërisë gjatë periudhave të planifikuara për ndërtimin e fazës “A” të terminalit të ri, fazës “B” të terminalit të ri, për zgjatimin e pistës dhe të rrugës së re hyrëse, si përcaktohet në mënyrë më të hollësishme në pikën 37.14 (Përjashtimi nga tatimet dhe rimbursimi i përshpejtuar i TVSH-së) të kontratës së koncesionit, e cila i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 4

Palët kontraktuese të njohin detyrimet e përcaktuara në pikën 4 të nenit 11 të ligjit nr.7973,

datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", i ndryshuar.

Neni 5

Siç është përcaktuar në kontratën e koncesionit, projekti, të drejtat dhe privilegjet e dhëna në lidhje me të nuk do t'u nënshtrohen shpronësimit dhe/ose shtetëzimit, duke përfshirë, pa kufizim, shpronësimin dhe/ose shtetëzimin, sipas ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me përjashtim të rastit kur shpronësimi dhe/ose shtetëzimi janë të domosdoshëm për mbrojtjen e interesave publikë, si e drejtë shpronësimi dhe/ose shtetëzimi, e dhënë nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik".

Neni 6

1. Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit dhe Ministria e Ekonomisë ngarkohen me detyrimin të ndihmojnë shoqërinë në dhënien e të drejtave, autorizimeve dhe lejeve, në përputhje me pikën 2.5 (Autorizimet) të kontratës së koncesionit, me përjashtim të autorizimeve të dhëna falas, sipas pikës 2.5 të shtojcës 14 (Autorizimet e dhëna) të kësaj kontrate, të cilat jepen falas me hyrjen në fuqi të këtij ligji, dhe në përfitimin nga të drejtat e uzufruktit dhe të drejtat e servitutit të kalimit në zonën e koncesionit, të përcaktuara në kontratë, në zbatim të këtij ligji.

2. Banka e Shqipërisë ngarkohet të miratojë hapjen e llogarive të shoqërisë koncesionare jashtë vendit, si dhe riatdhesimin e të ardhurave.

Neni 7

Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit dhe Ministria e Ekonomisë autorizohen të negociojnë dhe të arrijnë marrëveshje me shoqërinë koncesionare për ndryshimin e afateve dhe të kushteve të kontratës së koncesionit, me kërkesë të palëve kontraktuese, por vetëm nëse ndryshimet e propozuara:

a) u janë komunikuar dhe janë diskutuar me të gjitha subjektet qeveritare përgjegjëse për çështjet e veçanta, që propozohet të ndryshohen;

b) janë në përputhje të plotë me ligjin shqiptar në fuqi në kohën e arritjes së marrëveshjes, me politikën publike shqiptare, me interesat e brendshëm dhe ndërkombëtarë dhe me detyrimet, që ekzistonin në atë kohë;

c) nuk ndikojnë qenësisht dhe/ose negativisht në pozitën financiare të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, sipas kontratës së koncesionit;

ç) nuk ndikojnë qenësisht dhe/ose negativisht në kapacitetin e aeroportit ndërkombëtar "Nënë Tereza", Tiranë, për të përballuar pasagjerët dhe trafikun e kargos.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4392, datë 17.11.2004 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

KONTRATA E KONCESIONIT

QEVERIA E SHQIPËRISË DHE TIRANA AIRPORT PARTNERS (TAP) SH.P.K.

KJO KONTRATE ("Kontrata") lidhet ndermjet:

1. **QEVERISE SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE** (“Qeveria e Shqiperise”) e perfaqesuar nga Ministria e Ekonomise e Republikes se Shqiperise dhe Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit se Republikes se Shqiperise (se bashku “Organi Shteteror i Autorizuar”); dhe

2. **TIRANA AIRPORT PARTNERS** (SH.P.K.), shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e krijuar dhe qe funksionon sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise dhe e regjistruar me vendimin Nr. 32147, date 20 Shtator 2004 te Gjykates se Rrethit Tirane, me seli ne Rrugen e Kavajes nr. 59, Tirana Tower, Kati V, Tirane, Republika e Shqiperise, (“Shoqeria”) me ortake HOCHTIEF AirPort GmbH (“HTA”), DEG – Deutche Investitions – und Entwicklungsgesellschaft mbH (“DEG”) dhe Albanian – American Enterprise Fund (“AAEF”), (HTA, DEG, dhe AAEF, individualisht “Ortak”, dhe bashkerisht “Ortaket”).

NDERKOHE QE:

A) Ne baze te Nenit 9 te ligjit shqiptar nr. 7973 “Per Koncesionet dhe Pjesemarrjen e Sektorit Privat ne Sherbimet Publike dhe Infrastrukture”, date 26 Korrik 1995, i ndryshuar, (“Ligji Per Koncesionet”), vendimit te Keshillit te Ministrave te Republikes se Shqiperise (“Keshilli i Ministrave”) i titulluar “Per Miratimin e Programit dhe Dokumentacionit te Projektit per Zbatimin e Kontrates se Koncesionit per Aeroportin Nderkombetar “Nene Tereza”, Rinas, Tirane”, date 5 Qershor 2003 dhe vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 48 te titulluar “Per Perzgjedhjen e Ofertuesit te Preferuar per Realizimin e Kontrates se Koncesionit per Aeroportin Nderkombetar ”Nene Tereza”, Rinas, Tirane, date 27 Janar 2004 dhe vendimi i Keshillit te Ministrave Nr 675 Date 14 Tetor 2004 me titull: “Per miratimin ne parim te akt-marreveshjes per dhenien me konçesion te Aeroportit Nene Tereza“ , Organi Shteteror i Autorizuar eshte i autorizuar te lidhe kete Kontrate ne emer te Qeverise se Shqiperise.

B) Organi Shteteror i Autorizuar pranon te lidhe, ne emer te Qeverise se Shqiperise, kete Kontrate me Shoqerine, per dhenien e nje koncesioni (sic pershkruhet ne Piken 2.1, (Dhenia e Koncesionit) “Koncesioni”) Shoqerise sipas Ligjit te Zbatueshem.

C) Qeveria e Shqiperise dhe Shoqeria lidhin kete Kontrate me qellim percaktimin te kushteve dhe afateve ne baze te te cilave Shoqeria, nder te tjera, ka te drejte (a) te projektoje, financoje, instaloje, ndertoje, vere ne pune, mirembaje, operoje, administroje dhe zhvilloje Terminalin e Ri (sic pershkruhet me poshte) dhe Ndertimet e Reja (sic pershkruhet me poshte) dhe Ndertimet e Reja Shtese (sic pershkruhet me poshte) ne Zonen e Koncesionit (sic pershkruhet me poshte); (b) te perdore dhe te ripajise Terminalin Ekzistues (sic pershkruhet me poshte), Vendndodhjen e Terminalit Ekzistues (sic pershkruhet me poshte), Aktivet Perkatese (sic pershkruhet me poshte) dhe Zonen e Koncesionit; (c) te kete ne pronesi Ndertimet e Reja; (d) te gezoje Uzufruktin mbi Terminalin Ekzistues, Sheshin e Terminalit Ekzistues, Aktivet Perkatese dhe Zonen e Koncesionit (sic pershkruhet me poshte) per te pakten njezet (20) vjet; dhe (e) te lidhe kontrata per blerjen e cdo aktivi, te permbushe detyrimet dhe ushtroje te drejtat sipas kesaj Kontrate.

PALET KANE RENE DAKORD sa me poshte:

1. INTERPRETIMI

1.1 Perkufizime

Ne kete Kontrate, pervec termave te perkufizuar tjeterkund ne kete Kontrate:

“Shitje e Miratuar	eshte shitja nga AAEF e pjeseve

e AAEF”	te Kapitalit te saj ne Shoqeri ose riblerja e ketyre pjeseve nga Shoqeria, sipas rastit, ne perputhje me piken 4.2 (o) (Detyrimet e Pergjithshme te Shoqerise) dhe me Marreveshjen Mbeshtetese te Ortakeve.
“Rimbursimi i Pershpejtuar i TVSH”	ka kuptimin e dhene ne Piken 37.14(b) (Perjashtimi Tatimor dhe Rimbursimi i Pershpejtuar i TVSH).
“Detyrime Shtese”	ka kuptimin e dhene ne Piken 4.4 (Detyrimet Shtese te Shoqerise).
“Manual Aerodromi”	Eshte nje dokument (ose nje grup dokumentesh), qe permbajne te gjitha hollësite e Aeroportit, procedurat e operimit dhe planet qe kerkohen nga Organi Shteteror perkates dhe qe pershkruhet ne Dokumentin 9774AN/969 te ICAO Shtojca 1.
“Filial”	eshte, ne lidhje me cdo Person, cdo Person tjeter, i kontrolluar drejtperdrejt ose terthorazi, nga ose nen nje kontroll te perbashket, me

	nje Person te tille, ose ndonje Person tjeter te kontrolluar, drejtperdrejt ose terthorazi, nga ai Person, qe perfshin por pa kufizuar sa me siper, ne rastin e HTA, çdo trust, fond investimesh, korporate apo person tjeter juridik, investimet e te cilit, apo administratori dhe subjekti kontrollues i te cilit eshte HTA apo ndonje dege e HTA e kontrolluar prej saj.
“Shmangiet e pranuara”	jane shmangiet nga kushtet dhe afatet e Koncesionit, te pranuara me shkrim hera pas here ndermjet Shoqerise dhe Organit Shteteror te Autorizuar.
“Pjesa e Miratuar e Kostos se Operimit”	eshte pjesa e vendosur per rishikimin periodik te Pageses per sherbime te Aeroportit, bazuar ne parashikimet e arsyeshme financiare te Shoqerise, e totalit te kostos se operimit, taksimit dhe te sherbimit te kostos se kapitalit te Shoqerise, e cila lidhet me kostot operative te Shoqerise per permbushjen e

	Detyrimeve Kryesore dhe, te Detyrimeve Shtese, ne masen qe ato jane te zbatueshme.
“Projekti Teknik i Miratuar”	eshte projekti teknik i miratuar nga Shoqeria dhe Organi Shteteror i Autorizuar perpara nenshkrimit te kesaj Kontrate, me karakteristikat e treguara ne Shtojcen 16 (Projekti Teknik i Miratuar).
“Aeroport”	eshte Aeroporti Nderkombetar “Nene Tereza”, ne afersi te Tiranes, Republika e Shqiperise.
“Rruga Lidhese e Aeroportit”	eshte rruga ekzistuese nga nyja ne forme T-je ne Vore deri ne rrugen e Fushe Krujes per ne Aeroport.
“Pagesat per Sherbimet e Aeroportit”	kane kuptimin qe i jepet ne Shtojcen 7 (Pagesat per Sherbimet e Aeroportit).
“Rruga Qarkulluese e Aeroportit”	eshte rruga perreth Parkimeve te Automjeteve te Fazes A, te Parkimeve te Automjeteve te Fazes B dhe Terminalit te Ri, qe do te ndertohen nga Shoqeria ne perputhje me kerkesat e treguara ne
“Ligji Koncesionit te Aeroportit”	

	Shtojcen 27 (Rruga Lidhese e Aeroportit, Rruga Qarkulluese e Aeroportit dhe Parkimet e Automjeteve te Fazes A).
	eshte Ligji qe ratifikon kete Kontrate qe do te miratohet nga Kuvendi ne formen dhe permbajtjen e treguar ne Shtojcen 13 (Projektligji i Koncesionit te Aeroportit).
“Manualet e Mirembajtjes dhe te Operimit te Aeroportit dhe te tjera”	Eshte dokumenti (ose grupi i dokumenteve) qe permbajne detaje dhe plane qe nuk perfshihen ne Manualin e Aerodromit, por qe kerkohen per qellimin e operimit te sigurt dhe efektiv dhe mirembajtjen e Aeroportit dhe te infrastruktures se tij dhe per bashkeveprimin me palet e treta.
“Perimetri i Rrethimit te Sigurise se Aeroportit”	eshte perimetri i rrethimit te panderprere me specifikimet e pershkruara ne Shtojcen 25 (Rruga Rrethuese e Aeroportit dhe Perimetri i Rrethimit te Sigurise te Aeroportit), e cila mbyll Zonen e Koncesionit e vendosur ne

	Zonen e Koncesionit ose ne afersi te perimetrit te saj. Per te shmangur dyshimet, rrethime te tilla nuk kerkohen pergjate rrugeve jashte Zones se Koncesionit.
“Te drejtat e Aeroportit”	eshte cdo privilegj ose e drejte e dhene sipas kesaj Kontrate, ose cdo franchise, qira ose e drejte tjeter ose te drejta dytesore te dhena nga Shoqeria per shfrytezimin e cdo privilegji ose te drejte Koncesionit ose ne te kundert ne lidhje me cdo privilegj ose te drejte te dhene sipas kesaj Kontrate.
“Perdorues i Aeroportit”	eshte cdo shoqeri ajrore me fluturime te rregullta ose fluturime charter per dhe nga Aeroporti.
“Rruga Rrethuese e Anes Ajrore”	eshte rruga e shtruar, e panderprere me specifikimet e pershkruara ne Shtojcen 25 (Rruga Rrethuese e Anes Ajrore dhe Perimetri i Rrethimit te i Sigurise se Aeroportit), e cila shtrihet brenda (anes ajrore) te Rrethimit te Perimetrit te Sigurise se

	Aeroportit dhe lidh vendqendrimin kryesor te avioneve dhe ndertesat e tjera ndihmese si ato te lundrimit brenda Zones se Koncesionit.
“Kodi Civil Shqiptar”	eshte Ligji Nr. 7850, date 29 Korrik 1994 “Per Kodin Civil ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar hera heres.
“ICK Shqiptar”	eshte Indeksi i Cmimeve te Konsumatorit mujor, i botuar nga Instituti i Statistikave te Republikes se Shqiperise.
“Parimet e Pergjithshme te Pranuara te Kontabilitetit Shqiptar”	jane parimet e kontabilitetit te pershkruara nga Ligji i Zbatueshem, ne lidhje me pergatitjen e pasqyrave financiare nga shoqerite shqiptare per qellimet e raportimit te deyrueshem.
“ANTA”	eshte Agjencia Kombetare e Trafikut Ajror dhe cdo pasardhes i saj.
“Kompleksi i ANTA-s”	eshte zona e pershkruar si “Zona ATC” ne skicen nr. A/00-Rev02 dhe B7001-Rev02 te referuar ne

	Shtojcen 16 (Projekti Teknik i Miratuar).
“Ligji i Zbatueshem”	eshte Kushtetuta e Republikes se Shqiperise dhe cdo ligj i zbatueshem i qeverise vendore ose qendrore, urdherese, dekret, ligj ose rregullore e Republikes se Shqiperise ose cdo pjese e tyre ose Organ Shteteror, qe ka juridiksionin perkates, ne fuqi dhe ne veprim ne cdo kohe dhe kohe pas kohe gjate Afatit te Koncesionit.
“Aktivet ne Dorezim”	jane aktivet e Shoqerise qe i kalohen Qeverise se Shqiperise ne Daten e Dorezimit, ne perputhje me Piken 29 (Dorezimi), qe perfshijne, pa kufizim, Zonen e Koncesionit, Ndertimet e Reja, Aktivet Ekzistuese (ne varesi te kohes se perdorimit, dhe konsumimit dhe prishjes), Terminalin Ekzistues, Sheshin e Terminalit Ekzistues, Aktivet Perkatese dhe mjedise te tjera dhe aktive qe lidhen me Koncesionin.

“Autorizimet”	jane te gjitha, lejet, licencat, autorizimet, miratimet, vendimet ose certifikatat qe lidhen me zbatimin e Projektit dhe Koncesionin, qe do t’i jepen Shoqerise nga Qeveria e Shqiperise ose Organi Shteteror perkates pas Dates se Fillimit, sipas Pikes 2.5(b) dhe (c) (Autorizimet).
“Autorizime te Dhena”	jane lejet, licensat, autorizimet, miratimet ose certifikatat qe sipas Pikes 2.5(a) (Autorizimet), i jepen falas Shoqerise nga Qeveria e Shqiperise ose Organi Shteteror perkates ne Daten e hyrjes ne fuqi te Ligjit te Koncesionit te Aeroportit te renditura ne Shtojcen 14 “Autorizime te Dhena”.
“Kursi Mesatar Zyrtar i Kembimit”	eshte kursi mesatar zyrtar i kembimit per periudhen e pese (5) Diteve Pune para paraqitjes nga Shoqeria te rishikimit nga ana e saj te pagesave te sherbimeve te Aeroportit, kurs qe publikohet nga Banka e Shqiperise ne

	perputhje me Ligjin e Zbatueshem.
“Banka e Shqiperise”	eshte banka qendrore e Republikes se Shqiperise, (perfshire cdo pasardhes te saj).
“Data Baze”	ka kuptimin e dhene ne Shtojcen 7 (Pagesat per Sherbimet e Aeroportit)
“Keshilli Administrativ”	(i) ne rastin e nje Shoqerie me pergjegjesi te kufizuar eshte keshilli Administrativ, ndersa (ii) ne rastin e nje shoqerie anonime, drejtoria e Shoqerise.
“Takse Kufiri ne Dalje”	eshte taksa e kufirit ne dalje e vendosur ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem.
“Kosto e Humbjeve”	eshte kostoja e financimit te humbjeve dhe rregullimit te gabimeve (por vetem nese gabimi i ndermarre nga Shoqeria eshte ne formen e kembimit te normes se interesit te vendosur dhe zbatuar sipas dokumentacionit ISDA) te Huadhenesit Kryesor dhe te Huadhenesit te Nenrenditur te

	pales se trete.
“Dite Pune”	eshte dita gjate se ciles kryhet veprimtari tregtare ne Republiken e Shqiperise, me perjashtim te diteve te pushimit kombetar dhe te fundjaveve.
“Kosto Kapitale”	eshte kosto e vleresuar sipas ofertes se pergatitur dhe paraqitur nga Shoqeria ne tenderin konkurrues per qellime te Pikes 4.8 (Zgjatimi i Pistes) dhe punime te tjera kapitale te pa perfshira ne Shtojcen 16 (Projekti Teknik i Miratuar) ose ne Shtojcat e tjera perkatese.
“Pagesa e Kargos”	eshte pagesa e kargos e treguar ne Shtojcen 7 (Pagesat per sherbimet e Aeroportit).
“Huaja Kryesore e Certifikuar”	eshte: (i) ne lidhje me Fazen A te Punimeve te Ndertimit, Huaja Kryesore e Shoqerise (hollesite e se ciles tregohen ne Shtojcen 3 (Huaja Kryesore e Certifikuar per Fazen A te Punimeve te Ndertimit), qe perfshin nje

	shume te lejuar te barabarte me dhjete (10%) per qind te Huas Kryesore te Shoqerise, dhe (ii) ne lidhje me Punimet e Ndertimit, pervec ato te Fazes A te Punimeve te Ndertimit, Huaja Kryesore e Shoqerise qe i eshte njoftuar rregullisht Organit Shteteror te Autorizuar nga Shoqeria, dhe e miratuar dhe njohur si e tille me shkrim nga Organi Shteteror i Autorizuar qe perfshin, nese eshte miratuar me shkrim nga Qeveria e Shqiperise, nje shume te lejuar te barabarte me dhjete (10%) per qind te Huas Kryesore te Shoqerise.
“Hua e Nenrenditur e Certifikuar”	eshte Huaja e Nenrenditur e Shoqerise, qe i eshte njoftuar rregullisht Organit Shteteror te Autorizuar nga Shoqeria, e miratuar dhe njohur si e tille me shkrim nga Organi Shteteror i Autorizuar.
“Ndryshim ne Ligj”	eshte dekretimi, kalimi, paraqitja, revokimi, kthimi, modifikimi, ndryshimi ose

	shfuqizimi i Ligjit te Zbatueshem ne fuqi dhe veprim ne daten e kesaj Kontrate, perfshi cdo ndryshim ne normat Tatimore, qe hyn ne fuqi pas dates se kesaj Kontrate ose cdo ndryshim ne interpretimin ose zbatimin e sa me siper nga ndonje Ent Shteteror.
“Konventa e Cikagos”	eshte Konventa e Cikagos e vitit 1944, e ndryshuar dhe/ose shtuar here pas here, dhe cdo reference tek “Shtojca” e Konventes se Cikagos eshte vete kjo Shtojce, e ndryshuar dhe/ose shtuar hera heres.
“Taksat e Mbledhura”	eshte cdo shume e Takses se Vizes dhe/ose Takes se Kufirit ne Dalje, e mbledhur nga Shoqeria ne emer te Qeverise se Shqiperise ne perputhje me Piken 19.1(c) (Pagesat per Sherbimet e Aeroportit) dhe ne varesi te se Drejtave te Kompensimit te Vecante te Shoqerise.
“Data e fillimit”	ka kuptimin e dhene ne Piken 3.5 (Data e Fillimit).
“Shlyerja e Kapitalit te	ka kuptimin qe i jepet ne Shtojcen 2 (Shlyerja e

Deklaruar”	Kapitalit te Deklaruar per Fazen A te Punimeve te Ndertimit).
“Kushtet Paraprake per Shoqerine”	jane kushtet e percaktuara ne Piken 3.3 (Perpjekje te Arsyeshme per Permbushjen e Detyrimeve).
“Kontraktoret e Shoqerise”	eshte Personi i kontraktuar nga Shoqeria, ose Personi i nenkontraktuar prej Personit te kontraktuar nga Shoqeria, per pajisjen, ndertimin, administrimin ose zhvillimin e Terminalit Ekzistues, te Shtetit te Terminalit Ekzistues dhe Aktiveve Perkatese dhe Ndertesave te Reja Ndihmese.
“Rasti i Mospermbushjes nga Shoqeria”	ka kuptimin e dhene ne Piken 28.1 (Rastet e Mospermbushjes nga Shoqeria).
“Rasti Zgjidhjes se Kontrates nga Shoqeria”	ka kuptimin e dhene ne Piken 26.4 (Zgjidhja nga Shoqeria per Shkak te Rasteve te Vecanta te Mospermbushjes nga Qeveria).
“Garancia e Permbushjes se Detyrimeve nga Shoqeria”	ka kuptimin e dhene ne Piken 14.2 (Garancia e Permbushjes se Detyrimeve nga

	Shoqeria).
“Certifikate e Perfundimit“	eshte certifikata e leshuar nga Inxhinieri i Pavarur ose Inxhinieri i Kualifikuar, sipas rastit, ne perputhje me Piken 4.9 (Certifikata e Perfundimit) me permbushjen e cdo Detyrimi Kryesor dhe Detyrimi Shtese, sipas rastit, ne perputhje me kete Kontrate.
“Koncesion”	ka kuptimin e dhene ne Recitalin (B)
“Zone Koncesioni”	eshte zona, nje harte e se ciles tregohet ne Shtojcen 15 (Zona e Koncesionit), dhe qe tregon zonen qe mbulon Projekti, me perjashtim te Zones Ushtarake, Kompleksit te ANTA-s dhe kulles ekzistuese te kontrollit.
“Ligji i Koncesionit”	ka kuptimin e dhene ne Recitalin (A)
“Afati i Koncesionit”	ka kuptimin e dhene ne Piken 2.2 (a) (Afati).
“Shpronesim Konfiskues”	eshte cdo akt i Qeverise se Shqiperise ose nje Enti Shteteror pas Dates se Fillimit, qe i heq Shoqerise ndonje nder te drejtat qe ka sipas kesaj Kontrate.
“Kontrate e Lidhur”	

	eshte, ne cdo kohe dhe kohe pas kohe, cdo kontrate ose marreveshje e lidhur ndermjet, Shoqerise (ose cdo Personi te kontrolluar nga Shoqeria) nga njera ane, dhe, cdo Ortaku (pershi cdo Filial te ketij Ortaku) ose cdo ortaku te Personit te kontrolluar nga Shoqeria (perfshi cdo Filial te ketij Ortaku), nga ana tjeter.
“Personi i Lidhur”	eshte cdo pale ne nje Kontrate te Lidhur, pervec Shoqerise, dhe/ose cdo Person i kontrolluar nga Shoqeria.
“Punime Ndertimore”	jane punimet e ndertimit, qe duhet te kryhen nga Shoqeria sipas Shtojces 16 (Projekti Teknik i Miratuar) dhe Masterplanin e Perditesuar te Aeroportit, i ndryshuar kohe pas kohe ne perputhje me Piken 6.1(b) (Projekti Teknik i Miratuar dhe Masterplani i Perditesuar i Aeroportit).
“Konventat”	jane konventat dypaleshe nderkombetare dhe ato te Bashkimit Europian,

	protokollet dhe rregulloret e aeroportit, kontrollit te trafikut ajror, dhe industrive te shoqerive ajrore, te nenshkruara nga, ose qe prodhojne detyrime per Republiken e Shqiperise.
“Detyrimet Kryesore”	kane kuptimin e dhene ne Piken 4.3 (Detyrimet Kryesore te Shoqerise).
“Kosto e Kapitalit”	eshte norma e brendshme e planifikuar e kthimit te investimit te Kapitalit, e percaktuar 19 per qind ne vit.
“Keshilli i Ministrave”	ka kuptimin e dhene ne Recitalin (A).
“Kapaciteti Deklaruar i Pistes”	eshte aftesia per perdorimin e pistes se Aeroportit, perfshire rruget lidhese, gjate kohes qe Shoqeria e deklaron pisten te hapur per perdorim, e cila, per te shmangur dyshimet, nuk perfshin kohen e planifikuar ose te pa planifikuar te mirembajtjes ose te ndreqjes se pistes.
“Mospermbushje”	eshte mospermbushja e ndonje detyrimi sipas kesaj Kontrate, por jo

	per shkak te Forces Madhore e as ne Rastin e Clirimit nga Pergjegjesia.
“Konvertimi i DEG”	eshte konvertimi nga DEG i pjeseve te kapitalit te saj ne Shoqeri ne Hua te Nenrenditur ose pjese te ribleshme te kapitalit ne perputhje me piken 4.2 (o) (Detyrimet e Pergjithshme te Shoqerise) dhe me Marreveshjen Mbeshtetese te Ortakeve.
“Shoqeria e Perzgjedhur si Shoqeri Ajrore Kombetare”	eshte/jane shoqeria/te ajrore, qe perfiton/jne nga te drejtat e trafikut qe jepen sipas Ligjit te Zbatueshem dhe/ose kontratave dypaleshe ose shumepaleshe te lidhura nga Republika e Shqiperise.
“Zona e Zhvillimit”	eshte zona e shenuar ne ngjyre te verdhe ne harten e treguar ne Shtojcen 56 (Zona e Kufizuar dhe Zona e Zhvillimit) ne perputhje me vendimin e Keshillit Kombetar te Rregullimit te Territorit te Republikes se Shqiperise te dates 15 Korrik

	2004.
“Fitimi i Shperndashem”	eshte shuma maksimale qe Shoqeria ka ligjerisht te drejte, sipas Ligjit te Zbatueshem, ta deklaroje si dividend per Ortaket e saj ne kohen perkatese, duke marre parasysh fitimet, humbjet dhe rezervat e Shoqerise. Per sqarim, qenia e Fitimit te Shperndashem te Shoqerise nuk e detyron Shoqerine te shperndaje dividendet ose Pjeset e Fitimit te Kapitalit ne kundershtim me Dokumentet e Financimit ose Ligjin e Zbatueshem.
“DM”	eshte monedha e ligjshme e Republikes Federale te Gjermanise deri me 31 Dhjetor 2001.
“Data Efektive”	eshte data e ratifikimit nga Kuvendi i Republikes se Shqiperise i Ligjit Per Koncesionin e Aerportit, perfshire botimin e Ligjit te Koncesionit te Aeroportit ne Fletoren Zyrtare perkates te Republikes se Shqiperise.

“Ndryshim i Ligjshem”	eshte e drejta e Qeverise se Shqiperise t’i kerkoje Shoqerise te kryeje punime dhe sherbime shtese, ne lidhje me Koncesionin, te cilat dalin jashte qellimit te Koncesionit, me kusht qe ky ndryshim te mos kerkoje shpenzime mbi 25.000 Euro ne cdo vit gjate Afatit te Koncesionit.
“Rregullore e Mjedisit”	jane rregulloret e mjedisit dhe standardet ne fuqi qe nga data e kesaj Kontrate ne Republiken e Shqiperise, duke perfshire cdo Standard te treguar ne Shtojcen 17 (Kodet, Standardet, Rregulloret dhe Publikime te tjera) dhe Shtojcen 42 (Administrimi Mjedisor).
“Kapital”	eshte cdo klase aksionesh te nenshkruara dhe te shlyera, dhe/ose Huaja e Nenrenditur e dhene shoqerise nga Ortaket. Per te shmangur dyshimet, ne rolin e tij si dhenes i Huas Kryesore, cdo Aksioner do te trajtohet si nje Huadhenes Kryesor.

“Euro” ose “EUR”	eshte monedha e ligjshme e shteteve anetare te Bashkimit Evropian qe kane monedhe te vetme ne perputhje me Traktatin e themelimit te Komunitetit Evropian, i ndryshuar nga Traktati i Bashkimit Evropian.
“Eurozona”	jane, te marra se bashku, vendet e Bashkimit Evropian ne te cilat Euro eshte monedha e ligjshme.
“Masterplani Ekzistues i Aeroportit”	eshte masterplani i Aeroportit i pergatitur nga Spiekermann GmbH & Co. ne Qershor 2000 dhe i miratuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 475, date 17 Gusht 2000.
“Aktivet Ekzistuese”	jane aktivet e paluajtshme dhe te luajtshme te Aeroportit “Nene Tereza” Sh.A., ekzistuese ne Daten e Fillimit, ku keto aktive jane: (i) audituar nga nje auditor i kualifikuar perpara Dates se Fillimit, (ii) listuar ne nje liste inventari qe do te nenshkruhet nga Palet perpara ose ne Daten e Fillimit, dhe (iii)

	transferuar Shoqerise ne Daten e Fillimit, ne perputhje me procedurat e miratuara nga Palet para Dates se Fillimit.
“Ndertimet Ekzistuese”	jane Aktivet Ekzistuese, Terminali Ekzistues, Sheshi i Terminalit Ekzistues dhe Aktivet Perkatese dhe, sipas rastit, Ndertimet e Reja ne Zonen e Koncesionit (me perjashtim te Zones Ushtarake, Kompleksit te ANTA dhe Kulles ekzistuese te Kontrollit).
“Terminali Ekzistues”	eshte ndertesa ekzistuese e terminalit te pasagjereve ne Aeroport. Per te shmangur dyshimet, referimi qe i behet “Terminalit Ekzistues” perfshin referimin “Terminalit Ekzistues te Ripajisur”, sipas rastit.
“Sheshi i Terminalit Ekzistues”	eshte teresia e shesheve dhe pronat, ku ndodhet Terminali Ekzistues dhe cdo toke dhe te drejta ose menyra ose te drejta te tjera ne lidhje me Terminalin Ekzistues, te cilat jane te nevojshme per operimin dhe

	mirembajtjen e Terminalit Ekzistues nga Shoqeria.
“Mbyllje Financiare”	eshte data ne te cilen (i) hyjne ne fuqi Dokumentet e Financimi, dhe (ii) Shoqeria ka te drejten e financimit te menjehershem ne baze te ketyre Dokumenteve te Financimit.
“Dokumente Financimi”	jane kontratat e huas ose cdo dokument qe lidhet me to, te lidhur ndermjet Shoqerise dhe Huadhenesit, me qellim kryerjen e financimit te kerkuar ose rifinancimit te Projektit dhe qe perfshin cdo garanci, demshperblim ose kontrata te tjera te ngjashme qe do te lidhen nga Shoqeria me cdo Person ne lidhje me keto kontrata .
“Vit Financiar”	eshte periudha qe fillon cdo vit nga 1 Janari dhe qe perfundon ne 31 Dhjetorin vijues.
”Force Madhore”	eshte ndodhja e ndonje rasti ose rasteve qe kane efektin e pershkruar ne Piken 24.1 (Rastet e Forces Madhore) dhe “Rasti i Forces Madhore“ ka kuptimin e dhene

	ne Piken 24.1(b).
”Shoqeri Karburantesh”	eshte cdo shoqeri karburanti e krijuar dhe qe funksionon sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise.
“DPAC”	eshte autoriteti i aviacionit civil te Republikes se Shqiperise, i organizuar si Drejtoria e Pergjithshme e Aviacionit Civil dhe, e themeluar ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem, dhe qe ka autoritetin dhe pergjegjesite e pershkruara ne Ligjin e Zbatueshem, ose cdo pasardhes i saj.
“Parimet e Pergjithshme te Pranuara te Kontabilitetit”	jane, se bashku, Parimet e Pergjithshme te Pranuara te Kontabilitetit Shqiptar dhe Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiare.
“Praktika e Mire e Industrise”	jane standardet e treguara ne Shtojcen 17 (Kodet, Standardet, Rregulloret dhe Publikime te tjera) dhe, per ceshtjet e pa mbuluara nga kjo Shtojce, praktikat, metodat, standardet dhe procedurat konform Ligjit te

	Zbatueshem dhe qe ndiqen ne pergjithesi ne transportin ajror dhe ne industrine e manaxhimit te aeroportit ne lidhje me projektimin, ndertimin, operimin dhe mirembajtjen e aeroporteve, te cilat mund te priten ne menyre te aresyeshme nga nje operator i afte dhe me eksperience aeroportesh ne rrethana te njejta ose te ngjashme.
“Kontraktor i Qeverise”	eshte Personi i kontraktuar nga Qeveria e Shqiperise ose nje Ent Shteteror, ose Personi i nenkontraktuar nga Personi i kontraktuar nga Qeveria e Shqiperise ose nje Ent Shteteror, per cdo lloj veprimtarie brenda Zones se Koncesionit.
“Qeveria e Shqiperise”	eshte keshilli i Ministrave i Republikes se Shqiperise sipas Ligjit te Zbatueshem
“Kushtet Paraprake per Qeverine e Shqiperise”	jane kushtet e pershkruara ne Piken 3.3 (Perpjekjet e Arsyeshme per Permbushjen e Detyrimeve).
“Rast i	ka kuptimin e

Mospermbushjes nga Qeveria e Shqiperise”	pershkruar ne Piken 28.3 (Rasti i Mospermbushjes nga Qeveria e Shqiperise).
“Rasti i Zgjidhjes se Kontrates nga Qeveria e Shqiperise per Mospermbushje nga Shoqeria”	ka kuptimin e pershkruar ne Piken 26.3, (Zgjidhja s nga Qeveria e Shqiperise per Rastet e Vecanta te Mospermbushjes nga Shoqeria).
“Sherbimet e Dhena nga Qeveria”	jane sherbimet e dhena nga Qeveria e Shqiperise gjate Afatit te Koncesionit sic tregohet ne Shtojcen 34 (Sherbimet e Dhena nga Qeveria).
“Pagesat per Sherbimin e Perpunimit ne Toke”	jane pagesat per sherbimin e perpunimit ne toke qe tregohen ne Shtojcen 7 (Pagesat per Sherbimet e Aeroportit).
“Levizja ne toke dhe Sherbimet qe Lidhen me te”	jane sherbimet e zakonshme qe u behen avioneve (ne levizje ose jo), pasagjereve, bagazheve dhe mallrave ne toke ose ne lidhje me pasagjeret e ketyre avioneve ne aeroportet civile ne Evrope.
“Data e Dorezimit”	eshte data e mbarimit te Afatit te Koncesionit ose data e marrjes se

	Njoftimit per Zgjidhje, te derguar rregullisht.
“ICAO”	eshte Organizata Nderkombetare e Aviacionit Civil, e krijuar nga Konventa e Cikagos ose cdo pasardhes i saj.
“Rregullat e Arbitrazhit te ICC”	jane rregullat e arbitrazhit te Dhomes Nderkombetare te Tregtise, te ndryshuara hera heres.
“Afati i Zbatimit”	eshte afati i percaktuar ne Shtojcen 6 (Sanksionet per Mospermbushje te Detyrimeve Shtese), ne kolonen e titulluar “Afati i Zbatimit” dhe rreshtin qe lidhet me detyrimin perkates.
“Inxhinier i Pavarur”	ka kuptimin qe i eshte dhene ne Piken 6.3(f) (Ndertimi).
“Shqyrtimi i Pavarur”	ka kuptimin qe i eshte dhene ne Piken 19.4(a) (Shqyrtimi i Pavarur Ekonomik).
“Komiteti i Pavarur i Rishikimit”	ka kuptimin qe i eshte dhene ne Piken 9.1 (Anetaret).
“Hua Kryesore Fillestare”	eshte huaja kryesore e Shoqerise, e cila eshte marre persiper nga Huadhenesi ne

	daten e Mbylljes Financiare.
“Hua Fillestare e Nenrenditur”	eshte Huaja e Nenrenditur e Shoqerise, e cila eshte marre persiper nga Huadhenesi ne daten e Mbylljes Financiare.
“Rasti i Paaftesise Paguese”	eshte, ne lidhje me nje Person, njera nga ngjarjet e meposhtme: (i)paraqitja ne gjykate nga ky Person e kerkeses per caktimin e nje administratori, per vete ose per nje pjese te rendesishme te pasurise se tij. (ii)fillimi nga ky Person i ndonje procedure gjyqesore ose ligjore per shkak te mungeses se likuiditeteve ose mbingarkeses me hua ne kuadrin e ristrukturimit te huas, prishjeje ose likuidimi ose ligji falimentimi ose procedurave te ngjashme te cdo juridiksioni, perfshire pa kufizim, Republiken e Shqiperise; (iii) nxjerrja e nje dekreti ose urdheri, qe e shpall kete Person te falimentuar ose ne gjendje paaftesie paguese;

	ose (iv)fillimi kunder ketij Personi i procedurave gjyqesore ose ligjore te percaktuara ne paragrafin (iii) me siper, qe vazhdojne pa u pushuar per (60) dite.
“Te drejtat e Pronesise Intelektuale”	jane te gjitha patentat, te drejtat e projektimit, te drejtat e autorit, markat tregtare, markat e sherbimit, emrat tregtare dhe te gjitha te drejtat e tjera te pronesise intelektuale te cdo natyre ne te gjithe boten te regjistruara ose jo dhe ku perfshihen te gjitha kerkesat dhe te drejtat per te kerkuar per secilen prej tyre.
“Standardet Nderkombetare te Raportimit Financiar” ose “IFRS”	jane standardet e kontabilitetit dhe te raportimit financiar, te percaktuara here pas here nga Bordi i Standardeve Nderkombetare te Kontabilitetit .
“Pagesa e Koncesionit”	eshte shuma qe i paguhet Qeverise se Shqiperise nga Shoqeria ne perputhje me Piken 20(c) (Pagesat per Qeverine e Shqiperise).
“Pagesa e Uljes dhe Ngritjes”	eshte Pagesa e

	Uljes dhe e Ngritjes te treguara ne Shtojcen 7 (Pagesat per sherbimet e Aeroportit).
“Lek”	eshte monedha e ligjshme ne Republiken e Shqiperise.
“Huadhenes(it)”	eshte huadhenesi ose huadhenesit, perfshire Huadhenesin(t) Kryesore, sipas Dokumenteve te Financimit ose sipas cdo kontrate per rifinancimin e huas se dhene Shoqerise sipas Dokumenteve te Financimit, huadhenes ose huadhenesit te cilet mund te jene ose Huadhenesi Kryesor ose Huadhenesi i Nenrenditur.
“Huaja e KfW”	eshte kontrata e huas, date 11 Maj 1996, lidhur nga Republika e Shqiperise (si huamarres), Albtransport Sh.A. (si nenhuamarres dhe paraardhesi ligjor i Aeroportit “Nene Tereza” Sh.A.) dhe Kreditanstalt fur Wiederaufbau, ne shumen 48 milione DM, me qellim kryerjen e disa punimeve rikonstruktuese ne Aeroport dhe

	pagesen e kostove te kembimit te monedhes.
“Ndryshim Thelbesor me Pasoja te Renda”	eshte, ne lidhje me nje Person:
	(i) nje ndryshim thelbesor me pasoja te renda ne kushtet (financiare ose te tjera), biznesin, veprimet ose aktivet e Personit perkates, ose
	(ii) nje ndryshim thelbesor me pasoja te renda ne aftesine e Personit perkates per te permbushur ndonje nga detyrimet e tij sipas kesaj Kontrate ose cdo kontrate tjeter, qe lidhet me Koncesionin, ne te cilen ai eshte pale,
	dhe nese Personi eshte Shoqeria, atehere vendimi nese ka ndodhur ose mund te ndodhe Ndryshim Thelbesor me Pasoja te Renda, duhet te merret ne lidhje me vete Shoqerine dhe Shoqerine bashke me Filialet e saj, duke i marre si nje ndermarrje e vetme.
	Per te shmagur dyshimet, ndryshimet jodiskriminuese

	ne Ligj nuk jane Ndryshime Thelbesore me Pasoja te Renda.
“Shkelje Thelbesore”	ka kuptimin e dhene ne Piken 28.5 (Shkeljet Thelbesore).
“Zone Ushtarake”	eshte zona ose zonat e shenuara si “Zone Ushtarake” ne vizatimin nr. A-001/Rev02 dhe B/001-Rev02 ne Shtojcen 16 (Projekti Teknik i Miratuar).
“Veprime Ushtarake”	eshte cdo veprimtari e kryer nga forcat ajrore te Republikes se Shqiperise ose te ndonje vendi tjeter me ftese te Republikes se Shqiperise, veprimtari qe mund te kryhet ne Zonen e Koncesionit ose jashte saj (por qe shkakton kufizimin e veprimtarise se aviacionit civil ne Aeroport).
“Ndertimet Ushtarake”	eshte cdo instalim ose pajisje, e cila eshte prone ose nen kontrollin e forcave ajrore te Republikes se Shqiperise ose te forcave ajrore te nje vendi tjeter, instalime ose pajisje te cilat ndodhen ne Zonen e Koncesionit.
“Hipoteke”	ka kuptimin e percaktuar ne

	Ligjin e Zbatueshem.
“Aeroporti Nene Tereza Sh.A.”	eshte shoqeri anonime e krijuar dhe qe vepron sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, ne pronesi te plote te Republikes se Shqiperise, e quajtur me pare Albtransport Sh.A.
“Rruga e Re Lidhese”	eshte rruga qe do te projektohet, ndertohet, dhe vihet ne pune nga Shoqeria ne perputhje me kerkesat e treguara ne Shtojcen 32 (Rruga e Re Lidhese).
“Ndertimet Shtese”	jane, se bashku, Rruga e Re Lidhese dhe Ura e Re.
“Zyrat e Reja te Administrates”	jane zyrat e administrates qe do te ndodhen ne “Terminalin Ekzistues te Pajisur” te ndertuara, te perdorura dhe te mirembajtura nga Shoqeria ne perputhje me kerkesat e treguara ne Shtojcen 21(Terminali Ekzistues) dhe Shtojcen 19 (Faza A e Terminalit te Ri).
“Qendra e Re e Kargos Ajrore”	eshte qendra e re e kargos ajrore, qe do te projektohet, ndertohet, vihet

	ne pune, perdoret dhe mirembahet nga Shoqeria ne perputhje me kerkesat e treguara ne Shtojcen 21 (Terminali Ekzistues) dhe Shtojcen 19 (Faza A e Terminalit te Ri).
“Ura e Re”	eshte ura e re ne Rrugen Lidhese ekzistuese te Aeroportit, qe do te projektohet, ndertohet dhe vihet ne pune nga Shoqeria ne perputhje me kerkesat e treguara ne Shtojcen 27 (Rruga Hyrese e Aeroportit, Rruga Qarkulluese e Aeroportit dhe Faza A e Parkimeve te Automjeteve).
“Ndertimet e Reja”	jane, se bashku, Zyrat e Reja te Administrates Qendren e Re te Kargos Ajrore, Ndertimet e Reja te Karburantit dhe Terminali i Ri.
“Impianti i Ri i Karburantit”	jane ndertimet e reja ndihmese te karburantit, qe do te projektohen, ndertohen, perdoren dhe mirembahen nga Shoqeria ose do t’i jepen me nenkontrate nga Shoqeria nje pale te trete, ne perputhje me kerkesat e

	treguara ne Shtojcen 48 (Impianti i Ri i Karburantit).
“Terminali i Ri”	eshte terminali i ri qe do te projektohet, ndertohet, perdoret dhe mirembahet nga Shoqeria ne perputhje me kerkesat e treguara ne Shtojcen 19 (Faza A e Terminalit te Ri) dhe Shtojcen 30 (Faza B e Terminalit te Ri dhe Faza B e Parkimeve te Automjeteve).
“Data e Kerkimit te Detyrimit”	ka kuptimin qe i jepet ne Shtojcen 5 (Sanksionet per Mospermbushjen e Detyrimeve Kryesore), per secilin Detyrim Kryesor.
“Zaptimi”	eshte banimi ose cdo lloj tjeter zaptimi ose posedimi i pasurive te paluajtshme ose te luajtshme nga palet e treta (perfshire, pa kufizim, pronaret e meparshem) ne Zonen e Koncesionit, i cili (a) eshte ne kundershtim me Ligjin e Zbatueshem, dhe (b) cenon ushtrimin e te drejtave te Shoqerise sipas kesaj Kontrate.

“Mjediset e Operimit”	jane pajisjet dhe instalimet per operimin e Aeroportit sipas listes se Shtojces 20 (Mjediset e Operimit per Terminalin e Ri).
“Manual Operimi”	eshte dokumenti i pergatitur nga Shoqeria pas Dates se Fillimit qe zevendeson Manualin Operues ekzistues te dhene, por pa u kufizuar ne, informacionin e pershkruar ne Shtojcen 38 (Manuali Operues i Aerodromit).
“ Aksione te Zakonshme”	jane aksionet e zakonshme ose pjeset e kapitalit, sipas rastit, te Shoqerise.
“Pagesat per Sherbimet e Pasagjerit”	jane pagesat per sherbimet e pasagjerit te treguara ne Shtojcen 7 (Pagesat per Sherbimet e Aeroportit).
“Person”	eshte cdo individ, shoqeri, ndermarrje, partneritet, shoqeri e perbashket, shoqate, organizate, trust, shtet, Qeveria e Shqiperise, cdo Ent Shteteror ose cdo agjenci, autoritet, banke qendrore, departament, legjislature,
“Faza A e Parkimeve te Automjeteve”	

	minister, ministri, person zyrtar, publik ose ligjor (i pavarur ose jo) i cdo shteti (ne cdo rast, me ose pa personalitet juridik te vecante).
	ka kuptimin e dhene ne Shtojcen 27 (Rruga Lidhese e Aeroportit, Rruga Qarkulluese e Aeroportit dhe Faza A e Parkimeve te Automjeteve).
“Faza A e Punimeve te Ndertimit”	jane, se bashku, Faza A e Terminalit te Ri, Faza A e Parkimeve te Automjeteve, Faza A e Qendres se Re te Kargos Ajrore, Rruga e Re Lidhese dhe Ura e Re.
“Faza A e Qendres se Re te Kargos Ajrore”	ka kuptimin e dhene ne Shtojcen 22 (Faza A e Qendres se Re te Kargos Ajrore).
“Faza A e Terminalit te Ri”	ka kuptimin e dhene ne Shtojcen 19 (Faza A e Terminalit te Ri). Per te shmangur dyshimet, pas Dates se Hapjes se Terminalit te Ri, Faza A e Terminalit te Ri do te operohet nga Shoqeria ne perputhje me Standardet e realizimit te treguara ne Shtojcen 36

	(Kriteret e Permbushjes).
“Data se Hapjes se Fazes A te Terminalit te Ri”	eshte data ne te cilen Faza A e Terminalit te Ri eshte e hapur per perdorim nga pasagjeret me te gjitha Mjediset e Operimit, duke qene ne dispozicion dhe operative, ne perputhje me kete Kontrate dhe Standardet e Zbatueshme.
“Faza B e Parkimeve te Automjeteve”	ka kuptimin e dhene ne Shtojcen 30 (Faza B e Terminalit te Ri dhe Faza B e Parkimeve te Automjeteve).
“Faza B e Qendres se Re te Kargos Ajrore”	ka kuptimin e dhene ne Shtojcen 31 (Faza B e Qendres se Re te Kargos Ajrore).
“Faza B e Terminalit te Ri”	ka kuptimin e dhene ne Shtojcen 30 (Faza B e Terminalit te Ri dhe Faza B e Parkimeve te Automjeteve).
“Dates se Hapjes se Fazes B te Terminalit te Ri” Terminalit te Ri”	eshte data ne te cilen Faza B e Terminalit te Ri duke perfshire Fazen A te Terminalit te Ri) eshte e hapur per perdorim nga pasagjeret me te gjitha Mjediset e Operimit, ne gjendje pune dhe operative, sipas kesaj Kontrate dhe Standardeve

	te Zbatueshme.
“Master Plani Paraprak i Perditesuar i Aeroportit”	eshte Master Plani Paraprak i Perditesuar i Aeroportit, i pergatitur nga Shoqeria, qe i eshte dorezuar dhe miratuar ne perputhje me vendimin e Keshillit Kombetar te Rregullimit te Territorit te Republikes se Shqiperise, date 15 Korrik 2004 perpara nenshkrimit te kesaj Kontrate.
“Huadhenesi(t) Primar“	eshte Huadhenesi i pezgjedhur si Huadhenes Primar ne marreveshjen qe do te lidhet ndermjet, nder te tjera, Huadhenesit Primare dhe Shoqerise, identiteti i te cilit do t’i njoftohet Qeverise se Shqiperise ose Organit Shteteror te Autorizuar (cili eshte me pershtatshem) nga Shoqeria menjehere me nenshkrimin e nje marreveshjeje te tille. Per te shmangur dyshimin, Banka Evropiane per Rindertim dhe Zhvillim do te trajtohet si Huadhenesi Primarr.
“Shumat e Huas	jane shumat qe do t’i paguhen

Fillestare”	Organit Shteteror te Autorizuar nga Shoqeria, gradualisht, si principal dhe interes sipas Huas se KfW, ne perputhje me Shtojcen 4 (Pagesat per Qeverine e Shqiperise - Shumat e Huas Fillestare).
“Projekt”	eshte projektimi, financimi, ndertimi, venia ne pune, mirembajtja, operimi, administrimi dhe zhvillimi i Aeroportit, qe perfshin, nder te tjera, (i) pronesine mbi Ndertimet e Reja nga Shoqeria dhe gezimin dhe ushtrimin nga Shoqeria te Uzufruktit ne lidhje me Zonen e Koncesionit, Terminalin Ekzistues, Sheshin e Terminalit Ekzistues dhe Aktivet Perkatese dhe Ndertimet e tjera, te cilat nuk mund te kalojne ne pronesi te Shoqerise, (ii) projektimi, ndertimi dhe instalimi i Mjediseve te Reja dhe Mjediseve te Reja Shtese, (iii) pajisja dhe mirembajtja e Terminalit

	Ekzistues, Sheshit te Terminalit Ekzistues dhe Aktiveve Perkatese, Mjediseve te Reja dhe Zones se Koncesionit, (iv) transferimi i te gjitha te drejtave te zbatueshme ne lidhje me Ndertimet e Reja tek Qeveria e Shqiperise ose tek ndonje Ent i percaktuar nga Organi Shteteror i Autorizuar me mbarimin ose zgjidhjen e Afatit te Koncesionit, (v) lidhja e kontratave me pale te treta, dhe (vi) faturimi dhe arketimi i pagesave nga palet e treta per llogari te pagesave per sherbimet te Aeroportit si edhe te Pagesave per Sherbimete tjera te zbatueshme ne baze te kesaj Kontrate, Ligjit te Zbatueshem ose Konventave.
“Njesia e Zbatimit te Projektit”	eshte organi, qe do te krijohet nga Organi Shteteror i Autorizuar sipas Ligjit te Zbatueshem dhe kesaj Kontrate, i cili do te kete jo me shume se kater anetare dy prej te cileve nga D.P.A.C. –ja, dhe qe do te jete

	pergjegjes per mbikeqyrjen e Koncesionit, me ndihmen e Inxhinierit te Pavarur (sic eshte percaktuar me tej ne Shtojcen 8 (Inxhinieri i Pavarur) ose te nje specialisti teknik tjeter, sipas rastit.
“Inxhinier i Kualifikuar”	eshte nje inxhinier profesionist i kualifikuar me nje pervoje nderkombetare bashkekohore ne industrine e aeroportit, i emeruar nga Organi Shteteror i Autorizuar (emerim ky qe kerkon miratimin e Shoqerise, i cili nuk do te mbahet pezull dhe nuk do te vonohet pa shkak) per monitorimin e permbushjes se Detyrimeve Shtese nga Shoqeria.
“Date Tre Mujore”	eshte cdo 1 Janar, 1 Prill, 1 Korrik dhe 1 Tetor.
“Terminali Ekzistues i Riperteritur”	eshte Terminali Ekzistues qe do te modernizohet nga Shoqeria ne perputhje me Shtojcen 21 (Terminali Ekzistues).
“Aktivet Perkatese”	eshte, ne lidhje me Terminalin Ekzistues, cdo aktiv i luajtshem, dhe i paluajtshem,

	qe jane ne pronesi te Qeverise se Shqiperise ose te ndonje Organi Shteteror ne Daten e Fillimit ose perpara saj.
“Rast i Clirimit nga Pergjegjesia”	eshte nje nga ngjarjet e meposhteme: (i) Rast i Forces Madhore, ku Shoqeria ka te drejte te marre vendim sipas Pikes 23(b) (Rastet e Clirimit nga Pergjegjesia), (ii)sulm terrorist (qe nuk klasifikohet si Rast i Forces Madhore); dhe (iii)shperthim i ndonje semundjeje ngjitese, e shpallur si e tille nga Organizata e Boterore e Shendetesise (qe nuk klasifikohet si Rast i Forces Madhore); me kusht qe nje ngjarje e tille te sjelle drejtperdrejt pakesim te trafikut te pasagjereve ne Aeroport (e matur mbi bazen e tre mujorit, ku secila mbaron ne Daten e Tremujorit, sipas rastit) ne me shume se 5% krahasuar me mesataren e tremujoreve korrespondues ne nje periudhe prej

	dy (2) vjetesh qe i paraprijne ndodhjes se ngjarjes.
“Zone e Kufizuar”	eshte zona e tokes e nenvizuar me blu ne planin e Shtojces 56 (Zona e Kufizuar dhe Zona e Zhvillimit) ne perputhje me vendimin e Keshillit te Rregullimit te Territorit te Republikes se Shqiperise, date 15 Korrik 2004, e cila eshte objekt i kufizimeve te pengesave ajrore dhe e perdorimit te percaktuar ne Piken 6.4 (Zona e Kufizuar dhe Zona e Zhvillimit).
“Shpronesimi i Kerkuar i Tokes”	eshte shpronesimi nga Qeveria e Shqiperise ne kohen e perkatese, por perpara fillimit te punimeve perkatese te ndertimit, te tokes se kerkuar per Rrugen e Re Lidhese, Uren e Re, Zgjatimi i Pistes dhe Zonen e Koncesionit sic tregohet ne Shtojcen 15 (Zona e Koncesionit).
“Zgjatimi i Pistes”	ka kuptimin e dhene ne Piken 4.8 (Zgjatimi i Pistes) dhe Shtojcen 23 (Infrastruktura nga ana e

	Aerodromi)
“Propozimi i Zgjatimit te Pistes”	eshte propozimi per Zgjatimin e Pistes, qe do te pergatitet nga Shoqeria me marrjen e Kerkeses per Zgjatimin e Pistes.
“Kerkese per Zgjatimin e Pistes”	eshte kerkesa per zgjerimin e pistes qe i dorezohet Shoqerise, sic percaktohet me tej ne Piken 4.8 (Zgjatimi i Pistes), kerkese e cila, nder te tjera, do te perfshije percaktimin e avionit te ri qe do te hyje, rruget dhe destinacionet, frekuencat dhe parashikimin per pasagjeret dhe ngarkesen e kargos te pershkruara ne nje plan biznesi minimumi pese (5) vjecar dhe te mbeshtetur financiarisht.
“Marreveshje Schengen”	eshte marreveshja per kontrollin e kufijve, e lidhur nga disa shtete anetare te Bashkimit Evropian ne Schengen, Luksemburg, me 14 Qershor 1985, sic u perfshi me vone ne Traktatin e Amsterdamit te Bashkimit Evropian (qe hyri ne fuqi ne 1 maj 1999).

“Barre Siguruese”	eshte cdo Hipoteke, peng, barre, privilegj, perparesi, hipotekim, barresim, percaktim, bashkengjitje, kompensim ose barre te tjera siguruese te cdo lloji ose cdo kontrate ose rregullim tjeter, qe ka fuqi te jape garanci mbi ose ne lidhje me, ose cdo ndarje ose rregullim tjeter preferencial lidhur me, cdo aktiv te tashem ose te ardhshem te ardhura ose te drejta, perfshire, por pa u kufizuar, cdo percaktim humbjeje te paguesve ose perfituesve ose cdo rregullim tjeter i ngjashem sipas ndonje police sigurimi.
“Hua Kryesore”	eshte huaja e renditur kryesore e Shoqerise (qe perfshin, por pa u kufizuar ne, huan e renditur kryesore te dhene Shoqerise nga Ortaket), hua e renditur kryesore, qe nuk mund t’i jepet Shoqerise eksluzivisht nga Ortaket. Per te shmangur dyshimet, ne rolin e tij si dhenes i Huas Kryesore, cdo Ortak do te

	trajtohet si Huadhenes Kryesor”.
“Sherbimi i Huas Kryesore”	eshte cdo shume e pagueshme Huadhenesit Kryesor ne lidhje me principalin, interesin ose taksat mbi Huan Kryesore te Certifikuar te Shoqerise sipas Dokumenteve te Financimit.
“Huadhenesi Kryesor”	eshte cdo dhenes i Huas Kryesore tek Shoqeria sipas Dokumenteve te Financimit, qe perfshijne, por pa u kufizuar, Huadhenesin(t) Primar.
“Sherbime”	jane te gjitha sherbimet ne Zonen e Koncesionit, sic jane pershkruar me tej ne Shtojcen 36 (Kriteret e Permbushjes) dhe Shtojcen 37 (Administrimi Operacional pas Perfundimit te Fazes A te Terminalit te Ri).
“Ortak”	eshte cdo Person qe, ne baze te Ligjit te Zbatueshem, prezumohet i ortak i Shoqerise, dhe qe ka kufizimet te treguara ne Piken 4.1(g)(i) dhe (ii) (Te Drejtat e Shoqerise).

“Marreveshja Mbeshtetese e Ortakeve”	eshte Marreveshja e lidhur midis HTA, AAEF, Shoqerise dhe Qeverise se Shqiperise ne daten e nenshkrimit te Kontrates, me ane te se ciles HTA dhe AAEF marrin persiper nje sere detyrimesh ne lidhje me Shoqerine, Koncesionin, dhe kete Kontrate.
“Garanca e Transhit te Huas Shteterore”	eshte Garancia e Transhit te Huas Shteterore qe do t’i jepet Bankes Evropiane per Rindertim dhe Zhvillim nga Qeveria e Shqiperise ne baze te kushteve dhe afateve te Marreveshjes se Garancise se Transhit te Huas Shteterore.
“Marreveshje e Garancise se Transhit te Huas Shteterore”	eshte marreveshja e garancise se Transhit te Huas Shteterore qe do te lidhet ndermjet Qeverise se Shqiperise, si garantues, dhe Bankes Evropiane per Rindertim dhe Zhvillim, si perfitues, sipas se ciles Qeveria e Shqiperise merr persiper te garantoje permbushjen e detyrimeve te Shoqerise ne Marreveshjen e Transhit te Huas

	Shteterore, marreveshje e cila eshte ne nje forme dhe permbajtje te kenaqshme per Qeverine e Shqiperise.
“Transhi i Huas Shteterore”	eshte ai Transh i Huas qe do t’i jepet Shoqerise nga Banka Evropiane per Rindertim dhe Zhvillim ne baze te kushteve dhe afateve te Marreveshjes se Transhit te Huas Shteterore.
“Marreveshje e Transhit te Huas Shteterore”	eshte ajo pjese e marreveshjes se huas qe do te lidhet ndermjet Shoqerise, si huamarres, dhe Bankes Evropiane per Rindertim dhe Zhvillim, si huadhenes, ne baze te se ciles Banka Evropiane per Rindertim dhe Zhvillim bie dakord t’i jape Shoqerise nje hua ne shumen prej (9) nente milione Euro ne baze te garancise se vetme te Garancise te Transhit te Huas Shteterore dhe Shoqeria eshte dakord te marre persiper detyrimet e percaktuara ne kete marreveshje huaje (ne forme dhe permbajtje te pranueshme nga Qeveria e Shqiperise).

„Pagesa e Garancise se Transhit te Huas Shteterore“	ka kuptimin qe i jepet ne piken 20 (d)
“E Drejta per Kompensim te Vecante”	eshte e drejta e Shoqerise, gjate periudhave te ndertimit te Fazes A te Terminalit te Ri, Fazes B te Terminalit te Ri, te cdo zgjatimi te Pistes dhe Rruges se Re Lidhese (sic jane vendosur keto periudha ndertimi ne kete Kontrate) per te kompensuar shumat e Taksave te Mbledhura perkundrejt Rimbursimit te Pershpejtuar te TVSH nga autoritetet perkatese tatimore ne rast te ndonje vonese ne pagimin e cdo Rimbursimi te Pershpejtuar te TVSH pas dates se duhur, por vetem ne shumen e Rimbursimit te Pershpejtuar te TVSH.
“Standarde”	jane rregulloret dhe/ose standardet (perfshire, por pa u kufizuar, cdo praktike te rekomanduar dhe/ose procedure te perfshire, qe eshte pjese e kesaj rregulloreje dhe/ose standardeve) here pas here te zbatueshme ne

	lidhje me ndonje aspekt te Koncesionit, sic percaktohet me hollesisht ne Shtojcen 17 (Kodet, Standardet, Rregulloret dhe Publikime te tjera).
“Organ Shteteror”	eshte cdo ministri, departament, autoritet administrativ, civil ose ushtarak i Qeverise se Shqiperise ose ndarje administrative te Qeverise se Shqiperise, qe perfshin, pa kufizim, Organin Shteteror te Autorizuar dhe cdo organ te qeverisjes vendore dhe cdo shoqeri, organizate publike ose ndonje ent tjeter ne pronesi te ose qe kontrollohet direkt ose terthorazi, ose qe vepron per llogari ose ne favor te nje ose me shume agjencive te Qeverise se Shqiperise.
“Investitor Strategjik”	eshte HTA ose cdo Person tjeter (sic mund te bjere dakord kohe pas kohe Organi Shteteror i Autorizuar), i cili ploteson kerkesat e treguara ne

	Shtojcen 12 (Investitori Strategjik).
“Hua e Nenrenditur”	eshte cdo detyrim huaje i Shoqerise, pervec Huas Kryesore.
“Sherbime te Huas se Nenrenditur”	eshte cdo shume e pagueshme Huadhenesit te Nenrenditur per principalin, interesin ose komisionet e Huas se Nenrenditur te Certifikuar te Shoqerise sipas Dokumenteve te Financimit.
“Huadhenes i Nenrenditur”	eshte cdo Huadhenes i Shoqerise, pervec Huadhenesit Kryesor, qe perfshin cdo ish-Ortak pas kryerjes se konvertimit apo shkembimit ne Hua te Nenrenditur te pjeseve te tij te kapitalit ne Shoqeri ne Hua.
“Subjektet Zevendesues”	ka kuptimin qe i jepet ne Piken 32.2 (Zevendesimi nga Qeveria e Shqiperise).
“Tatimi”	eshte cdo lloj tatimi, i tashem ose i ardhshem, detyrimi, taksa, norma, ulje, detyrime, hua te detyrueshme dhe mbajtje ne burim te cfaredo lloji (sido qe te quhen), te vendosura, te vleresuara ose te vena nga cfaredo

	Enti Shteteror, duke perfshire sanksionett dhe kamatat ne lidhje me to.
“Njoftimi per Zgjidhjen e Kontrates”	eshte njoftimi me shkrim i dhene sipas kesaj Kontrate, qe zgjidh kete Marreveshje, i cili permban te pakten shkakun e zgjidhjes.
“Transhi 1 i Shlyerjes se Kapitalit te Deklaruar”	eshte Kapitali qe Shoqeria nenshkruan dhe shlyen ne Daten e Fillimit, sic percaktohet ne Shtojcen 2 (Shlyerja e Kapitalit te Deklaruar per Fazen A te Punimeve te Ndertimit).
“Plan Kalimtar”	eshte plani i pergatitur nga Shoqeria per punesimin dhe trainimin e stafit nga ose ne favor te Shoqerise, ne pergatitje per realizimin e detyrimeve te Shoqerise sipas kesaj Kontrate ne Daten e Fillimit, sic pershkruhet ne Shtojcen 51 (Plani Tranzitor).
“Data e Nisjes”	eshte: i) ne Fazen B te Terminalit te Ri dhe/ose Fazen B te Parkimit te Automjeteve, Data e Tremujorit te dyte ne te cilen trafiku

permbledhes vjetor i pasagjereve per fluturimet e rregullta dhe fluturimet charter (te llogaritura si mesatarja e fluturimeve charter ne tre vitet paraardhese, pa perfshire ndonje muaj perjashtimor te trafikut charter), sic vertetohet nga Shoqeria ne statistikat zyrtare vjetore te saj dhe raportet vjetore, kalon 800,000 pasagjere për 12 muajt paraardhes;

ii) ne Zgjatimin e Pistes, data e marreveshjes se shkruar ndermjet Paleve mbi baza teknike dhe tregtare per ndertimin e Zgjatimin te Pistes, pas dorezimit te nje Propozimi per Zgjatimin e Pistes nga Shoqeria ne perputhje me Piken 4.8 (Zgjatimi i Pistes), dhe

iii)lidhur me Fazen B te Qendres se Re te Kargos Ajrore, Data e Tremujorit te dyte ne te cilen tonazhi kumulativ vjetor i programuar i kargos ajrore dhe tonazhi i kargos ajrore charter

	(llogaritur si mesatarja e tonazhit te kargos ajrore charter ne tre vitet paraardhese, pa perfshire ndonje muaj perjashtimor te trafikut carter), sic vertetohet nga Shoqeria ne statistikat zyrtare vjetore te saj dhe raportet vjetore, kalon 4,200 tone ne lidhje me 12 muajt paraardhes.
“Ngjarja Shkakesore”	eshte, per nje Detyrim Shtese te vecante, ngjarja shkakesore sic percaktohet per ate Detyrim Shtese ne tabelen e Shtojces 6 (Sanksionet per Mospermbushje te Detyrimeve Shtese).
“Masterplani i Perditesuar i Aeroportit”	eshte masterplani i perditesuar i aeroportit, i ndryshuar kohe pas kohe, sic pershkruhet ne Shtojcen 18 (Planifikimi Kryesor dhe Planifikimi i Mjediseve Ndihmese).
“Uzufrukt”	ka kuptimin qe i jepet ne Ligjin e Zbatueshem.
”Shtesa Uzufrukti“	ka kuptimin e dhene ne Piken 15.4 (a) (Dhenia dhe Krijimi i Uzufruktit).
“Shuma Fillestare e Pageses	ka kuptimin e dhene ne Piken 20(a) (Pagesat per

se Koncesionit	Qeverinne e Shqiperise).
“Takse Hyrjeje”	eshte taksa e hyrjes e vendosur ne perputhje me Ligjin Nr. 8977, date 12 Dhjetor 2002 “Per sistemin e taksave ne Republiken e Shqiperise”.
“Sherbime Jetike te Dhena nga Qeveria”	eshte dhenia e sherbimeve nga Qeveria e Shqiperise gjate Afatit te Koncesionit ne lidhje me kontrollin e trafikut ajror, sherbimin kufitar dhe nepunesit e imigrim/emigrimit dhe sherbimet e shpetimit nga Zjarri.
“Pjese Kapitali me te drejte Vote”	Do te thote Pjese te Zakonshme Kapitali ose cdo pjese tjeter kapitali te Shoqerise, me te drejte vote ne nje mbledhje te pergjithshme te Ortakeve.

1.2. Interpretimi

(a) Ne kete Kontrate, ne qofte se nuk kane tjeter qellim, fjala:

i) “aktive” perfshin pasurite, te prekshme ose te paprekshme, te ardhurat dhe te drejtat te cdo natyre

“muaj” eshte afati qe fillon ne nje dite ne nje muaj kalendarik dhe mbaron ne diten numerike korresponduese te muajit tjeter kalendarik, dhe kur nuk ka dite korresponduese kalendarike ne muajin ne te cilen mbaron kjo periudhe, ky afat do te mbaroje ne diten e fundit ne ketij muaji kalendarik;

”Pale” perfshin Shoqerine dhe Qeverine e Shqiperise, sipas rastit; dhe

“rregullore” perfshin cdo rregullore, rregull, direktive zyrtare, kerkese ose udhezim (me ose pa fuqine e ligjit) te cdo organi qeveritar, agjencie, departamenti ose rregullatori, vete rregullatorin ose cdo autoritet ose organizate tjeter;

ii) Person perfshin pasardhesit e tij dhe te caktuarit ose te transferuarit e lejuar;

(iii) Pike, paragraf ose Shtojce eshte, kur nuk parashikohet shprehimisht ndryshe, referim tek ajo Pike, paragraf ose Shtojce e kesaj Kontrate.

(iv) Kontrate ose cdo dokument tjeter, kontrate ose marreveshje perfshin cdo ndryshim te lejuar, ose shtojce te kesaj Kontrate dhe nje dokument te tille, kontrate ose marreveshje, ndryshuar ose shtuar kohe pas kohe;

(vi) kjo Kontrate do te thote kjo Kontrate se bashku me Shtojcat e saj; dhe

(vi) kur nuk parashikohet shprehimisht ndryshe ne kete Kontrate, cdo ligj, dekret ose dispozite ligjore perfshin cdo ligj, dekret ose dispozite ligjore, qe ndryshon ose zevendeson ose qe ka ndryshuar ose zevendesuar ate dhe qe perfshin cdo akt nenligjor (qe perfshin por pa u kufizuar, cdo udhezim ose vendim te nje ministrie ose autoriteti tjeter kompetent) te hartuar sipas nje ligji, dekreti ose dispozite ligjore te tille. Per shmangien e dyshimeve, kjo nuk paragjykon te drejtat e Shoqerise sipas Pikes 37.16 (Ndryshime ne Ligj).

(b) Kur e kerkon konteksti, fjalet ne numrin njejes perfshijne shumesin, dhe anasjelltas.

(c) Titujt jane vetem per lehtesi referimi dhe nuk ndikojne ne interpretimin e Kontrates.

(d) Ne rast se ka perplasje te drejtprdrejte ndermjet nje dispozite te tekstit kryesor te Kontrates dhe nje Shtojce, do te kete perparesi dispozita e shprehur qe pasqyron nivelin me te larte, objektiv te pershkrimit ose kur nuk eshte e mundur te percaktohet nje nivel i tille, do te kete perparesi dispozita qe eshte rregulluar me hollesisht. Per ceshtje te parashikuara vetem ne Shtojce (at), ceshtja do te rregullohet nga Shtojca(at). Kur perplasen dy ose disa Shtojca te Kontrates, radha e perparesise se Shtojcave eshte si me poshte:

i) Shtojca (at), per sigurine teknike dhe sigurine ;

ii) Shtojcat(at), per ceshtjet e sigurimit;

iii) Shtojca (at), per Garancine e Shoqerise per Permbushjen e Kontrates;

iv) Shtojca (at), per Huan Kryesore te Certifikuar;

v) Shtojcat(et), per sanksionet per mospermbushje dhe/ose permbushje me vonese te detyrimeve te Shoqerise ne kete Kontrate; dhe

vi) te gjithe Shtojcat e tjera te Kontrates, jane te barabarta midis tyre. Per te shmangur dyshimet, kur nje ceshtje e vecante rregullohet ne me shume se nje nder Shtojcat e renditura me siper, ato Shtojca jane te barabarta midis tyre.

2. DHENIA E KONCESIONIT

2.1 Dhenia e Koncesionit

(a) Qeveria e Shqiperise, e perfaqesuar nga Organi Shteteror i Autorizuar, i jep Shoqerise, ne varesi te Pikes 3 (Kushtet Paraprake), te drejten e vetme dhe ekskluzive qe gjate Afatit te Koncesionit te kryeje Projektin ne Zonen e Koncesionit dhe, pa kufizim, te drejtat per te:

projektuar, financuar, operuar, ndertuar, vene ne pune, mirembajtur, administruar dhe zhvilluar Terminalin e Ri, i cili mund te lejoje zgjerimin ne te ardhmen;

(ii) administruar, operuar dhe mirembajtur te gjithe anen ajrore dhe infrastrukturen (pervec kontrollit te trafikut ajror, por duke perfshire Levizjen ne Toke dhe Sherbimet e Lidhura);

(iii) operuar dhe modernizuar mjetet e kargos dhe perpunimit tokesor, duke perfshire, por pa u kufizuar, Ndertimet e Reja;

(iv) permiresuar rruget lidhese dhe mirembajtur pisten dhe Zgjerimin e Pistes, perfshire projektimin, financimin, operimin, ndertimin, venien ne pune, mirembajtjen, administrimin dhe zhvillimin e kesaj infrastrukture sipas kushteve te treguara ne Piken 4.8 (Zgjatimi i Pistes) dhe Shtojcen 23 (Infrastruktura e Anes Ajrore).

(v) projektuar, financuar, operuar, ndertuar, vene ne pune, mirembajtur, administruar dhe zhvilluar Fazen A te Parkimit te Automjeteve dhe te Fazes B te Parkimit te Automjeteve;

(vi) projektuar, financuar, operuar, ndertuar, vene ne pune, mirembajtur ndertesat e tjera, infrastrukturen dhe sherbimet komunale ne Zonen e Koncesionit sic kerkohet per kryerjen e ketij Projekti;

(vii) mirembajtur rruget e percaktuara ne Zonen e Koncesionit dhe projektuar, financuar, ndertuar dhe vene ne pune Rrugen e Re Hyrese dhe zevendesuar uren ekzistuese ne rrugen e cila lidh Aeroportin me Uren e Re, te dyja Rruga e Re Hyrese dhe Ura e Re per tu financuar me hua shteterore te siguruar me garanci shteterore;

(viii) zhvendosur radarin dytesor ekzistues ne rast se kerkohet ne lidhje me Projektin, dhe ne marreveshje paraprake me ANTA-n;

(ix) operuar, pajisur dhe mirembajtur Terminalin Ekzistues ne perputhje me Shtojcen 21 (Terminali Ekzistues);

(x) te drejtat per zhvillimin tregtar eksluziv ne Zonen e Koncesionit dhe ne Zonen e Zhvillimit (nese Shoqeria fiton pronesine mbi truall ne kete Zone Zhvillimi);

(xi) te ndermarre veprime ne lidhje me te gjitha mjetet ndihmese te ardhshme te vendosura ne Master Planin e Perditesuar te Aeroportit; dhe

(xii) te drejten per te zhvilluar marketing eksluziv per Aeroportin dhe per te lidhur drejtperdrejt kontrata me Shoqerite Ajrore dhe Perdoruesit e Aeroportit ne perputhje me kete Kontrate, Ligjin e Zbatueshem, Konventat dhe marreveshjet ndermjet Republikes se Shqiperise dhe vendeve te tjera.

a) Koncesioni nuk perfshin:

i) veprimtari ne lidhje me Operacionet Ushtarake dhe Mjetet Ushtarake.

(ii) operimin e kontrollit te trafikut ajror dhe menaxhimin e trafikut ajror, dhe as te drejtat e operimit te kulles se kontrollit e te qendres se operimeve; dhe

(iii) veprimtarite ne lidhje me projektimin, financimin, ndertimin, kompletimin, venien ne pune, mirembajtjen, operimin, menaxhimin dhe zhvillimin e kulles se re te kontrollit te trafikut ajror

2.2. Afati

a) Koncesioni jepet per njezet (20) vjet, qe fillon te llogaritet nga Data e Fillimit ("Afati i Koncesionit"). Afati i Koncesionit mund te zgjatet:

i) me marreveshje me shkrim te paleve (per nje afat te lejuar nga Ligji i Zbatueshem); ose

(ii) me afatin e Forces Madhore, qe eshte mbi dy (2) muaj, ne perputhje me Piken 24.5 (Zgjatja e Afatit te Koncesionit per shkak te Forces Madhore); ose

(iii) per aq kohe sa kerkon kryerja e Ndryshimeve te Pranueshme.

b) Si Organi Shteteror i Autorizuar edhe Shoqeria, duke njoftuar me shkrim njera tjetren, pas (5) pese vjeteve nga Data e Fillimit por jo me vone se (12) dymbedhjete muaj para mbarimit te Afatit te Koncesionit, fillojne procesin e negocimit per zgjatjen e afatit fillestar te Koncesionit.

2.3. Ekskluziviteti

a) Koncesioni eshte ekskluziv dhe Shoqeria ka te drejten ekskluzive te ushtroje te drejtat sipas Koncesionit.

b) Qeveria e Shqiperise nuk do te lejoje dhe do te detyroje Organin Shteteror te Autorizuar dhe asnje Ent Shteteror te mos perpiqen te lidhin ose te ndermarrin lidhjen e ndonje marreveshjeje te cfaredolloji me te tretet, e cila mund t`u jape ose synon t`u jape ndonje nga te drejtat sipas Koncesionit (dhe ne vecanti te drejtat e percaktuara ne Piken 2.1 (Dhenia e Koncesionit)) paleve te treta ose te marre cdo mase qe perfshin lidhjen e kontratave, qe ne cdo menyre tjeter mund te cenoje te drejtat ekskluzive te dhena Shoqerise sipas kesaj Kontrate.

c) Qeveria e Shqiperise garanton se gjate Afatit te Koncesionit nuk do te licensohet, autorizohet dhe as operohet asnje aeroport tjeter per fluturime nderkombetare tregtare (kargo dhe pasagjere), ne Republiken e Shqiperise, me perjashtim te uljeve emergjente. Asnje kusht i kesaj Kontrate nuk mund te kufizoje perdorimin e asnje aeroporti ne Republiken e Shqiperise per qellime te ndihmave humanitare ose te ndihmave emergjente ne kohe katastrofash ose emergjencash civile ne Republiken e Shqiperise ose ne territoret fqinje.

2.4. Te Drejta plotesuese

Qeveria e Shqiperise, krahas Koncesionit, i jep Shoqerise, si pjese perberese e te pandashme te Koncesionit, te drejten, fuqine dhe autoritetin te kryeje projektimin, financimin, ndertimin, venien ne pune, mirembajtjen, operimin, menaxhimin dhe zhvillimin e Aeroportit dhe te drejten, kompetencat dhe autoritetin per te bere gjithcka qe, ne menyre te arsyeshme, mund te nevojitet per permbushjen prej Shoqerise te detyrimeve te saj ne kete Kontrate.

2.5. Autorizimet

a) Kur:

i) Te hyje ne fuqi te Ligjit "Per Dhenien me Koncesion te Aeroportit",

ii) Shoqeria te plotesoje kerkesat e percaktuara ne kete Kontrate dhe Dispozitat detyruese te Ligjit te Zbatueshem per Autorizimet e Dhena falas, Qeveria e Shqiperise i jep Shoqerise Autorizimet e Dhena falas.

b) Qeveria e Shqiperise do ti jape vete Shoqerise dhe do te garantoje se edhe cdo Ent

Shteteror qe eshte ne varesi te drejtperdrejte te Qeverise se Shqiperise, menjehere pas dates se fillimit dhe me marrjen nga Organi Shteteror i Autorizuar te nje njoftimi me shkrim nga Shoqeria pa vonesa te paarsyeshme pas Dates se Fillimit, dhe ne varesi te marrjes nga Organi Shteteror i Autorizuar te njoftimit me shkrim nga Shoqeria, do t'i jape Shoqerise Autorizimet, me kusht qe:

i) Keto Autorizime te kerkohen per ushtrimin e drejtave dhe permbushjen nga Shoqeria te detyrimeve te saj ne kete Kontrate;

ii) Dhenia e Autorizimeve te tilla te jete ne kompetence te Qeverise se Shqiperise ose te Entit Shteteror perkates;

iii) Dhenia e Autorizimeve te tilla te jete ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem; dhe

iv) Shoqeria ti kete dorezuar Qeverise se Shqiperise ose Entit Shteteror perkates, sipas rastit, informacionin e plote (perfshire cdo dokumentacion) qe argumenton kerkesen per Autorizimin perkates.

Kur Qeveria e Shqiperise ose cdo Ent Shteteror (nen varesine e drejtperdrejte te Qeverise se Shqiperise) nuk kane te drejte te japin Autorizime, Qeveria e Shqiperise do te beje te gjitha perpjekjet per te siguruar qe Autorizimet perkatese t'i jepen Shoqerise ne perputhje me kete Kontrate dhe Ligjin e Zbatueshem, dhe pa vonesa te paarsyeshme, pas depozitimit rregullisht te kerkeses nga Shoqeria.

c) Qeveria e Shqiperise garanton se:

(i) te gjitha Entet Shteterore qe ushtrojne autoritetet e tyre perkatese ne lidhje me Koncesionin, do te vihen teresisht ne dijeni te kesaj Kontrate dhe te Ligjit te Koncesionit te Aeroportit, dhe

(ii) me kusht dhe ne masen qe Qeveria e Shqiperise te jete epror i drejtperdrejte i tyre, te gjitha Entet Shteterore qe kryejne funksionet perkatese ne lidhje me Koncesionin do te bashkepunojne pa vonesa te paarsyeshme me Shoqerine per zbatimin e Projektit.

2.6. Ligji i Koncesionit te Aeroportit

Kur nuk eshte percaktuar ndryshe ne kete Kontrate, me hyrjen ne fuqi te Ligjit te Koncesionit te Aeroportit (sipas Ligjit te Zbatueshem), kjo Kontrate ka perparesi mbi cdo Ligj te Zbatueshem qe eshte ne fuqi ne daten e hyrjes ne fuqi te Ligjit te Koncesionit te Aeroportit.

3. KUSHTET PARAPRAKE

3.1. Kushtet Paraprake te Shoqerise

Me perjashtim te Pikes 3.5 (Data e Fillimit) detyrimet e Qeverise se Shqiperise sipas kesaj Kontrate (pervec Pikes 34 (Konfidencialiteti), Pikes 36 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve) dhe Pikes 38 (Ligji Rregullues) varen nga marrja prej Paleve te njoftimit te permbushjes, qe tregohet ne Piken 3.4 (Njoftimi i Permbushjes) dhe permbushja nga Shoqeria te kushteve vijuese:

(a) kur nuk eshte hequr dore me shkrim (teresisht ose pjeserisht) nga Qeveria e Shqiperise, deklarimet dhe garancite e Shoqerise, ne kete Kontrate jane te verteta dhe sakta ne te gjitha ceshtjet thelbesore, si te ishin bere ne Daten e Fillimit, dhe si te tilla te konfirmuar ne letra ne formen e Shtojces 57 (Formulari i Letres nga Shoqeria qe Konfirmon Vertetesine dhe Saktesine e Deklarimeve dhe Garancive te saj);

(b) kur Qeveria e Shqiperise nuk ka hequr dore me shkrim nga marrja, Qeveria e Shqiperise ka marre dokumentet dhe instrumentet e renditura me poshte:

(i) prove se Shuma Fillestare e Pageses se Koncesionit eshte shlyer plotesisht ne nje llogari te ngurtesuar te hapur dhe te mbajtur ne perputhje me kushtet e kontrates per llogari te ngurtesuar te lidhur ndermjet Shoqerise, Qeverise se Shqiperise dhe nje agjenti te llogarise se ngurtesuar, kontrate qe ka formen dhe permbajtjen e paraqitur ne Shtojcen 63 (Kontrata e Llogarise se Ngurtesuar); dhe

(ii) prove se Shoqeria eshte themeluar rregullisht sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise dhe ne perputhje me kete Kontrate, dhe se eshte plotesisht e autorizuar te nenshkruaje kete Kontrate dhe Dokumentet e Financimit;

(iii) prove se Garancia e Permbushjes se Kontrates eshte ofruar e plote, sipas kerkesave te kesaj Kontrate, ne shumen 3,000,000 EUR.

(c) kur nuk eshte hequr dore me shkrim (teresisht ose pjeserisht) nga Qeveria e Shqiperise, Shoqeria ka marre persiper zotime detyruese, ne Dokumentet e Financimit (te cilat jane nenshkruar dhe jane plotesisht ne fuqi dhe te zbatueshme) per financimin e detyrimeve te saj sipas kesaj Kontrate, qe perfshin, pa u kufizuar vetem ne to:

(i) kontraten e huas, lidhur ndermjet Huadhenesit dhe Shoqerise (perfshire pa kufizim

Marreveshjen e Transhit te Huas Shteterore),

(ii) kontraten e financimit te ortakeve, midis secilit Ortak dhe Shoqerise ne lidhje me shlyerjen e kapitalit te deklaruar, sic percaktohet ne Shtojcen 2 (Shlyerja e Kapitalit te deklaruar për Fazën A të Punimeve të Ndërtimit), keto zotime te jene te konfirmuara me ane te letres te pershkruar ne Shtojcen 60 (Formulari i Letres se Shoqerise qe Konfirmon marrjen e Zotimeve Financiare sipas Dokumenteve te Financimit) ;

(d) kur nuk eshte hequr dore (teresisht ose pjeserisht) nga Qeveria e Shqiperise me shkrim, Shoqeria ka marre pergjegjesi te detyrueshme dhe te kenaqshme per marrjen e sigurimit nga sigurues me reputacion, sic percaktohet ne Shtojcen 11 (Sigurimi) dhe zotime te tilla te jene konfirmuar me leter ne formen e dhene ne Shtojcen 61 (Formulari i Letres nga Shoqeria ne lidhje me Sigurimin);

(e) kur nuk eshte hequr dore (teresisht ose pjeserisht) nga Qeveria e Shqiperise me shkrim, Shoqeria do te permbushe te gjitha detyrimet ne kete Kontrate dhe ne Dokumentet e Financimit, dhe kjo permbushje te jete konfirmuar me leter nga perfaqesuesit e autorizuar te Shoqerise ne formen e dhene ne Shtojcen 62 (Formulari i Letres nga Shoqeria qe Konfirmon Perputhjen me Detyrimet e saj sipas Kontrates se Koncesionit dhe Dokumenteve te Financimit);

(f) kur nuk eshte hequr dore (teresisht ose pjeserisht) nga Qeveria e Shqiperise me shkrim, Shoqeria do t'i dorezoje Organit Shtetror te Autorizuar nje leter ne forme dhe permbajtje te kenaqshme per Qeverine e Shqiperise, me ane te se ciles konfirmon se DEG ka nenshkruar dhe shlyer ne masen e saj te plote kontributin e Kapitalit te Deklaruar per tu Shlyer ne perputhje me Shtojcen 2 (Kapitali i Deklaruar per Shlyerje ne Fazen A te Puneve Ndertimore) se bashku me nje ekstrakt te Regjistrit Tregtar te Gjykates se Rrethit Tirane, qe konfirmon se ky nenshkrim dhe shlyerja nga DEG eshte regjistruar ne Regjistrin Tregtar

(g) kur nuk eshte hequr dore (teresisht ose pjeserisht) nga Qeveria e Shqiperise me shkrim, Shoqeria do ti paraqese Organit Shteteror te Autorizuar letrat qe jane ne formen e Shtojces 64 (Formulari i Letres nga HTA dhe AAEF qe konfirmon se shume 614.700 euro do te nenshkruhet dhe shlyhet prej tyre ne Daten e Fillimit) me ane te te cilave si HTA dhe AAEF konfirmojne dhe zotohen se pjesa qe i perket atyre ne shumen 614.700 euro do te nenshkruhet dhe do te shlyhet ne Daten e Fillimit (per tremujorin e pare te vitit pas Dates se Fillimit, si pjese e secilit ne Kapitalin e Deklaruar per tu Shlyer), ne perputhje me Shtojcen 2 (Kapitali i Deklaruar per Shlyerje ne Fazen A te Puneve Ndertimore).

(h) kur nuk eshte hequr dore (teresisht ose pjeserisht) nga Qeveria e Shqiperise me shkrim Shoqeria do te pranoje nje kopje te Manualit Ekzistues te Aerodromit, te Manualit te Operimit dhe te Mirembajtjes se Aeroportit dhe Manuale te tjera, te cilat jane pergatitur ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem dhe Konventat; dhe

(i) kur nuk eshte hequr dore (teresisht ose pjeserisht) nga Qeveria e Shqiperise me shkrim, Shoqeria ka plotesuar te gjitha kerkesat e percaktuara ne Ligjin e Zbatueshem qe Banka e Shqiperise te jape Autorizimet per celjen nga Shoqeria te llogarive bankare jashte shtetit dhe riatdhesimin e fitimit, dhe

(j) kur nuk eshte hequr dore (teresisht ose pjeserisht) nga Qeveria e Shqiperise me shkrim, Shoqeria, HTA dhe AAEF kane lidhur Marreveshje Mbeshtetese te Ortakeve me Qeverine e Shqiperise, dhe;

(k) kur nuk eshte hequr dore (teresisht ose pjeserisht) nga Qeveria e Shqiperise me shkrim, Shoqeria do ti jape provat Qeverise se Shqiperise se nje banke tregtare ka leshuar ne emer te HTA dhe AAEF nje Garanci Bankare te pakthyeshme dhe te pakushtezuar te pagueshme me kerkese ne shumen 6.403.125 per Shoqerine, te pagueshme per Qeverine e Shqiperise sipas Kushteve te Marreveshjes Mbeshtetese te Ortakeve.

Palet merren vesh ne menyre te shprehur se: (i) Qeveria e Shqiperise do ta shqyrtoje kerkesen e Shoqerise per heqjen dore menjehere me marrjen e saj dhe (ii) ne rast se Qeveria e Shqiperise pranon te jape heqjen dore sic percaktohet ne Piken 3.1, atehere Qeveria e Shqiperise nuk do ta mbaje pezull e as vonoje ne menyre te paarsyeshme leshimin e saj me shkrim.

3.2. Kushtet paraprake te Qeverise se Shqiperise

Me perjashtim te Pikes 3.5 (Data e Fillimit), detyrimet e Shoqerise ne kete Kontrate (pervec Pikes 34 (Konfidencialiteti), Pikes 36 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve) dhe Pikes 38 (Ligji Rregullues) varen nga marrja e njoftimit te permbushjes nga Palet, sipas Pikes 3.4 (Njoftimi i Permbushjes) dhe

nga permbushja prej Qeverise se Shqiperise e kushteve te meposhtme:

(a) kur Shoqeria nuk ka hequr dore (teresisht ose pjeserisht) me shkrim, deklarimet dhe garancite e Qeverise se Shqiperise sipas kesaj Kontrate jane te verteta dhe te sakta ne te gjitha ceshtjet thelbesore, si te ishin bere ne Diten e Fillimit, dhe si te tilla jane per tu konfirmuar me leter te Organit Shteteror te Autorizuar ne formen e Shtojces 65 (Formulari i Letres nga Organi Shteteror i Autorizuar qe Konfirmon Vertetesine dhe Saktesine e Deklarimeve dhe Garancive te dhena nga Qeveria e Shqiperise);

(b) kur Shoqeria nuk ka hequr dore me shkrim, Shoqeria ka marre dokumentet dhe aktet e meposhteme:

(i) opinionin ligjor leshuar nje dite para Dates se Fillimit nga Ministri i Drejtesise se Republikes se Shqiperise ne formen dhe me permbajtje te kenaqshme per Shoqerine i cili duhet te sqaroje se:

1. kjo Kontrate eshte noterizuar rregullisht nga nje noter publik ne daten e nenshkrimit te saj dhe eshte e vlefshme dhe efektive, detyruese dhe e zbatueshme sipas Ligjit te Zbatueshem;

2. kjo Kontrate eshte nenshkruar rregullisht, ne emer te Qeverise se Shqiperise, nga Organi Shteteror i Autorizuar, i cili ka te drejte dhe tagre te plota per ta nenshkruar ate, ne emer dhe per llogari te Qeverise se Shqiperise.

3. nenshkrimi, dorezimi dhe permbushja e kesaj Kontrate eshte ratifikuar nga Kuvendi i Republikes se Shqiperise, dhe Ligji i Koncesionit te Aeroportit ka hyre ne fuqi.

4. Ligji i Zbatueshem pranon zgjedhjen e ligjit Anglez si ligj rregullues dhe cdo vendim arbitrazhi i dhene ne perputhje me Piken 36 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve) eshte i zbatueshem ne Republiken e Shqiperise dhe mbi aktivet e Qeverise se Shqiperise te ndodhura ne Republiken e Shqiperise ose kudo tjeter,

5. Nenshkrimi dhe zbatimi i kesaj Kontrate nga ana e Qeverise se Shqiperise eshte i lejueshem dhe nuk vjen ne kundershtim me asnje dispozite te Ligjit te Zbatueshem e as Konventat.

(ii) prova se Shoqerise i jane dhene te gjitha Autorizimet e Dhena;

(iii) prove, ne formen e paraqitur ne Shtojcen 53 (Forma e Letres se Qeverise se Shqiperise qe konfirmon se Pasuria e Paluajtshme brenda Zones se Koncesionit eshte shpronesiar regullisht dhe eshte ne pronesi te Qeverise), qe konfirmon se shpronesimi i Zones se Koncesionit eshte kryer dhe pasurite e paluajtshme ne listen e renditura ne Shtojcen 15 (Zona e Koncesionit) eshte i lire nga Barret Siguruese dhe Zaptimi, dhe se pronesia mbi token ne Zonen e Koncesionit eshte transferuar ne favor te Qeverise se Shqiperise ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem.

(iv) prove, ne formen e Shtojces 66 (Formulari i Letres nga Qeveria e Shqiperise) se Uzufrukti eshte dhene ne menyre te rregullt pa pagese, regjistruar dhe kompletuar ne favor te Shoqerise), qe konfirmon se Shoqerise i eshte dhene pa pagese Uzufrukti per Zonen e Koncesionit dhe cdo pasuri te paluajtshme, te trupezuara dhe pasuri te luajtshme ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem, per 20 vjet dhe se ai eshte regjistruar dhe kompletuar ne Regjistrin e Pasurive te Paluajtshme;

(c) kur Shoqeria nuk ka hequr dore (teresisht ose pjeserisht) me shkrim:

(i) asnje urdher, statut, rregull, rregullore, urdher ekzekutimi, vendim gjyqesor, pezullim, dekret ose urdher kufizues nuk do te zbatohet, futet, botohet ose urdherohet nga asnje gjykate qe ka jurisdiksion ose organ pushteti ose rregullator ose Ent Shteteror qe ka jurisdiksion mbi ceshtjen qe kufizon, ndalon ose deklaron te paligjshme transaksionet e kryera sipas kesaj Kontrate, dhe

(ii) asnje padi, hetim ose procedim ligjor nuk eshte filluar dhe nuk kercenohet se do te fillohet nga ndonje autoritet qeveritar ose rregullator ose Ent Shtetror qe ka juridiksion mbi ceshtjen qe kerkon te kufizoje, ndaloje ose ti deklaroje te paligjshme transaksionet e kryera sipas kesaj Kontrate, te cilat duhet te konfirmohen nga nje leter ne forme te plote ne Shtojcen 67 (Formulari i Letres nga Qeveria e Shqiperise qe Konfirmon se nuk kane ndodhur Ngjarjet e Renditura ne Piken 3.2 (c) te Kontrates se Koncesionit);

(d) kur Shoqeria nuk ka hequr dore (teresisht ose pjeserisht) me shkrim, Shoqerise i eshte dhene perjashtimi nga pagimi i tatimeve sic percaktohet ne Piken 37.14 (Perjashtimi nga Tatimet dhe Rimbursimi i Pershpejtuar i TVSH); qe zbatohet nga data e Regjistrimit te Shoqerise deri ne daten qe bie 20 vjet pas Dates se Fillimit

(e) kur Shoqeria nuk ka hequr dore (teresisht ose pjeserisht) me shkrim, Qeveria e Shqiperise

dhe cdo Ent Shteteror duhet te permbushin te gjitha detyrimet e tyre perkatese ne kete Kontrate, dhe kjo permbushje konfirmohet me leter ne formen e Shtojces 68 (Formulari i Letres se Qeverise se Shqiperise qe Konfirmon Permbushjen e Detyrimeve te saj ne kete Kontrate);

(f) kur Shoqeria nuk ka hequr dore (teresisht ose pjeserisht) me shkrim; Qeveria e Shqiperise garanton se cdo prokurimi i mallrave, punimeve dhe Sherbimeve qe do te perdoren nga Shoqeria nuk do tu nenshtrohen Ligjit te Zbatueshem per prokurimet publike, ose perndryshe Qeveria e Shqiperise do te marre te gjitha masat per sa me siper dhe do te paraqese prova te mjaftueshme qe Shoqeria mund te kerkoje ne menyre te arsyeshme dhe se keto masa jane te detyrueshme dhe te vlefshme;

Kur Shoqeria nuk ka hequr dore (teresisht ose pjeserisht) me shkrim; Qeveria e Shqiperise do te kete garantuar se Shoqerise i jepen pa asnje shpenzim dhe detyrim te gjitha te drejtat e kalimit, servitutet dhe te gjitha te drejtat reale dhe te pronesise te cilat mund te kerkohen nga Shoqeria per permbushjen e detyrimeve te saj ne kete Marreveshje (per shmangjen e dyshimit Shoqeria nuk detyrohet te paguaje asnje shume ose pagese pronareve te tokave perfshire ish-pronaret, ose ndonje Enti Shteteror per sa me siper); dhe

(h) kur Shoqeria nuk ka hequr dore (teresisht ose pjeserisht) me shkrim, Qeveria e Shqiperise duhet te kete siguruar qe Shoqerise t'i jete dhene Manuali i Aerodromit ekzistues.

(i) kur Shoqeria nuk ka hequr dore (teresisht ose pjeserisht) me shkrim, Qeveria e Shqiperise do te kete lidhur Kontraten e Garancise se Transhit te Huas Shteterore.

(j) kur Shoqeria nuk ka hequr dore (teresisht ose pjeserisht) me shkrim, Banka e Shqiperise do t'i kete dhene Shoqerise Autorizimet per celjen e llogarive bankare jashte Shqiperise dhe riatdhesimin e fitimeve te Shoqerise

3.3. Perpjekjet e arsyeshme per permbushjen e Detyrimeve

Shoqeria do te beje te gjitha perpjekjet e arsyeshme per te permbushur kushtet e renditura ne Piken 3.1 (Kushtet Paraprake te Shoqerise). Qeveria e Shqiperise do te siguroje vete apo qe Organi Shteteror i Autorizuar te beje te gjitha perpjekjet e arsyeshme per te permbushur kushtet e renditur ne Piken 3.2 (Kushtet Paraprake te Qeverise se Shqiperise).

3.4. Njoftimi i Permbushjes

Ne daten qe njera pale ne kete Kontrate meson se eshte perbushur ndonje nga kushtet e saj ne Piken 3.1 (Kushtet Paraprake te Shoqerise) dhe 3.2 (Kushtet Paraprake te Qeverise se Shqiperise), ajo duhet t'ia njoftoje kete menjehere me shkrim Pales tjeter.

3.5. Data e Fillimit

Me perjashtim te Pikes 3.1 (Kushtet Paraprake te Shoqerise) dhe 3.2 (Kushtet Paraprake te Qeverise se Shqiperise), Shoqeria nuk u nenshshtrohet detyrimeve sipas kesaj Kontrate (pervec Pikes 34 (Konfidencialiteti), Pikes 36 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve) dhe Pikes 38 (Ligji Rregullues)) perpara dates qe bie dy (2) dite pasi se bashku edhe Shoqeria edhe Qeveria Shqiptare te kene permbushur Kushtet e tyre Paraprake ose te kene hequr dore prej dyre dhe njoftimi i permbushjes te jete marre nga Pala tjeter ("Data e Fillimit") .

3.6. Mospermbushja e Kushteve Paraprake

a) Nese Data e Fillimit nuk ndodh ne daten e hyrjes ne fuqi te Ligjit te Koncesionit ose brenda (6) muajve pas hyrjes se tij ne fuqi apo ne nje date tjeter te mevonshme te caktuar me shkrim nga Palet, per shkak te mospermbushjes nga Shoqeria te Kushteve Paraprake te Shoqerise, atehere Qeveria e Shqiperise ka te drejte ta zgjidhe Kontraten duke i derguar Shoqerise Njoftimin e Zgjidhjes. Me dergimin e ketij njoftimi te zgjidhjes Palet ne kete Kontrate nuk kane me te drejta ose detyrime sipas kesaj Kontrate (pervec te drejtave dhe detyrimeve qe ne menyre te shprehur mbeten ne fuqi edhe pas mbarimit te kesaj Kontrate sipas Pikes 34 (Konfidencialiteti), Pikes 36 (Zgjidhja e Mosmarrveshjeve) dhe Pikes 38 (Ligji Rregullues)).

(b) Nese Data e Fillimit nuk ndodh ne daten e hyrjes ne fuqi te Ligjit te Koncesionit ose brenda (6) muajve pas hyrjes se tij ne fuqi apo ne nje date tjeter te mevonshme te caktuar me shkrim nga Palet, per shkak te mospermbushjes nga Qeveria Shqiptare te Kushteve Paraprake te Shoqerise, atehere Shoqeria ka te drejte ta zgjidhe Kontraten duke i derguar Qeverise Shqiptare Njoftimin e Zgjidhjes. Me dergimin e ketij njoftimi te zgjidhjes, Palet ne kete Kontrate nuk kane me te drejta ose detyrime sipas kesaj Kontrate (pervec te drejtave dhe detyrimeve qe ne menyre te shprehur mbeten ne fuqi edhe pas mbarimit te kesaj Kontrate sipas Pikes 34 (Konfidencialiteti), Pikes 36 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve) dhe Pikes 38 (Ligji Rregullues)).

4. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E SHOQERISE

4.1. Te drejtat e Shoqerise

Shoqeria, pervec te drejtave te tjera te fituara me dhenien e Koncesionit, ka te drejte:

a) Te punesoje ose angazhoje Persona, kur ta gjykoje te nevojshme, per te dhene keshilla ne lidhje me projektimin, financimin, ndertimin, venien ne pune, mirembajtjen, operimin, menaxhimin dhe zhvillimin Terminalit Ekzistues, Shjeshin e Terminalit Ekzistues dhe Aktiveve perkatese si dhe Mjediseve te Reja, duke perfshire, llogaritare, inxhiniere, juriste, profesioniste dhe specialiste e tjere;

b) te vendose politikat e veta te punesimit ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem

(c) te kryeje veprimet e tjera qe i konsideron te nevojshme per Shoqerine per zbatimin e Projektit, te permbushe detyrimet e saj dhe te ushtroje te drejtat e saj sipas kesaj Kontrate .

(d) te zgjase afatin aq sa do te zgjase edhe vonesa ne shpronesimin e prones private te paluajtshme ne Zonen e Koncesionit dhe Shpronesimi i Kerkuar i Tokes dhe shkarkohet nga pagesat e sanksioneve (per mospermbushje te Detyrimeve Baze dhe Detyrimeve Shtese) te prejardhura nga:

i) Vonesa e Qeverise se Shqiperise ne shpronesimin e pasurive te paluajtshme private ne Zonen e Koncesionit, ose

(ii) ankesat e ngritura per shkak te shpronesimit te pasurive te paluajtshme private ne Zonen e Koncesionit, ose

(iii) ankesat ne lidhje me shpronesimin e prones se paluajtshme private ne Zonen e Koncesionit.

Per te shmangur dyshimet, Shoqeria mund t'i ushtroje keto te drejta vetem pasi te kete bere te gjitha perpjekjet e duhura per te zbutur pasojat e voneses se Qeverise se Shqiperise ne shpronesimin e pasurive te paluajtshme private ne Zonen e Koncesionit dhe zonen qe ka lidhje me Shpronesimin e Kerkuar te Tokes. Te gjitha ankesat e ngritura ne lidhje me shpronesimin e pasurive te paluajtshme private ne Zonen e Koncesionit ose te ruajtjes se Zones se Kufizuar do te trajtohen nga Qeveria e Shqiperise, pervec rastit kur ato vijne nga pakujdesia ose faji me dashje i Shoqerise; dhe

(e) kur nuk parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, te prokuroje ne menyre te drejtperdrejte mallra dhe Sherbime, pavaresisht nga dispozitat e kunderta ne Ligjin e Zbatueshem per prokurimin publik

(f) te optimizoje strukturen e financimit te Shoqerise gjate Afatit te Koncesionit (duke perfshire edhe cdo rifinancim huaje) me kusht qe nje optimizim i tille mos te mos zmadhoje detyrimet financiare te Qeverise se Shqiperise ne perfundim te kesaj Kontrate dhe te mos rrise raportin kapitalit - hua te Shoqerise gjate Fazes A te Punimeve Ndertimore.

(g) te ndryshoje, kur e gjykon te pershtatshme, strukturen e pjeseve te kapitalit te Shoqerise, ose te zmadhoje apo zvogeloje pjeset e kapitalit te Ortakeve, ne zbatim te Pikes 3 te Marreveshjes Mbeshtetese te Ortakeve.

(h) t'i zgjatet afati per aq kohe sa do te zgjase edhe cdo afat vonesa e shaktuar nga zbulime arkeologjike dhe/ose hetim te kerkuar nga Qeveria e Shqiperise ose Ent Shteteror ne Zonen e Koncesionit, qe mund te cenoje permbushjen nga Shoqeria te cilitdo prej Detyrimeve Baze dhe Detyrimeve Shtese perfshi edhe shkarkimin nga pergjegjesia per pagesat e sanksioneve (per mospermbushje te Detyrimeve Baze ose Detyrimeve Shtese) sipas kesaj Kontrate te shkaktuara nga zbulime dhe kerkime te tilla. Per shmangien e dyshimeve, Shoqeria mund t'i ushtroje keto te drejta vetem nese ben te gjitha perpjekjet e aresyeshme per te zbutur efektet e zbulimeve te tilla arkeologjike dhe/ose kerkimeve gjate permbushjes nga Shoqeria te Detyrimeve Baze ose te Detyrimeve Shtese;

(i) t'i zgjatet afati pertej Dates se nje Detyrimi te Kerkuar, ose pertej Afatit te Zbatimit per aq kohe sa do te zgjase edhe vonesa ne permbushjen e Detyrimeve Baze ose te Detyrimeve Shtese te shkaktuara nga Ndryshimet e Mundshme; dhe

(j) te beje nje oferte publike fillestare (deri ne dy transhe) te Pjeseve te Zakonshme te Kapitalit deri ne nje shume maksimale 49% te pjeseve te Kapitalit, ne cdo kohe gjate Afatit te Koncesionit ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem, me kusht qe:

(i) mos te kete asnje Mospermbushje sipas kesaj Kontrate dhe

(ii) oferta te tilla publike fillestare:

1. mos te prekin as drejtperdrejt, as terthorazi dhe as ne te kundert zbatimin e Projektit;

2. te mos ndodhin perpara pervjetorit te peste (5) te Dates se Fillimit; dhe

3. t'i nenshtrohen miratimit paraprak me shkrim nga Organi Shteteror i Autorizuar.

Detyrimet e Pergjithshme te Shoqerise

Shoqeria:

do te kryeje shpenzimet dhe do perballoje te gjitha kostot ne lidhje me permbushjen e Detyrimeve Baze dhe Detyrimeve Shtese, ne perputhje me kete Kontrate (qe i neshtrohet cdo Derogimi te Pranuar ne fuqi) dhe Praktika e Mire e Industrise;

nuk do te beje investime, pervec atyre qe nevojiten per menaxhimin e kujdesshem te parave dhe vetem ne kategorite e meposhtme te instrumenteve financiare:

(i) depozita me bankat ne Republiken e Shqiperise te renditura ne Shtojcen 10 (Lista e Institucioneve financiare) dhe bankat e licensuara te nivelit A (sipas normave te Standard & Poor's), ose te niveleve me te larta, ne vendet anetare te Bashkimit Europian;

(ii) certifikata te depozitimit ne banka te nivelit A-1 ose te nivelit me te larte te leshuara brenda Bashkimit Europian

(iii) letrat me vlere te Qeverise se Shqiperise;

(iv) letrat me vlere te qeverise se cdo vendi anetar te Bashkimit Europian, me kusht qe emetuesi i tyre te jete i nivelit A (sipas normave te Standard & Poor's); dhe

(v) cdo instrument tjeter i miratuar here heres nga Organi Shteteror i Autorizuar, per investimin e matur nga Shoqeria te te hollave te teperta.

(c) do te mbaje hapur librin e llogarise ne perputhje me Parimet e Pergjithshme te Pranuara te Kontabilitetit, dhe me kerkese te Qeverise se Shqiperise do t'i siguroje asaj akses ne ndertimin e kostove dhe manaxhimin e tyre dhe si dhe ne regjistrat e analizat e llogarive financiare dhe;

(d) kur nuk parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, do te kerkoje dhe paguaje per marrjen dhe mbajtjen e te gjithe autorizimeve te nevojshme per permbushjen e detyrimeve te saj sipas kesaj Kontrate (pervec Autorizimeve te Dhena).

(e) do te siguroje qe zhvillimet ne Zonen e Koncesionit te njoftohen rregullisht ne te gjitha botimet e detyrueshme sipas Ligjit te Zbatueshem, perfshi ketu pa perjashtim, BIA-n (Botimet rreth Informacioneve te Aeroportit), njoftimet per pilotet (NOTAM-et) dhe te tjera si keto;

(f) do te vere ne zbatim procedurat dhe ndryshimet e levizjes se pasagjereve ne Terminalin e Ri per te siguruar perputhjen me rregullat e izolimit te pasagjereve te treguara Marreveshjen e Shengen-it, nese dhe kur Marreveshja e Shengenit te zbatohet edhe Republiken e Shqiperise);

(g) do te siguroje se eshte kryer i gjithe sondazhi i nevojshem dhe marre i gjithe informacioni gjeo-teknik ne lidhje me zbatimin e Detyrimeve Baze dhe Detyrimeve Shtese.

(h) do te mbaje llogari bankare ne Republiken e Shqiperise ose jashte saj ne cfaredolloj monedhe dhe do te bleje apo shese valuten, ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem;

(i) do te pergatise llogari financiare ne perputhje me Parimet e Pergjithshme te Pranuara te Kontabilitetit dhe do t'i auditoje rregullisht nga nje shoqeri auditimi e kualifikuar me emer dhe reputacion te mire, ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem;

(j) do te siguroje qe veprimtarite e saj brenda Zones se Koncesionit dhe vete Zona e Koncesionit te perputhen ne cdo aspekt me planin e mjedisit (te pershkruar ne Shtojcen 42 (Administrimi Mjedisor) perfshire, pa perjashtim, kryerjen e cdo vleresimi mjedisor ne perputhje me Direktiven e KE – 85/33EEC (te ndryshuar nga Direktiva e Keshillit 97/11/KE), megjithe Derogimet e Pranuara ne fuqi. Per te shmangur dyshimet, Shoqeria nuk eshte pergjegjese per ndotje apo ndikime te tjera mjedisore qe ekzistonin ne Zonen e Koncesionit perpara Dates se Fillimit;

(k) do te siguroje qe Personat e caktuar nga DPAC te gezojne te drejten e hyrjes ne Zonen e Koncesionit ne perputhje me standardet e sigurise teknike te percaktuara ne Ligjin e Zbatueshem dhe kete Kontrate;

(l) do ta mbaje Zonen e Koncesionit te sigurt gjate gjithe Afatit te Koncesionit, duke perfshire pa perjashtim, punesimin e personelit te sigurise dhe pajisjen e tij per kete qellim. Per te shmangur dyshimet, ne rastin e Forces Madhore, Qeveria e Shqiperise do te siguroje personel policor ushtarak si dhe pajisje shtese sipas nevojes per ruajtjen e sigurise ne Zonen e Koncesionit.

(m) do te pergatise dhe do t'i jape Qeverise se Shqiperise informacionet dhe dokumentet e caktuara ne Shtojcën 54 (Raportimi Periodik);

(n) do te siguroje se kontratat apo marreveshjet e lidhura nga Ortaket e zakonshem te saj

jane te nje natyre te tille qe asnjera prej tyre s'do te kerkoje apo detyroje ndonje nga Ortaket e zakonshem te Shoqerise a Person tjeter te veproje ne kundershtim me kete Kontrate apo Statutin e Shoqerise ose te kerkoje a detyroje qe ndonje Administrator i Shoqerise te veproje ne kundershtim me interesat e mira te Shoqerise;

(o) do te garantoje se :

(i) nuk do te kryhet asnje riblerje te pjeseve te Kapitalit para Dates se Hapjes te Fazes A te Terminalit te Ri; dhe

(ii) cfaredo riblerje ne lidhje me Kapitalin pas Dates se Hapjes seFazes A te Terminalit te Ri do te kufizohet ne Konvertimin e pjeseve te kapitalit nga DEG dhe Shitjen e Pranuar te AAEF;

(p) do te siguroje dhe kujdeset qe cdo kontrate materiale dhe/ose marreveshje e lidhur nga Shoqeria ne lidhje me Koncesionin te permbaje dispozita te tilla qe autorizojne Qeverine e Shqiperise apo te caktuarin e saj te nderhyje ne marreveshje apo kontrata te tilla, sipas gjykimit te lire te Qeverise Shqiptare, ne vend te Shoqerise dhe per ta zevendesuar ate ne rast se ajo nuk permbush detyrimet nga ato kontrata apo marreveshje apo ne rastin e zgjidhjes se kesaj Kontrate per shkak te mospermbushjesh nga Shoqeria.

(q) do te siguroje dhe kujdeset qe cdo kontrate thelbesore dhe/ose marreveshje e lidhur nga Shoqeria ne lidhje me Koncesionin te permbaje dispozita qe autorizojne Huadhenesi(t) Primar(e) apo te emeruarin e tij/tyre te nderhyje sipas gjykimit te lire te Huadhenesit Kryesor gjate ushtrimit te se drejtes se nderhyrjes (ne perputhje me Piken 32 (Te Drejtat e Nderhyrjes se Huadhenesit dhe Zevendesimi), ne vend te Shoqerise dhe ta zevendesoje ate;

(r) do te bashkepunoje me Inxhinierin e Pavarur, Inxhinierin e Kualifikuar, Komitetin e Pavarur Rishikues dhe Njesine e Implementimit te Projektit nese ata e shohin te arsyeshme per realizimin e te drejtave dhe detyrimeve te tyre perkatese sipas kesaj Kontrate ;

(s) do te percaktoje, mbikeqyre, kontrolloje dhe monitoroje aktivitetet e Kontraktoreve te Shoqerise sipas marreveshjeve perkatese, kur te nevojitet;

(t) nuk do te vendose apo krijoje, si dhe nuk do lejoje qe ndonje Kontraktor i Shoqerise a Person tjeter te pretendoje nepermjet ose ne emer te Shoqerise vendosjen apo krijimin e Barres Siguruese mbi te gjitha ose pjese te mjediseve te lidhura me Projektin, ose mbi ndonje te drejte te Shoqerise, me perjashtim te rasteve te parashikuara shprehimisht ne kete Kontrate;

(u) pergjigjet per sigurine, rezistencen dhe qendrueshmerine e mjediseve te ndertuara apo pajisura nga Shoqeria ne lidhje me Projektin, duke perfshire te gjitha strukturat qe formojne pjese te tyre si edhe perputhjen e tyre me te gjitha kerkesat e percaktura ne kete Kontrate ;

(v) do te bashkepunoje ne pergjithesi me Organin Shteteror te Autorizuar dhe Njesine e Zbatimit te Projektit ne interes te zbatimit te duhur te Projektit dhe

(w) do te siguroje se asnje nga Huadhenesit e Ndervarur te mos trajtohet si Ortak ne te njejten kohe.

(x) do te sigurohet se asnje nga filialet e tij nuk do te perfshihet ne asnje veprimtari nuk do te kryeje asnje veprimtari tregtare, pervec atij qe lidhet direkt me Koncesionin dhe brenda Zones se Koncesionit dhe/ose Zones se Zhvillimit.

(y) do te njoftoje Qeverine e Shqiperise per cdo mospagim te shumave te detyrueshme sipas Dokumenteve te Financimit dhe per cdo heqje dore nga detyrimet e Dokumenteve te Financimit te dhena nga cdo Huadhenes Kryesor;

(z) do te siguroje se s'do te kete asnje shkelje nga Shoqeria sipas marreveshjes se Transhit te Huas Shteterore;

(aa) do ta pajise menjehere Organin Shteteror te Autorizuar me kopje te te gjitha parashikimeve financiare dhe buxheteve qe i jane dorezuar Huadhenesve Kryesore, perfshire analizat e koeficentit te mbulimit;

(bb) do te hape dhe mbaje nje llogari rezerve te sherbimit te huase dhe do te derdhe e mbaje ne kete llogari rezerve huaje gjendjen qe arrin apo tejkalon shumen e sherbimit te huas te 6 muajve pasardhes (p.sh. principalin dhe interesin), perfshi ketu edhe huan sipas Kontrates se Transhit te Huas Shteterore e cila preferohet kundrejt pagesave per Huadhenesit e Nenrenditur apo Ortaket ose ata te Kuotes Junior;

(cc) do te siguroje qe raporti midis shumes se pergjithshme te Garancise se Transhit te Huas Shteterore te papaguar ne fund te Fazes A Punimet e Ndertimit dhe shumes se Huas Kryesore te

Shoqerise te papaguar po ne ate kohe te mos kaloje 9/33.845;

(dd) do te siguroje qe Transhi i Huase Shteterore te mos terhiqet me shpejt se shlyerja perpjestimore e pjeseve te Kapitalit nga Ortaket;

(ee) do te siguroje qe Transhi i Huase Shteterore te shfrytezohet vetem per qellimin e ndertimit te Rruges se Re Hyrese (perfshire ndricimin e pranuar te rruges), Ures se Re dhe per ndonje qellim tjeter te pranuar nga Shoqeria, Qeveria e Shqiperise dhe Huadhenesi(t) Kryesor(e);

(ff) kur nuk parashikohet shprehimisht ndryshe ne kete Kontrate, nuk do te krijoje hua te metejshme te renditura pari passu ose te shkalles superiore ne raport me Huan Shteterore apo Garancine e Transhit te Huase Shteterore, pa miratimin paraprak me shkrim te Ministrise se Finances se Republikes se Shqiperise; dhe

(gg) do te siguroje qe Kontrata e Transhit te Huas Shteterore te mos permbaje asnje dispozite sipas se ciles (i) Huadhenesi perkates si huadhenes ne Kontraten e Transhit te Huas Shteterore te jete ne gjendje te vendose ne cfaredolloj menyre ndonje Barre Siguruese mbi aktivet e Shoqerise, dhe (ii) Huadhenesi te mund te kete te drejten e ndarjes me Shoqerine te kompensimit qe i eshte paguar Shoqerise nga Qeveria e Shqiperise sipas kesaj Kontrate. Per te shmangur dyshimet, kjo dispozite nuk shteron te drejten e Bankes Europiane per Rindertim dhe Zhvillim te vendose Barre Siguruese mbi aktivet e Shoqerise lidhur me Huan Kryesore (pervec Transhit te Huas Shteterore).

4.3 Detyrimet Kryesore te Shoqerise

Detyrimet Kryesore **("Detyrimet Kryesore")** te Shoqerise jane:

(a) operimi i Aeroportit per qellime te aviacionit civil, perfshi ketu mbajtjen e Aeroportit funksional dhe te gatshem per perdorim gjate gjithe kohes se aryeshme.

(b) berja e Masterplanit te Perditesuar te Aeroportit ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcein 18 (MasterPlani dhe Planifikimi i Mjediseve);

(c) projektimi, ndertimi, venia ne funksionim dhe mirembajtja e Fazes A te Terminalit te Ri ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcen 19 (Faza A e Terminalit te Ri) dhe Shtojcen 37 (Kerkesat Operacionale per Terminalin e Ri);

(d) te riperterije, vere ne pune dhe mirembaje Terminalin Ekzistues ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcein 21 (Terminali Ekzistues);

e) te projektoje, ndertoje, vere ne pune dhe mirembaje Fazen A te Qendres se Re te Kargos ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcen 22 (Faza A e Qendres se Re te Kargos);

f) te permiresoje rruget lidhese te pistes dhe mirembaje pisten, vend qendrimin e avioneve dhe rruget lidhese, ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcein 23 (Infrastruktura e Anes Ajrore);

g) te perfundoje dhe mirembaje Perimetrin e Rrethimit te Sigurise se Aeroportit ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcen 25 (Rruga e Perimetrit te Aeroportit dhe Rrethimi i Sigurise se Aeroportit);

h) te projektoje, ndertoje dhe mirembaje Rrugen e Perimetrit te Anes Ajrore ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcein 25 (Rruga e Perimetrit te Aeroportit dhe Rrethimi i Sigurise se Aeroportit);

i) te pajise Aeroportin me furnizim te sigurte te energjise elektrike ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcen 26 (Sherbimet komunale). Per te shmangur dyshimet, Qeveria e Shqiperise eshte pergjegjese per furnizimin me energji elektrike nga rrjeti elektrik deri tek Zona e Koncesionit;

j) te siguroje furnizimin me uje te Aeroportit ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcen 26 (Sherbimet Komunale). Ne rast te prezantimit te nje rrjeti ujor kombetar nga Qeveria e Shqiperise, Palet do te negociojne ne mirebesim per furnizimin me uje nga nje rrjet i tille furnizimi kombetar te Zones se Koncesionit.

k) te siguroje, mbaje ne funksionim dhe mirembaje nje sistem per trajtimin e ujrave te zeza dhe te mbeturinave ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcen 26 (Sherbimet Komunale);

l) te projektoje, ndertoje, vere ne funksionim dhe mirembaje Rrugen Qarkulluese te Aeroportit dhe Fazen A te Parkimeve te Automjeteve, ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcen 27 (Rruga e Hyrjes ne Aeroport, Rruga Qarkulluese e Aeroportit, Faza A e Parkimeve te Automjeteve);

(m) te siguroje qe Aeroporti te jete i pajisur gjate gjithe kohes me mjete dhe mjedise kundra zjarrit dhe per shpetimin ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcen 29 (Zjarri dhe Shpetimi dhe Kontrollet Perkatese);

(n) te siguroje dhe mirembaje ndricimin tokesor te fushes se uljes ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcen 28 (Ndricimi Tokesor);

(o) te siguroje heqjen e te gjitha pengesave nga brezi i fushes se uljes ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcen 23 (Infrastruktura Ajrore);

(p) te projektoje, ndertoje, vere ne funksionim dhe mirembaje Ndertimet e Reja te Furnizimit me Karburant ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcen 48 (Ndertimet e Reja te Furnizimit me Karburant), perfshi edhe te drejten e lidhjes se nen-kontratave;

(q) te mirembaje Zonen e Koncesionit ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcen 40 (Mirembajtja e Aeroportit);

(r) te pajise Zyrat e Reja Administrative ne Terminalin Ekzistues ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcen 21 (Terminali Ekzistues);

(s) te projektoje, ndertoje, vere ne pune dhe t'i transferoje Qeverise Shqiptare Rrugen e Re Hyrese ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcen 32 (Rruga e Re Hyrese); dhe

(t) te projektoje, ndertoje, vere ne pune dhe t'i transferoje Qeverise se Shqiperise Uren e Re sic eshte vendosur vendosura ne Shtojcen 27 (Rruga Hyrese e Aeroportit, Rruga Qarkulluese e Aeroportit dhe Faza A e Parkimit te Automjeteve).

4.4 Detyrime Shtese te Shoqerise

Detyrimet Shtese ("Detyrime Shtese ") te Shoqerise jane per te:

a) projektuar, konstruktuar, operuar dhe mirembajtur Fazen B te Terminalit te Ri ne perputhje me kerkesar e vendosura ne Shtojcein 30 (Faza B e Terminalit te Ri dhe Faza B e Parkimeve te Automjeteve);

b) projektuar, konstruktuar, operuar dhe mirembajtur Fazen B te e Parkimeve te Automjeteve ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcein 30 (Faza B e Terminalit te Ri dhe Faza B e Parkimeve te Automjeteve);

c) projektuar, konstruktuar, operuar dhe mirembajtur Fazen B te Qendres se Re te Kargos Ajrore ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Shtojcein 31 (Faza B e Qendres se Re te Kargos Ajrore); dhe

d) projektuar, konstruktuar, operuar dhe mirembajtur Zgjatimin e Pistes dhe punimet perkatese ne perputhje me kerkesat e vendosura ne Piken 4.8 (Zgerimii i Pistes) dhe ne Shtojcen 23 (Infrastruktura e Anes Ajrore).

4.5 Kerkesa dhe Rishikimi i Detyrimeve Shtese te Shoqerise

a) Pas ndodhjes se nje Ngjarjeje Shkakesore dhe brenda afatit tre mujor, Shoqeria do te dorezoje nje propozim (perfshi, pa kufizuim, detajet teknike) tek Organi Shteteror i Autorizuar ne lidhje me Detyrimin(et) Shtese. Vetem ne se Organi Shteteror i Autorizuar leshon, brenda dhjete (10) diteve te marrjes se propozimit, nje njoftim kundershtimi (sipas formes se Aneksit 52 (Njoftime Kundershtimi)), propozimi do te quhet i miratuar nga Organi Shteteror i Autorizuar dhe Shoqeria duhet te permbushe Detyrimet Shtese te miratuara, brenda Periudhes se Zbatimit te caktuar, ne perputhje me Shtojcen 6 (Sanksione per Mospermbshje te Detyrimeve Shtese), ose te nje Periudhe tjeter Zbatimi te pranuar me shkrim ndermjet Shoqerise dhe Organit Shteteror te Autorizuar. Nje Periudhe e tille Zbatimi, ne perputhje me Shtojcen 6, nuk do te filloje perpara se nje detyrim i tille shtse te miratohet nga Huadhenesi Primar, me kusht qe nje miratim i tille te mos vonohet be menyre te paarsyeshme. Organi Shteteror i Autorizuar mund vetem te leshoje nje njoftim te tille kundershtimi, nese per mendimin e tij te aresyeshem, propozimi nuk eshte ne perputhje me kushtet e kesaj Kontrate ose parashikimet e Ligjit te Zbatueshem;

b) Nese, per mendimin e aresyeshem te Shoqerise dhe duke siguruar se Shoqeria nuk ka bere shkelje te ndonje nga detyrimeve te saj sipas kesaj Kontrate dhe te Dokumenteve te Financimit, plotesimi nga Shoqerisa i Detyrimit Shtese ka ndikim direkt ne aftesite e saj per te paguar kostot operacionale, Sherbimin e Borxhit Kryesor, apo cdo detyrim sipas Dokumenteve te Financimit ne dy (2) vjetet e ardhshem, Shoqeria mund te kerkoje nje rishikim te pavarur (nga nje shoqeri konsulence e kualifikuar dhe e pavarur) te problemeve ekonomike dhe financiare te Shoqerise ne permbushjen e Detyrimit Shtese. Mbi bazen e rezultateve te nje rishikimi te tille te pavarur, Palet duhet te negocionojne me besim te plote per nje rishikim te programit te implementimit dhe/ose specifikimin e Detyrimeve Shtese.

4.6 Detyrimet e Shoqerise ne Lidhje me Programet Perkatese

Shoqeria do te bashkepunoje me DPAC dhe ANTA, perfshi keshilltaret e tyre respektive dhe kontraktoret ne lidhje me zhvillimin, ndertimin ose operimin e punimeve si me poshte:

a) kullen e re te trafikut ajror dhe qendren e operimeve; dhe

b) paisjet e sherbimit te trafikut ajror, pajisjes se doplerit me frekuence shume te larta shumedrejtimesh te matjes se distances/rrezes (DVOR/DME) dhe sistemin e uljes instrumentale (ILS) dhe zhvendosjen e radarit sekondar;

(c) testimin e fluturimeve dhe kalibrimin e procedurave te avionit; dhe

(d) instalimin e pajisjeve te reja ose zevendesimin e paisjeve nga DPAC ose ANTA, si te jete e aplikueshme, dhe kalibrimin dhe testimin e fluturimeve te paisjeve te tilla.

Qe nje bashkepunim i tille te kete efekt, Shoqeria, me marrjen e nje njoftimi paraprak dhe vezhgimit te kerkesave te sigurise se aplikueshme, do t'i jape DPAC dhe/ose ANTA-s (perfshi keshilltaret dhe kontraktoret e saj), sipas rastit, t'i lejoje te kene hyrje ne pjeset perkatese te Zones se Koncensionit per te zbatuar te drejtat dhe detyrat e tyre.

Me qellim per te patur efekt nje kooperim i tille, Qeveria e Shqiperise duhet te siguroje se gjate Periudhes se Koncensionit, ANTA te vezhgoje kerkesat e vendosura ne Shtojcen 35 (ANTA).

4.7 Detyrimet e Shoqerise Lidhur me Terminalin Ekzistues dhe Terminalin e Ri

Shoqeria do te siguroje qe Terminali Ekzistues dhe Terminali i Ri te manaxhohen dhe te operohen gjate gjithe kohes ne perputhje me kete Kontrate dhe Praktikat e Industrise se Mire, subjekt i cfaredo Derogimi te Miratuar ne fuqi. Ne vecanti Shoqeria do te siguroje se:

a) Mjedise Operuese te jene te vlefshme per perdorim ne Terminalin e Ri nga Data e Hapjes se Fazes A te Terminalit te Ri deri ne Daten e Dorezimit.

b) Terminali Ekzistues te operohet ne perputhje me Shtojcen 21 (Terminali Ekzistues) deri ne Fazen A te Dates se Hapjes te Terminalin te Ri,

(c) plani i administrimit dhe operimit te pergatitet nga Shoqeria jo me vone se Fazen A te Dates se Hapjes se Terminalit te Ri dhe nje plan i tille te perfshije Manualin e Aerodromit dje ate te Mirembajtjes se Aeroportit dhe Operacionet si dhe dhe Manuale te tjera si pjese integrale e tij;

(d) ventilimi dhe sistemi i ajrit te kondicionuar ne Terminalin Ekzistues dhe ne Terminalin e Ri te jene operacional ne te gjitha zonat ne perdorim (kur keto zona ne perdorim, jane objekt i kerkesave te mirembajtjes normale);

(e) automjetet dhe pajisjet dhe sistemet e tjera te levizjes se pasagjereve do te transportojne pasagjeret ne nisje nga Terminali i Ri ose Terminali Ekzistues (sipas rastit) tek avioni dhe te transportojne pasagjeret ne mberritje nga avioni tek Terminali i Ri ose Terminali Ekzistues (sipas rastit);

(f) automjetet e mbrojtjes ndaj zjarrit dhe te sigurise si dhe pajisjet emergjente te jene ne gatishmeri dhe ne gjendje te pershtatshme sipas shkalleve te aktiviteteve ne Aeroport, ne perputhje me kete Kontrate, Ligjin e Zbatueshem dhe Konventat dhe keto automjete te emergjences dhe pajisje te kene gjate gjithe kohes hyrje te lire ne Zonen e Koncensionit, piste, rruget lidhese, vendqendrim te avioneve, Terminalin Ekzistues, (sipas rastit) dhe ne Terminalin e Ri;

(g) te vendose ne zonat publike ne Zonen e Koncensionit shenja te lexueshme dhe te kuptueshme lehtesisht ne te dy gjuhet shqip dhe anglisht me simbole te qarta te njohura nderkombetare;

(h) shenjat e reklamave dhe shenja te tjera te pershtatshme te mos pengojne sinjalizimet e informacionit te Aeroportit;

4.8 Zgjatimi i Pistes

(a) Nese Shoqeria do te marre ndonje Kerkese per Zgjatimin e Pistes, e dorezuar nga Organi Shteteror i Autorizuar, , Shoqeria do te pergatise dhe t'i dorezoje Propozimin per Zgjatimin e Pistes Komitetit te Rishikimit te Pavarur, jo me vone se nentedhjete (90) dite pas marrjes se Kerkeses per Zgjatimin e Pistes. Komiteti Rishikimit te Pavarur do te jape rekomandimet e tij tek Palet ne lidhje me Propozimin per Zgjatimin e Pistes. Ky Propozimin per Zgjatimin e Pistes do te perfshije:

(i) propozime teknike per Zgjatimin e Pistes, perfshi token e kerkuar per t`u blere, brezat shoqerues, sistemet e ndricimit dhe rruget lidhese perkatese

(ii) nje propozim prokurimi i bazuar ne procedurat e prokurimit konkurues, perfshi vleresimin e kostos te konfirmuar si te arsyeshme nga nje Inxhinier i Kualifikuar, propozimi per prokurim do te perfshije dy (2) per qind te Kostos se Kapitalit te vleresuar (perjashtuar fondet rezerve)

pagesen e mbikeqyrjes per Shoqerine. Asnje pagese tjeter nuk do te behet tek Shoqeria ne lidhje me Zgjatimin e Pistes, pervec per rritjen e aplikueshme te Pagesave per Sherbimet e Aeroporti; dhe

(iii) nje propozim financimi te bazuar ne financimin me te favorshem me ane te huas se disponueshme per Shoqerine dhe i miratuar nga Huadhenesi, nje norme e pranuar e rikthimit te Kapitalit dhe perfshirja e ndonje rritje te propozuar ne Pagesat per Sherbimet e Aeroportit, ndonje ndryshim te propozuar ne Kuoten Junior dhe ndonje zgjatje te propozuar te Afatit se Koncensionit.

(b) Shoqeria ka detyrim te beje me shume se nje (1) Propozim te Zgjatimit te Pistes brenda nje periudhe (12) muajore gjate Afatit te Koncesionit. Me marrjen e rekomandimit nga Komiteti i Shqyrtimit te Pavarur per Propozim te Zgjerimit te Pistes dhe miratimin e shkruar te Huadhenesit Primar, me kusht qe nje miratim I tille te mos vonohet pa arsye, Qeveria e Shqiperise do te siguroje qe ndonje Organi Shteteror perkates, ta rishikoje ate dhe jo me vone se gjashtedhjete (60) dite te marrjes se tij nga Qeveria e Shqiperise, do te vendose mbi te. Nese Qeveria e Shqiperise ose Enti Shteteror kompetent nuk mund te marre vendimin ne nje kohe te tille limit, Qeveria e Shqiperise ose Enti Shteteror kompetent, sipas rastit, do te gjykohet se e ka miratuar Propozimin e Zgjerimit te Pistes.

(c) Pavaresisht nga sa shprehet ndryshe ne kete kontrate, ndertimi i Zgjerimit te Pistes do te jete Objekt i Shpronesimeve te Tokes se Kerkuar, (perfshi, nese eshte e rendesishme, sistemin e ndricimit pas tij) dhe te rruges se perimetrit te jashtem qe qarkohet rreth zones se Zgjatimit te Pistes (perfshi, nese shihet e rendesishme, sistemin e ndricimit pas tij).

(d) Qeveria e Shqiperise dhe Shoqeria do te rishikojne Pagesat per Sherbimet e Aeroportit dhe do t'i ndryshoje ato ne se bihet dakort, ne perputhje me Propozimin e Miratuar Zgjerimit te Pistes.

(e) Shoqeria do te filloje ndertimin e Zgjatimit te Pistes jo me vone se tre (3) muaj pas miratimit te Propozimit te Zgjatimit te Pistes, duke siguruar se jane marre te gjitha autorizimet e nevojshme nga Shoqeria dhe se e gjithe toka e kerkuar per ndertimin e Zgjatimit te Pistes eshte shpronesuar nga Qeveria e Shqiperise.

(f) Ne varesi te nenpikes (b) me siper, vetem Qeveria e Shqiperise dhe Shoqeria mund te bien dakort mbi baza teknike dhe komerciale per ndertimin e Zgjatimit te Pistes.

4.9 Certifikata e Perfundimit

(a) Me permbushjen nga Shoqeria te Detyrimeve Kryesore dhe Detyrimeve Shtese, sipas Shtojces 5 (Sanksionet Per Mospermbushje te Detyrimeve Kryesore) dhe Shtojces 6 (Sanksionet per Mospermbushje te Detyrimeve Shtese) (per qellim te kesaj Pike 4.9, "Detyrimet"), ne perputhje me kushtet dhe afatat e kesaj Kontrate, Inxhinieri i Pavarur apo Inxhinieri i Kualifikuar sipas Rastit, do te leshojne Certifikaten e Perfundimit me ane te se ciles konfirmojne permbushjen e Detyrimeve ne perputhje me kete Kontrate. Ne perputhje me Piken 4.9(b), me marrjen e Certifikates se Perfundimit nga Qeveria Shqiptare, certifikate e cila verteton qe te gjitha Detyrimet Kryesore dhe, neqoftese eshte rasti, Detyrimet Shtese te Shoqerise jane permbushur ashtu sic duhet, Qeveria Shqiptare nuk do kete me te drejte te kerkoje zbatimin e dispozitave te parashikuara ne Shtojcen 5 (Sanksionet per Mospermbushjen e Detyrimeve Kryesore) dhe Shtojca 6 (Sanksionet per Mospermbushjen e Detyrimeve Shtese).

(b) Leshimi i Certifikates se Perfundimit nuk do te cenoje te drejtat qe Qeveria Shqiptare mund te kete sipas ligjit apo kontrates (perfshi ketu pa kufizim dhe kete Kontrate) ne lidhje me punet e kryera nga Shoqeria ose Kontraktoret e saj ne lidhje me Koncesionin apo anasjelltas.

5. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E QEVERISE SE SHQIPERISE

5.1 Te Drejtat e Qeverise se Shqiperise

Pa u kufizuar ne te drejtat e tjera qe Qeveria e Shqiperise mund te kete sipas kesaj Kontrate, nese pas nje afati te arsyeshem ndreqjeje te dhene nga Qeveria e Shqiperise, Shoqeria:

a) do te jete ne shkelje te ndonje koeficienti te pritshem finaciar ne ndonje prej Dokumenteve Financiare, perfshire, pa u kufizuar, Kontraten e Transhit te Huas Shteterore, ose

b) nuk do t'i paguaje Qeverise se Shqiperise ndonje pjese te Pageses se Garancise Transhit te Huas Shteterore se Infrastruktures Publike qe eshte per t'u paguar,

Qeveria e Shqiperise ka te drejte te caktoje nje anetar jo-ekzekutiv ne Keshillin Administrative te Shoqerise. Shoqeria do te siguroje qe Statuti i saj ta pasqyroje qarte kete te drejte te Qeverise se Shqiperise.

5.2 Detyrimet e Qeverise se Shqiperise

Pavaresisht nga ndonje parashikim tjeter i kundert ne kete Kontrate ose ndonje detyrim tjeter

qe do te permbushet nga Qeveria e Shqiperise sipas kesaj Kontrate, Qeveria e Shqiperise do te, dhe do t`i caktoje Organit Shteteror te Autorizuar dhe ndonje Enti Shteteror te:

(a) jape, perterije ose zgjate te gjithe Autorizimet ne perputhje me Piken 2.5(b) dhe (c) (Autorizimet);

(b) t'i siguroje Shoqerise nje ndihme te tille qe Shoqeria ne menyre te arsyeshme mund te kerkoje per dhenien, perteritjen ose zgjatjen nga Shoqeria te Autorizimeve (pervec Autorizimeve te Dhena falas) te kerkuara per ushtrimin e te drejtave te Shoqerise dhe detyrimeve sipas kesaj Kontrate;

(c) t'i siguroje Shoqerise te dhena dhe informacion te rendesishem per permbushjen e detyrimeve te Shoqerise ne kete Kontrate, dhe/ose te dhena e informacion qe kerkohen per menaxhimin, operimin dhe zhvillimin e Projektit, dhe te informoje Shoqerine per cdo ndryshim ose shtese, dhe t'i dorezoje Shoqerise kopje te ketij informacioni dhe te te dhenave te kerkuara ne menyre te arsyeshme.

(d) te siguroje qe Shoqerise t'i jepet, pa pagese ose detyrim financiar te gjitha te drejtat e kalimit, lehtesirat dhe te drejta te tjera pronesie, dhe te drejta reale te kerkuara nga Shoqeria per te zbatuar detyrimet e saj sipas kesaj Kontrate (per te shmangur dyshimet, asnje kompensim ose pagese nuk do te kryhet nga Shoqeria sipas Ligjit te Zbatueshem per pronaret e tokes ose te pasuesve te tyre, ose te ndonje Enti tjeter Shteteror);

(e) te jape, me kerkese te Shoqerise, dhe pa asnje kosto e vonese te paarsyeshme informacione, dokumente dhe regjistrime qe kane te bejne ose qe kane lidhje me Projektin qe Organi i Autorizuar Shteteror ka ne zoterim te tij dhe te cilin Shoqeria e kerkon me qellim per te permbushur detyrimet e saj sipas kesaj Kontrate ;

(f) te siguroje se asnje Organ Shteteror:

(i) nuk do te ndermarre ndonje veprim;

(ii) te mos jete ne gjendje te ndermarre ndone veprim nese keshtu kerkohet sipas Ligjit te Zbatueshem, qe mund te pengoje ose te nderhyje ne zbatimin e Projektit, operimet eficente te Projektit ose te permbushjes nga Shoqeria te kushteve te kesaj Kontrate, perfshi ushtrimin nga Shoqeria te te drejtave te transferimit te fondeve dhe pagesave pa kufizime dhe pa vonesa, ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem;

(g) t'i jape punonjesve te Shoqerise dhe Kontraktoreve te Shoqerise te gjitha vizat perkatese dhe dokumentet per te hyre ne Republiken e Shqiperise si dhe te lejeve te nevojshme te qendrimit; dhe

(h) ne menyre te pergjithshme te bashkepunoje me Shoqerine me besim te plote dhe ne interes te implementimit te Projektit, dhe nese eshte e aplikueshme, implementime te tjera;

(i) pervec kur eshte thene shprehimisht ne kete Kontrate, te mos kete nderprerje te projektit, ndertimit, perfundimit, benies ne pune, mirembajtjes, financimit, funksionimit dhe menaxhimit te Aeroportit nga Shoqeria;

(j) te jete ne perputhje me traktatet nderkombetare ne te cilat Republika e Shqiperise aderon (perfshi ato me politikat e qiejve te hapur) me qellim per te cuar ne maksimum nivelin e sherbimeve ajrore per dhe nga Republika e Shqiperise;

(k) te siguroje qe Ligji i Zbatueshem, per aq sa eshte e nevojshme per permbushjen e te drejtave dhe te detyrimeve sipas kesaj Kontrate, te jete ne perputhje me Konventat (perfshi, por pa u kufizuar ne Konventen e Cikagos).

(l) te siguroje qe kushtet uniforme te jene te gatshme per perdorim nga avionet e cdo shteti qe ka pranuar dhe ratifikuar Konventen e Cikagos, te te gjitha mjeteve ndihmese te lundrimit ajror, te cilat mund te sigurohen nga Republika e Shqiperise per perdorim publik, per sigurine dhe drejtimin e lundrimit Ajror;

(m) te siguroje mjetet ndihmese per doganen dhe procedurat operative te imigrimit qe prekin navigimin nderkombetar ne perputhje me praktikat e vendosura, ose te rekomanduara here pas here dhe te bazuara ne Konventen e Cikagos;

(n) te siguroje pranine e duhur te policise ne Aeroport;

(o) te siguroje parashikimin ne Republiken e Shqiperise, te sherbimit me radio, sherbimet meteorologjike dhe mjete te tjera ndihmese te lundrimit ajror me qellim per te lehtesuar navigimin ajror nderkombetar, ne perputhje me konventat dhe gjuhen Angleze;

(p) te adoptoje dhe te vere ne operim sisteme te pershtatshme te procedurave te komunikimit; kodet, shenjat, sinjalet dhe ndricimin, rregulla dhe praktika te tjera operative ne perputhje me

konventat dhe gjuhen Angleze;

(q) te pergatise dhe te publikoje te gjitha hartat e nevojshme aeronautike dhe harta te tjera te kerkuara nga operatoret per perdorim ne Aeroport;

(r) te siguroje qe asnje Autorizim te mos leshohet per perdorim, ndertim ose konstruksion te ndertimeve ose instalimeve ne Zonen e Kufizuar ne kundershtim me kufizimet e zbatueshme te ruajtjes dhe sigurise. Nese kjo kerkohet nga Shoqeria, cfaredo strukture e re qe prek sigurimin dhe sigurine teknike te Aeroportit duhet te shembet nga Qeveria e Shqiperise, dhe pa asnje kosto ne ngarkim te Shoqerise, ne varesi te Ligjit te Zbatueshem. Qeveria e Shqiperise duhet te ndaloje dhe/ose te heqe, ne varesi te Ligjit te Zbatueshem, cdo aktivitet komercial ne Zonen e Zhvillimit qe, ne menyre te drejtperdrejte, konkuron Detyrimet Baze dhe Detyrimet Shtese te Shoqerise;

(s) te siguroje furnizimin me energji elektrike nga rrjeti elektrik deri ne Zonen e Koncesionit.

(t) te negocioje me besim te plote me Shoqerine mbi furnizimin me uje nga rrjeti kombetar tek Zona e Koncesionit ne rast te futjes se nje rrjeti te tille nga Qeveria e Shqiperise;

(u) te siguroje qe Aeroporti te lejohet te funksionoje 24 ore ne dite pa ndonje limit ose kufizim te cdo lloji; dhe

(v) te siguroje se gjate Afatit te Koncesionit asnje aeroport tjeter per fluturime nderkombetare komerciale (pasagjer dhe kargo) te mos licensohet, autorizohet dhe te mos veproje ne Republiken e Shqiperise me perjashtim te uljeve emergjente. Per te shmangur ndonje paqartesi, asgje ne kete Kontrate nuk do te kufizoje perdorimin e ndonje aeroporti ne Republiken e Shqiperise me qellim te dhenies se ndihmave humanitare ose te ndihmes se asistences ne kohe katastrofe ose te emergjencave civile ne Republiken e Shqiperise apo ne territoret fqinje.

6. PROJEKTI DHE NDERTIMI

6.1.Projekti Teknik i Miratuar dhe Master Plani i Perditesuar i Aeroportit

(a) Shoqeria do te siguroje se Punimet e Ndertimit, projekti, ndertimi, perfundimi dhe venia ne pune e Aeroportit, perfshire ndonje Ndryshim te Pranueshem, dhe te gjitha punet, materialet, pajisjet, sistemet dhe procedurat e perfshira ne lidhje me to, do te jene ne pajtueshmeri dhe ne perputhje me Projektin Teknik te Pranuar, Master Planin e Perditesuar te Aeroportit, Standardet dhe Ligjin e Zbatueshem.

(b) Asnje Projekt Teknik i Pranuar nuk mund te ndryshohet, modifikohet ose te shmanget nga Komiteti i Pavarur i Rishikimit, pervec kontrates ndermjet paleve ne vijim te nje korrespondence rekomandimi te ketyre ndryshimeve, modifikimeve ose shmangieve te propozuara nga Komiteti i Pavarur i Vleresimit.

6.2. Projektimi

(a) Shoqeria do te siguroje qe, duke filluar qe nga data qe materialet dhe dokumentet ne lidhje me projektin te sigurohen, te kete pronesi te plote dhe te garantuar te te Drejtave te Prones Intelektuale ne skicat per projektet e bera dhe materiale te tjera e dokumente te prodhuara nga ose ne interes te Shoqerise per qellim te Projektit, ose do te kete nje license te parevokueshme, pa royalty, jo-eskluzive dhe te transferueshme, qe te kete te drejten te leshoje nen-licensa dhe te kopjoje, riprodhoje, modifikoje, perktheje dhe te perdore te gjitha keto skica projektesh te bera, materiale dhe dokumente per cdo qellim ne lidhje me Projektin.

(b) Asnje paraqitje e ndonje prej skicave ose dokumenteve ne perputhje me kete Kontrate, as miratimi ose mosmiratimi i saj, asnje ngritje pikepyetjesh, asnje kundershtim apo berje komentesh, sugjerimesh ose rekomandimesh mbi to nga ndonje Person tjeter pervec Paleve, nuk mund te cenoje ose preke ndonje nga Detyrimet e Shoqerise sipas kesaj Kontrate, i cili nuk mund te shkarkohet, çlirohet ose modifikohet ne asnje aspekt.

6.3. Ndertimi

(a) Shoqeria do te jete pergjegjese per zbatimin, kryerjen dhe venien ne pune te Punimeve te Ndertimit dhe do te perballoje te gjitha kostot dhe riskun ne lidhje me Punimet e Ndertimit ne perputhje me kete Kontrate. Detyrimet e Shoqerise do te pershijne, nder te tjera:

(i) zbatimin, kryerjen dhe venien ne pune te Punimeve te Ndertimit ne perputhje me:

(1) Ligjin e Zbatueshem dhe te gjitha Autorizimet e kerkuara (perfshi, por pa u kufizuar ne, Autorizimet e Dhena);

(2) Praktikat e Mira te Industrise;

(3) te gjitha kerkesat e tjera te kesaj Kontrate, perfshire, por pa kufizuar ne Projektin Teknik

te Pranuar, Kerkesat Teknike, Detyrimet Baze, dhe Detyrimet Shtese, Master Planin e Perditesuar te Aeroportit dhe Standartet e vendosura ne Shtojcen 17 (Kodet, Standardet, Rregulloret dhe Publikime te tjera)

(ii) organizimin e Zones se Koncesionit gjate afatit te ndertimeve ne lidhje me kujdesin per sigurine, mbrojtjen ndaj zjarrit, sigurimin, transportin, shperndarjen e mallrave, materialeve, makinerine dhe pajisjet, kontrollin e ndotjes, mirembajtjen e personelit kompetent, dhe marredheniet e punes dhe industriale si edhe me sherbimet e pergjithshme, perfshire, por pa u kufizuar ne kerkesen qe Kontraktoret e Shoqerise te marrin te gjitha masat e arsyeshme per te siguruar sigurine teknike ne menyrat e tyre te ndertimit dhe ne aktivitetet me qellim mbrojtjen e jetes, shendetit, prones dhe ambientit;

(iii) siguroje qe Punimet e Ndertimit dhe punimet e tjera te perfshijne vetem materiale dhe mallrat te jene te forta dhe te nje cilesie te tregetueshme ne peruthje me kete Kontrate;

(iv) kerkesen qe Kontraktoret e Shoqerise te marrin te gjitha masat e arsyeshme per te minimizuar nderprerjen dhe problemet e tjera me bizneset e vendosura ne Zonen e Koncesionit gjate ndertimit; dh

(v) vetem nese eshte shprehur ndryshe ne kete Kontrate, te beje kerkesen dhe te marre (me ndihmen dhe bashkepunimin e Organit Shteteror te Autorizuar) ne kohen e duhur dhe me pas t'i ruaje, te gjitha Autorizimet perkatese te kerkuara per implementimin e Projektit dhe te kesaj Kontrate

(b) Shoqeria do te filloje ndertimin e Fazes A te Terminalit te Ri jo me vone se tre (3) muaj pas Dates se Fillimit.

(c) Sa me shpejt te jete e volitshme ne menyre te arsyeshme pas Dates se Fillimit, Shoqeria do te filloje planifikimin e levizjes nga Terminali Ekzistues ne Fazen A te Terminalit te Ri. Si pjese e ketij procesi, Shoqeria do te konsultohet me Organin Shteteror te Autorizuar dhe Perdoruesit e Aeroportit per te lehtesuar levizjen e stafit te Perdoruesve te Aeroportit dhe te pajisjeve ne Fazen A te Terminalit te Ri. Qeveria e Shqiperise nuk do te jete pergjegjese per cfaredo kosto ne lidhje me mbylljen e Terminalit Ekzistues dhe me levizjen nga Terminali Ekzistues ne Fazen A te Terminalit te Ri.

(d) Shoqeria do te siguroje qe cdo Detyrim Baze te plotesohet jo me vone se Afati i Kerkuar te Detyrimeve te vendosur ne Shtojcen 5 (Sanksionet per Mospermbushje te Detyrimeve Baze). Nese nje Detyrim Baze nuk plotesohet para ose ne nje date te tille, Shoqeria do t'i paguaje Qeverise se Shqiperise, ne Diten e pare te Punes te cdo muaji, shumen e sanksionit per dite per mospermbushje te nje Detyrimi Baze te tille te vendosur ne Shtojcen 5 (Sanksione per Mospermbushje te Detyrimeve Baze).

(e) Shoqeria do te siguroje qe cdo Detyrim Shtese te plotesohet jo me vone se data e fundit e Afatit te Zbatimit perkates te vendosur ne Shtojcen 6 (Sanksione per Mospermbushje te Detyrimeve Shtese). Nese nje Detyrim Shtese nuk plotesohet para ose ne nje date te tille Shoqeria do t'i paguaje Qeverise se Shqiperise, ne Diten e pare te Punes te cdo muaji, shumen e denimit per dite, per mospermbushje te nje Detyrimi Shtese, te vendosur ne Shtojcen 6 (Sanksione per Mospermbushje te Detyrimeve Shtese).

(f) Palet, me marreveshje te tyre do te caktojne bashkerisht nje inxhinier te pavarur te pershtatshem te kualifikuar, me ane tenderi te hapur, transparen dhe te drejte nderkombetar midis shoqerive te percaktuara ne Shtojcen 8 (Inxhinieri i Pavarur), perpara dates se fillimit. Brenda 30 diteve pas Dates se Fillimit, Shoqeria do te emeroje Inxhinierin e Pavarur. Shoqeria do te siguroje qe Inxhinieri i Pavarur te lidhe nej marreveshje sherbimi me Shoqerine e cila do te shqyrtohet dhe miratohet bashkerisht nga Organi Shteteror i Autorizuar dhe Shoqeria ne perputhje me permbledhjen e fushes se sherbimeve per t'u kryer nga Inxhinieri i Pavarur te sipas Shtojces 8 (Inxhinieri i Pavarur). Shoqeria do te perballoje kostot dhe shpenzimet e Inxhinierit te Pavarur.

Neqoftese, para Dates se Fillimit, nuk arrihet marreveshje per personin e Inxhinierit te Pavarur dhe kushtet e marreveshjes se sherbimit, atehere do t'i kerkohet Huadhenesit Primar qe perzgjedhe Inxhinierin e Pavarur per t'u emeruar nga Shoqeria, ndermjet Shoqerive te renditura ne Shtojcen 8 te cilat paraqesin oferta te vlefshme.

Nese ndera pale nuk eshte dakor me sherbimin e dhene nga Inxhinieri i Pavarur, atehere kjo mosmarreveshje do te zgjidhet ne te njeten menyre qe eshte vendosur ne Piken 36 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve).

(g) Shoqeria do t'i jape Qeverise se Shqipersise dhe Njesise se Zbatimit te Projektit (nepermjet Inxhinierit te Pavarur) informacione dhe dokumente sic jane vendosur ne Shtojcen 54 (Raportim Periodik) dhe Shtojcen 8 (Inxhinieri i Pavarur) . Gjate gjithe kohes se kryerjes se Punimeve te Ndertimit, Shoqeria do te:

(i) publikoje hollesi (nepermjet leshimit te njoftimeve me ane te (NOTAM-eve)) te modifikimeve perkatese te vecorive te projektit dhe/ose ndertimeve te cilat mund te prekin funksionimin e avionit, dhe

(ii) ne rast se Inxhinieri i Pavarur (per cfaredo aresye) nuk ose nuk mund te kryeje detyrat e tij te raportimit tek Njesia e Implementimit te Projektit dhe ne rastin kur nuk ka ndonje Inxhinier te Pavarur te caktuar dhe qe vepron per te dhene raporte te tilla tek Njesia e Implementimit te Projektit mbi perparimin aktual te Punimeve te Ndertimit, ashtu sic Njesia e Implementitmit te Projektit, ne menyre te aresyeshme, mund te kerkoje dhe te jape informacione te tjera perkatese te kerkuara ne menyre te arsyeshme nga Njesia e Implementimit te Projektit.

(h) ne rast se ndonje fosil, antikuar, strukture dhe send tjeter, ose dhe mbetje te vecanta gjeologjike ose me interes arkeologjik, do te zbulohen ne Zonen e Koncesionit ose ne Zonen e Kufizuar apo gjate kryerjes se ndonje punimi, Palet kane te drejten te fillojne nje proces zbulimi arkeologjik ne Zonen e Koncesionit ose ne Zonen e Kufizuar. Kosto e ketyre zbulimeve dhe te vonesave ne plotesimin e detyrimeve te paleve sipas kesaj Kontrate do te perballohen nga Qeveria e Shqiperise.

(i) Punimet e Ndertimit te ndermarra nga Shoqeria do te marrin ne konsiderate, kur eshte e aplikueshme, per qellim te plotesimit te Detyrimeve Baze dhe te Detyrimeve Shtese, nese ka, materialet dhe perfundimet e pershkruara ne Shtojcen 33 (Modelimit), kerkesat e ndricimit te rruges te specifikuara ne Shtojcen 47 (Ndricimi i Rrugeve), kerkesat e peisazhit te pershkruara ne Shtojcen 49 (Panorama) dhe parashikimet perkatese te Shtojcave 24 (Pajisjet e Aerodromit), 45 (Ndertesat Ndihmese-nga Ana e Tokes) dhe 46 (Ndertesat Ndihmese-Ana Ajrore).

6.4. Zona e Kufizuar

(a) Nese Shoqeria demostron tek Qeveria e Shqiperise se ndertimet ose instalimet qe jane arsyetisht te nevojshme per Projektin, nuk mund te ndertohen brenda Zones se Koncesionit, ndertime ose instalime te tilla do te kryhen ne Zonen e Kufizuar, ne varesi te Shpronesimeve te Tokes se Kekuar (me kosto te Shoqerise) ne Zonen e Kufizuar qe kane patur efekt per kete qellim. Ne vijim te Shpronesimeve te Tokes se Kekuar, Shoqeria do te behet perfitues i te Drejtave te Perdorimit te Tokes, te krijoje lehtesira dhe te drejta detyruese te menyrave mbi ate pjese te Zones se Kufizuar mbi te cilen e Drejta e Perdorimit te Prones, mjediset dhe te drejtat detyruese ose menyrat jane te nevojshme me qellim qe te zbatohen ndertime ose instalime te tilla.

(b) Qeveria e Shqiperise duhet te siguroje se:

(i) asnje pjese e Zones se Kufizuar te mos perfshihet brenda ndonje plani urbanistik; dhe

(ii) te mos i leshohet asnje autorizim ndonje pale te trete per te perdorur, ndertuar ose konstruktuar ne Zonen e Kufizuar ne kundershtim me sigurine teknike perkatese dhe kufizimet e sigurimit, ose ne kundershtim me te drejtat e Shoqerise sipas kesaj Kontrate .

(c) Palet bien dakord se brenda dy muajve nga Data e Fillimit, Shoqeria dhe Enti Shteteror perkates ne krye te urbanistikes se qytetit do te takohen per te vendosur proceduren e keshillimit per ndikimin qe ka shfrytezimi i ardhshem i Zones se Kufizuar dhe/ose ndonje ndertim ose instalim nga palet e treta mbi sigurine e jetes.

6.5 Zona e Zhvillimit

(a) Palet bien dakord se, pas Dates se Fillimit, cdo ndertim ose instalim nga Pale te treta ne Zonen e Zhvillimit, pervec ndertesave te banimit (perfshire garazhe deri ne dy automjete per shtepi) ose fermave do te kryhet vetem pasi Organi Shteteror i Autorizuar dhe Shoqeria te kene arritur marreveshje dhe pas miratimit paraprak nga Enti Shteteror perkates.

(b) Qeveria e Shqiperise garanton se:

(i) zona e Zhvillimit do te perfshihet si e tille ne cdo plan urbanistik, dhe

(ii) nuk do t'i jepet asnje autorizim asnje pale te trete per te perdorur, ndertuar ose konstruktuar ne Zonen e Zhvillimit ne kundershtim me te drejtat e Shoqerise ne kete Kontrate dhe me Ligjin e Zbatueshem. Veprime te tilla nga palet e treta perfshijne, pa u kufizuar, parkim makinash, mallra dhe pije, pika shitjeje dhe logjistike; dhe

(iii) nuk lejohet te ndertohet asnje strukture e re ne Rrugen e Re Hyrese (perfshire zonen e bashkengjitur me distance 20 metra nga secila ane e Rruges se Re Hyrese). Per te shmangur ndonje paqartesi, Qeverise se Shqiperise nuk do t'i kerkohet qe:

(1) te rrezoje ndonje prej strukturave ekzistuese ose te ndaloje ndonje aktivitet biznesi ne Zonen e Zhvillimit, nese keto struktura apo aktivitete biznesi jane ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem;

(2) te pengoje perdorimin e ndonje toke ne Zonen e Zhvillimit per qellime bujqesore ose kopshtarie; dhe

(3) te pengoje perdorimin e vazhdueshm te ndonje pjese te Zones se Zhvillimit qe eshte shtepi banimi ekzistuese ose ferme;

(c) Shoqeria mund te ngreje nje mur rrethues te pershtatshem pergjate te dy aneve te shtrirjes 500 metra te Rruges se Re Hyrese me te afert te Aeroportit. Menjehere pas transferimit te Rruges se Re Hyrese tek Qeveria e Shqiperise, Shoqerise do t'i jepet e drejta per te hyre ne kete mur rrethues (nese eshte ngritur nga Shoqeria) dhe do te jete e detyruar per ta mirembajtur sic duhet ate. Gjate Afatit te Koncesionit asnje mase e ndermjetme nuk do t'i shtohet shtrirjes 500 metershe te Rruges se Re Hyrese me te afert te Aeorportit pa u rene dakord ndermjet Paleve.

6.6 Mjediset dhe Inspektimi

(a) Organi shteteror i autorizuar do te:

(i) bashkerendoje dhe lehtesoje te gjitha marreveshjet e Shoqerise me entet e pershtatshme shteterore; dhe

(ii) siguroje qe shoqeria dhe kontraktuesit e Shoqerise te kene hyrje dhe zoterim te lire te Zones se Koncesionit qe i eshte siguruar Shoqerise si perfituese e Uzufruktit aty.

(b) Menjehere pas Dates se Fillimit, per sa eshte ne menyre te arsyeshme e mundur Shoqeria do te keshillohet me Organin e Autorizuar Shteteror dhe çdo Ent Shteteror pergjegjes per funksionet qe do te kryhen nga Qeveria e Shqiperise ose Ent i tille Shteteror ne Aeroport (si funksione imigracioni, sigurie dhe te doganave). Pas ketyre keshillimeve, Shoqeria do t'i dergoje pa vonesa te paarsyeshme Organit te Autorizuar Shteteror dhe çdo Enti te tille Shteteror kalendarin per te cilin eshte rene dakort (siç eshte percaktuar ne Shtojcen 50 (Plani Kohor) per ndertimin e Terminalit te Ri, si dhe t'i jape Organit te Autorizuar Shteteror dhe çdo Enti te tille Shteteror kohe te arsyeshme per te pergatitur plane per instalimin dhe porositja e te gjitha pajisjeve dhe mjeteve te kerkuara per funksionet qe ajo duhet te permbushe ne Aeroport.

(c) Gjate periudhes se kryerjes se çfaredolloj Pune Ndertimi (duke perfshire pune te lidhura pergatitore ne Aeroport), Inxhinieri i pavarur do te mbikqyre perputhjen e Punes se Ndertimit me kete Kontrate dhe te kryeje inspektime te arsyeshme te punes se ndertimit dhe pune te tjera ne prani te nje perfaqesuesi te Shoqerise. Inxhinieri i Pavarur do te siguroje qe nje mbikqyrje dhe inspektime te tilla te mos nderhyjne ne perparimin e ndertimit.

7. FINANCIMI

(a) Shoqeria do te organizohet per fondet e pershtatshme me qellim financimin e Projektit dhe permbushjen e detyrimeve te tij ne baze te kesaj Kontrate.

(b) Perveç dhenies se Garancise se Transhit te Huas Shteterore dhe kur parashikohet shprehimisht ndryshe ne kete Kontrate, qeveria e Shqiperise nuk do te kete detyrim te jape kontribute te çfaredolloji (financiare ose te tjera) ne lidhje me Koncesionin.

(c) Ne rast se ndonje Ortak do te dhuroje Barren Siguruese mbi pjeset qe i takojne atij ne Shoqeri, pas permbushjes nga mbajtesi te ndonje Barre Siguruese mbi ose ne lidhje me pjeset e kapitalit te Shoqerise, ky i fundit do te jete i detyruar nga Statuti i Shoqerise ne ushtrimin e çfaredolloj te drejte bashkengjitur Shoqerise, ose shitjen, transferimin apo ndonje forme dhenie tjeter te pjeseve te kapitalit te Shoqerise. Qeveria e Shqiperise nuk do te jete e detyruar ne lidhje me ndonje lloj financimi ndaj Shoqerise ose nga ana tjeter te krijoje ndonje Garanci mbi ndonje pjese kapitali te Shoqerise qe ajo zoteron.

(d) Shoqeria do te siguroje qe çdo ftese e bere me pikepamjen per te krijuar ndonje financim me qellimin per ose ne lidhje me Koncesionin (ose nepermjet financimit te huas ose pjesemarrjes ne vleren e pasurise se Shoqerise) do te marre nje deklarim te dukshem dhe te qarte qe Qeveria e Shqiperise nuk ben dhe nuk do te kete bere asnje deklarim, qofte ai i shprehur apo i nenkuptuar, ne lidhje me mbarevajtjen e Projektit ose ne lidhje me saktesine e llogaritjeve, parashikimeve ose

projektimeve ose te tjera.

(e) Nese:

(i) nje ndryshim i kundert thelbesor do te kete ndodhur ne perputhje me dokumentin (et) qe rregullon Financimin e Huas Kryesore te Shoqerise.

(ii) nje ndryshim i tille i kundert thelbesor nuk vjen si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve te Shoqerise sipas dokumentit(eve) qe rregullon Financimin e Huas Kryesore te Shoqerise, dhe

(iii) nje ndryshim i tille i kundert thelbesor ka nje ndikim te drejtperdrejte mbi aftesine e Shoqerise per te zvogeluar sipas dokumentit(eve) qe rregullon Financimin e Huas Kryesore te Shoqerise,

Shoqerise do t'i lejojet shtyrja, ne nje baze ditore, e Dates se Detyrimit te kerkuar perkates ose Periudhes perkatese te Implementimit, sipas rastit.

8. Njesia e Zbatimit te Projektit

Njesia e Zbatimit te Projektit do te caktohet nga Organi Shteteror i Autorizuar ne perputhje me dispozitat e Ligjit per Koncesionin dhe me kete Kontrate me qellimin e mbikqyrjes se zbatimit te Projektit dhe te kesaj Kontrate, aktivitete te tilla te Njesise se Zbatimit te Projektit do te asistohen nga Inxhinieri i Pavarur, Inxhinieri i Kualifikuar ose çdo ekspert tjeter i emeruar nga Organi Shteteror i Autorizuar, sipas rastit.

9. Komiteti i Pavarur i Rishikimit

9.1 Anetaret

Komiteti i Pavarur i Rishikimit ("Komiteti i Pavarur i Rishikimit") do te perbehet nga pese anetare, te cilet do te emerohen jo me vone se 30 dite qe nga dita e fillimit, si me poshte:

(a) nje anetar, te jete nje nepunes zyrtar i larte, do te emerohet nga Ministria e Ekonomise e Republikes se Shqiperise;

(b) nje anetar te jete nje nepunes zyrtar i larte i DPAC, qe do te emerohet nga DPAC;

(c) nje anetar te jete partner i nje firme nderkombetare llogarie, qe do te emerohet se bashku nga Shoqeria dhe nga Organi Shteteror i Autorizuar;

(d) nje anetar te jete:

(i) Inxhinieri i Pavarur, gjate periudhes se kryerjes se puneve te ndertimit ne lidhje me permbushjen e detyrimeve baze;

(ii) nje Inxhinier i Kualifikuar, gjate periudhes se kryerjes se puneve te ndertimit ne lidhje me permbushjen e detyrimeve shtese ose, ne mungese te nje Inxhinieri te tille te Kualifikuar, nje perfaqesues nga Huadhenesi Kryesor; dhe

(e) nje anetar te jete nje inxhinier i kualifikuar qe do te emerohet nga Shoqeria.

9.2 Detyrat

(a) Ne rast se nuk parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, Komiteti i Pavarur i Rishikimit nuk eshte i detyruar nga rregulla proceduriale ne permbushjen e detyrave te tij. Ai do te mblidhet vetem kur kerkohet dhe do te:

(i) shqyrtoje çdo variant te propozuar te Master Planit te Perditesuar te Aeroportit dhe do te beje nje rekomandim per te;

(ii) shqyrtoje çdo projekt per Zgjatimin e Pistes dhe te beje nje rekomandim per kete;

(iii) marre ne kosiderate çeshtje te tjera teknike qe kane lidhje me kete Kontrate ashtu si i referohen atij nga secila prej paleve ne menyre te arsyeshme.

(b) Çdo rekomandim nga Komiteti i Pavarur i Rishikimit per te cilin palet nuk jane marre vesh mund te referohet per zgjidhje ne perputhje me Piken 36 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve) nga secila prej paleve.

(c) Te gjitha njoftimet per Komitetin e Pavarur te Rishikimit do t'i dergohen Komitetit te Pavarur te Rishikimit tek personi i adresuar nga Organi Shteteror i Autorizuar, i cili do te beje dorezimin tek Komiteti i Pavarur i Vleresimit. Ky i adresuar do te jete i detyruar te komunikoje menjehere njoftime te tilla tek çdo anetar i Komitetit te Pavarur te Rishikimit

(d) Komiteti i Pavarur i Rishikimit do te mblidhet ne Tirane sipas nevojes.

9.3 Kostot dhe Shpenzimet

Kostot dhe shpenzimet e arsyeshme te Komitetit te Pavarur te Rishikimit perballohen nga Shoqeria, me perjashtim te mbledhjeve te organizuara ne perputhje me Piken 9.2(a)(ii) dhe (iii) (Detyrat) me lart. Kosto te tilla do t'i ngarkohen pales qe ka kerkuar takime te tilla, perveçse ne rastin

e Propozimit te Zgjatimit te Pistes qe vjen si rezultat i nje Kerkese per Zgjatimin e Pistes, do te perballohen gjysma nga Shoqeria dhe gjysma nga Organi Shteteror i Autorizuar. Shoqeria do te demshperbleje cdo antar te Komitetit te Pavarur te Vleresimit, per te gjitha kostot e arsyeshme, shpenzimet, detyrimet financiare dhe/ose demet e pesuara prej tij ne lidhje me permbushjen e detyrave si anetar i Komitetit te Pavarur te Vleresimit

10. PUNONJESIT

10.1 Rregullat e Punesimit

Shoqeria do te jete e autorizuar te percaktoje dhe te ndjeke politiken e saj te punesimit ne perputhje me ligjet e Zbatueshme dhe Praktikat e Industrise se Mire. Shoqeria do te siguroje qe te pakten 60 % e personelit te saj te jene shtetas shqiptare. Shoqeria do te kete nje numer te mjaftueshem punonjesit, te cilet do te kene kualifikimet e pershtatshme, eksperience dhe kompetenca per te kryer aktivitetet e lidhura me Koncesionin.

10.2 Punonjesit Ekzistues te Aeroportit Nene Tereza Sh.A

(a) Shoqeria nuk do te jete e detyruar te punesoje punemarresit e Aeroportit Nene Tereza Sh.A ose te marre persiper ndonje prej kontratave te lidhura mes Aeroportit Nene Tereza Sh.a dhe çdo personi tjeter ne lidhje me punesimin.

(b) Qeveria e Shqiperise dhe Aeroporti Nene tereza Sh.A do te jete e shkarkuar nga te gjitha detyrimet ne lidhje me punemarresit e Aeroportit Nene Tereza Sh.A. Te gjitha rrogat, pagesat dhe kompensime te tjera dhe te gjitha kontributet per te cilat Qeveria e Shqiperise dhe/ose Aeroporti Nene Tereza SH.A eshte pergjegjes si nje punedhenes ne lidhje me secilin prej punemarresve te Aeroportit Nene Tereza Sh.A sipas çdo detyrimi kontraktor apo ligjor dhe çdo pretendim ne lidhje me kete, do te perballohen nga Qeveria e Shqiperise dhe/ose Aeroportit Nene Tereza Sh.a.

(c) Çdo pretendim i punemarresve dhe ish punemarresve te Aeroportit Nene Tereza Sh.A ne lidhje me kompensimin e personave te shkurtuar ose çeshtje te tjera lidhur qofte me punesimin e tyre te Aeroporti Nene tereza Sh.A, qofte me nderprerjen e punesimit te tyre tek Aeroporti Nene tereza Sh.A, do te zgjidhet nga Qeveria e Shqiperise dhe/ose Aeroporti Nene tereza Sh.A.

10.3. Punonjesit e Rinj

Shoqeria mund te identifikoje, rekrutoje, intervistoje dhe punesoje personel te ri punetor dhe profesional, mbikqyres dhe drejtues siç kerkohet ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem, objekt i procedurave te specifikuara ne Shtojcen 39 (Sistemi i Administrimit te Mbrojtjes se Aeroportit), Shtojcen 44 (Siguria dhe Kontrolli i Bagazheve) dhe kjo Pike 10 (Punonjesit).

10.4 Kontraktoret e Shoqerise

Shoqeria mund te punesoje Kontraktore te Shoqerise, shqiptare ose te huaj ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem dhe kete Kontrate.

11. Prania e Ushtrise

11.1. Prania e Ushtrise

Shoqeria do te:

(a) lejoje hyrjen ne Zonen e Koncesionit, piste, rruget lidhese dhe vendqendrimin e avioneve ne Aeroport, te personelit te forcave ajrore dhe Personave te autorizuar nga forcat ajrore (duke perfshire pa u kufizuar, anetaret e forcave te armatosura te shteteve anetare te NATO-s te autorizuara nga forcat ajrore ose nga Ministria e Mbrojtjes se Republikes se Shqiperise);

(b) te ruaje te drejten e hyrjes per veprimtarite ushtarake me avione ne pista, rruget lidhese, rruget paralele lidhese dhe nyjen e rruges lidhese;

(c) te lejoje dhe te lehtesoje hyrjen ne kullen ushtarake te kontrollit deri ne daten me te vonshme te (i) fillimit te operacionit te kulles se re te kontrollit te trafikut ajror, dhe (ii) mbylljes se kulles ushtarake te kontrollit; dhe

(d) te lehtesoje nivelin e rene dakord te veprimtarive ushtarake siç eshte percaktuar ne Shtojcen 55 (Veprimtari ushtarake) dhe te bazuar ne parimet e meposhtme:

(i) Operacionet Ushtarake do te caktohen rreth levizjeve te avioneve civile kurdohere qe eshte e mundur dhe ne perputhje me kete Kontrate;

(ii) Operacionet e NATO-s te lehtesohen ne perputhje me politiken dhe angazhimet nderkombetare te Republikes se Shqiperise, keto operacione te caktohen rreth levizjeve te avioneve civile kurdo qe eshte e mundur dhe ne perputhje me kete Kontrate;

(iii) Prioritet ne rast se avionet luftarake duhet te ngrihen;

(iv) Ministria e Mbrojtjes se Republikes se Shqiperise te nise te nderprese lidhjen e rruges lidhese jashte aeroportit drejt perendimit te Aeroportit ne 2005; dhe

(v) Te ngrihet nje rrethim i ri, brenda tre muajve qe nga Data e Fillimit, nga Shoqeria tek kanali ne veri ne fund te Zones Ushtarake, me kende te drejte te perimetrit te rrethimit, siç tregohet tek Shtojca 16 (Vizatimi teknik i rene dakord).

11.2. Kapaciteti i Pistes ushtarake

Ne baze te kerkeses se Organit Shteteror te Autorizuar, Shoqeria do te siguroje kapacitetin e pistes per perdorim nga forcat ajrore shqiptare brenda nje kufiri ditor 10 perqind (10%) te Kapacitetit te Deklaruar te Pistes (dmth. deri ne 24 ore ne dite). Per me teper, Shoqeria mund te lejoje te siguroje kapacitet shtese te pistes per sa kohe qe fluturimet qe kane lidhje me veprime ushtarake nuk nderhyjne ne veprimet tregtare ne Aeroport (nje leje e tille nuk duhet te mbahet pezull pa arsye). Ne rast fluturimesh ushtarake qe kapercejne keto kufij, Qeveria e Shqiperise do te rimbursoje Shoqerine per humbjen e te ardhurave qe vjen drejtpersedrejti nga çdo nderprerje e panevojshme e veprimeve tregtare ne Aeroport e shkaktuar nga fluturime te tilla ushtarake. Per te shmangur paqartesite, çdo dem i shkaktuar nga avione luftarake, qe rezulton ne kosto ose detyrime financiare te shkaktuara Shoqerise ose çdo rritje e kosteve te operacioneve te shkaktuara Shoqerise per shkak te operacioneve te detyruara ushtarake do te kompensohen plotesisht nga Qeveria e Shqiperise.

12. Siguria dhe MBROJTJA

(a) Shoqeria do te jete pergjegjese per sigurine ne zonen e Koncesionit. Shoqeria do te jete pergjegjese per sigurine ne Zonen e Koncesionit, ne varesi te konfirmimit me shkrim nga Organi Shteteror i Autorizuar, nje konfirmim i tille duhet t'i jepet Shoqerise jo me vone se dhjete (10) dite pas dates se hyrjes ne fuqi dhe krijimit te efekteve te Ligjit te Koncesionit te Aeroportit. Ne permbushjen e ketij detyrimi Shoqeria do te veproje ne perputhje me procedurat dhe funksionet e pershkruara ne Shtojcen 39 (Sistemi Administrimit te Ruajtjes se Aeroportit) dhe Shtojcen 44 (Siguria dhe Kontrolli i Bagazheve).

(b) Plani ekzistues i sigurise dhe sigurimit do te perditesohet nga Shoqeria jo me vone se 90 dite pas Dates se Fillimit. Nje plan i tille i perditesuar i sigurise dhe sigurimit do te jete nje pjese perberese e Manualit Ekzistues te Aerodromit dhe Manualit Ekzistues te Operacioneve, dhe do t'i paraqitet DPAC per informacion menjehere pas perditesimit te tyre respektiv.

(c) Ne rast se Shoqeria do te kete vendosur te nen-kontraktoje kryerjen e veprimtarive te sigurimit dhe/ose te sigurise ne Zonen e Koncesionit, Shoqeria do ta beje ate ne perputhje te plote me kete Kontrate dhe Ligjin e Zbatueshem dhe do te kerkoje paraprakisht miratimin nga DPAC ose Ent tjeter perkates Shteteror. Kjo shoqeri e perzgjedhur nga Shoqeria do te jete pergjegjese per kerkesen, marrjen dhe ruajtjen e te gjitha autorizimeve, lejeve dhe miratimeve te kerkuara per kryerjen e veprimtarive te sigurise dhe sigurimit.

(d) I gjithe stafi i angazhuar ne veprimtarite e sigurise dhe sigurimit, dhe stafi i angazhuar ne operacione ne anen e aerodromit, do te jete objekt i procedurave te posaçme te rekrutimit qe do te kryhen ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem dhe Konventat. Asnje person apo nen-kontraktor nuk do te ndermarre veprimtari sigurie dhe/ose sigurimi ne Zonen e Koncesionit pa miratim te meparshem nga Shoqeria dhe ne perputhje me kete Kontrate dhe Ligjin e Zbatueshem.

13. NDARJET

Te gjitha qirate, detyrimet e qirave, perqindjet, primet e sigurimeve, gazi, uji, electriciteti, dhe detyrimet e telefonit, royalty si dhe pagesa te tjera ne lidhje me ose per shkak te, dhe te pagueshme ose te mbartura ne lidhje me Terminalin Ekzistues, Sheshin e Terminalit Ekzistues dhe Aktivet e Lidhura deri ne Daten e Fillimit, do t'i ngarkohen Qeverise se Shqiperise dhe, qe nga Data e Fillimit do t'i ngarkohen Shoqerise. Te gjitha qirate, royalties dhe pagesa te tjera periodike te arketueshme ose te mbartura ne lidhje me Terminalin Ekzistues, Sheshin e Terminalit Ekzistues dhe Aktivet e lidhura deri ne Daten e Fillimit do t'i perkasin Qeverise se Shqiperise dhe qe nga Dita e Fillimit do t'i perkasin Shoqerise.

14. Marreveshjet kontraktORE

14.1. Marreveshjet Kontraktore

(a) Shoqeria do te lidhe kontrata dhe marreveshje te tilla siç mund te jete e nevojshme per te siguruar ushtrimin e te drejtave te saj dhe permbushjen e detyrimeve te saj sipas kesaj Kontrate.

(b) Shoqeria do te siguroje dhe do te garantoje qe:

(i) çdo kontrate dhe/ose marreveshje perkatese e lidhur nga Shoqeria ne lidhje me ndertimin, kryerjen e punimeve dhe perfundimin e Aeroportit ose çdo Punim Ndertimi do te drejtohet, kur eshte e zbatueshme, nga Rregullat e Librit te Verdhe FIDIC qe jane ne fuqi ne periudhen perkatese,

(ii) çdo kontrate dhe/ose marreveshje e rendesishme e lidhur nga Shoqeria ne lidhje me Koncesionin do te perfshije dispozita qe autorizojne Qeverine e Shqiperise ose nje person te emeruar nga Qeveria e Shqiperise te lidhe marreveshje te tille atehere kur Qeveria e Shqiperise e quant e arsyeshme, ne vend dhe zevendesim te Shoqerise ne rast mospermbushjeje te kontrates dhe/ose marreveshjes ose ne rast te zgjidhjes se kesaj Kontrate ne lidhje me dispozitat e kesaj Kontrate, dhe

(iii) çdo kontrate dhe/ose marreveshje ne shuma te konsiderueshme e lidhur nga Shoqeria ne lidhje me Koncesionin do te perfshije dispozita qe autorizojne Huadhenesin(t) Primar ose nje person te emeruar nga Huadhenesi(t) Primar per te lidhur marreveshje te tilla atehere kur Huadhenesit(ve) Primar ushtron te drejten e tij/tyre per t'u futur ne marreveshje (ne perputhje me Piken 32 (E Drejta e Huadhenesit per t'u Futur ne Marreveshje dhe e Zevendesimit) ne vend dhe zevendesim te Shoqerise.

(c) Para lidhjes se kontratave dhe/ose marreveshjeve per Koncesionin, ose ne lidhje te, Shoqeria (duke perfshire edhe çdo Filial ketu) do te:

(i) veproje ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem; dhe

(ii) nuk do te diskriminoje ne akordimin e kontratave dhe/ose marreveshjeve mbi baze kombesie.

14.2 Garancia e Permbushjes se Detyrimeve

a. Shoqeria do te leshoje nje garanci te permbushjes se detyrimeve ne baze te kerkeses ("Garancia ePermbushjes se Detyrimeve te Shoqerise") ne formen e Shtojces 9 (Garancia e Kerkueshme e Permbushjes se Detyrimeve te Shoqerise) leshuar nga njeri prej Institucioneve Bankare te listuara ne Shtojcen 10 (Lista e Institucioneve Financiare), ose ne forme tjeter te pranueshme nga Qeveria e Shqiperise, ne shumen tre (3) milione euro, Garancia e Permbushjes se Detyrimeve te Shoqerise do te mbaroje jo me shpejt se 365 dite pas Fazes A Dates se Hapjes se Terminalit te Ri.

b. Garancia e Permbushjes se Detyrimeve nga Shoqeria duhet te behet e pagueshme sipas Shtojces 9 (Garancia e Kerkueshme e Permbushjes se Detyrimeve te Shoqerise) ne favor te Qeverise se Shqiperise ne rastet e meposhtme

i. Shoqeria nuk ka arritur Daten e kerkuar te Detyrimit per Fazen A te Terminalit te Ri dhe nga dita e pare e kesaj mospermbushje nga Shoqeria kane kaluar 180 dite;

ii. ka ndodhur nje Rast Paaftesie Paguese ne lidhje me Shoqerin

dhe per rrjedhoje Shoqeria eshte ne gjendje Paaftesie Paguese; ose

iii. kane ndodhur Rastet e Mospermbushjes nga Shoqeria qe renditen ne piken 28.1.(a), (d) ose (e) te kesaj Kontrate. Per qartesi, rasti i mesiperm nuk do te konsiderohet ne qofte se Rasti i Mospermbushjes nga Shoqeria ka ndodhur per shkak te Ngjarjes se Forces Madhore ose te rastit te Shkarkimit nga Pergjegjesia per Mospermbushje nga Qeveria e Shqiperise.

14.3 Kontrata te Lidhura

a) Çdo Kontrate e Lidhur dhe/ose ndryshim, ose deklarate e heqjes dore, zgjatje ose zgjidhje, ose nepermjet marreveshjes me Shoqerine te çdo Kontrate te tille te Lidhur, mund te jete vetem per furnizimin me mallra ose sherbime keshillimi, ose kryerjen e çdo pune lidhur me kete Kontrate dhe ne baze te vendosjes se çmimit mbi baza tregu, ku nje vendosje e tille mbi baza tregu do te behet nepermjet krahasimit me tregun Europian te aviacionit tregtar dhe, nese keto mallra, sherbime apo punime nuk jane ne tregun Europian te aviacionit tregtar, ne krahasim me tregun nderkombetar te aviacionit tregtar.

b) Shoqeria do te mbaje dhe do te ruaje liste te perditesuar te Personave te cilet jane ortake te Shoqerise, ortake te secilit prej Filialeve te saj dhe te gjitha Filialeve te cdo ortaku te tille.

14.4 Zgjidhja e Kontratave

a) Shoqeria do te siguroje qe ne çdo kontrate dhe/ose marreveshje ne te cilin ajo ose nje prej Filialeve te saj behet pale, te vendoset nje kusht qe i jep te drejten asaj (ose, sipas rastit nje Filialit ne fjale) te zgjidhe kontraten dhe ose marreveshjen ne perputhje me Piken 14.4 (Zgjidhja e kontratave).

b) Ne rast se ne çdo kohe Shoqeria eshte ne dijeni ose vihet ne dijeni nga Qeveria e Shqiperise ose çdo Ent Shteteror, se Shoqeria ose çdo njeri prej Filialeve te saj ka lidhur, ka amenduar, ka leshuar deklarate doreheqjeje ose ka zgjatur nje kontrate dhe/ose marreveshje pa respektuar Piken 14 (Marreveshjet Kontraktore), Shoqeria ose Filiali i saj, nese kushtet e kesaj

kontrate dhe /ose marreveshje jane me pak te favorshme per Shoqerine dhe /ose Filialin e saj, sesa ato te cilat do te kishte perfituar nga nje pale e trete ne mirebesim ne kushtet e cmimit te tregut dhe pala tjeter kontraktore ishte ne dijeni te nje mosrespketimi te tille, do te zgjidhe kontraten dhe/ose marreveshjen perkatese pa kundershperblim ndaj pales tjeter kontraktore dhe do te marre nga pala tjeter kontraktore te gjitha shumat e paguara prej saj ose ne emer te Shoqerise ose te Filialit te saj, pertej vleres se punes se kryer ose te mirave apo sherbimeve te dhena ne baze te marreveshjeve ose kontratave perkatese se bashku me nje shume te mjaftueshme per te demshperblyer Shoqerine dhe ose Filialin e saj per demin financiar si rezultat i nje mosrespektimi te tille.

14.5 Kontratat e Rendesishme

Çdo kontrate dhe/ose marreveshje e lidhur nga Shoqeria ose Filiali i saj ne lidhje me kete Kontrate (duke perfshire pa kufizim, te Drejtat e Aeroportit), kontrate dhe/ose ujdi e cila perfshin shpenzime ose angazhim te Shoqerise ose te Filialit te saj do te behet ne perputhje me rregulloren e brendshme te Shoqerise dhe Ligjin e Zbatueshem.

15. NDERTIMET Ekzistuese

15.1 Titulli i Pronesise

Titulli i Pronesise per Terminalin Ekzistues, Sheshin e Terminalit ekzistues, Aktivet e Lidhura dhe Zonen e Koncesionit, siç pershkruhet ne Shtojcen 18 (Master Plani dhe Planifikimi i Mjediseve), i mbetet dhe do t'i mbetet gjate gjithe Afatit te Koncesionit Qeverise se Shqiperise.

15.2 E drejta e Uzufruktit

Ne varesi te Pikes 2.1 (Dhenia e Koncesionit) dhe Pikes 15.4 (Dhenia dhe Krijimi i Uzufruktit) qe nga Data e Fillimit, Shoqeria, per qellim dhe brenda kuadrit te kesaj Kontrate, do te kete te drejten e vetme dhe ekskluzive te Uzufruktit mbi Zonen e Koncesionit dhe Ndertimet Ekzistuese gjate Afatit te Koncesionit, objekt i te drejtave te dhenies me qira te pjeseve te tokes ose te mjediseve te Zones se Koncesionit.

15.3 Dorezimi ne Daten e Fillimit

Ne Daten e Fillimit Organi i Autorizuar Shteteror do t'i dorezoje Shoqerise:

a) te gjitha Ndertimet Ekzistuese brenda Zones se Koncesionit, me perjashtim te kulles ekzistuese te kontrollit, me qellimin e gezimit te Uzufruktit nga Shoqeria ne lidhje me projektin; dhe

b) te gjitha Aktivet Ekzistuese brenda Zones se Koncesionit, keto Aktive Ekzistuese do te zoterohen nga Shoqeria per qellim te ketij Projekti.

Pas Dates se Fillimit, asnje Person tjeter perveç Shoqerise nuk do te kete te drejten e Uzufruktit mbi Ndertimet Ekzistuese ose zoterimin e Aktiveve Ekzistuese brenda Zones se Koncesionit ndersa Ndertimet Ekzistuese ose Aktivet Ekzistuese jane objekt i Koncesionit ne perputhje me kete Kontrate.

15.4 Dhenia dhe krijimi i Uzufruktit

a) Qeveria e Shqiperise do te detyroje Organin e Autorizuar Shteteror te lidhe marreveshje ne formen e Shtojces 1 (Akti Uzufruktit) per krijimin dhe vendosjen e Uzufruktit ne favor te Shoqerise mbi te gjithe Zonen e Koncesionit dhe Ndertimet Ekzistuese, dhe do te ndermarre te gjitha hapat e nevojshme per te siguruar krijimin dhe vendosjen e menjehershme dhe regjistrimin e Uzufruktit mbi Zonen e Koncesionit, Ndertimet Ekzistuese dhe te gjitha Ndertimet e Reja, ndertimet, instalimet dhe pasurite e tjera te paluajtshme ("Shtesat e Uzufruktit") para Dates se Fillimit dhe ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem.

b) Qeveria e Shqiperise do te siguroje qe Zona e Koncesionit dhe Terminali Ekzistues qe jane ne pronesi te Qeverise se Shqiperise drejtperdrejt ose nepermjet ndonje Enti Shteteror dhe/ose personi juridik shteteror, te jene te lira nga çdo Barre Siguruese, detyrim, qera, barre, pretendim te ish pronareve dhe te drejta te tjera te ushtrueshme nga pale te treta, duke perfshire Aeroportin e Nene Terezes Sh.A dhe kreditoret e Aeroportit te Nene Tereza Sh.A, gjate Afatit te Koncesionit.

c) Shoqeria do te lejohet te vendose Barre Siguruese mbi Uzufruktin e dhene ne lidhje me Zonen e Koncesionit, Terminalin Ekzistues, Aktivet e Lidhura dhe Shtesa te Uzufruktit ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem.

d) Perveç ne rast se parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, Shoqeria si uzufruktare, do te jete pergjegjese per, dhe do te mbaje te gjitha kostot dhe shpenzimet ne lidhje me, marrjen, ruajtjen dhe ushtrimin e Uzufruktit. Shoqeria nuk do te jete pergjegjese dhe nuk do te paguaje asnje takse ose kosto dhe shpenzime te tjera ne lidhje me pronesine e Qeverise se Shqiperise ose cdo Enti Shteteror

ose personi juridik ne pronesi shteterore nen Uzufrukt.

e) Me mbarimin e Afatit te Koncesionit ose me zgjidhjen e kesaj Kontrate, Uzufrukti do te perfundoje automatikisht dhe do te pushoje efektet ndersa Qeveria e Shqiperise do te marre ne zoterim te gjitha pasurite e dhena ne Uzufrukt Shoqerise (se bashku me Shtesat e Uzufruktit) dhe do te gezoje te gjitha te drejtat e pronesise dhe posedimit mbi pasurite e dhena ne Uzufrukt (dhe Shtesat e Uzufruktit), pa pagese te çfaredolloji dhe pa Barre Siguruese, detyrime, qera dhe te drejta te tjera te ushtrueshme nga palet e treta.

16. NDERTIMET e reja DHE AKTIVET

a) Shoqeria do te kete titull te pakufizuar pronesie mbi Ndertimet e Reja. Nese per ndonje arsye Shoqeria nuk mund te jete pronare e Ndertimeve te Reja, Shoqerise do t'i akordohet Uzufrukti mbi keto pajisje te reja.

b) Shoqeria do te kete te drejten e vetme dhe ekskluzive per te perdorur Ndertimet e Reja, me perjashtim te Personave qe i perdorin Ndertimet si pasagjere, kontraktues, Perdorues te Aeroportit dhe Persona te tjere qe perdorin Ndertimet e Reja pa ndikuar negativisht tek te Drejtat e Shoqerise sipas kesaj Kontrate.

c) Shoqeria do te kete mundesine te krijoje Barre Siguruese mbi Ndertimet e Reja, ne perputhje me kete Kontrate dhe Ligjin e Zbatueshem. Qeveria e Shqiperise nuk do te jete pergjegjese dhe nuk do te paguaje asnje takse ose kosto dhe shpenzime te tjera ne lidhje me pronesine e Shoqerise mbi Ndertimet e Reja.

17. Operimi dhe Mirembajtja

17.1. Operimi, Mirembajtja dhe Manualet

a) Shoqeria do te:

i) pas dates se Hapjes se Fazes A te Terminalit te Ri dhe ne çdo kohe me pas gjate Afatit te Koncesionit, drejtoje Aeroportin (duke perfshire Terminalin Ekzistues te Riperteritur) ne perputhje me kete Kontrate (duke perfshire pa kufizime, kerkesat dhe standardet e percaktuara ne Shtojcen 36 (Kriteret e Permbushjes) dhe Shtojcen 37 (Administrimi Operacional pas perfundimit te Fazes A te Terminalti te Ri); dhe

ii) pas Dates se Hapjes se Fazes B te Terminalit te Ri, Faza B e Terminalit te ri (duke perfshire fazen A te Terminalit te Ri) do te drejtohet nga Shoqeria ne perputhje me standardet e kryerjes se detyrave te percaktuara ne Piken 36 (Kriteret e Permbushjes) dhe Piken 37 (Administrimi Operacional pas Perfundimit te Fazes A te Terminali te Ri); dhe

iii) qe nga Data e Fillimit deri ne daten e hapjes se Fazes A te Terminalit te Ri, te drejtoje Terminalin Ekzistues ne perputhje me kete Kontrate (duke perfshire, pa u kufizuar, kerkesat dhe standardet e percaktuara ne Shtojcen 21 (Terminali Ekzistues)).

b) Gjate gjithe Afatit te Koncesionit, Shoqeria do te mirembaje, mbaje ne funksionim dhe kushte te mira, rinovoje dhe permiresoje Aeroportin, duke perfshire ndertesat e tij, mjetet, sistemet dhe ndertimet e vendosura ne Zonen e Koncesionit, te gjitha ne perputhje me kete Kontrate dhe Ligjin e Zbatueshem. Te gjitha punet e mirembajtjes, riparimit dhe pune te tjera do te kryhen ne nje menyre te tille qe te minimizojne pengesat ndaj Perdoruesve te Aeroportit. Nese ndonje pune mirembajtjeje, riparimi ose pune te tjera kerkojne nderprerjen ose pezullimin e uljes dhe ngritjes se ndonje avioni, ose mbylljen (per çfaredolloj afati kohor) e Aeroportit, Shoqeria do t'i jape DPAC dhe te gjithe Perdoruesve te Aeroportit te ndikuar, me perjashitm te rasteve te urgjences, njoftim paraprak me shkrim duke i informuar ata per nderprejen, pezullimin, ose mbylljen e detyruar.

c) Manuali i Aerodromit dhe Manualet e Mirembajtjes dhe Operacioneve te Aeroportit dhe Manuale te tjere do te publikohen dhe azhornohen nga Shoqeria sipas kerkesave te Kontrates, Ligjit te Zbatueshem dhe Konventave. Manuali i Aerodromit dhe Manuali i Mirembajtjes dhe Operacioneve dhe Manuale te tjere do t'i paraqiten DPAC per informim menjehere pas azhornimeve te tyre respektive.

d) Pas Dates se Hapjes se Fazes A te Terminalit te Ri, ne drejtimin e Aeroportit, Shoqeria do te marre parasysh kerkesat e specifikuara ne Shtojcen 40 (Mirembajtja e Aeroportit) dhe Shtojcen 41 (Administrimi i Cilesise) dhe dispozitat perkatese te Shtojces 24 (Pajisjet e Aerodromit) Shtojces 45 (Ndertesat Ndihmese-nga Ana e Tokes) dhe Shtojces 46 (Ndertesat Ndihmese- nga ana e Aerodromit).

17.2 Detyrimet e Qeverise se Shqiperise

a) Qeveria e Shqiperise do te siguroje qe gjate gjithe Afatit te Koncesionit Shoqeria te kete te drejten te hyje dhe te perdore Zonen e Koncesionit. Keto te drejta do t'i akordohen Shoqerise pa asnje kosto.

b) Qeveria e Shqiperise vete, dhe duke detyruar Organin e Autorizuar Shteteror:

i) do t'i kaloje Shoqerise, menjehere pas Dates Efektive por para Dates se Fillimit, kopje te te gjitha llogarive, faturave, pasqyrave, kerkesave, njoftimeve, kerkesa sigurimesh dhe çdo korrespondence tjeter qe mund te kaloje ne zoterim ne lidhje me projektin;

ii) do t'i jape Shoqerise gjate Periudhes se Koncesionit te gjithe informacionin qe zoteron, keshilla dhe asistence, te cilat Shoqeria ne menyre te arsyeshme do t'i kerkoje ne lidhje me kerkesen per akordimin e te gjitha Autorizimeve te kerkuara ne menyre te arseyshme per drejtimin e Projektit dhe mbajtjen e statusit te saj te taksave (siç eshte specifikuar ne kete Kontrate dhe ne Ligjin per Koncesionin e Aeroportit);

iii) do t'i siguroje Shoqerise pas Dates Efektive por para Dates se Fillimit, kopje te informacioneve te tilla, dokumenteve dhe regjistrimeve ne lidhje me Projektin qe ata kane ne posedimin e tyre dhe te cilat Shoqeria mund t'i kerkoje ne menyre qe te permbushe detyrimet e saj sipas kesaj Kontrate;

iv) ta ndihmoje Shoqerine nese dhe per sa kohe qe Shoqeria kerkon nje prone te paluajtshme, te drejtat e rruges ose lehtesira per te ushtruar te drejtat e saj dhe per te permbushur detyrimet e saj sipas kesaj Kontrate, ne perfitimin e kesaj prone te paluajtshme, ne perfitimin e te drejtave te rruges ose te lehtesirave (duke perfshire perdorimin e pushtetit te saj per te perfituar ose shpronesuar ne menyre te detyrueshme kete prone te paluajtshme); dhe

v) do te detyroje Organin Shteteror te Autorizuar te caktoje dhe krijoje ne favor te Shoqerise te gjitha servitutet e nevojshme dhe te drejtat e detyrueshme te kalimit te lidhura me Projektin dhe Zonen e Koncesionit ose qe kerkohen ne menyre te arsyeshme per Projektin ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem. Çdo shume e paguar ndaj pronarit te nje pasurie te tille te paluajtshme, do te paguhet, nese kerkohet, nga Organi Shteteror i Autorizuar dhe Shoqeria nuk do te detyrohet te paguaje asnje kompensim per pronarin e nje pasurie te tille te paluajtshme dhe do te rimbursohet nga Qeveria e Shqiperise kundrejt pageses se nje kompensimi te tille.

18. Te drejtat e aeroportit

18.1 Te Drejtat e Aeroportit

a) Shoqeria do te vendose kritere te drejta, te arsyeshem dhe objektive ne percaktimin e dhenies ose jo, te amendimit ose te heqjes dore te te Drejtave te Aeroportit.

b) Çdo person qe gezon te drejtat tek Terminali Ekzistues ose ne lidhje me Terminalin Ekzistues do t'i ofrohet e njejta mundesi si dhe Personave te tjere te interesuar per te marre ndonje prej te Drejtave te Aeroportit ne Daten e Fillimit dhe me pas ne perputhje me Rregulloren e Brendshme kontraktuese te Shoqerise dhe Ligjit te Zbatueshem, nese ai ploteson kriteret e vendosura nga Shoqeria per akordimin e te Drejtave te Aeroportit.

c) Shoqeria do te vendose, ashtu sic do ta shohe ajo vete te arsyeshme, per akordimin e ndonje te drejte te aeroportit ne perputhje me rregulloren e brendshme te Shoqerise dhe Ligjin e Zbatueshem.

18.2. Kushtet e Tregut

Shoqeria do te siguroje qe kushtet e kontrates se pales se trete ne rast se ka te tille te jene ne perputhje me kushtet e tregut dhe normat e tregut. Nese akordimi i te drejtave te Aeroportit ndonje personi do te perbente nje Kontrate te Lidhur, Shoqeria do te veproje ne perputhje me Piken 14.3 (Kontratat e Lidhura).

18.3 Qirate dhe Marreveshje te tjera Kontraktore

a) Te gjitha dheniet me qera dhe rregullime te tjera te ngjashme te lidhura here pas here nga Shoqeria ne lidhje me Koncesionin do te jene ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem. Palet e nje kontrate te tille qeraje ose te marreveshjeve te tjera te ngjashme do te deklarojne qe dhenia me qira ose marreveshja tjeter e ngjashme eshte nje instrument i zbatueshem qe lejon Shoqerine te perjashtoje palen ose palet nga kjo dhenie me qera ose marreveshje e ngjashme nga pjesa perkatese e Zones se Koncesionit ne zgjidhjen e saj per cfaredolloj arsyeje.

b) Ne masen qe çdo e Drejte e Aeroportit e akorduar ne perputhje me kete Kontrate perfshin qera, nen-qera dhe/ose marreveshje per perdorimin ose zenien e nje toke ose ndertese (duke perfshire edhe nje pjese te saj) kushtet e kesaj kontrate qiraje, nen-qiraje dhe/ose marreveshjeje do te perputhen

me Ligjin e Zbatueshem qe rregullon kohezgjatjen e kesaj kontrate qiraje, nen-qeraje ose marreveshje dhe/ose te drejtave per te zgjidhur dhe/ose nivelin e rritjeve ne qira ose pagesa te tjera periodike te tyre.

18.4 Mosdiksriminimi

a) Shoqeria nuk do te adoptoje, ne lidhje me aktivitetet e kryera prej saj ne Zonen e Koncesionit, asnje praktike tregtare, ose politike çmimesh, te cilat ne menyre te paarsyeshme diskriminojne çdo klase te Perdoruesve te Aeroportit ose çdo Perdorues te veçante te Aeroportit, duke perfshire çdo Shoqeri Ajrore Kombetare, ose te cilat ne menyre te pandershme shfrytezojne pozicionin e favorshem ne lidhje me Perdoruesit e Aeroportit ne pergjithesi ose te cilat shkaktojne drejtpersedrejti miratimin nga çdo Person tjeter te nje praktike qe ka nje efekt te ngjashem. Shoqeria nuk do te adoptoje, ne lidhje me akordimin e te Drejtave te Aeroportit ndonje praktike e cila:

i) ne menyre te paarsyeshme diskriminon personat te cileve u jane dhene nje klase te drejtash, ose i eshte bere nje akordim i veçante i nje te drejte te tille, ose qe shfrytezon padrejtesisht poziten e favorshme ne lidhje me akordimin e te drejtave te tilla ne pergjithesi, ose

ii) ne menyre te paarsyeshme diskriminon çdo klase Personash te cilet kerkojne te drejta te tilla ose çdo kerkues i veçante, ose ne menyre te paarsyeshme kufizon numrin e te drejtave te tilla qe jane akorduar ne rast te sherbimeve ose pajisjeve te posaçme,

iii) ose qe shkakton miratimin nga çdo Person tjeter te nje praktike qe ka nje efekt te ngjashem.

iv) Shoqeria do te siguroje qe perveç parashikimeve te tjera te kerkuara nga Ligji i Zbatueshem, Aeroporti do te jete i hapur me kushte te njejta avioneve te te gjitha shteteve.

18.5 Shoqeria Ajrore Kombetare

Asgje ne kete Kontrate nuk do te cenoje te drejtat e çdo Shoqerie Ajrore Kombetare sipas çdo marreveshjeje ndermjet Qeverise se Republikes se Shqiperise dhe çdo shteti, Ligjit te Zbatueshem dhe Konventave ne te cilat Republika e Shiperise eshte pale.

19. PAGESAT PER SHERBIMET e Aeroportit dhe VLERESIMI i pavarur ekonomik

19.1 Pagesat per Sherbimet e Aeroportit

a) Shoqeria do te jete e autorizuar te percaktoje Pagesat per Sherbimet e Aeroportit nga Perdoruesit e Aeroportit dhe te mbaje Pagesat per Sherbimet e Aeroportit gjate Afatit te Koncesionit ne perputhje me Shtojcen 7 (Pagesat per Sherbimet e Aeroportit). Shoqeria nuk do t'u vendose asnje Pagese per Sherbime te Aeroportit shoqerive ajrore, Perdoruesve te Aeroportit ose Pasagjereve qe e perdorin Aeroportin perveç atyre te parashikuara shprehimisht ne kete Kontrate ose siç eshte miratuar me shkrim nga DPAC, me kusht qe kjo nuk do te kufizoje veprimtarite perkatese tregtare te Aeroportit.

b) Ne caktimin e Pagesave per Sherbimet e Aeroportit, Shoqeria do te veproje ne nje menyre te tille qe te mos vije ne kundershtim me detyrimet nderkombetare te Republikes se Shqiperise dhe e cila eshte ne Perputhje me Konventen e Çikagos.

c) Shoqeria do te mbledhe taksat e meposhtme ne emer te Qeverise se Shqiperise (qe perndryshe mblidhen nga Qeveria e Shqiperise ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem):

i) Takse Vize;

ii) Takse kufiri ne Dalje; dhe

iii) Taksa te tilla te tjera qe Qeveria e Shqiperise dhe Kuvendi i Republikes se Shqiperise mund te vendosin kohe pas kohe dhe ne raste te tilla, subjekti i kostos se arsyeshme te mbledhjes se tyre nga Shoqeria do te rimbursohet nga Qeveria e Shqiperise;

dhe do t'i paguaje pa asnje zbritje perveç te Drejtes se Vecante te Eliminimit Reciprok shumen e mbledhur Qeverise se Shqiperise, jo me vone se diten e 30-te te çdo muaji per muajin paraardhes ne llogarine e caktuar nga Qeveria e Shqiperise.

19.2 Vleresimi Periodik i Pagesave te Sherbimeve te Aeroportit.

a) Organi i Autorizuar Shteteror dhe Shoqeria do te rishikojne Pagesat per Sherbimet e Aeroportit çdo tre vjet gjate Periudhes se Koncesionit, Rishikimi i pare do te kryhet me 1 janar 2007 dhe do te rrise Pagesat per Sherbimet e Aeroportit ne baze te ketij rishikimi sipas cilitdo faktor qe eshte me i madh:

i) çdo perberes i Tarifave te Aeroportit eshte rritur ne tejkalim te dy perqind (2%) per vit te mesatares se shkalles se inflacionit ne Zonen e Euros (siç matet nga CPI EUR per çdo vit) per tre vitet

paraardhes te dates se rishikimit; dhe

ii) Pjesa e rene dakord e Kostos Operacionale te Tarifave te Aeroportit e rritur me

(X1 x CPI EUR) + (X2 x CPI ALBx XCH)

ku:

X1 + X2 = 1 dhe CPI EUR eshte ndryshimi ne CPI e harmonizuar e publikuar nga EUROSTAT per Zonen e Euros qe nga data e harmonizuar e rishikimit,

CPI ALB eshte ndryshimi ne CPI shqiptar qe nga data e fundit e rishikimit, dhe

XCH eshte nje koeficient qe llogaritet (XR2/XR1) ku XR2 eshte mesatarja e Mesatares se Kursit Zyrtar te Kembimit ne Euro per lek gjate pese Diteve te Punes te fundit para dates se rishikimit sipas publikimit te Bankes se Shqiperise dhe XR1 eshte mesatarja e Mesatares se Kursit Zyrtar te Kembimit ne Euro per lek ne pese Ditet e Punes te fundit para dites se rishikimit qe bie tre vjet para dates se shqyrtimit te publikuar nga Banka e Shqiperise.

X1 dhe X2 do te jene objekt rishikimi ne te njeten kohe si dhe Pagesat per Sherbimet e Aeroportit per te reflektuar ndryshimet ne perpjestim te kostove te huaja ndaj kostove lokale te Shoqerise.

Rritja e llogaritur ne Pagesat per Sherbimet e Aeroportit do te rrumbullkoset ne Euro 0,05 cent. Ne çdo llogaritje sipas kesaj Pike 19.2 (a) (Vleresimi periodik i Pagesave per Sherbime te Aeroportit) nuk do te merren parasysh shkallet e inflacionit para Dates Baze.

b) Shoqeria mund te pergatise dhe te paraqese tek Organi i Autorizuar shteteror per miratim nje propozim per ndryshime ne Pagesat per Sherbimet e Aeroportit ne çdo rishikim periodik te Pagesave per Sherbime te Aeroportit. Çdo propozim do te shoqerohet nga dokumentacioni i shkruar i supozimeve te perdorura dhe i llogaritjeve te bera per te perpunuar ate. Qeveria e Shqiperise do te kete te drejten te kerkoje nje kontroll te nje propozimi te tille nga nje shoqeri nderkombetare kontabiliteti.

19.3 Rishikimi ne Periudha te Ndermjetme i Pjeses se Miratuar te Kostos se Operimit

Shoqeria mund te pergatise dhe te paraqese tek Organi i Autorizuar per miratim nje propozim per çdo ndryshim ne Pjesen e Miratuar te Kostos Operacionale, perveç rritjes se saj ne perputhje me Piken 19.2 (a) me lart, per shkak te kryerjes nga Shoqeria te sherbimeve shtese operacionale sipas kerkeses nga te tretet. Çdo propozim i tille do te shoqerohet nga dokumentacion i shkruar i supozimeve te perdorura dhe te llogaritjeve te bera per te perpunuar ate.

19.4 Rishikimi i Pavarur Ekonomik

a) Çdo pale ka te drejten te kerkoje nje rishikim te pavarur (“Rishikimi i Pavarur”) te pozicionit ekonomik te Koncesionit, i cili do te perfshije, nese ka lindur nje disekuiliber, rekomandime per te rikthyer ekuilibrin ekonomik te Koncesionit nga nje keshilltar i pershtatshem financiar i kualifikuar i pavarur. Kostoja e nje vleresimi(eve) te tilla do t’i ngarkohet pales qe e kerkon nje Rishikim te tille te Pavarur.

b) Vleresimi i Pavarur do te marre parasysh masen e permbushjes nga Palet, te detyrimeve te tyre respektive sipas kesaj Kontrate, efektin e ngjarjeve te jashtme jashte kontrollit te Paleve, tendencat ne trafikun pasagjereve e mallrave dhe rritjen ekonomike ne Republiken e Shqiperise dhe ne shtetet tek te cilet dhe nga te cilet udhetojne shumica e pasagjereve te Aeroportit. Pozicioni ekonomik i Koncesionit do te vleresohet duke iu referuar totalit te te ardhurave dhe shpenzimeve te Shoqerise dhe normes se rikthimit te Kapitalit Ortak sipas skenarit baze te parashikimeve financiare te rena dakord mes Shoqerise dhe Huadhenesit dhe te njohur nga Enti perkates Shteteror ne baze te nenshkrimit te kesaj Kontrate.

c) Duke u bazuar ne rezultatet e Vleresimit te Pavarur, Palet do te bisedojne per amendamente te kesaj Kontrate (duke perfshire pa kufizim, rregullime te kohes se detyrimeve, specifikime, Kuoten Junior dhe/ose Pagesat per Sherbimet e Aeroportit (perveç atyre ne perputhje me Piken 19.2(a) me lart)) siç do te konsiderohet e pershtatshme nga Palet ne menyre qe te rikthejne ekuilibrin ekonomik te Koncesionit duke vepruar ne perputhje me Praktiken e Mire te Industrise dhe Ligjin e Zbatueshem. Vleresimi i Pavarur mund te kerkohet nga secila Pale jo me shpesh se nje here ne çdo vit kalendarik. Nje Vleresim i tille i Pavarur do te perfshije gjithashtu dispozita per Shoqerine per te mbuluar pjesen e munguar te normes se rikthimit te Kapitalit Aksioner per shkak te ngjarjeve jashte kontrollit te Shoqerise.

20. Pagesa ndaj Qeverise se Shqiperise

a) Shoqeria do te paguaje nje shume (Pagesa Fillestare te Koncesionit) prej 3,000,000 Euro Qeverise se Shqiperise per te drejtat dhe privilegjet e akorduara ne kete Kontrate ne shumat dhe menyren e percaktuar ne Shtojcen 70 (Pagesat ndaj Qeverise se Shqiperise – Pagesa Fillestare e Koncesionit).

b) Shoqeria do t'i paguaje Qeverise se Shqiperise Shumat e Huase se Meparshem qe nga Data e Fillimit deri ne zgjidhjen ose mbarimin e kesaj Kontrate, ne shumat dhe ne datat e pageses te percaktuara ne Shtojcen 4 (Pagesat Qeverise se Shqiperise – Shumat e Huas se Meparshme). Çdo vonese ne pagesen e Shumave te Huas se Meparshme nga Shoqeria (qe shkaktohet vetem nga faji i Shoqerise) do te jete objekt pagese nga Shoqeria i nje shume shtese kamate vonese. Kjo kamate vonese do te llogaritet se eshte e njejta shume sikur kjo vonese te kishte ndodhur ne pagesen e shumes korresponuese nga marresi perkates sipas Huas KfW.

c) Shoqeria do t'i paguaje çdo vit Qeverise se Shqiperise Kuoten Junior ne perputhje me Shtojcen 43 (Pagesat ndaj Qeverise se Shqiperise PjesaKuota Junior), ku kjo Kuote Junior perfaqeson 30% te te gjithe Fitimit te Shperndashem te Shoqerise. Kuota Junior do t'i paguhet Qeverise se Shqiperise nga Shoqeria me prioritet ndaj shperndarjes se dividenteve Ortakeve te Shoqerise. Shoqeria nuk do te jete e detyruar te paguaje nje shume te Kuotes Junior ne rast se pagesa e nje shume te tille eshte e kufizuar nga Dokumentet e Financimit (por vetem ato me Huadhenes Kryesore ose Huadhenes te Nenrenditur ne kohen perkatese, duke patur parasysh se, ne nje rast te tille, gjate periudhes se kufizimit te tille, shuma Kuotes Junior do te mbartet dhe shuma e mbartur do te behet e gatshme dhe e pagueshme nga Shoqeria ndaj Qeverise se Shqiperise menjehere pasi Dokumentet e Financimit (por vetem ato me Huadhenes Kryesore ose Huadhenes te Nenrenditur do te lejojne per pagesen e çdo shume te Kuotes Junior. Per te shmangur dyshimin, asgje ne kete Pike nuk do te detyroje Shoqerine te deklaroje dividentet pertej atyre te lejuar sipas Dokumenteve te Financimit ose Ligjit te Zbatueshem.

d) Shoqeria do te paguaje, dy here ne vit ne datat e pageses se interesit per Huan Kryesore, ndaj Qeverise se Shqiperise nje pagese ("Pagesa e Garancise se Transhit te Huase Shteterore") ne shumen e barabarte me SLTGF dhe te llogaritur ne baze te formules se percaktuar ne Shtojcen 69 (Pagesat ndaj Qeverise se Shqiperise- Pagesa e Garancise se Transhit te Huase Shterore). Pagesa e Garancise se Transhit te Huase Shteterore do t'i paguhet Qeverise se Shqiperise nga Shoqeria ne lidhje me dhenien nga Qeveria e Shqiperise te Garancise se Transhit te Huase Shteterore, siç pershkruhet me tej ne Shtojcen 69 (Pagesat ndaj Qeverise se Shqiperise - Pagesa e Garancise se Transhit te Huas Shteterore).

21. Detyrimet per Sigurimin

a) Shoqeria do te garantoje dhe mbaje me shpenzimet e saj pergjate gjithe Afatit te Koncesionit mbulimin e sigurimit te pershkruar ne Shtojcen 11 (Sigurimi) dhe mbulimin e sigurimit sipas kerkesave te Ligjit te Zbatueshem. Duke permbushur kete detyrim, Shoqeria do te kete te drejte te marre parasysh disponueshmerine e tregut nderkombetar dhe lokal dhe primet e ketyre sigurimeve.

b) Shoqeria do t'i siguroje menjehere Qeverise se Shqiperise kopje te policave te sigurimit qe ajo ka lidhur. Ne rast se keto polica sigurimi nuk jane ne perputhje me dispozitat e kesaj Kontrate, Shoqeria do te siguroje, me shpenzimet e veta, qe keto polica te amendohen ne menyre te pershtatshme sa me shpejt qe te jete e mundur.

c) Te gjitha parate e marra nga policat e sigurimit, subjekt i dispozitave te Dokumenteve te Financimit, do te perdoren menjehere nga Shoqeria per riparim, rinovim ose restaurim ose zevendesim te pajisjeve qe kane lidhje me Projektin ose çdo pjese te tij, dhe qe mund te jene demtuar ose shkaterruar. Shoqeria mund te caktoje Huadhenesin si perfituesin e humbjes ne baze te polices se sigurimit ose te caktoje policat e sigurimit ne favor te Huadhenesit ne rast se keto pretendime tejkalojne masen 500, 000 Euro per pretendim ose shumen e perbashket te nje (1) milion Euro per çdo vit financiar. Shoqeria do te kryeje riparime rinovime ose restaurime ose zevendesime ne masen qe eshte e mundur, ne nje menyre te tille qe pajisjet e lidhura me Projektin ose çdo pjese te tij, pas riparimeve rinovimeve ose restaurimeve ose zevendesimeve te jene sa me shume te jete e mundur ne te njejtat kushte siç ishin para demtimit ose shkaterrimit.

d) Çdo police sigurimi do te siguroje se ajo nuk do te anullohet ose zgjidhet ne rast se Qeveria e Shqiperise nuk eshte njoftuar me shkrim te pakten dhjete (10) dite para anullimit.

e) Nese ne çdo kohe Shoqeria nuk arrin te bleje dhe te mbaje ne fuqi dhe efekt te plote nje ose

te gjitha sigurimet e kerkuara sipas kesaj Kontrate, Qeveria e Shqiperise mundet ne baze te zgjedhjes se saj te bleje dhe te mbaje nje sigurim te tille dhe te gjitha shumat e shpenzuara nga Qeveria e Shqiperise, do te rimbursohen nga Shoqeria menjehere pas kerkeses, dhe ne rast deshtimi do te rikuperohen nga Qeveria e Shqiperise duke ushtruar te drejten e kunderbalancimit ose ne forma te tjera.

f) Shoqeria do te jete pergjegjese per 25 % e pare te rritjes vjetore ne primin e perbashket te sigurimeve nga njeri vit deri tek viti pasardhes. 25% tjeter i nje rritjeje te tille do te ndahet pergjysme mes Qeverise se Shqiperise dhe Shoqerise dhe mbi 50% i nje rritjeje te tille vjetore do te paguhet nga Qeveria e Shqiperise. Nese ndonje prej rritjeve vjetore ne primin e perbashket te sigurimit eshte rrjedhoje e drejtperdrejte e ndonje veprimi ose mosveprimi te Qeverise se Shqiperise ose ndonje Enti Shteteror, kjo rritje ne prim do te paguhet nga Qeveria e Shqiperise. Nese ndonje prej rritjeve vjetore ne primin e perbashket te sigurimit eshte rrjedhoje e drejtperdrejte e ndonje veprimi ose mosveprimi te Personit (ave) dhe jo e Qeverise se Shqiperise ose e ndonje Enti Shteteror, (duke perfshire, pa kufizime, Shoqerine dhe Ortak(et)) e saj kjo rritje ne prim do te paguhet nga Shoqeria.

g) Nese sigurimi mungon ne tregun perkates ne parametra ekonomike (te cilat do te percaktohen ne baze te faktit nese bizneset e krahasueshme me Shoqerine jane duke perfituar sigurimin ne parametrat e cituara), Shoqeria dhe Qeveria e Shqiperise do te bisedoje ne mirebesim, ne menyre qe Qeveria e Shqiperise ose:

i) t'i akordoje Shoqerise çlirim nga detyrimet perkatese te sigurimit gjate periudhes ne te cilen nje mbulim i tille nuk eshte i gatshem ne tregun perkates ne parametra ekonomke, ose

ii) te asistoje Shoqerine ne perfitimin e sigurimeve qe nuk jane te disponueshme ne tregun perkates ne shkalle ekonomike.

h) Nese Shoqerise i kerkohet sipas Ligjit te Zbatueshem te perfitoje sigurimet nga shoqeri shqiptare sigurimesh (duke perjashtuar agjentet shqiptare te sigurimeve) dhe nese ky sigurim nuk do te jete i disponueshem ne tregun shqiptar ne shkalle qe jane me pak se 105% te shkalles se sigurimit te barazvlefshem ne tregun nderkombetar (siç eshte percaktuar nga referimi ne tre sigurues te pavarur ne tregun nderkombetar te identifikuar nga Shoqeria dhe te konsideruar te pranueshem nga Qeveria e Shqiperise, ky pranim te mos mbahet pezull ne menyre te paarseyshme), Qeveria e Shqiperise do t'i paguaje Shoqerise diferencen ndermjet mesatares se primeve te marra nga tre sigurues te pavarur ne tregun nderkombetar dhe primet e marra ne tregun shqiptar menjehere pas blerjes nga Shoqeria te nje sigurimi te tille ne tregun shqiptar.

22. Pergjegjesite dhe Kufizimet e pergjegjesive

22.1 Pergjegjesite

Sipas Pikes 22.4 (Demet e Prejardhura) Shoqeria do te jete pergjegjese per çdo humbje te rendesishme dhe demtim te pesuar nga Qeveria e Shqiperise dhe/ose Ent shteteror qe vjen si rezultat i shkeljes se kesaj Kontrate nga kjo Shoqeri, kjo shkelje te mos jete shkaktuar ne menyre te drejtperdrejte nga nje Ndryshim ne Ligj.

22.2 Zbritja e Humbjeve

Ne te gjitha rastet pala qe vendos ose pretendon nje shkelje te Kontrates ose te se drejtes per t'iu mbuluar humbjet ne perputhje me kete Kontrate do te kete detyrimin te marre te gjitha masat per te zbritur humbjet qe kane ndodhur, duke marre parasysh se ajo mund ta beje kete pa shkaktuar probleme te paarsyeshme ose shpenzime te paarsyeshme. Çdo deshtim per zbritjen e humbjeve nga pala qe vendos ose pretendon nje shkelje te tille kontrate ose te drejte per t'iu mbuluar shpenzimet do te rezultoje ne nje reduktim demesh, nje reduktim i tille do te percaktohet nga gjykata e arbitrazhit i percaktuar ne perputhje me Piken 36 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve).

22.3 Kufizimi i Pergjegjesise

a) Kufizimi i Pergjegjesise se Qeverise se Shqiperise

Qeveria e Shqiperise (duke perfshire punemarresit e saj, nepunesit dhe agjentet) nuk do te jete pergjegjese per kostot, shpenzimet, humbjet, demtimet dhe/ose detyrimet financiare, te pesuara ose shkaktuara, ndaj nje Personi qe kane ardhur, drejtpersedrejti ose terthorazi, si rezultat ose ne lidhje me:

i) çdo infomacion ne çfaredolloj forme te siguruar nga Qeveria e Shqiperise ose çdo Enti Shteteror (duke perfshire te gjithe punemarresit respektive, agjentet dhe nepunesit), Shoqeria, Kontraktorer e Shoqerise, Ortaket ose te çdo Person tjeter, ose ne emret te tyre, te lidhur

drejtpersedrejti ose jo me Koncesionin, Projektin ose Aeroportin, perveç informacionit te meposhtem:

l) te gjithe informacionin e shkruar te dhene Ortakeve ne dokumente te shtypur te pergatitura dhe te miratuara per t'u leshuar nga nje Ent Shteteror para Dates se Fillimit, i cili materialisht ndikon te drejtat dhe detyrimet e Paleve sipas kesaj Kontrate, dhe

2. Opinioni ligjor i dhene nga Ministria e Drejtesise e Republikes se Shqiperise ne perputhje me Piken 3.2(b)(1) te kesaj Kontrate;

ii) punimet, ose fakti qe ato kryhen nga Shoqeria ose Kontraktoret e Shoqerise; dhe

iii) çdo veprim apo mosveprim i Shoqerise ose çdo Personi tjeter (te ndryshem nga Qeveria e Shqiperise, Kontraktoret e Qeverise ose çdo Ent Shteteror) sipas ose ne zbatim te kesaj Kontrate ose ne lidhje me kete Kontrate, Koncesion, Projekt ose Aeroport. Shoqeria do te mbroje dhe denshperbleje teresisht Qeverine e Shqiperise dhe çdo Ent Shteteror (dhe punemarresit, nepunesit dhe agjentet respektive) nga çdo kosto, shpenzim, humbje, detyrim financiar, dem, pretendim, padi ose procedure.

b) Kufizimi i Pergjegjesise se Shoqerise

Shoqeria (duke perfshire punemarresit e saj dhe zyrtaret) nuk do te jete pergjegjese ne lidhje me kostot, shpenzimet, humbjet, demet dhe ose detyrimet financiare te pesuara ose te shkaktuara nje Personi qe kane ardhur, drejtpersedrejti ose jo drejtpersedrejti, si rezultat ose ne lidhje me:

(i) çdo informacion (i siguruar ne çfaredolloj forme nga ose ne emer te Qeverise se Shqiperise ose çdo Kontraktori te Qeverise ose çdo Enti Shteteror);

(ii) punimet ose faktin qe ato kryhen nga Qeveria e Shqiperise ose Kontraktoret e Qeverise;

(iii) çdo veprim ose mosveprim i Qeverise se Shqiperise ose i Kontraktoreve te Qeverise sipas ose ne peputhje me kete Kontrate ose perndryshe ne lidhje me Kontraten, Koncesionin, Projektin ose Aeroportin;

(iv) me kusht qe Praktikat e Mira te Industrise, Ligjit te Zbatueshem dhe dispozitat e kesaj Kontrate te jene permushur nga Shoqeria, demet, zhurmat, vibracionet ose ndotjet e shkaktuara nga:

1. avionet ne Aeroport ose mbi te, duke u ngritur dhe ose duke u ulur ne te;

2. çdo aktivitet tjeter i kryer nga Shoqeria ose Kontraktoret e Shoqerise ne Zonen e Koncesionit, ne Zonen e Kufizuar dhe ne Zonen e Zhvillimit ne perputhje me kete Kontrate; dhe

3. Punimet e Ndertimit dhe punimet e lidhura me ndertimin te kryera ne Zonen e Koncesionit, Zonen e Kufizuar dhe Zonen e Zhvillimit ne perputhje me kete Kontrate.

22.4. Demet e Prejardhura

Asnje pale nuk do te jete pergjegjese ndaj ndonje pale tjeter per te mbuluar humbjet ose per arsye te shkeljes se kesaj Kontrate ose te detyrimeve statutore ose sipas ligjit te pergjithshem (duke perfshire, pa u kufizuar, Ligjin e Zbatueshem dhe Ligjin Anglez) per çdo dem rastesor, te prejardhur, ndeshkues ose te posaçem ose humbje te rendesishme ose ekonomike duke perfshire, por duke mos u kufizuar ne, humbje te fitimit, perdorimi, mundesie ose humbje tjeter jo e drejtperdrejte ose e prejardhur qe mund te kete pesuar pala tjeter.

23. RASTET E ÇLIRIMIT NGA PERGJEGJESIA

a) Pasi ndodh Rasti i Clirimit, Shoqeria perfiton nga nje ose te gjithe clirimet e meposhtem sic e vendos firma nderkombetare e kontabilitetit, bazuar ne kete Kontrate, te nevojshme per te eliminuar ndikimin e Rastit te Clirimit (por te mos kompensoje per nje ecuri te dobet nga ana e Shoqerise sipas kesaj Kontrate):

(i) zgjatje te afatit te barabarte me periudhen e Rastit te Clirimit ne menyre qe te permbushe Detyrimet Baze, dhe nese eshte e zbatueshme , Detyrimet Shtese;

(ii) çlirimi nga zbatimi i Pikes 26.3 (Zgjidhje nga Qeveria e Shqiperise per shkak te rastit te mospageses se posaçme nga Shoqeria) dhe Pikes 28.1 (Rastet e Mospageses nga Shoqeria),

(iii) çlirimi nga pagesa e sanksioneve sipas Shtojces 5 (Sanksioni per Mosperputhje me Detyrimet Baze) dhe Shtojces 6 (Sanksioni per Mosperputhje me Detyrimet Shtese) te zbatueshme, dhe nga pagesa e demeve qe lindin nga efektet e Rasteve te Clirimit;

(iv) shtyrje te pageses te maturuar dhe te pagueshme nga Shoqeria ndaj Qeverise se Shqiperise sipas Pikes 20 (c) (Pagesat ndaj Qeverise se Shqiperise), subjekt i nje norme interesi Euro LIBOR plus 3% per vit per çdo shume te Kuotes Junior te gatshme dhe te pagueshme, per çdo periudhe vonese ne pagese te kesaj Kuote Junior (perveçse nese eshte per shkak te rastit te Forces Madhore ose te Rastit te Clirimit nga Pergjegjesia) dhe

(v) shtyrje te tjera te tilla te investimeve ose rregullimeve te detyrimeve ose taksave te Aeroportit qe Palet mund te bien dakord me shkrim.

(b) Ne rast se ndodh nje ngjarje qe cilesohet si Force Madhore dhe njekohesisht Rast Clirimi, Shoqeria do te kete te drejten te vendose (vendim i cili do t'i njoftohet menjehere Qeverise se Shqiperise) nese do te pretendoje Rast Force Madhore apo Rast Clirimi nga Pergjegjesia. Nese Shoqeria do te vendose te pretendoje ndodhien nje Rasti Clirimi nga Pergjegjesia, ajo nuk do te kete te drejten te zgjidhe kete Kontrate para mbarimit te periudhes 12 mujore qe pason daten e njoftimit te ngjarjes se nje Rasti Clirimi nga Pergjegjesia Qeverise se Shqiperise.

(c) Afati i Rastit te Clirimit nga Pergjegjesia do te mbaroje kur niveli i trafikut te pasagjereve ne Aeroport ne nje periudhe gjashte mujore ka arritur mesataren e dy periudhave gjashte mujore ne vitin para ngjarjes se nje Rasti Clirimi nga Pergjegjesia.

(d) Nese Shoqeria do te pretendoje Rastin e Clirimit nga Pergjegjesia, Shoqeria do t'i paguaje Qeverise se Shqiperise kosto te arsyeshme per perfitimin e keshilles financiare nga nje firme kontabiliteti nderkombetare ose keshilltar tjeter i pavarur i pranueshem nga Qeveria e Shqiperise. Nje keshille e tille mund te kerkohet nga Qeveria e Shqiperise ne menyre qe te percaktoje shkallen e humbjes para Shoqerise te shkaktuar nga Rasti i Clirimit nga Pergjegjesia i pretenduar dhe grada e çlirimit te nevojshem per te mundesuar qe Shoqeria te permbushe detyrimet e Sherbimit te Huase Kryesore. Qeveria e Shqiperise eshte e detyruar t'i paguaje Shoqerise shumen e vendosur nga nje firme kontabiliteti nderkombetare ose konsulent financiar i pavarur si te ishte shkalla e humbjes nga Shoqeria e shkaktuar nga Rasti i Clirimit qe pretendohet, perfshire shumen e nevojshme qe mundeson Shoqerine per te permbushur detyrimet e saj sipas Sherbimeve te Huas Kryesore. Humbjet e Shkaktuara nga shkelja prej Shoqerise e kesaj Kontrate ose çdo marreveshjeje tjeter ne lidhje me Koncesionin ose Rastin e Mosprmbushjes te Shoqerise ose çdo ecuri te dobet te Shoqerise qe nuk eshte shkaktuar nga Rasti i Clirimit, nuk do te merret parasysh kur te percaktohet shkalla e nevojshme e çlirimit.

(e) Ne menyre qe te perfitoje nga rastet e çlirimit te percaktuar ne nendarjen (a) me lart, Shoqeria duhet te tregoje se ajo ka bere te gjitha perpjekjet e nevojshme per te lehtesuar kostot e saj te shkaktuara nga ndodhja e nje Rasti Clirimi, si, shtyrja e shpenzimeve jo themelore, shkurtimi i stafit jo kryesor, dhe dhenia e çlirimit ne baze te Kontratave te Lidhura, por pa u kufizuar ne to.

24. Forca madhore

24.1 Rastet e Forces madhore

a) "Rast i Forces madhore" do te thote çdo ngjarje ose rrethane ose kombinim i ngjarjeve ose rrethanave qe teresisht ose pjeserisht parandalojne çdo pale nga permbushja e detyrimeve sipas kesaj Kontrate, por vetem nese dhe ne masen qe raste dhe rrethana te tilla:

(i) nuk jane brenda kontrollit te arsyeshem, te drejtperdrejte ose jo, te pales se ndikuar,

nuk jane rezultat i shkeljes ose pamundesise se pageses nga pala e ndikuar, dhe

nuk do te mund te evitoheshin nese pala e ndikuar do te kishte marre masa te arsyeshme.

Rasti i Forces Madhore perfshin, por nuk kufizohet ne, ngjarjet dhe rrethanat e meposhtme ne masen qe ato ose pasojat e tyre plotesojne kerkesat e mesiperme dhe Piken 24.3 (Detyrimi per te deklaruar Force Madhore) dhe Piken 24.4 (Detyrimi per ndreqjen e Forces Madhore):

(i) çdo veprim lufte (qofte kjo e deklaruar apo jo) lufte civile, pushtim, konflikt i armatosur ose veprim i nje armiku te jashtem, proteste ose terrorizem, ne secilin rast perfshin ose drejtperdesrejti ndikon ne Republiken e Shqiperise;

(ii) revolucion, proteste, rebelim ose çdo kryengritje civile, akt terrorizmi ose sabotimi qe ne secilin rast perfshin ose drejtpersedrejti ndikon ne Republiken e Shqiperise;

(iii) grevat qe kane perhapje te gjere dhe ose jane kombetare dhe ose politike;

(iv)çdo termet, vershim ujrash, zjarr, uragane, ose çdo Akt i Zotit ose fatkeqesi mjedisore qe ndikon drejpersedrejti ose jo drejtperedrejti ne Zonen e Koncesionit;

(v) kontaminimi nuklear, kimik ose biologjik qe drejtpersedrejti ose jo drejtpersedrejti ndikon ne Zonen e Koncesionit, perveç se kur burimi ose shaku i nje kontaminimi te tille eshte rezultat i veprimeve te Shoqerise ose te ndonje prej kontraktoreve te Shoqerise;

(vi) valet e presionit te shkaktuara nga mjete qe udhetojne me shpejtesi supersonike qe drejtpersedrejti ose jo drejtpersedrejti ndikojne ne Zonen e Koncesionit qe parandalon palet nga perputhja me te gjitha ose me nje pjese thelbesore te detyrimeve respektive sipas kesaj Kontrate;

(vii) veprim te kontrolloreve te trafikut qe kontrollojne hapesiren ajrore mbi Republiken e Shqiperise; ose

(viii) epidemi ose infeksione qe drejtpersedrejti ose jo drejtpersedrejti ndikojne ne Zonen e Koncesionit.

24.2 Mospermbushja e Justifikuar e Detyrimeve

Asnje pale nuk do te konsiderohet se nuk ka Permbushur Detyrimet sipas kesaj Kontrate kur dhe ne masen qe permbushja e detyrimeve sipas kesaj Kontrate pengohet ose teresisht ose pjeserisht, nga çdo rrethane Force Madhore qe lind pas dates se kesaj Kontrate dhe çdo pale do te jete e autorizuar te pezulloje permbushjen e detyrimeve ne masen qe kjo pale eshte e penguar teresisht ose pjeserisht nga permbushja e detyrimeve te veta, sipas kesaj Kontrate nga kjo rrethane e Forces Madhore. Ne rast te ngjarjes se nje Force Madhore, Shoqeria do te kete te drejten te perfitoje nga disa ose te gjitha çlirimet e caktuara ne Piken 23 (Rastet e Clirimit).

24.3 Detyrimi per te deklaruar Force Madhore

Nese ndonje pale do te mbeshtetet ne ngjarjen e nje Force Madhore si baze per justifikimin e mospermbushjes se detyrimit sipas kesaj Kontrate, atehere pala qe mbeshtetet ne ngjarjen ose kushtet do te njoftoje menjehere palen tjeter per ngjarjen ose kushtet duke dhene nje vleresim te kohezgjatjes se pritur dhe ndikimin e mundshem ne permbushjen e detyrimeve ketej e tutje.

24.4 Detyrimi per ndreqjen e Forcen Madhore

Ne varesi te Pikes 24.3 (Detyrimi per te Deklaruar Force Madhore) me lart, nese njera prej paleve do te mbeshtetet ne ngjarjen e nje Force Madhore si baze per t'u justifikuar per mospermbushjen e detyrimeve sipas kesaj Kontrate, atehere pala qe mbeshtetet tek ngjarja ose tek kushtet do te:

a) ushtroje çdo perpjekje te arsyeshme per te vazhduar te kryeje detyrimet ketej e tutje;

b) do te ndermarre menjehere veprime per te korrigjuar apo riparuar ngjarjen ose kushtet qe justifikojne permbushjen e detyrave;

c) te ushtroje te gjitha perpjekjet e arsyeshme per te lehtesuar ose kufizuar demet e pales tjeter ne masen qe nje veprim i tille nuk do te ndikoje nga ana e kundert e interesit te tij; dhe

d) do te njoftoje periodikisht palen tjeter ne lidhje me veprimet e saj dhe planet per veprime ne perputhje me (a), (b) dhe (c) me lart dhe do te njoftoje menjehere palen tjeter per pushimin e ngjarjes ose kushteve qe e shkaktuan ate, duke qene e justifikuar nga permbushja e detyrimeve ne rast se nje mosmarreveshje lind mes paleve ne lidhje me faktin nese nje ngjarje ose kushtet qe shkaktuan Forcen Madhore po vazhdojne, rast ne te cilin palet do ta referojne çeshtjen per t'u vendosur ne lidhje me Piken 36 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve).

24.5 Zgjatja e Afatit te Koncesionit per shkak te Forces Madhore

Ne varesi te Pikes 26.2 (Zgjidhja per shkak te Forces Madhore te Tejzgjatur), nese nje Rast Force Madhore me kohezgjatje me shume se nje muaj ndodh ose Rastet e Forces Madhore te marra se bashku me nje gjatesi qe tejkalon dy muaj ndodhin pas Dates se Fillimit dhe para fundit te Afatit te Koncesionit, atehere Afati i Koncesionit do te zgjatet per te gjithe periudhen e kesaj Force Madhore.

24.6 Veprimet jo-Tregtare gjate Forces Madhore

Nese nje Rast i Forces Madhore ka ndodhur dhe po vazhdon, dhe per shkak te ketij Rasti Force Madhore, Aeroporti mbetet i mbyllur ose perndryshe pushon ose ne menyre thelbesore pushon se pranuari trafik ajror tregtar per me shume se 72 ore te njepasnjeshme, Shoqeria nuk do te pengoje ose te kufizoje perdorimin e Aeroportit nga Qeveria e Shqiperise dhe/ose ndonje Ent Shteteror per fluturime ushtarake, qeveritare humanitare ose per fluturim qe kane lidhje me sigurine gjate periudhes se Forces Madhore.

25. Nderhyrja

25.1 E drejta e nderhyrjes

(a) Perveç se kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, as Qeveria e Shqiperise as Enti Shteteror nuk do te nderhyje ose te nderprese, projektimin, ndertimin, perfundimin, venien ne pune, mirembajtjen, financimin, operimin, drejtimin ose zhvillimin e Aeroportit;

(b) Qeveria e Shqipersie mundet ose vete ose nepermjet Entit Shteteror te nderhyje ose te nderprese projektimin, ndertimin, perfundimin, porosine, mirembajtjen, financimin, veprimin, drejtimin ose zhvillimin e Aeroportit vetem ne rrethanat e meposhtme, qe jane kuptuar dhe eshte rene

dakord shprehimisht mes paleve qe neni 13 paragrafi 3 i Ligjit te Koncesionit nuk do te zbatohet ne kete Kontrate:

(i) per mbrojtjen kombetare;

(ii) nese Aeorporti mbetet mbyllur ose perndryshe pushon ose ne menyre thelbesore pushon se pranuari trafik ajror tregtar, per arsye te vetme qe i atribuohen Shoqerise, per me shume se 72 ore te njepasnjeshme pas njoftimit me shkrim nga DPAC qe Shoqeria te hape dhe/ose te vere ne perdorim Aeroportin; ose

(iii) nese nje Rast i Forces Madhore ka ndodhur dhe po vazhdon dhe per shkak te ketij Rasti te Forces Madhore, Aeroporti mbetet i mbyllur ose perndryshe pushon ose ne menyre thelbesore pushon se pranuari trafik ajror tregtar, per me shume se 72 ore njera pas tjetres, duke parashikuar se kjo nderhyrje mund te jete vetem me qellimin e mundesimit te perdorimit te Aeroportit ne rast urgjence, ndihme humanitare, qeveritare, ose aviacioni ushtarak, gjate periudhes se nje Rasti Force Madhore.

(c) Asnje nderprerje ose nderhyrje e kesaj natyre nuk do te zgjase me shume se sa eshte e nevojshme duke patur parasysh rrethanat qe çojne ne lindjen e kerkesave si pasoje.

(d) Pasi Shoqeria ka njoftuar Qeverine e Shqiperise per aftesine e saj per te permbledhur permbushjen e detyrimeve te saj sipas kesaj Kontrate dhe i ka dhene Qeverise se Shqiperise prova te kenaqshme te kesaj aftesie, Qeveria e Shqiperise do te pushoje nderhyrjen e saj brenda 72 oresh dhe do te bashkepunoje me Shoqerine ne lidhje me rikthimin e pergjegjesive dhe kontrollin e Shoqerise mbi Aeroportin.

25.2 Kompensimi per Nderhyrjen

a) Nese Qeveria e Shqiperise ose nje Ent Shteteror ka nderhyre ne perputhje me Piken 25.1 (b) (i) (E Drejta e Nderhyrjes) Qeveria e Shqiperise do t'i paguaje Shoqerise ne lidhje me periudhen e nje nderhyrjeje te tille shumen e Sherbimit te Huas Kryesore, detyrimet e Shoqerise per Sherbimin per Huan e Nenrenditur, Koston e Kapitalit dhe kostot e operacioneve dhe çdo kosto tjeter te Shoqerise qe eshte shpenzuar ne menyre te domosdoshme nga Shoqeria ne lidhje me nderhyrjen dhe gjate saj, minus shumen e Pagesave te Aeroportit dhe te ardhura te tjera te mbledhura nga Shoqeria gjate periudhes se nderhyrjes. Asnje Shume e Huas se Meparshme nuk do te paguhet nga Shoqeria gjate periudhes se nderhyrjes.

b) Nese Qeveria e Shqiperise ose ndonje Ent Shteteror ka nderhyre ne perputhje me Piken 25.1 (b) (i) (E Drejta e Nderhyrjes), Qeveria e Shqiperise do t'i paguaje Shoqerise ne lidhje me periudhen e kesaj nderhyrjeje shumen e Sherbimit te Huas Kryesore, detyrimet e Shoqerise per Sherbimet per Huan e Nenrenditur dhe kostot operacionale dhe kosto te tjera te shpenzuara nga Shoqeria ne menyre te domosdoshme ne lidhje me nderhyrjen dhe gjate saj, minus shumen e pagesave te Aeroportit dhe te ardhura te tjera te mbledhura nga Shoqeria gjate periudhes se nderhyrjes. Per te shmangur dyshimin, nese, gjate periudhes se nderhyrjes ne perputhje me Piken 25.1 (b) (ii) (E Drejta e Nderhyrjes) Qeveria e Shqiperise do te vendose te vere ne perdorim Aeroportin me personelin e saj, Qeveria e Shqiperise do t'i paguaje Shoqerise vetem shumen e Sherbimit te Huas Kryesore, detyrimet e Shoqerise per Sherbimet e Huas se Nenrenditur dhe kostot qe nuk jane te lidhura me personelin qe jane shpenzuar ne menyre te dosmosdoshme nga Shoqeria ne lidhje me nderhyrjen dhe gjate saj, minus shumen e Pagesave te Aeroportit, Shumat e Huas se Meparshme dhe te ardhura te tjera te mbledhura nga Shoqeria gjate periudhes se nderhyrjes. Asnje Shume e Huas se Meparshme nuk do te paguhet nga Shoqeria gjate periudhes se nderhyrjes;

c) Ne rast vonese te permbushjes se ndonjerit prej Detyrimeve Kryesore ose te Detyrimeve Shtese nga Shoqeria per arsye te nderhyrjes nga Qeveria e Shqiperise ose nga ndonje Ent Shteteror, Shoqeria do te jete e autorizuar per:

(i) zgjatje te Periudhes se Kerkuar te Detyrimeve ose te Periudhes se Zbatimit, siç eshte e zbatueshme, duke i korresponduar periudhes se nderhyrjes; dhe

(ii) çlirimin nga pagesa e sanksioneve per mospermbushje te Detyrimeve Kryesore ose Detyrimeve Shtese ne masen kur nje mospermbushje e tille eshte shkaktuar nga nderhyrja.

d) Per raste te tjera nga ato te referuara ne Piken 25.1(ii), Shoqeria do te clirohet nga detyrimet e saj per t'i paguar Qeverise se Shqiperise Pagesen e Garancise se Transhit te Huas Shteterore lidhur me peridhen e nderhyrjes nga Qeveria e Shqiperise.

26. Zgjidhja

26.1 Zgjidhja pas Nderhyrjes

a) Pas dates qe bie 60 dite pas dates se pare te nderhyrjes nga Qeveria e Shqiperise ose ndonje Ent tjeter Shteteror, duke marre parasysh qe nje nderhyrje e tille eshte e vazhdueshme, kjo Kontrate mund te zgjidhet nga Shoqeria, pasi Shoqeria t'i jape Njoftimin per Zgjidhje, Qeverise se Shqiperise, siç vijon;

(i) ne rast nderhyrjeje sipas pikes 25.1 (b) (ii) (E Drejta e Nderhyrjes) ne perputhje me Piken 26.3 (Zgjidhja nga Qeveria ne Rastin e Vecante te Mospermbushjes nga Shoqeria)

(ii) ne rast nderhyrjeje sipas Pikes 25.1 (b) (iii) (E Drejta e Nderhyrjes) ne perputhje me Piken 26.2 (Zgjidhja per shkak te Forces Madhore te Tejzgjatur).

b) Ne rast nderhyrjeje sipas Pikes 25.1 (b) (i) (E Drejta e Nderhyrjes) duke pasur parasysh se kjo nderhyrje vazhdon per me shume se 60 dite te njepasnjeshme ose 90 dite se bashku gjate nje afat dy vjeçar, Shoqeria do te jete e autorizuar te zgjidhe Kontraten dhe t'i paguhet kompensim ne perputhje me Piklen 26.4 (b) dhe (c) (Zgjidhja nga Shoqeria ne Rastin e Vecante te Mospermbshjes nga Qeverisa e Shqiperise).

26.2 Zgjidhja per shkak te Forces Madhore te Tejzgjatur

a) Nese nje Rast i Forces Madhore vazhdon ose eshte e mundur te vazhdoje per nje peiudhe me te gjate se gjashte muaj te njepasnjeshen, sipas gjykimit te arsyeshem te Paleve, perveç te drejtes se parashikuar ne Piken 24. 5 (Zgjatja e Afatit te Koncesionit per shkak te Forces Madhore) çdo pale mund te zgjidhe kete Kontrate duke i bere nje Njoftim per Zgjidhje Pales tjeter.

b) Shoqeria do te kete te drejten e kompensimit te llogaritur si shuma e:

i) shumes se mbetur te principalit te Huas Kryesore te Certifikuar dhe Huas se Nenrenditur te Certifikuar ne periudhen e zgjidhjes, duke perfshire çdo interes te mbartur deri ne daten qe nje kompensim i tille te paguhet i plote dhe Kostot e Demtimeve;

ii) Kapitalitin Aksioner te Shoqerise, (perjashtuar Huan e Nenrenditur te Certifikuar) minus shumen shperndarjeve te dividendit ose pagesa te tjera te Shoqerise ndaj Ortakeve, perveç Kontratave te Lidhura ne perputhje me Piken 14.3 (Kontratat e Lidhura). Per te shmangur paqartesite, kjo shume nuk do t'i paguhet Shoqerise ne rastin e ngjarjeve te Forces Madhore Natyrore; dhe

iii) shumes se llogaritur me interes 5% ne vit mbi shumen e plote te paguar te Kapitalit te Shoqerise (perjashtuar Huan e Nenrenditur te Certifikuar) ne lidhje me periudhen qe nga fillimi i Ngjarjes se Forces Madhore Natyrore qe çon ne zgjidhjen e kesaj Kontrate dhe daten e zgjidhjes se kesaj Kontrate;

minus shumat e:

1) gjendjes se llogarise se likuiditetit te Shoqerise duke zbritur te gjitha shumat e duhura per shperndarje te dividendeve, te deklaruara nga Shoqeria ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem per vitin qe paraprin vitin e Rastit te Forces Madhore ose, nese Rasti i Forces Madhore ndodh para tre pervjetorit te Dates se Fillimit, per tre vitet e para te Afatit te Koncesionit, dhe

2) shumes se te ardhurave ne baze te sigurimit te Shoqerise te perfituar ne lidhje me kete Kontrate, te ardhura te cilat jane marre ose do te merren nga Shoqeria dhe jane mbajtur ose do te mbahen ne nje llogari te vecante te Shoqerise, llogari, e cila (perfshire gjendjen e saj) mund t'i nenshtrohet Barres Sigurues te vendosur ne favor te Huadhenesit Kryesor.

Nje kompensim i tille do te paguhet si nje shume e vetme ose ne forme tjeter nese keshtu eshte rene dakord.

c) Shoqeria eshte e autorizuar te kerkoje nje vleresim te pavarur nga nje ekspert i pershtatshem i kualifikuar te vleres se aktiveve te saj (mbi nje baze te kostos historike te amortizuar) duke marre parasysh kushtet e pasurive te tilla dhe koston e modifikimeve per t'i sjelle aktivet ne kushtet e kerkuara me qellim perputhjen me kete Kontrate. Çdo tejkalim i vleres se vendosur nga nje ekspert i tille i pershtatshem i kualifikuar mbi shumen e kompensimit te llogaritur ne perputhje me Piken 26.2 (b) (Zgjidhja per shkak te Forces Madhore Natyrore te Tejzgjatur) me lart do t'i paguhet Shoqerise nga Qeveria e Shqiperise. Raporti i vleresimit i pergatitur nga eksperti do te jete i detyrueshem per te dyja Palet. Tejkalimi i vleres se percaktuar nga raporti i vleresimit do te paguhet si nje shume me nje kest te vetem.

26.3 Zgjidhja nga Qeveria e Shqiperise ne Rastet e Vecanta te Mospermbushjes nga Shoqeria

(a) Pa paragjykuar ndonje te drejte tjeter qe ajo mund te kete ne baze te kesaj Kontrate,

Qeveria e Shqiperise mund ta zgjidhe kete Kontrate, pasi t'i jape nje Njoftim per Zgjidhje Pales tjeter, nese ndodh ndonje prej rasteve te meposhtme ("Rasti i Zgjidhjes se Kontrates nga Qeveria e Shqiperise")

(i) nje Shkelje Thelbesore nga Shoqeria qe ka ndodhur dhe po vazhdon per 30 Dite Pune njera pas tjetres pas dates se njoftimit te vlefshem per riparim te leshuar nga Qeveria e Shqiperise;

(ii) pamundesia e Shoqerise per te paguar ndonje shume thelbesore te gatshme dhe te pagueshme ndaj Qeverise se Shqiperise sipas kesaj Kontrate, qe ka ndodhur dhe po vazhdon per 30 dite pune njera pas tjetres;

(iii) nje Rast Pamundesie Pagese ndodh ne lidhje me Shoqerine;

(iv) vazhdimi nga Shoqeria i ndonje aktiviteti ne lidhje me Koncesionin pa sigurimin (et) e kerkuar sipas kesaj Kontrate qe te jene ne fuqi dhe efekt te plote, duke patur parasysh se ne rast te nje terheqjeje te papritur dhe mos-disponueshmerie ne treg te sigurimeve te kerkuara, nese Shoqeria menjehere informon Qeverine e Shqiperise per nje fakt te tille, Shoqeria do te jete e autorizuar per nje periudhe riparimi (nje periudhe e tille do te percaktohet ne menyre te arsyeshme nga Qeveria e Shqiperise);

(v) mosfillimi nga Shoqeria brenda periudhes tre mujore qe nga data e fillimit i ndertimit (qe do te perfshije per kete qellim germimin e themeleve) ose, pastaj nderprerja se ndertuari e Fazes A te Terminalit te Ri per nje periudhe 60 ditesh te njepasnjeshme;

(vi) mosdhenia nga Shoqeria e Garancise se Permbushjes se Detyrimeve te Shoqerise;

(vii) shkelja nga Shoqeria te ndonje prej detyrimeve te saj sipas kesaj Kontrate, te cilat ne rast mosmarreveshjeje midis Paleve, vazhdojne te parregulluara per me shume se 60 dite te njepasnjeshme pas dates se marrjes nga Palet te nje vendimi te tribunalit te arbitrazhit te caktuar ne perputhje me Piken 36 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve);

(viii) shkelje te ndonje ose te gjitha deklarateve dhe garancive te Shoqerise te specifikuara ne Piken 27.2 (Shoqeria); ose

(ix) mospagimi nga secili Ortak i cdo kesti te Kapitalit Aksioner te Deklaruar (siç parashikohet ne Shtojcen 2 (Shlyerja e Kapitalit te Deklaruar per fazen A te Punimeve te Ndertimit) ndaj Shoqerise ne kohen e caktuar, me perjashtim te zevendesimit te financimit te Kapitalit Aksioner te vene ne vend nga Ortaku (et) brenda 45 diteve nga mospagesa.

(b) Shoqeria do te kete te drejten e kompensimit te llogaritur si vlera me e larte midis:

(i) shumes se principalit te mbetur te Huas Kryesore te Certifikuar dhe Huas se Nenrenditur te Certifikuar ne kohen e zgjidhjes se Kontrates, duke perfshire çdo interes te mbartur deri ne daten qe nje kompensim i tille paguhet plotesisht dhe Kostot e Demtimeve; dhe

(ii) kostos historike te amortizuar, duke marre parasysh kushtet e aktiveve ne kohen e zgjidhjes se kesaj Kontrate, te Aktiveve ne Dorezim, minus kostot e arsyeshme te Qeverise se Shqiperise te ri-tenderimit te Koncesionit.

Shumes se kompensimit te mesiperm i zbritet shuma e:

(i) gjendjes se llogarise se likuiditetit te Shoqerise minus te gjithe shumat qe duhet per shperndarje dividendesh te deklaruar nga Shoqeria ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem per vitin qe paraprin vitin e Rastit te Mospermbushjes nga Shoqeria ose, nese Rasti i Mospermbushjes nga Shoqeria ndodh perpara tre pervjetorit te Dates se Fillimit, per tre vitet e para te Afatit te Koncesionit; dhe

(ii) shuma e procedimeve sipas sigurimit te Shoqerise te marre ne lidhje me kete Kontrate, te ardhura, te cilat jane arketuar ose do te arketohen nga Shoqeria dhe jane mbajtur ose do te mbahen ne nje llogari te vecante te Shoqerise, llogari, e cila (perfshire gjendjen e saj) mund te jete ne varesi te Barres Siguruese te vendosur ne favor te Huadhenesit Kryesor.

Ky kompensim do te paguhet si nje shume e vetme ose ne forme tjeter ne rast se keshtu eshte rene dakord.

(c) ne Rast te Zgjidhjes nga ana e Qeverise se Shqiperise, Qeveria e Shqiperise do te kete te drejten te njoftoje Shoqerine dhe Huadhenesin duke specifikuar qe nje shkelje e Kontrates ka ndodhur, natyren e rrethanave perkatese dhe (nese eshte e mundur riparimi) duke kerkuar qe Shoqeria te riparoje brenda periudhes se specifikuar ne njoftim, kjo periudhe riparimi duhet t'i korrespondoje periudhes se riparimit te percaktuar ne Piken 26.3 (a) (Zgjidhja nga Qeveria e Shqiperise ne Rastin e Vecante te Mospermbushjes nga ana e Shoqerise) per nje rast specifik, qe do te jete e arsyeshme (por

ne asnje rast me pak se 30 dite). Nese Shoqeria kundershton se Rasti i Zgjidhjes nga Qevria Shqiptare te referuar ne njoftimin e dhene nga Qeveria e Shqiperise ka ndodhur, Shoqeria do te kete te drejten brenda 30 diteve pas dates se marrjes se njoftimit, te paraqese kete mosmarreveshje para arbitrazhit ne perputhje me Piken 36 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve).

(d) nese rrethana perkatese qe sjell Rastin e Zgjidhjes nga Qeveria e Shqiperise nuk eshte e mundur te riparohet ose, nese eshte e mundur te riparohet, nuk eshte riparuar para mbarimit te periudhes se riparimit te specifikuar ne njoftim, Qeveria e Shqiperise do te kete te drejten ta zgjidhe kete Kontrate ne perputhje me Piken 32.1(a) (Te drejtat e Nderhyrjes se Huadhenesit). Nese qeveria e Shqiperise zgjedh te mos e zgjidhe kete Kontrate ne perputhje me Piken 32.1(a) (Te drejtat e Nderhyrjes se Huadhenesit), Qeveria e Shqiperise do te njoftoje Huadhenesin se ai ka 60 dite (ose nje periudhe me te gjate siç mund te specifikohet ne njoftim) brenda se ciles te zbatoje marreveshjen qe rregullon te drejtat e nderhyrjes se Huadhenesit. Nese Huadhenesi zbaton marreveshjen qe rregullon te drejtat e nderhyrjes se Huadhenesit, Qeveria e Shqiperise nuk do te jete e autorizuar ta zgjidhe kete Kontrate si rezultat i ndonje shkeljeje apo mospagese ekzistuese ne daten e zbatimit te saj deri (nese eshte i mundur riparimi) ne periudhen e arsyeshme qe ka patur Huadhenesi per ta riparuar, ne Rastin e Zgjidhjes se Kontrates nga Qeveria e Shqiperise.

(e) nese Qeveria e Shqiperise nuk e zgjidh kete Kontrate ne perputhje me Piken 32.1 (a) (Te Drejtat e Nderhyrjes se Huadhenesit) dhe Huadhenesi nuk e zbaton marreveshjen qe rregullon te drejtat e nderhyrjes se Huadhenesit, Qeveria e Shqiperise mund te ushtroje te drejten e saj te zevendesimit ne perputhje me Piken 32.2 (Zevendesimi nga Qeveria e Shqiperise), ne te cilin rast kjo Kontrate nuk do te zgjidhet, por do te vazhdoje ndermjet Qeverise se Shqiperise dhe Entit Zevendesues.

(f) Qeveria e Shqiperise nuk do ta zgjidhe kete Kontrate perveç Rastit te Zgjidhjes nga Qeveria e Shqiperise ose siç eshte parashikuar posaçerisht ndryshe ne kete Kontrate. Çdo shkelje nga Qeveria e Shqiperise se kesaj dispozite do te autorizoje Shoqerine per te marre kompensim, i cili do te llogaritet ne perputhje me Piken 26.4 (b) (Zgjidhja nga Shoqeria ne Rastet e Vecanta te Mospermbsuhjes nga Qeveria e Shqiperise).

26.4 Zgjidhja nga Shoqeria ne Rastet e Vecanta te Mospermbushjes nga Qeveria e Shqiperise

(a) Pa paragjykime ndaj cdo te drejte tjeter qe ajo mund te kete sipas kesaj Kontrate, Shoqeria mund ta zgjidhe kete Kontrate, pasi t'i kete dhene nje Njoftim per Zgjidhje Pales tjeter, nese ndonje prej rasteve te meposhtme ("Rasti i Zgjidhjes nga Shoqeria") ndodh:

(i) nje Shkelje Thelbesore nga Qeveria e Shqiperise, qe ka ndodhur dhe po vazhdon per 30 Dite Pune te njepasnjeshme pas dates se njoftimit te vlefshem per te riparuar, te leshuar nga Shoqeria;

(ii) deshtimi per te siguruar Sherbimet e Siguruara te Qeverise (perveç se per shkak te ngjarjes se nje Rasti te Forces Madhore) te cilat kerkohen per operimin normal te Aeroportit per nje periudhe jo me te gjate se 20 dite te njepasnjeshme;

(iii) pas kerkimeve arkeologjike te Zones se Koncesionit ose Zones se Kufizuar te ndermarra ne perputhje me Piken 6.3 (h) (Ndertimi), konfirmimi se ka struktura ose gjera te nje interesi te veçante gjeologjik ose arkeologjik, per nje periudhe me te gjate kohore se 180 dite te njepasnjeshme, ekzistenca e te cilave pengon Shoqerine nga kryerja e detyrimeve te saj sipas kesaj Kontrate;

(iv) shkelja nga Qeveria e Shqiperise (duke perfshire çdo Ent Shteteror) te ndonje prej detyrimeve te kesaj Kontrate, i cili ne rast mosmarreveshjeje mes Paleve vazhdon i pariparuar per me teper se 60 dite te njepasnjeshme pas dates se marrjes nga Palet te nje vendimi te tribunalit te arbitrazhit ne perputhje me Piken 36 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve); ose

(v) Shkelja e nje ose te gjitha deklarimeve dhe garancive te Qeverise se Shqiperise te specifikuara ne Piken 27.1 (Qeveria e Shqiperise).

(b) Shoqeria do te kete te drejten e kompensimit te llogaritur si shuma e:

(i) shumes se principalit te Huas Kryesore te Certifikuar dhe Huas se Nenrenditur te Certifikuar ne kohen e perfundimit, duke perfshire çdo interes te mbartur aty deri ne daten qe ky interes eshte plotesisht i paguar, dhe Kostot e Demtimeve;

(ii) Kapitalit Aksioner te Shoqerise;

(iii) vleres se llogaritur ne nje Kosto e Kapitalit e akumulueshme te Shoqerise, ne lidhje me periudhen ndermjet Dates se Fillimit dhe dates se perfundimit, minus shumen e shperndarjeve te

dividenteve ose pagesave te tjera perveç Kontratave te Lidhura te lejuara sipas Pikes 14.3 (Kontratat e Lidhura) nga Shoqeria per Ortaket (duke perfshire riblerjen e Kapitalit) dhe duke pasur parasysh qe asnje kompensim i tille nuk do te jete i pagueshem nga Qeveria e Shqiperise per te mbuluar deficitet qe ka pesuar Shoqeria para ngjarjes se nje Rasti te Zgjidhjes nga Shoqeria (me perjashtim te rastit kur keto deficite jane shkaktuar drejtpersedrejti nga veprimet e Qeverise se Shqiperise ose nga nje Rast Force Madhore);

minus shumen e:

(1) gjendjes se llogarise se likuiditetit teShoqerise; dhe

(2) vleres se te ardhurave sipas sigurimeve te Shoqerise te bera ne lidhje me kete Kontrate, te ardhura te cilat jane marre ose do te merren nga Shoqeria dhe jane mbajtur ose do te mbahen ne nje llogari te vecante te Shoqerise, llogari, e cila (perfshire gjendjen e saj) mund te jete ne varesi te Barres Siguruese te vendosur ne favor te Huadhenesit Kryesor.

Nje kompensim i tille do te paguhet si nje shume e vetme, ose ne nje menyre tjeter nese keshtu eshte rene dakort.

(c) Ne Rastin e Zgjidhjes nga Shoqeria, Shoqeria do te kete te drejten te njoftoje Qeverine e Shqiperise duke specifikuar qe nje shkelje e kesaj Kontrate ka ndodhur, natyra e rrethanave perkatese dhe (nese eshte i mundur riparimi) duke i kerkuar Qeverise se Shqiperise ta riparoje brenda periudhes se riparimit te specifikuar ne njoftim, kjo periudhe riparimi duhet t'i korrespondoje periudhes se riparimit te caktuar ne Piken 26.4 (a) (Zgjidhja nga Shoqeria ne Rastin e Vecante te Mospermbushjes nga Qeveria e Shqiperise) per nje ngjarje specifike, ose nese nuk eshte percaktuar ne Piken 26.4 (Zgjidhja nga Shoqeria ne Rastin e Vecante te Mospermushjes nga Qeveria e Shqiperise) per nje rast specifik, te jete i arsyeshem (por ne asnje rast me pak se 30 dite). Nese Qeveria e Shqiperise kundershton qe Rasti i Zgjidhjes nga Shoqeria i referuar ne njoftimin e dhene nga Shoqeria ka ndodhur, Qeveria e Shqiperise do te kete te drejten, qe brenda 30 diteve pas dates se marrjes se njoftimit, ta paraqese kete mosmarreveshje para arbitrazhit, ne peputhje me Piken 36 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve).

(d) Shoqeria do te kete te drejten per ta zgjidhur Kontraten nese Rasti i Zgjidhjes nga Shoqeria, nese mund te riparohet, nuk eshte riparuar brenda periudhes perkatese te riparimit pas njoftimit nga Shoqeria Qeverise se Shqiperise. Qeveria e Shqiperise, perveç rastit kur ajo kundershton ose vlefshmerine e kerkeses, ose shumen e kompensimit, do te paguaje shumen e kompensimit te kerkuar nga Shoqeria brenda 30 diteve nga marrja e nje kerkese te tille. Nese Qeveria e Shqiperise do te kundershtoje vlefshmerine e kerkeses ose shumen e kompensimit te kerkuar, dhe Qeveria e Shqiperise dhe Shoqeria do te jene te paafta ta zgjidhin kete mosmarreveshje brenda 30 diteve nga marrja e kerkeses, pastaj ose Qeveria e Shqiperise ose Shoqeria mund ta paraqesin mosmarreveshjen para arbitrazhit sipas Pikes 36 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve).

26.5 Vazhdimi i Detyrimeve pas Zgjidhjes

Ne varesi te Pikes 3.6 (Mospermbushja e Kushteve Paraprake), dispozitat e Pikes 22 (Pergjegjesite dhe Kufizimet e Pergjegjesise), Pikes 33 (Te Drejtat e Pronesise Intelektuale), Pikes 34 (Konfidencialiteti), Pikes 36 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve) dhe Pikes 38 (Ligji Rregullues) do te vazhdojne te mbeten ne fuqi edhe pas zgjidhjes se kesaj Kontrate.

26.6 Pasojat e Zgjidhjes

Mbarimi i Afatit te Koncesionit ose zgjidhja e kesaj Kontrate do te behet pa paragjykime per te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe i jane grumbulluar Qeverise se Shqiperise ose Shoqerise dhe pa paragjykime per ato dispozita te cilat shprehimisht parashikojne vazhdimin e detyrimeve ose te cilat kerkohen qe t'i japin efekt ketij perfundimi ose zgjidhje ose pasojave te perfundimit ose te zgjidhjes.

27. DEKLARIMET DHE GARANCITE

27.1 Qeveria e Shqiperise

Qeveria e Shqiperise deklaron, garanton dhe merr persiper ndaj Shoqerise, se qe nga data e nenshkrimit kesaj Kontrate dhe deri ne Daten e Fillimit:

a) ka tagre dhe autoritet te plote te lidhe kete Kontrate;

b) si rrjedhoje e krijimit, dhenies dhe regjistrimit te se drejtes se perdorimit dhe te Uzufruktit ne lidhje me Zonen e Koncesionit dhe te dorezimit te Zones se Koncesionit Shoqerise, Shoqeria gezon te drejta te plota per perdorimin dhe posedimin e Zonen se Koncesionit dhe te Aktiveve te Lidhura me te;

c) Pergjate Afatit te Koncesionit, Aktivet e Lidhura ne pronesi te Qeverise Shqiptare jane dhe do te mbeten te lira nga cdo Barre Siguruese apo te drejta te paleve te treta, duke perfshire pa kufizim edhe te drejtat e pronareve te meparshem;

d) ka kryer te gjitha veprimet e duhura per lidhjen e kesaj Kontrate dhe permbushjen e detyrimeve te saj sipas kesaj Kontrate; dhe

e) me hyrjen ne fuqi te Ligjit te Koncesionit te Aeroportit, kjo Kontrate behet e vlefshme, efektive, e detyrueshme dhe e zbatueshme ne te gjitha kushtet e saj sipas Ligjit te Zbatueshem, dhe

f) Zona e Koncesionit, Terminali Ekzistues dhe Sheshi i Terminalit Ekzistues, jane dhe do te mbeten prone e Qeverise Shqiptare gjate Afatit te Koncesionit, te lira nga cdo garanci apo te drejta te ndonje pale te trete, duke perfshire pa kufizim te drejtat e pronareve te meparshem.

27.2 Shoqeria

Shoqeria deklaron, garanton dhe merr persiper ndaj Qeverise se Shqiperise se, qe nga Data Efektive, kur te ndodhe, Data e Fillimit dhe ne cdo kohe me pas, gjate Afatit te Koncesionit:

a) eshte shoqeri e krijuar rregullisht ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise dhe ka si objekt te vetem te veprimtarise se saj, kryerjen e veprimtarive, te cilat sipas kesaj Kontrate jane te lidhura me Koncesionin;

b) nuk ka asnje Filial;

c) nuk eshte ne gjendje Paftesie Paguese;

d) vepron ne perputhje te plote me Ligjet e Zbatueshme dhe dispozitat e kesaj Kontrate;

e) ka tagre dhe autoritet te plote per te lidhur kete Kontrate, ka kryer te gjitha veprimet e nevojshme per te marre autorizimin per lidhjen e kesaj Kontrate si dhe permbushjen e detyrimeve sipas saj;

f) gezon kapacitetin dhe gjendjen financiare per te ndermarre kete Projekt;

g) kjo kontrate perfaqeson ligjshmerine, vlefshmerine dhe detyrueshmerine e detyrimeve te saj te zbatueshme ndaj shoqerise sipas kushteve te ketij dokumenti;

h) neneshkrimi, depozitimi dhe zbatimi i kesaj Kontrate, sipas rastit, nuk do te jete ne kundershtim, rezultoje ne ndonje shkelje, nuk do te perbejne nje Mospermbushje apo nuk do te pershpejtoje zbatimin e kerkuar te ndonje prej kushteve te Statutit ose Ligjeve te Zbatueshme, ndonje angazhimi, kontrate, memorandumi mirekuptimi, dekreti apo urdheri ne te cilen ajo eshte pale ose me te cilen ajo vete apo aktivet e saj jane te lidhur apo te prekur.

i) nuk do te kete veprime, padi, procedime, ose hetime ne zhvillim, ne dijeni te Shoqerise, te drejtuara kunder saj perpara cdo trupi gjykues ose perpara cdo autoriteti gjyqesor, pothuaj – gjyqesor, ose autoriteti tjeter, perfundimi i te cilave mund te rezultoje ne shkelje ose te perbeje nje Mospermbushje nga Shoqeria sipas kesaj Kontrate , ose ky perfundim vetem apo bashke me te tjeret te prodhoje nje Ndryshim Thelbesor Negativ.

j) shuma e pjeseve te Kapitalit te nenshkruara dhe shlyera plotesisht arrin te pakten 27% te shumes totale te financimit te arritur nga Shoqeria sipas Dokumentave te Financimit ne lidhje me plotesimin nga Shoqeria te Detyrimeve Kryesore dhe detyrimeve ne lidhje me Rrugen e Re Hyrese;

k) pervec Barres Siguruese te dhene ose qe duhet t'i jepet Huadhenesit sipas Dokumenteve te Financimit, asnje Barre tjeter Siguruese nuk vendoset mbi pjeset e kapitalit te Shoqerise; dhe

l) ajo organizohet dhe drejtohet ne perputhje me rregullat dhe parimet e qeverisjes se mire te shoqerise.

Shoqeria eshte ne gjendje qe t'i perserite te gjitha deklarimet dhe garancite e Shoqerise ne kete Pike, ne cdo dite gjate Afatit te Koncesionit, mbeshtetur ne faktet dhe rrethanat e rastit

28. RASTET E MOSPERMBUSHJES

28.1 Rastet e Mospermbushjes nga Shoqeria

Secili prej rasteve qe vijon perben rastin e mospermbushje nga Shoqeria (Rastet e Mospermbushjes nga Shoqeria) pervec kur Rasti i Mospermbshjes nga Shoqeria vjen per shkak te Rastit te Forces Madhore ose Rastit te Clirimit te Mospermbushjes nga Qeveria e Shqiperise:

a) Shoqeria nuk ka permbushur ndonje prej detyrimeve te saj ne afatin e duhur sipas Kontrates (pervec detyrimeve te saj te lidhur me sigurine teknike dhe sigurimin ne pergjithesi) dhe nuk ka arritur qe brenda afatit perkates te ndreqjes te caktuar ne kete Kontrate per nje rast specifik, ose kur nuk behet fjale per kete rast, brenda afatit te ndreqjes te njoftuar Shoqerise nga Qeveria Shqiptare, te ndreqe kete mospermbushje me kusht qe afati i ndreqjes te jete jo me pak se 30 dite.

b) çdo deklarim i bere ose garanci e dhene nga Shoqeria sipas kesaj Kontrate zbulohet te jete fals ose ne mashtrim.

c) Shoqeria ndodhet para Rastit te Paaftesise Paguese

d) ka nje Mospermbushje sipas Dokumenteve te Financimit dhe ndonje nga Huadhenesit Kryesore ka kerkuar pagesat e tij te ardhshme dhe pershpejtuar shlyerjet e shumave qe duhen bere sipas secilit prej Dokumenteve te Financimit.

e) Shoqeria nuk e njeh kete Kontrate ose ne nje menyre tjeter le te kuptoje qellimin e saj per te mos qene me e detyruar sipas kesaj Kontrate .

28.2 Pasojat e Mospermbushjes nga Shoqeria

Pa paragjykuar asnje nga te drejtat e tjera ose te ndreqjes qe Qeveria Shqiptare gezon sipas kesaj Kontrate, kur te ndodhet para Rastit te Mospermbushjes nga Shoqeria, Qeveria e Shqiperise ka te drejte t'i dergoje kesaj te fundit kerkese me shkrim per ndreqjen e mospermbushjes perkatese brenda nje afati te arsyeshem te ndreqjes qe caktohet ne kerkesen me shkrim. Shoqeria duhet qe menjehere (duke marre parasysh edhe natyren e mospermbushjes) t'i dorezoje Qeverise Shqiptare nje plan te hartuar me shkrim per ndreqjen e kesaj mospermbushje dhe te vere ne zbatim pa vonese kete plan, te pranuar nga Qeveria Shqiptare. Ne rast se Shoqeria, per cfaredolloj aresyeje, nuk e ndreq mospermbushjen perkatese brenda afatit te ndreqjes, kjo mospermbushje shnderrohet ne Shkelje Thelbesore menjehere pas perfundimit te afatit te ndreqjes, dhe Qeveria Shqiptare:

a) ne lidhje me Rastin e Mospermbushjes te Shoqerise te pershkruar ne Piken 28.1(a) (Rastet e Mospermbushjes te Shoqerise), (ne lidhje me permbushjen vetem te Detyrimit Kryesor) perfiton nga Shoqeria, ne diten e pare te secilit muaj gjate afatit ne te cilen Rasti i Mospermbushjes nga Shoqeria ka filluar dhe vazhdon, pagesen ne shumen dhe kushtet e pershkruara ne Shtojcein 5 (Sanksionet per Mospermbushje te Detyrimeve Kryesore).

b) ne lidhje me Rastin e Mospermbushjes te Shoqerise te pershkruar ne Piken 28.1(a) (Rasti i Mospermbushjes se Shoqerise) (lidhur vetem me permbushjen e Detyrimeve Shtese), perfiton nga Shoqeria ne diten e pare te secilit muaj gjate periudhes qe ky Rast Mospermbushje nga Shoqeria ka filluar dhe vazhdon, pagesen ne shumen dhe kushtet e pershkruara ne Shtojcen 6 (Sanksionet per Mospermbushje te Detyrimeve Shtese).

28.3 Rastet e Mospermbushjes nga Qeveria e Shqiperise

Rastet qe vijojne perbejne rastet e mospermbushjes se detyrimeve nga Qeveria Shqiptare ("Rast i Mospermbushjes nga Qeveria Shqiptare"), perjashtuar rastet kur ky Rast Mospermbushje nga Qeveria e Shqiperise ndodh si rrjedhoje e nje Rasti Mospermbushje te Shoqerise ose per shkak te nje Rasti te Forces Madhore:

a) Pervec rastit te pershkruar ne nen-paragrafin (d) me poshte, Qeveria e Shqiperise nuk permbush ndonje nga detyrimet e saj sipas kesaj Kontrate dhe njekohesisht nuk e ndreq kete mospermbushje brenda afatit perkates te ndreqjes te caktuar ne kete Kontrate per nje rast specifik, dhe nese nuk behet fjale per kete rast, pas afatit te caktuar per ndreqje Qeverise se Shqiperise me kusht qe ky afat mos te jete me pak se 30 dite.

b) Qeveria e Shqiperise nuk e njeh kete Kontrate ose ne nje menyre tjeter le te kuptoje qellimin e saj per te mos qene me e detyruar sipas kesaj Kontrate .

c) Qeveria e Shqiperise apo cdo Ent tjeter Shteteror, si rrjedhoje e veprimeve apo mosveprimeve te tyre si dhe atehere kur duhet, sipas kesaj Kontrate, krijojne rrethana te tilla qe shkaktojne nje Ndryshim Thelbesor Negativ ne permbushjen e detyrimeve te Shoqerise sipas kesaj Kontrate dhe nuk e ndreqin kete mospermbushje brenda 3 diteve pas mbarimit te periudhes se ndreqjes te lajmeruar nga Shoqeria, ne perputhje me piken 28.3(a) si me siper.

d) Qeveria Shqiptare vonon pagesen e cdo shume te detyruar dhe te kerkueshme prej Qeverise Shqiptare sipas kesaj Kontrate tej afatit tridhjete (30) ditor pas njoftimit te kesaj fundit nga Shoqeria.

e) Cdo deklarim i bere ose garanci e dhene nga Qeveria Shqiptare sipas kesaj Kontrate zbulohet qe eshte fals ose ne mashtrim.

28.4. Pasojat e Mospermbushjes nga Qeveria e Shqiperise

Pa cenuar asnje te drejte tjeter apo te drejte ndreqjeje qe Shoqeria perfiton sipas kesaj Kontrate, kur ajo te ndodhet para Rastit te Mospermbushjes nga Qeveria e Shqiperise, ka te drejte t'i dergoje asaj nje kerkese me shkrim ku t'i kerkoje ndreqjen e mospermbushjes brenda nje afati te

arsyeshem te caktuar prej saj ne kerkesen me shkrim. Qeveria e Shqiperise duhet qe menjehere (duke marre parasysh edhe natyren e nje mospermbushje te tille) t'i dorezoje Shoqerise nje plan te hartuar me shkrim per ndreqjen e mospermbushjes dhe te vere ne zbatim pa u vonuar kete plan te pranuar nga Shoqeria. Ne rast se Qeveria e Shqiperise per cfaredolloj arsye nuk mund te ndreqe mospermbushjen perkatese brenda afatit te ndreqjes, kjo mospermbushje do te shnderrohet ne nje Shkelje Thelbesore menjehere pas mbarimit te afatit te ndreqjes.

28.5 Shkelja Thelbesore

Pa cenuar asnje te drejte tjeter apo te drejte ndreqjeje qe Palet perfitojne nga kjo Kontrate, edhe pse nese mund te parashikohet ndryshe, secili nga rastet qe vijon perben nje shkelje thelbesore te kesaj Kontrate ("Shkelja Thelbesore"):

a) Shoqeria s'ka permbushur detyrimet e saj lidhur me sigurine teknike dhe sigurimin ne perputhje me Shtojcen 39 (Sistemi i Administrimit te Sigurise ne Aeroport) dhe Shtojcen 44 (Kontrolli i Sigurise dhe i Bagazheve), perjashtuar Rastin e Forces Madhore, dhe nuk e ka ndrequr kete mospermbushje brenda pese (5) diteve pasi ka marre njoftim me shkrim nga Qeveria Shqiptare ku ajo njofton Shoqerine per kete mospermbushje;

b) mospermbushja nga Shoqeria ose nga Qeveria Shqiptare (pershi ketu edhe cdo Ent Shteteror) te secilit prej detyrimeve te tyre parashikuar ne Kontrate, e cila:

i) ka te ngjare te shkaktoje, ne gjykimin e arsyeshem te pales se cenuar (dhe kur ka mosmarreveshje midis paleve, si ato qe i nenshtrohen Pikes 36 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve)), Ndryshim Thelbesor Negativ; dhe

ii) Shoqeria ose Qeveria e Shqiperise (perfshire ketu cdo Ent Shteteror) nuk e ndreq mospermbushjen brenda afatit te ndreqjes (qe eshte caktuar dhe i eshte njoftuar perpara ne kohe pales mospermbushese nga pala e cenuar);

c) Mospermbushja nga Shoqeria e te gjitha detyrimeve te saj qe ne kete Kontrate klasifikohet si mospermbushje e plote, sic eshte pershkruar dhe me tej ne Shtojcen 36 (Kriteret e Permbushjes);

d) ne rastin e Punimeve te Ndertimit, projektimi, ndertimi, perfundimi dhe venia ne pune e Aeroportit, (perfshire ketu dhe cdo Ndryshim te Mundshem) punimet, materialet, pajisjet, sistemet dhe procedurat e perfshira ne lidhje me to nuk perputhen me kerkesat e pershkruara ne kete Kontrate; ose

e) ne rastin e Operacioneve Ushtarake te çdo lloji nga forcat ajrore shqiptare te cilat kalojne njezet e pese perqind (25%) te Kapacitetit te Deklaruar te Pistes (nje shkelje e tille perben Shkelje Thelbesore nga Qeveria Shqiptare).

f) Mosdhenia nga Qeveria Shqiptare per nje afat me te gjate se 72 ore rresht, i Sherbimeve Jetesore te Dhena nga Qeveria (pervec kur kjo vjen si pasoje e Rastit te Mospermbushjes nga Shoqeria apo Rastit te Forces Madhore).

g) mosnjoftimi i Qeverise Shqiptare nga Shoqeria per cdo mospagese te shumave te detyrueshme sipas Dokumenteve te Financimit si dhe per cdo heqje dore nga detyrimet qe lidhen me pagesat sipas Dokumenteve te Financimit te dhena nga çdo Huadhenes Kryesor.

28.6 Kunderbalancimi dhe e Drejta per Kunderbalancim te Vecante

a) Me kete kontrate kuptohet dhe pranohet ne menyre te shprehur se Shoqeria gezon nje te Drejte Kunderbalancimi te Veçante.

b) Pa cenuar asnje te drejte tjeter qe Shoqeria gezon sipas kesaj Kontrate (perfshi ketu pa kufizim edhe te Drejten e Kunderbalancimit te Vecante), Shoqeria ka te drejte te kunderbalancoje nga cdo shume qe i detyrohet Qeverise Shqiptare ose cdo Enti Shteteror (perfshi ketu pa kufizim edhe taksat) perkundrejt shumave te detyruara dhe te kerkueshme qe Qeveria e Shqiperise ose Enti Shteteror i ka Shoqerise sipas kesaj Kontrate. Te drejtat e Shoqerise sipas kesaj Pike 28.6(b), i nenshtrohen kerkesave te percaktuara ne ligjin e zbatueshem dhe kesaj Kontrate dhe behen te ushtrueshme vetem ne rast se asnjera pale ne kete Kontrate nuk kundershton ekzistencen ose vleren e ketyre detyrimeve.

c) Pa cenuar asnje te drejte tjeter qe Qeveria Shqiptare gezon sipas kesaj Kontrate, ajo ka te drejte te kunderbalancoje nga cdo shume qe i detyrohet Shoqerise, perkundrejt shumave te detyruara dhe te kerkueshme qe Shoqeria i ka Qeverise Shqiptare ose ndonje Enti Shteteror sipas kesaj Kontrate. Te drejtat e Qeverise Shqiptare sipas kesaj Pike 28.6(c)(b) i nenshtrohen kerkesave te percaktuara ne ligjin e zbatueshem dhe kesaj Kontrate dhe behen te ushtrueshme vetem ne rast se

asnjera pale ne kete Kontrate nuk kundershton ekzistencen ose vleren e ketyre detyrimeve.

29. DOREZIMI

a) Palet bien dakort qe ne Daten e Dorezimit, çdo e drejte perdorimi apo Uzufrukti qe i ka takuar Shoqerise ne lidhje me Zonen e Koncesionit, Ndertimet Ekzistuese dhe Aktivet Ekzistuese, perfshi ketu pa kufizim edhe Aktivet ne Dorezim, do te mbaroje dhe Shoqeria:

i) Do t'i kaloje Qeverise Shqiptare cdo titull pronesie qe ka mbi Ndertimet e Reja;

ii) Do t'i kaloje Qeverise Shqiptare te gjitha te drejtat, detyrat dhe detyrimet e Shoqerise ne lidhje me Aktivet ne Dorezim, Zonen e Koncesionit dhe vete Koncesionin, pervec Dokumenteve te Financimit dhe te drejtave qe gezon ne lidhje me to; dhe

iii) Do t'i dorezoje Qeverise Shqiptare te gjithe dokumentet qe posedon ne lidhje me sendet e permendura ne pikat (i) dhe (ii) me siper dhe nuk do te mbaje asnje kopje te tyre;

ne kembim te pageses nga Qeveria e Shqiperise, por vetem ne rastin e mbarimit te kesaj Kontrate (dhe jo zgjidhjes se saj), te shumes se barabarte me vleren neto kontabel te Shoqerise (ne Daten e Dorezimit, sipas Parimeve te Pergjithshme te Pranuara te Kontabilitetit ne Shqiperi) (me perjashtim te Fazes A Terminali i Ri dhe Fazes A Ndertimet e Reja te Kargos), te vendosur nga nje ekspert vleresues i pavarur (duke marre parasysh gjendjen e aktiveve perkatese). Te gjitha taksat dhe shpenzimet e procesit te kalimit dhe dorezimit te aktiveve te permendura ne nen-paragrafet (i) dhe (ii) me siper do te perballohen nga Shoqeria. Shoqeria do te bashkepunoje dhe ndihmoje Qeverine e Shqiperise apo cdo Ent Shteteror, sipas kerkeses se arsyeshme te Organit Shteteror te Autorizuar, per qellimet e nen-paragrafeve (i) dhe (ii) me siper.

b) Shoqeria garanton se e gjithe prona, aktivet, te drejtat dhe sendet e tjera te permendura ne kete Pike 29 te fituara nga ose te kaluara tek Qeveria e Shqiperise, jane ne gjendje te mire pune dhe te mirembajtura sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 17 (Kode, Standarde, Rregulla dhe Publikime te tjera) dhe se Aeroporti do t'i dorezohet Qeverise se Shqiperise si nje ndermmarrje funksionale dhe ne gjendje te mire pune.

c) Qeveria e Shqiperise nuk eshte pergjegjese per asnje detyrim, hua, kapital ose obligacion tjeter te Shoqerise ne lidhje me funksionimin dhe administrimin e Aeroportit apo per shkak te fitimit apo kalimit te aktiveve, pronave, te drejtave dhe detyrimeve te ndryshme te referuara ne kete Pike 29 nga dhe tek Qeveria e Shqiperise, ose ne nje forme tjeter.

d) Ne varesi te Pikes 26.5 (Vazhdimi i Detyrimeve pas Zgjidhjes) dhe Pikes 26.7 (Pasojat e Zgjidhjes), me perfundimin e ceshtjeve te permendura ne nen-paragrafin (a) te kesaj Pike, detyrimet e Shoqerise sipas kesaj Kontrate do te pushojne.

e) Nderkohe qe te gjitha aktivet e Shoqerise do t'i kalohen Qeverise Shqiptare ne Daten e Dorezimit, Shoqeria vete nuk do t'i kalohet Qeverise Shqiptare.

30. INSPEKTIMET DHE LEJET

a) Nga Data e Fillimit, Organi Shteteror i Autorizuar, Njesia e Zbatimit te Projektit, DPAC ose ndonje Ent tjeter Shteteror (perfshi ketu edhe punonjesit dhe agjentet perkates) mund te inspektojne Zonen e Koncesionit, duke njoftuar pese (5) dite perpara me shkrim, dhe duke siguruar qe ky inspektim te shkaktoje minimumin e shqetesimit per ndertimin, menaxhimin, perdorimin, mirembajtjen, nxjerrjen nga puna dhe rinovimin e Terminalit Ekzistues, Sheshin i Terminalit Ekzistues dhe Aktiveve te Lidhura, Mjediseve te Reja dhe Rruges se Re Hyrese.

b) Pa cenuar asnje te drejte tjeter qe gezojne sipas kesaj Kontrate, Qeveria e Shqiperise dhe ndonje Ent tjeter Shteteror, perfshi ketu pa kufizim DPAC dhe ANTA-n, gezojne hyrje te lire ne Kullen Ekzistuese te kontrollit, Kompleksin e ANTA-s dhe Zonen Ushtarake (nga ana e aerodromit), ne çdo kohe, duke filluar qe nga data e kesaj Kontrate deri ne fund te Afatit te Koncesionit.

31 DETYRAT JO NE MIREBESIM

Asgje ne kete Kontrate, nuk perben ortakeri, asnje lloj marredhenie agjencie, ose nuk krijon marredhenie varesie apo kujdestarie mes Qeverise Shqiperise (perfshi edhe cdo Ent Shteteror) dhe Shoqerise.

32. E DREJTA E NDERHYRJES SE HUADHENESIT DHE ZEVENDESIMI

32.1 E Drejta e Nderhyrjes se Huadhenesit

a) Edhe pse mund te parashikohet ndryshe ne kete Kontrate apo ne kontraten qe rregullon te drejten e nderhyrjes se Huadhenesit, Qeveria Shqiptare, kur te ndodhet para Rastit te Zgjidhjes nga Qeveria Shqiptare per shkak te Shoqerise, ka te drejte ta zgjidhe kete Kontrate ne perputhje me Piken

26.3 (Zgjidhja nga Qeveria Shqiptare ne Rastin e Vecante te Mospermbushjes nga Shoqeria). Ne rast se Qeveria Shqiptare zgjedh te ushtroje kete te drejte per zgjidhjen e kontrates, ajo i dergon Huadhenesit nje njoftim per vendimin e saj dhe duhet t'i paguaje Huadhenesit Kryesor, jo me vone se gjashtedhjete (60) dite pas perfundimit te kesaj Kontrate, kompensimin e llogaritur ne perputhje me Piken 26.2(b). (Zgjidhja per shkak te Forces Madhore te Zgjatur).

b) Qeveria Shqiptare me kete Kontrate pranon krijimin e Barres Siguruese mbi te drejtat e Shoqerise dhe pranon qe kur te ndodhe nje shkelje e kesaj Kontrate nga Shoqeria apo nje Rast Mospermbushje po prej saj, Huadhenesi do te kete te drejte qe:

i) brenda afatit kohor te specifikuar ne kontraten qe rregullon te drejten e nderhyrjes se Huadhenesit, te ndreqe shkeljen ose Rastin e Mospermbushjes nga Shoqeria, nderkohe qe brenda ketij afati ndreqjeje e drejta e Qeverise Shqiptare per te zgjidhur Kontraten eshte e pezulluar; dhe

ii) te prezumohet ose te behet i ceduari te cilit i kalohen te gjitha te drejtat dhe detyrimet e Shoqerise sipas kesaj Kontrate, dhe ne vecanti ato ne lidhje me:

1. manaxhimin dhe vazhdimin e çdo biznesi te Shoqerise ne lidhje me Koncesionin

2. ushtrimin e cdonjeres dhe te gjitha te drejtave te Shoqerise per aq kohe sa te gjitha detyrimet e Shoqerise sipas kesaj Kontrate te mos jene permbushur;

3. ushtrimin e cdo te drejte dhe menaxhimin e cdo aktivi te Shoqerise si dhe ushtrimin dhe kryerjen (ose lejimin e Shoqerise qe te ushtroje dhe kryeje) e gjithe te drejtave dhe veprimeve njesoj sikur Huadhenesi te jete pronari dhe perfituesi direkt i ketyre te drejtave dhe aktiveve, perfshi ketu pa kufizim, pergatitjen dhe shperndarjen e te gjitha sherbimeve qe Huadhenesi do t'i gjykoje te nevojshme per manaxhimin efektiv, perdorimin e aktiveve ose ushtrimin e ketyre te drejtave;

4. punesimin e nje operatori aeroporti i cili permbush te gjitha kerkesat e pershkruara ne Shtojcen 12 (Investitori Strategjik); dhe

5. kryerjen e te gjitha veprimeve dhe akteve te tjera qe Huadhenesi do i gjykoje te nevojshme, te pershtatshme apo dytesore ne ushtrimin e cilesdo prej te drejtave te dhena sipas ose per shkak te kontrates qe rregullon te drejten e nderhyrjes se Huadhenesit dhe pranimin per te bere gjithcka qe i takon te beje.

por duke patur parasysh qe:

(A) Huadhenesi nuk mund (dhe nuk ka te drejte te beje marreveshje) te shese, transferoje, kaloje, apo ne cdo rast tjeter, te urdheroje, krijoje apo lejoje te vazhdoje ndonje Barre Siguruese apo e drejte manaxhimi, operimi apo kontrolli mbi Aeroportin;

(B) kontrata qe rregullon te drejten e nderhyrjes te Huadhenesit do te perfundoje dhe nuk do te kete me fuqi (dhe nese Huadhenesi eshte duke ushtruar te drejten e tij te manaxhimit do te pushoje menjehere se e beri kete) me mbarimin e kesaj Kontrate; dhe

(C) menjehere pas marrjes ne dore te ushtrimit te te drejtave nga Huadhenesi sipas kontrates qe rregullon te drejten e nderhyrjes se tij, ky i fundit do te publikoje nje njoftim ne nje gazete te perditshme biznesi dhe nje gazete te perditshme te Tiranes, ku ne emer Shoqerise do te njoftoje se manaxhimi do te behet nga ose per llogari te Huadhenesit, dhe menjehere pasi Huadhenesi te kete perfunduar menaxhimin, Shoqeria do te publikoje nje njoftim ne keto gazeta per rimarrjen ne dore te manaxhimit.

c) Qeveria Shqiptare pranon qe Huadhenesi mund te ushtroje te drejtat e tij sipas kontrates qe rregullon te drejtat e nderhyrjes te Huadhenesit:

i) brenda gjashtedhjete (60) diteve pasi Qeveria Shqiptare te kete njoftuar Huadhenesin per shkeljen e Kontrates nga Shoqeria ose per Rastin e Mospermbushjes te Shoqerise;

ii) brenda gjashtedhjete (60) diteve pas pershpejtimit te cdo Huaje te Projektuar qe ndjek deklaraten e Huadhenesit per nje rast mospermbushje.

d) Zbatimi dhe ushtrimi i te drejtave sipas kontrates qe rregullon te drejten e nderhyrjes se Huadhenesit nuk e shkarkon Shoqerine nga detyra per te ushtruar te drejtat e saj si dhe nga kryerja dhe permbushja e detyrimeve te saj sipas kesaj Kontrate .

e) Ne ushtrimin e te drejtave sipas kontrates qe rregullon te drejtat e nderhyrjes te Huadhenesit, ky i fundit vepron si agjent i Shoqerise per te gjitha qellimet dhe Shoqeria eshte pergjegjese per te gjitha kontratat, angazhimet, veprimet, mosveprimet, difektet, humbjet dhe pergjegjesite e Huadhenesit.

f) Ne çdo kohe brenda pas se ciles Huadhenesi ka filluar zbatimin e kontrates qe rregullon te

drejten e nderhyrjes se Huadhenesit dhe gjate se ciles ai po ushtron te drejtat e tij sipas saj, dispozitat e meposhtme do te jene te zbatueshme dhe te detyrueshme:

i) s'mund te merret vendim apo nxirret urdher per likuidimin, mbarimin ose shkrirjen e Shoqerise;

ii) pervec rastit te emerimit sipas kontrates qe rregullon te drejtat e nderhyrjes se Huadhenesit, asnje person tjeter, administrator, drejtor apo nepunes tjeter i ngjashem, nuk mund te emerohet ne lidhje me Shoqerine apo aktivet e saj sikurse nuk mundet nje Person i emeruar me pare ne keto funksione te qendroje ne detyre apo te perdore ndonje pushtet ne lidhje me Shoqerine apo aktivet e te ardhurat e saj;

iii) asnje hap nuk mund te ndermerret pa miratimin e meparshem te Shoqerise per te vendosur Barre Siguruese (pervec Barres Siguruese te krijuar ne favor te Huadhenesit) mbi aktive apo te ardhura qe jane objekt i kontrates qe rregullon te drejten e nderhyrjes se Huadhenesit; dhe

iv) pervec zbatimit te ndonje Barre Siguruese te krijuar ne favor te Huadhenesit, asnje procdim, ekzekutim oapo proces tjeter ligjor nuk mund te filloje apo vazhdoje dhe asnje ankim nuk mund te ngrihet kunder Shoqerise ne lidhje me cfaredo aktivi ose te ardhure objekt i kontrates qe rregullon te drejten e nderhyrjes se Huadhenesit.

32.2 Zevendesimi nga Qeveria e Shqiperise

a) Atehere kur do te shihet e nevojshme, Qeveria Shqiptare, per qellim te kesaj Pike 32.2 (Zevendesimi nga Qeveria Shqiptare) mund te caktoje nje shoqeri ne pronesi te plote te Qeverise Shqiptare per te zevendesuar shoqerine, qe do te sillet si Shoqeria ne kete Kontrate ("Subjekti Zevendesues").

b) Nese Qeverise se Shqiperise i lind e drejta e zgjidhjes se kesaj Kontrate dhe Huadhenesi nuk ve ne zbatim kontraten qe rregullon te drejten e nderhyrjes se Huadhenesit ne perputhje dhe brenda afatit te caktuar ne Piken 26.3 (Zgjidhja nga Qeveria e Shqiperise ne Rastin e Vecante te Mospermbushjes nga Shoqeria), Qeveria e Shqiperise ka te drejte qe pas lajmerimit me shkrim te Shoqerise dhe Huadhenesit, te zevendesoje Shoqerine me Subjektin Zevendesues.

c) Qe nga data e zevendesimit, Subjekti Zevendesues perfiton te gjitha te drejtat dhe merr persiper te gjitha detyrimet e Shoqerise sipas kesaj Kontrate njesoj sikur te ishte vete Shoqeria dhe te gjitha referimet qe behen ne kete Kontrate per "Shoqerine" do te prezumohen sikur jane per Subjektin Zevendesues.

d) Ne kete zevendesim, dhe per aq kohe sa Subjekti Zevendesues te jete Shoqeria, interesi i Shoqerise ne:

i) ushtrimin e te drejtes se Uzufruktit i kalon Subjektit Zevendesues pa pagese dhe i lire nga cdo Barre Siguruese ose detyrim tjeter (pervec Barres Siguruese te lejuar ne kete Kontrate);

ii) te gjitha aktivet e levizshme, licencat, inventaret, materialet, automjetet dhe pjeset e kembimit qe Subjektit Zevendesues i nevojiten ne lidhje me Koncesionin do t'i kalojne Subjektit Zevendesues pa pagese, por do te mbeten te varura ndaj cdo Barre Siguruese ose detyrimi tjeter te lidhur me to;

iii) te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga kontratat dhe marreveshjet e tjera te lidhura ne perputhje me kete Kontrate midis Shoqerise dhe mbajtesve te te Drejtave te Aeroportit do t'i kalojne Subjektit Zevendesues (duke prezumuar marrjen persiper te detyrimeve qe rrjedhin nga kontratat ose aktet e tjera prej Subjektit Zevendesues), pa pagese dhe te lira nga cdo Barre Siguruese (pervec Barres Siguruese te lejuar nga kjo Kontrate); dhe

iv) te drejtat dhe detyrimet qe burojne nga kontratat e tjera, marreveshjet, aktivet, pronat dhe te drejtat te cilat Subjekti Zevendesues nevojit ne lidhje me Koncesionin do t'i kalojne atij (duke prezumuar marrjen persiper te detyrimeve qe burojne nga kontratat ose marreveshjet e tjera, aktivet, pronat dhe te drejta te tjera), pa pagese dhe te lira nga cdo Barre Siguruese (pervec Barres Siguruese te lejuar sipas kesaj Kontrate).

e) Pervecse kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, Subjekti Zevendesues nuk eshte pergjegjes per asnje pergjegjesi, hua apo detyrim tjeter te Shoqerise ne lidhje me Koncesionin ose si rrjedhoje dhe pasoje e kalimit apo transferimit te aktiveve te ndryshme, te drejtave dhe detyrimeve te referuara ne kete Pike 32.2 (Zevendesimi nga Qeveria e Shqiperise) tek Subjekti Zevendesues.

f) Qe nga data e zevendesimit, kushtet qe vijojne do jene te zbatueshme per Subjektin Zevendesues si dhe te detyrueshme per te gjithe Personat:

i) asnje vendim dhe urdher s'mund te merret apo nxirret per likuidimin, mbarimin ose shkrirjen e Subjektit Zevendesues;

ii) asnje Person tjeter, administrator, drejtor ose nepunes i ngjashem nuk mund te emerohet ne lidhje me Subjektin Zevendesues apo aktivet e tij dhe as nuk mundet nje Person i tille i emeruar me pare ne kete funksion te qendroje ne detyre apo te perdore ndonje pushtet ne lidhje me Subjektin Zevendesues, dhe/ose me secilin nga aktivet ose te ardhurat e tij;

iii) asnje hap nuk mund te ndermerret pa miratimin e meparshem te Subjektit Zevendesues per te vendosur Barre Siguruese (pervec Barres Siguruese te krijuar ne favor te Huadhenesit) mbi aktivet ose te ardhurat e Subjektit Zevendesues; dhe

iv) pervec vendosjes se ndonje Barre Siguruese te krijuar ne favor te Huadhenesit, asnje procedim, ekzekutim apo proces tjeter ligjor nuk mund te filloje apo vazhdoje dhe asnje ankim nuk mund te ngrihet kunder Subjektit Zevendesues ne lidhje me aktivet ose te ardhure te tij.

g) Qe nga data e zevendesimit, Subjekti Zevendesues do te ruaje per aq kohe si i tille, personalitetin juridik dhe do te sigurohet qe detyrimet e Shoqerise sipas kesaj Kontrate te permbushen plotesisht dhe ne afat.

h) Secila nga palet ne kete kontrate pranon te nenshkruaje apo siguroje nenshkrimin e atyre dokumenteve si dhe kryerjen e atyre veprimeve te nevojshme apo te kerkuara ne menyre te arsyeshme, per te vene ne jete kushtet e kesaj Pike 32.2 (Zevendesimi nga Qeveria e Shqiperise).

i) Dispozitat e kesaj Pike 32.2 (Zevendesimi nga Qeveria e Shqiperise) do te mbizoterojne mbi dispozitat e cdo Ligji te tjeter te Zbatueshem qe do te jete ne fuqi ne daten e kesaj Kontrate.

33. TE DREJTAT E PRONESISE INTELEKTUALE

a) Nese ndonje nga te Drejtat e Prones Intelektuale zhvillohet ne menyre specifike nga Shoqeria dhe/ose punonjesit e saj per qellimet e Projektit gjate ushtrimit te te drejtave dhe permbushjes se detyrimeve sipas kesaj Kontrate, keto te Drejta te Pronesise Intelektuale do t'i takojne Shoqerise gjate afatit te Koncesionit. Ne fund te Afatit te Koncesionit, te Drejtat e Prones Intelektuale do t'i transferohen Qeverise se Shqiperise.

b) Shoqeria demshperblen dhe nuk ngarkon me pergjegjesi Qeverine Shqiptare apo cdo tjeter Ent Shteteror per humbjet, kostot, shpenzimet, detyrimet financiare ose cdo demtim tjeter te pesuar ose qe i ka ndodhur, si dhe per te gjitha pretendimet per demshperblim, padite, kerkesat, dhe procedimet e bera dhe te ngritura ne emer te ndonje shkelleje te te Drejtave te Pronesise Intelektuale ne lidhje me dokumente, impiante, bime, makineri, pajisje te Projektit ose te perdorura per te.

34. KONFIDENCIALITETI

34.1 Shtrirja e Konfidencialitetit

Secila nga Palet do te trajtoje si konfideciale te gjithe dokumentet dhe informacionet e tjera ne lidhje me Projektin qofshin keto ne forme te shkruar apo gojore, qofshin teknike apo tregtare, qe u jane dhene atyre nga cdo pale ose ne emer te cilesdo pale tjeter ne kete Kontrate, dhe nuk duhet as t'ja beje te ditur nje pale te trete te gjithe apo pjese te dokumentit dhe informacionit, as t'ja komunikoje pa pranimin e shkruar te pales tjeter apo ne perputhje me Ligjet e tjera te Zbatueshme, rregulloret e cdo burse nderkombetare apo praktika te njohura proceduriale, (perjashtuar ketu rastin e informacionit qe i jepet Huadhenesit) pervecse per qellimet e permbushjes te kushteve te kesaj Kontrate .

34.2 Dhenia e Lejuar e Informacionit

Pavaresisht nga Pika 34.1 (Shtrirja e Konfidencialitetit), Shoqeria, Ortaket dhe shoqerite e tyre meme, kane te drejte te lejojne dhenien e informacionit:

a) neqoftese shihet e nevojshme sipas Ligjit te Zbatueshem,

b) Huadhenesit (duke perfshire cilindo nga punonjesit, keshilltaret dhe kontraktoret e tij, autoritetet rregullatore, autoritetet e taksave dhe kompanite meme sipas rastit), ose

c) cilitdo prej punonjesve, keshilltareve ose kontraktoreve te saj,

d) filaleve te tyre respektive (pasi te jete marre me pare aprovimi i shkruar i Organit te Autorizuar Shteteror)

te gjitha dokumentet dhe informacionet e tjera qe shihen te nevojshme ose per qellimin e permbushjes te detyrimeve te kesaj Kontrate, por ne cdo rast ata nuk do te japin shkas apo lejojne keta Persona te ekspozojne cdo dokument apo informacion te vene ne dispozicion te tyre pervec se atyre qe do te shihen te nevojshme per permbushjen e detyrimit.

35. KALIMI

35.1 Kalimi nga Qeveria e Shqiperise

Qeveria e Shqiperise nuk do te kaloje apo te transferoje kete Kontrate si dhe cdo te drejte e detyrim qe lind apo rrjedh prej saj apo cdo perfitim dhe interes te ketushem pa aprovimin e meparshem dhe te shkruar te Shoqerise.

35.2 Kalimi nga Shoqeria

a) Vetem neqoftese Palet merren vesh me shkrim (me kusht qe kjo marreveshje mos vonohet apo bllokohet pa aresye), Shoqeria nuk mund te jape ose ne cdo rast tjeter te transferoje kete Kontrate, te drejtat e detyrimet qe lindin apo rrjedhin prej saj ose cdo perfitim tjeter e interes te ketushem ose nuk mund te vendose apo lejoje te vazhdoje ndonje Barre Siguruese mbi kete Kontrate ose ndonje te drejte e detyrim qe rrjedh prej kesaj barre apo ndonje perfitim ose interes te parashikuar ne te.

b) Qeveria e Shqiperise dhe Shoqeria pranojne te lidhin cdo kontrate apo instrument tjeter me Huadhenesin per kalimin, transferimin ose krijimin e Barres Siguruese mbi te gjitha ose secilin nga perfitimet e kesaj Kontrate (dhe per te shmangur dyshimet, vete Koncesionin) per qellimet e financimit te Shoqerise dhe/ose Projektit, ne masen qe kjo do te kerkohet nga Huadhenesi.

36. ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

36.1 Zgjidhja

a) Cdo kundershti, mosmarreveshje apo ankese qe lind ose ka lidhje me kete Kontrate, duke perfshire, por jo vetem, ceshtjet qe kane te bejne me perfundimin e saj, shkeljet, zgjidhjen, pavlefshmerine ose efektet para dhe pas kontraktore, qofshin keto te bazuara ne kete Kontrate apo instrumenta te tjere ligjore ("Mosmarreveshja"), do te kalohet nga Palet e perfshira ne Mosmarreveshje fillimisht tek perfaqesuesit e Organit Shteteror te Autorizuar dhe perfaqesuesit e Shoqerise, te cilet do te takohen dhe do te perpiqen ta zgjidhin mosmarreveshjen me mirekuptim midis tyre. Vendimi i perbashket dhe unanim i perfaqesuesit te Organit Shteteror te Autorizuar dhe te perfaqesuesit te Shoqerise do te jete nje vendim perfundimtar dhe i detyrueshem per palet e Mosmarreveshjes.

b) Pala qe deshiron te filloje kete procedure do t'i dergoje nje njoftim me shkrim pales tjeter. Nese perfaqesuesi i Organit Shteteror te Autorizuar dhe perfaqesuesi i Shoqerise nuk takohen, ose, Mosmarreveshja nuk zgjidhet brenda nje (1) muaji nga marrja e ketij njoftimi, çdo pale e Mosmarreveshjes mund te kerkoje qe Mosmarreveshja te zgjidhet me arbitrazh ne perputhje me Piken 36.2 (Arbitrazhi)

36.2 Arbitrazhi

a) Ne perputhje me Piken 36.1(Zgjdhja), cdo Mosmarreveshje, ne shkalle te fundit do te zgjidhet me arbitrazh ne perputhje me Rregullat e Arbitrimit te ICC te zbatueshme ne kohen e nenshkrimit te kesaj Kontrate .

b) Numri i arbitrave do te jete: (i) nje, neqoftese Mosmarreveshja ka te beje me nje pretendim jopasuror ose pretendim per nje shume qe nuk e kalon vleren 500.000 EURO (ose shumen ekuivalente ne Lek), ose (ii) tre, nqs pretendimi eshte per nje shume qe e kalon vleren 500.000 EURO (ose shumen ekuivalente ne Lek). Caktimi i arbitrave do te behet ne perputhje me Rregullat e Arbitrimit te ICC ne kohen e nenshkrimit te kesaj Kontrate. Vendi i zhvillimit te arbitrazhit do te jete ne Vjene, Austri. Gjuha e arbitrazhit do te jete Anglisht. Nese nje vendim apo urdher i gjykates se arbitrazhit nuk mund te arrihet nga mazhoranca, ai do te merret vetem nga Kryetari i trupes se arbitrazhit. Shpenzimet e arbitrazhit do te percaktohen nga trupi i arbitrazhit.

c) Duke pranuar arbitrazhin ne perputhje me kete Pike, palet heqin dore ne menyre te parevokueshme nga te drejtat per apel, rishikim, apo rekurs ne cdo gjykate shteterore apo autoritet tjeter gjyqesor, per aq kohe sa kjo heqje dore behet ne menyre te vlefshme. Gjithsesi, per sa i perket rrethanave per kundershtimin e nje vendimi arbitrazhi ne perputhje me seksionin 595 te Kodit Austriak te Procedures Civile, Palet heqin dore vetem nga e drejta per te kundershtuar vendimin ne perputhje me seksionin 595 (1) numer 7 te Kodit Austriak te Procedures Civile ne lidhje me faktet ose provat e reja. Palet nuk heqin dore nga rrethanat e tjera per te kundershtuar. Palet bien dakort qe cdo vendim mund te ekzekutohet ndaj tyre ose aktiveve te tyre kudo gjenden.

36.3 Masat Paraprake

Asgje ne kete Kontrate nuk e pengon nje Pale qe te kerkoje para cdo autoriteti gjyqesor kompetent te marre vendime paraprake ose masa te perkohshme per ceshtje qe lidhen me kete Kontrate.

36.4 Detyrimet qe Vazhdojne

As fillimi dhe as vazhdimi i negociatave ne cfaredolloj forme apo menyre te parashikuar sipas kesaj Kontrate nuk do te shkarkoje apo ne te kundert cenoje apo preke ndonje detyrim te Paleve sipas kesaj Kontrate, perfshi ketu edhe permbushjen e tyre sipas rastit.

37. TE NDRYSHME

37.1 Marreveshja si e Tere

Kjo Kontrate dhe dokumentet e permendura ne te perbejne marreveshjen e plote midis Paleve ne lidhje me transaksionet e perfshira ne Kontrate dhe secila nga Palet merr persiper qe duke lidhur kete Kontrate nuk mbeshtetet ne asnje perfaqesim ose garanci pervec atyre te parashikuara ne kete Kontrate.

37.2 Njoftimet

Cdo njoftim sipas kesaj Kontrate do te behet me shkrim dhe mund t'u dorezohet, adresohet apo dergohet paleve si me poshte (ose ne ato adresa e numra faksi te ndryshuara qe palet do vendosin me njoftim pas dates se kesaj Kontrate):

Ministria e Ekonomise
Bulevardi Zhan D'Ark Nr.3 Tirane
Republika e Shqiperise
Ne vemendje te: Ministrit
Fax: 003554222655

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
Rruga Abdi Toptani Nr.2
Tirane
Republika e Shqiperise

Ne vemendje te: Ministrit Fax: 003554 232389
Tirana Airport Partners (TAP) SHPK
Rruga e kavajes,Nr. 59, Tirana Tower, Kati i Peste
Tirane,Shqiperi
Ne vemendje te: Drejtorit Ekzekutiv
Fax 00355 422 4727

Cdo njoftim i Shoqerise ne zbatim te kesaj Kontrate do te behet nga Personi bere i njohur kohe pas kohe tek Qeveria Shqiptare nga Shoqeria per kete qellim.

b) Te gjitha njoftimet ose komunikimet e tjera sipas kesaj Kontrate tek cdo Pale e saj do te quhen si te dhena ose te bera ne daten e dergimit (ne rastin e dergimit personal ose postar) ose ne daten e marrjes ne rastin e fakseve. Cdo lajmerim ose komunikim tjeter sipas kesaj Kontrate i bere nga Shoqeria per Qeverine e Shqiperise duhet te tregoje ne menyre te qarte se i referohet Koncesionit dhe kesaj Kontrate.

c) Njoftime apo komunikime te tjera te mberritura ne nje dite pushimi ose pas orarit te punes ne vendin e marrjes do te prezumohen si te mberritura ne diten e mepasshme te punes po ne kete vend.

37.3 Heqjet Dore

a) Asnje mosushtrim apo ushtrim i vonuar nga ana e Shoqerise apo Qeverise Shqiptare i te drejtave, pushteteve apo privilegjeve te kesaj Kontrate dhe asnje perdorim i vetem apo i pjeshem i tyre, ose ushtrimi i ndonje te drejte, pushteti apo privilegji tjeter nuk do te konsiderohet si heqje dore prej tyre.

b) Asnje heqje dore nga Shoqeria apo Qeveria Shqiptare nga cilado prej te drejtave dhe detyrimeve te tyre sipas kesaj Kontrate nuk do te jete e vlefshme neqoftese nuk behet me shkrim.

37.4 Vecueshmeria

Nese ndonje dispozite e kesaj Kontrate anullohet, behet e paligjshme ose e pazbatueshme brenda nje juridiksioni te caktuar, ky anullim, paligjshmeri, ose pazbatueshmeri nuk do te preke vlefshmerine e dispozitave te tjera te kesaj Kontrate ose te ndikoje ne vlefshmerine, ligjshmerine apo zbatueshmerine e dispozitave ne cdo jurisdiksion tjeter.

37.5 Ekzemplaret

Kjo Kontrate ne pesembedhjete kopje dhe te gjitha kopjet te marra se bashku do te quhen sikur perbejne nje instrument te vetem.

37.6 Gjuha

Kjo Kontrate do te firmoset ne gjuhen Shqipe me perkthimin e sigluar ne Anglisht te bashkengjitur si nje pjese integrale e saj. Ne rast mosperputhjeje midis perkthimit te Kontrates ne gjuhen Angleze te sigluar dhe tekstit Shqip te kesaj Kontrate, perkthimi Anglisht i kesaj Kontrate do te mbizoteroje. Cdo dokument i permendur ne kete Kontrate ose qe duhet te dorezohet sipas kesaj Kontrate do te jete ne gjuhen Anglisht dhe/ose ne gjuhen Shqip, sipas nevojes.

37.7 Ndryshimet

Asnje modifikim, amendament apo ndryshim i kesaj Kontrate nuk do te jete i detyrueshem mbi cilendo pale te Kontrates neqoftese nuk eshte rene dakord me shkrim nga te gjitha Palet. Organi i Autorizuar Shteteror gezon te drejten per te rene dakord dhe nenshkruar cdo modifikim, amendament ose ndryshim tjeter te kesaj Kontrate ne emer te Qeverise se Shqiperise. Qeveria Shqiptare pranon me kerkese te Shoqerise te negocioje ne mirebesim cdo modifikim, amendament ose ndryshim tjeter te kesaj Kontrate e cila do te kerkohet ose gjykohet me vend nga Shoqeria per te bere te zbatueshme te drejtat e Shoqerise sipas kesaj Kontrate dhe Ligjeve te tjera te Zbatueshme.

37.8 Veprimet dhe Dokumentet Shtese

Cdo pale bie dakord te nenshkruaje dhe t'u dorezoje paleve te tjera dokumente te tilla shtese si dhe te ndermarre ato veprime shtese qe ne menyre te arsyeshme mund te gjykohen te nevojshme per venien ne jete dhe dhenien e fuqise se plote ligjore kesaj Kontrate.

37.9 E drejta e Kufizuar e Ankimit

Cdo pretendim ndaj Shoqerise qe mund te ngrihet sipas kesaj Kontrate ose ne lidhje me Projektin, do te drejtohet vetem kundrejt aktiveve te Shoqerise, dhe asnje vendim, urdher ose ekzekutim i marre apo nxjerre ne zbatim te nje padie penale apo civile apo procesi nuk do te merret apo zbatohet ndaj cdo Ortaku te Shoqerise apo aktiveve te themeluesve, bashkepronareve, ortakeve, nepunesve ose drejtoreve te tyre (ose, ne rastin e Personave qe jane partneritet, te cdo partneri te tyre) ose ndaj shoqerive meme, te drejtperdrejta ose jo, si dhe ndaj cdo themeluesi, bashkepronari, nepunesi ose drejtori te tyre per qellimin e marrjes se konfirmimit te pageses dhe te vete pageses per cfaredo shume qe perben detyrim sipas kesaj Kontrate.

37.10 Kostot

Perveç sa mund te parashikohet ndryshe ne kete kontrate, secila nga palet do te paguaje kostot dhe shpenzimet e veta ne lidhje me negocimin, pergatitjen dhe perfundimin e kesaj Kontrate .

37.11 Heqja dore nga Imuniteti Shteteror

Qeveria e Shqiperise

a) Bie dakort qe nenshkrimi, shperndarja dhe zbatimi nga ana e saj i kesaj Kontrate perbejne akte private dhe tregtare me shume se sa publike dhe qeveritare;

b) Pranon te zhvishet nga cdo e drejte imuniteti, te cilen ajo dhe aktivet e saj gezojne tani ose mund te gezojne pas dates se kesaj Kontrate ne cdo proces ligjor te drejtuar kunder saj apo aktiveve te saj ne zbatim te Kontrates nga Shoqeria.

c) Pranon qe s'do te pretendoje asnje imunitet (perfshi ketu pa kufizim paditjen, sekuestrimin para gjykimit, sekuestrime te tjera, dhenien e vendimit, ekzekutimin e tij ose ekzekutime te tjera) ne emer te saj ose ne lidhje me aktivet e saj; dhe

d) Jep, ne pergjithesi, pelqimin ne lidhje me procedimet e mesiperme per te lehtesuar apo zbatuar procedurat ne lidhje me to, perfshi ketu pa kufizim, hartimin, zbatimin ose ekzekutimin ndaj cfaredolloj prone (pavaresisht nga perdorimi i saj ose qellimi i perdorimit) te cdo udheri ose vendimi gjyqesor qe mund te nxirret ose jepet ne keto procedime.

37.12 Pasardhesit dhe te Caktuarit

Palet e ketushme bien dakort qe Huadhenesi mund t'i kaloje dhe/ose te rinovoje kete Kontrate, perfshi ketu te gjitha te drejtat dhe detyrimet e Shoqerise sipas kesaj Kontrate, nje pale te trete me eksperience ne industrine e transportit ajror me aprovimin e Organit te Autorizuar Shteteror, me kusht qe ky aprovim te mos vonohet pa arsye.

37.13 Mungesa e Detyrimeve te Nenkuptuara

a) Eshte pranuar ne menyre te shprehur qe Shoqeria nuk merr persiper detyrime te

nenkuptuara qe lindin apo rrjedhin nga dhenia e Koncesionit, ndonje autorizim tjeter apo ushtrimi i te drejtave dhe permbushja e detyrimeve qe rrjedhin prej tyre sipas kesaj Kontrate.

b) Asgje ne kete Kontrate nuk do te interpretohet si transferim i ndermarrjeve tek Shoqeria ne lidhje me punesimin dhe perfitimet e tij sipas ndonje Ligji te Zbatueshem. Asgje ne kete Kontrate nuk do te interpretohet si nje transferim i Aeroportit Nene Tereza Sh.A. tek Shoqeria sipas Ligjeve te Zbatueshme.

37.14 Perjashtimi Tatimor dhe Rimbursimet e Pershpejtuara te TVSH-se

a) Te gjitha pajisjet, automjetet ose materialet e ndryshme te importuara ose te blera ne Republiken e Shqiperise per Shoqerine dhe per qellimin e rinovimit, ndertimit, manaxhimit te ndertimeve ose zhvillimit te Terminalit Ekzistues, Sheshit te Terminalit Ekzistues dhe Aktivet e Lidhura me te, Ndertimet e Reja, gjate afatit te ndertimit te Fazes A te Terminalit te Ri, te Fazes B te Terminalit te Ri, Zgjatimin se Pistes, dhe Rruges se Re Hyrese do te jene:

i) te lira dhe shkarkuara nga te gjitha detyrimet doganore dhe ato mbi importet te pagueshme sipas Ligjit nr. 8449, date 27 Janar 1999 “Mbi Kodin Tatimor te Republikes se Shqiperise”, dhe ndryshimet e tij kohe pas kohe.

ii) te lira dhe shkarkuara nga aplikimi i tatimit mbi vleren e shtuar mbi importet, te pagueshme sipas Ligjit nr. 7928 me date 27 Prill 1995 “Mbi Tatimin mbi Vleren e Shtuar”, dhe ndryshimet e tij kohe pas kohe.

b) Pavaresisht nga perjashtimet e tjera tatimore qe Shoqeria perfiton sipas kesaj Kontrate, Qeveria e Shqiperise, me kete dokument, bie dakort qe rimbursimi i TVSH-se te paguar nga Shoqeria mbi mallrat dhe sherbimet e blera ne Republiken e Shqiperise gjate periudhave te planifikuara te ndertimit te Fazes A te Terminalit te Ri, te Fazes B te Terminalit te Ri, Zgjatimit te Pistes dhe Rruges se Re Hyrese do te kryhet mbi baza mujore, jo me vone se 30 dite pas dorezimit nga Shoqeria te dokumentacionit te plote dhe te duhur te pagesave te ketyre TVSH-ve te paguara nga Shoqeria ne muajin parardhes (“Rimbursimet e Pershpejtuara te TVSH”).

37.15 Te Drejtat e Paleve te Treta

Asnje Person qe nuk eshte pale ne kete Kontrate nuk gezon te drejta sipas Ligjit te Kontratave (Te Drejtat e Paleve te Treta) 1999.

37.16 Ndryshime ne Ligj

a) Kur nuk parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, Shoqeria do te marre parasysh Ndryshimet antidiskriminuese ne Ligj qe hyjne ne fuqi pas dates se kesaj Kontrate.

b) Kur si rezultat i drejtperdrejte i Ndryshimit perkates te Ligjit, Shoqerise i shkaktohen rritje ose ulje ne kosto, rritje ose ulje ne te ardhurat post-tatimore ose barre dhe perfitime te tjera financiare, me nje efekt te pergjithshem financiar mbi 300.000 Euro ne cdo vit financiar, Shoqeria njofton per keto efekte te pergjithshme financiare Qeverine Shqiptare nepermjet analize mbeshtetese te arsyeshme financiare me shkrim, te shoqeruar me shpjegime, me qellim qe Shoqeria te rivendoset ne te njejten gjendje financiare net e cilen do ishte sikur te mos kishte patur asnje Ndryshim perkates ne Ligj.

c) Qeveria Shqiptare i paguan Shoqerise, ne vit, cdo shume qe nevojitet per rivendosjen e Shoqerise ne te njejten gjendje financiare qe do te kishte qene po te mos kishte patur asnje Ndryshim ne Ligj, per cdo vit perkates gjate afatit te mbetur nga Afati i Koncesionit. Ne perllogaritjen e efektit financiar te permendur me siper merret parasysh efekti kumulativ mbi Shoqerine i te gjitha Ndryshimeve perkatese ne Ligj qe nga data e hyrjes ne fuqi te kesaj Kontrate.

37.17 Pergjegjesia individuale e ortakeve

Cdo Ortak i Shoqerise eshte pergjegjes individualisht sipas kesaj Kontrate.

38. LIGJI RREGULLUES

Kjo Kontrate regullohet nga ligji Anglez.

ME DESHMINE e duarve te paleve (ose te perfaqesuesve te tyre) ne 15 Tetor 2004 ne Tirane, Republika e Shqiperise, perpara noterit publik Shpresa Kurti.

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONEVE
REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E EKONOMISE

REPUBLIKES SE SHQIPERISE

TIRANA AIRPORT PARTNERS (TAP) (SHPK)

SHTOJCAT

Shtojca 1 Akti i Uzufruktit
Shtojca 2 Shlyerja e Kapitalit te Deklaruar për Fazën A të Punimeve të Ndërtimit
Shtojca 3 Huaja Kryesore e Certifikuar për Fazën A të Punimeve të Ndërtimit
Shtojca 4 Pagesat e Qeverisë Shqiptare – Shumat e Huave të Mëparshme
Shtojca 5 Sanksionet për Mospërmbushjen e Detyrimeve Kryesore
Shtojca 6 Sanksionet për Mospërmbushjen e Detyrimeve Shtesë
Shtojca 7 Pagesat për Shërbimet e Aeroportit
Shtojca 8 Inxhinieri i Pavarur
Shtojca 9 Garancia e Përmbushjes së Detyrimeve të Shoqërisë e Pagueshme sipas Kerkeses
Shtojca 10 Lista e Institucioneve Financiare
Shtojca 11 Siguracioni
Shtojca 12 Investitori Strategjik
Shtojca 13 Projektligji "Per koncesionin e Aeroportit"
Shtojca 14 Autorizimet e Dhena
Shtojca 15 Zona e Koncesionit
Shtojca 16 Projekti i Miratuar Teknik
Shtojca 17 Kodet, Standardet, Regulloret dhe botime të tjera
Shtojca 18 Master Plani dhe Plani i Ndërtimeve
Shtojca 19 Faza A e Terminalit të Ri
Shtojca 20 Lehtësirat Operacionale për Terminalin e ri
Shtojca 21 Terminali Ekzistues
Shtojca 22 Faza A e Qendres së Re të Mallrave
Shtojca 23 Infrastruktura nga ana Aerodromit
Shtojca 24 Pajisjet e Aerodromit
Shtojca 25 Rruga Perimetër e Aeroportit dhe Perimetri i Rrethimit te Sigurise së Aeroportit
Shtojca 26 Shërbime komunale
Shtojca 27 Rruga Hyrëse e Aeroportit, Rruga Qarkulluese e Aeroportit dhe Parkingu i Makinave Faza A
Shtojca 28 Ndriçimi Tokësor i Aerodromit
Shtojca 29 Mjetet Kundra Zjarrit dhe Shpëtimit dhe Kontrollet Përkatëse
Shtojca 30 Faza B e Terminalit të ri dhe Faza B e Parkingut të Makinave
Shtojca 31 Faza B e Qendrës se Re të Kargos
Shtojca 32 Rruga e re Hyrëse
Shtojca 33 Modelimi
Shtojca 34 Shërbimet e Ofruara nga Qeveria
Shtojca 35 ANTA
Shtojca 36 Kriteret e Përmbushjes
Shtojca 37 Administrimi Operacional Pas Përfundimit të Fazës A të Terminalit të Ri
Shtojca 38 Manuali Operacinal i Aerodromit
Shtojca 39 Sistemi i Administrimit të Sigurisë në Aeroport
Shtojca 40 Mirëmbajtja e Aeroportit
Shtojca 41 Administrimi i Cilësisë
Shtojca 42 Administrimi Mjedisor

Shtojca 43 Pagesat për Qeverinë e Shqipërisë – Pjesa ne Fitim
Shtojca 44 Siguria dhe Kontrolli i Bagazheve
Shtojca 45 Ndërtesë Ndihmëse – Nga Ana e Tokës
Shtojca 46 Ndërtesa Ndihmëse – Nga Ana e Aerodromit
Shtojca 47 Ndriçimi Rrugëve
Shtojca 48 Impianti i Ri i Karburantit
Shtojca 49 Panorama
Shtojca 50 Afatet Kohore
Shtojca 51 Plani Kalimtar
Shtojca 52 Njoftimi i Kundërshtimit
Shtojca 53 Forma e Letres se Qeverise se Shqiperise qe Konfirmon Shpronesimin e Pasurive te Paluajtshme Brenda Zonës se Koncesionit
Shtojca 54 Raportimi Periodik
Shtojca 55 Veprimtaritë Ushtarake
Shtojca 56 Zona e Kufizuar dhe Zona e Zhvillimit
Shtojca 57 Forma e Letrës së Shoqërisë që Konfirmon Vërtetesinë dhe Korrektësinë e Deklarimeveh dhe Garancive te saj
Shtojca 58 [I Lënë Bosh me Qëllim]
Shtojca 59 [I Lënë Bosh me Qëllim]
Shtojca 60 Forma e Letrës së Shoqërisë që konfirmon Zotimet Financiare të Marra në Bazë të Dokumenteve të Financimit
Shtojca 61 Formulari i Shoqërisë në Lidhje me Sigurimin
Shtojca 62 Forma e Letrës së Shoqërisë që Konfirmon Përmbushjen e Detyrimeve të saj Sipas Kontratës së Koncesionit dhe Dokumenteve të Financimit
Shtojca 63 Marrëveshja e Llogarisë së Ngurtësuar
Shtojca 64 Formulari i Letrës së Shoqërisë që Konfirmon dhe Premton që Shuma e Përgjithshme 614,700 Euro do të Nënshkruhet dhe Paguhet në Datën e Fillimit
Shtojca 65 Formulari i Organit të Autorizuar Shtetëror që Konfirmon Vëretësinë dhe Saktësinë e Deklaratave dhe Garancive të Dhëna nga Qeveria e Shqipërisë
Shtojca 66 Formulari i Letrës së Qeverisë së Shqipërisë që Konfirmon se e Drejta e Uzufruktit Është Dhënë, Regjistruar dhe Realizuar në Favor të Shoqërisë
Shtojca 67 Formulari i Letrës së Qeverisë së Shqipërisë që Konfirmon mosndodhjen e Rasteve te renditura në pikën 3.2(c)
Shtojca 68 Formulari i Letrës së Qeverisë së Shqipërisë që Konfirmon Përmbushjen e Detyrimeve sipas Kontratës së Koncesionit
Shtojca 69 Pagesat për Qeverinë e Shqipërisë – Pagesa e Garancisë së Transhit te Huas Shteterore
Shtojca 70 Pagesat për Qeverinë e Shqipërisë – Pagesa Fillestare e Koncesionit

SHTOJCA 1

KONTRATA E UZUFRUKTIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NR._____ REP.
NR._____ COL.

KONTRATA E UZUFRUKTIT

Sot më [●] në pranine time [emri] Noteri Publik, me seli në [adresa] janë paraqitur:

(1) Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, të QEVERISË SË SHQIPËRISË (Organi Shtetëror i Autorizuar) e përfaqësuar nga [emri] me kompetencën [e tij/ e saj] [titulli/autoriteti] (përfaqesuesi i autorizuar i organit kompetent) në emër të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Qeveria e Shqipërisë), dhe

(2) [të dhëna për shoqerinë], ("Shoqëria"), më seli në [adresa], Tirane, Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga [emri] në kompetencën [e tij/ e saj] si [titulli/autoriteti].

Palët më kanë kërkuar që ky Akt i Krijimit të të Drejtave të Uzufruktit të jetë si më poshtë:

Duke patur parasysh që:

(A) Qeveria e Shqipërisë dhe Shoqëria kanë nënshkruar Kontratën e Koncesionit datë [●]e vitit 2004, (Kontrata e Koncesionit)

(B) Neni 15.4 (Plotësimi dhe Krijimi i Uzufruktit) i Kontratës së Koncesionit parashikon që Qeveria e Shqipërisë duhet të mundësojë që Organi Shtetëror i Autorizuar të nënshkruajë marrëveshjen për krijimin dhe themelimin e uzufruktit përkatës, dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar krijimin, themelimin dhe regjistrimin e plotë të të drejtave të uzufruktit lidhur me Zonën e Koncesioneve, lehtësitë ekzistuese dhe lehtësitë e reja (të përcaktuara si më poshtë).

(C) Sipas Nenit 9 të Ligjit shqiptar nr. 7973 " Për Koncesionet dhe pjesëmarrjen e Sektorit privat ne Shërbimet Publike dhe Infrastrukturën" datë 26 Korrik 1995, vendimi i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Këshilli i Ministrave) i titulluar „ Për miratimin e Programit dhe Dokumentacionit të Projektit për Zbatimin e Kontratës së Koncesioneve për Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza„ Rinas, Tiranë, datë 5 Korrik 2003 dhe vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 48 i titulluar „ Për përzgjedhjen e Ofruesve të preferuar per realizimin e Kontratës se Koncesionit për Aeroportin Ndërkombëtar "Nënë Tereza„ Rinas, Tiranë, datë 27 Janar 2004, Organi Shtetëror i Autorizuar është ngarkuar të zbatojë këtë marrëveshje në emër të Republikës së Shqipërisë.

(D) Me [titulli i dokumentit që ngarkon Përfaqësuesin e Organit Shtetëror të Autorizuar të kryejë të gjitha veprimet që duhet të ndërmerren nga Organi Shtetëror i Autorizuar në lidhje me krijimin e Uzufruktit] datë [●] 2004, Organi Shtetëror i Autorizuar ka autorizuar Përfaqesuesin e tij të krijojë, themelojë, dhe regjistrojë Uzufruktin (sic përcaktohet më poshtë) në favor të Shoqërisë.

(E) Përfaqësuesi i Organit Shtetëror të Autorizuar dëshiron të krijojë Uzufruktin mbi Pronësinë në favor të Shoqerisë mbi kushtet dhe afatet e përcaktuara në krijimin e Aktit të të Drejtave të Uzufruktit.

KONTRATA E UZUFRUKTIT PARASHIKON SA VIJON:

1. INTERPRETIME

Përveç se kur përkufizohen ndryshe në këtë Akt per Krijimin e te Drejtave te Uzufruktit, të gjitha termat e përdorura në këtë Kontrate do të kenë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në Kontraten e Koncesionit, dhe termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

" Organ shtetëror i Autorizuar"	ka kuptimin e dhënë në paragrafin (1) të parathënies së Aktit.
"Përfaqësuesi i Organit Shtetëror të Autorizuar	ka kuptimin e dhënë në paragrafin (1) të parathënies së Aktit

"Shoqëri"	ka kuptimin e dhënë në paragrafin (2) të parathënies së Aktit
"Kontratë e Koncesionit"	ka kuptimin e dhënë në Përshkrimin (A) të Aktit
"Këshilli i Ministrave"	ka kuptimin e dhënë në Përshkrimin (C) të Aktit.
"**Akti i Krijimit të të drejtave të Uzufruktit"**	nënkupton, aktin e krijimit të të drejtave të Uzufruktit, i ndryshuar dhe/ose i rishpallur nga koha në kohë.
"Pronësia"	ka kuptimin e dhënë në seksionin 2(a) të Aktit
"Uzufrukt"	ka kuptimin e dhënë në seksionin 2 (a) të Aktit

2. KRIJIMI I UZUFRUKTIT

(a) Përfaqësuesi i Organit Shtetëror të Autorizuar krijon në favor të Shoqërisë të drejtat e Uzufruktit ("Uzufrukti") [vendos listën e pronave mbi të cilat Uzufrukti është dhënë] ("Prona") dhe Shoqëria bie dakord për krijimin dhe themelimin e Uzufruktit mbi Pronësinë.

(b) Përfaqësuesi i Organit Shtetëror të Autorizuar krijon dhe themelon Uzufruktin mbi Pronën pa ndonjë pengesë si garanci pagese, detyrim, qira, barrë apo pretendim të pronarëve të mëparshëm dhe të drejta të tjera të ushtruara nga ndonjë palë e tretë gjatë Periudhës së Koncesionit.

3. REGJISTRIMI I UZUFRUKTIT

Përfaqësuesi i Organit Shtetëror të Autorizuar pranon të përfundojë të gjitha veprimet dhe të marrë të gjitha masat e nevojshme për rregjistrimin e Uzufruktit mbi Pronën në Zyrën e Rregjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme në [Krujë] brenda dy javëve nga data e Aktit të Krijimit të të Drejtave të Uzufruktit, sipas ligjit Nr. 7843, datë 13 Korrik 1994, "Për rregjistrimin e Pasurive të Paluajtshme" (i ndryshuar herë pas here)

4. PËRFUNDIMI I UZUFRUKTIT

(a) Përfundimi i Uzufruktit duhet të përkojë me përfundimin e Kontratës së Koncesionit, nëqoftëse palet nuk kanë vendosur ndryshe.

(b) Në mbarim të Uzufruktit, Organi Shtetëror i Autorizuar siguron që fakti i mbarimit të Uzufruktit të jetë regjistruar si duhet në Zyrën e Pasurive të Paluajtshme në [Krujë]

5. DEKLARIMET DHE GARANCITË

(a) Perfaqësuesi i Organit Shtetëror të Autorizuar përfaqëson dhe garanton Shoqërinë për sa më poshtë:

(1) Perfaqësuesi i Organit Shtetëror të Autorizuar ka të drejtë të krijojë dhe themelojë Uzufruktin mbi Pronën në favor të Shoqërisë sipas kushteve të vendosura në Aktin e Krijimit të të Drejtave të Uzufruktit.

(2) Pjesëmarrja dhe përmbushja nga Perfaqësuesi i Organit Shtetëror të Autorizuar, dhe veprimet e parashikuara nga Akti i Krijimit të të drejtave të Uzufruktit nuk duhet të jenë në kundërshtim me asnjë ligj Shqiptar aktualisht të zbatueshëm ose me ndonjë normë,urdhër, marrëveshje, dokument ligjor ose sipërrmarrje e lidhur me ndonjë Subjekt Shtetëror; dhe

(3) Prona që zotërohet nga Republika e Shqipërisë nuk i nënshtrohet asnjë barre (duke përfshirë pa asnjë kufizim ndonjë privilegj, peng, qira, të drejta Uzufrukti, lehtësira, të drejtat e kalimit dhe të drejta të tjera reale) ose ndonjë marrëveshjeje ose angazhimi për të krijuar ndonjë heqje dore nga të drejtat gjatë Afatit të Koncesionit.

(b) Shoqëria deklaron dhe i garanton Qeverisë së Shqipërisë dhe Perfaqësuesit të Organit Shtetëror të Autorizuar se ka të drejtën të hyjë në Aktin e Krijimit të të drejtave të Uzufruktit.

6. SIPËRMARRJET

Palët kanë rënë dakord që:

(a) Pavarësisht nga Neni 240 i Kodit Civil Shqiptar, Shoqëria lejohet të sigurojë Uzufruktin, nëse ky sigurim bëhet në përputhje me Ligjet e zbatueshme.

(b) Pavarësisht nga Neni 244 i Kodit Civil Shqiptar, Shoqëria nuk ka të drejtë të japë me qira Pronën, pervec kur parashikohet ne kete Kontrate; dhe

(c) Pavarësisht nga Neni 256 i Kodit Civil Shqiptar, Qeveria e Shqipërisë, Organi Shtetëror i Autorizuar dhe/ose Përfaqësuesi i Organit Shtetëror të Autorizuar nuk kanë të drejtë të kërkojnë përfundimin e Uzufruktit përpara përfundimit të Kontratës së Koncesionit.

7. TAKSAT

Sipas Nenit 254 të Kodit Civil Shqiptar, cdo taksë, tarifë, pagesë, taksë toke dhe cdo detyrim tjetër i lidhur me të ardhurat që rrjedhin nga Uzufrukti do të përballohen nga Shoqëria. Shoqëria nuk është përgjegjëse dhe nuk paguan asnjë taksë ose ndonjë pagesë tjetër ose shpenzime lidhur me zotërimin e Pronës nga Qeveria e Shqipërisë ose Organi Shtetëror përkatës.

8. LIGJI I RREGULLUES

Formimi, vlefshmëria, interpretimi, zbatimi, ndryshimi dhe përfundimi i Aktit të Krijimit të të Drejtave të Uzufruktit do të rregullohen nga ligjet e Republikës së Shqipërisë.

9. GJUHA

Ky Akt nenshkruhet ne Gjuhen Shqipe me perkthimin ne Anglisht te sigluar, qe i bashkengjitet si pjese e pandashme. Ne rast mosperputhjeje midis perkthimit ne Anglisht te sigluar dhe tekstit ne Shqip te ketij Akti, perparesi ka perkthimi ne Anglisht. Cdo dokument qe permendet ose eshte per tu dhene ne kete Akt do te jete ne Anglisht dhe/ose ne Shqip, si te kerkohet. Akti i Krijimit të të drejtave të Uzufruktit, në katër kopje, u lexua dhe nënshkrua nga palët përpara meje.

Përfaqësuesi i Organit Shtetëror të Autorizuar **Tirana Airport Partners shpk**

_____ _____

[Vula e Noterit Publik]

SHTOJCA 2

SHLYERJA E KAPITALIT TE DEKLARUAR PËR FAZËN A TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT

Shoqëria garanton që Ortaket do të nënshkruajnë dhe paguajnë për Shoqërinë shumat në para në lidhje me Kapitalin e Deklaruar per t'u Shlyer që tregohen në tabelën në vijim në çdo vit, me

qëllim që t'i mundësojnë Shoqërisë të përmbushë Detyrimet Bazë.

Periudha nga Data e Fillimit	Para ose ne Datën e Fillimit	Deri në pervjetorin e pare (I-re) te Datës së Fillimit	Nga pervjetori i pare (1–re) deri ne pervjetorin e dyte (2-te) te Dates se Fillimit	Nga pervjetori i dyte (2–te) deri ne pervjetorin e trete (3-te) te Dates se Fillimit	Gjithsej
Shlyerja e Kapitalit te Deklaruar (ne EURO) e HTA dhe AAEF	614,700	2,051,732	3,089,209	647,484	6,403,125
Shlyerja e Kapitalit te Deklaruar (ne EUR) nga DEG	2,971,875				2,971,875
Shlyerja e Kapitalit te Deklaruar ne Total	3,586,575	2,051,732	3,089,209	647,484	9,375,000

Per te shmangur dyshimet Shlyerja e Kapitalit te Deklaruar mund te nenshkruhet dhe shlyer Shoqerise me perpara sesa tregohet ne tabelen me siper sipas zgjedhjes se Shoqerise dhe HTA dhe AAEF.

Detyrimet e Aksionereve per te nenshkruar dhe shlyer Shlyerjen e Kapitalit te Deklaruar (nepermjet shoqerive ndermjetesuese perkatese te zoteruara 100 %) jane te ndryshme dhe perqindjet e totalit te zbatueshem per secilin nga Aksioneret Fillestare jane si me poshte:

Ortaket	Përqindja
Hochtief AirPort AG	47%
DEG – Deutsche Investitions-und Entëicklungsgesellschaft mbH	31.7%
Albanian-American Enterprise Fund	21.3%

SHTOJCA 3

HUAJA KRYESORE E CERTIFIKUAR PËR PUNIMET E NDËRTIMIT TË FAZËS A

Shoqëria do të marrë nga Huadhënësi zotime të detyrueshme për të dhënë një Hua Kryesore në shumën e përgjithshme prej Euro 33,845,000 (tridhjetë e tre milion e tetëqind e dyzet e pesë mijë) në përputhje me Dokumentet e Financimit dhe afatet e parashikuara të tërheqjeve në vijim. Për sqarim shuma e Huasë Kryesore të dhënë do t'i nënshtrohet miratimit përfundimtar nga Huadhënësi.

Periudha nga Data e Fillimit	Deri në Njëvjetorin e Datës së Fillimit	Nga Njëvjetori deri në Dyvjetorin e Datës së Fillimit	Nga Dyvjetori në Trevjetorin e Datës së Fillimit	Gjithsej
Tërheqjet e Huasë Kryesore në Euro	14,096,000	16,327,000	3,422,000	33,845,000

Në rast se Kontrata e Koncesionit do te zgjidhet nga secila prej Paleve perpara tre vjetorit te Datës së Fillimit, shuma maksimale e pjeses se kompensimit qe Qeveria e Shqiperise i paguan Shoqerise ne llogari te Huase Kryesore te Certifikuar per zgjidhje te Kontrates, do te jete totali i shumes se principalit te Huase Kryesore te Certifikuar te terhequr nga Shoqeria sipas Dokumenteve te Financimit perkatese dhe interesi i papaguar dhe tarifat qe rrjedhin perpara dates se perfundimit te kesaj Kontrate. Si rjedhim shuma maksimale për t'u paguar nga Qeveria e Shqipërisë me qëllim kompesimin për zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje në lidhje me Huanë Kryesore nuk duhet të kalojë 110% të shumës së përcaktuar si "Total" në tabelën e mësipërme, në qoftë se me shkrim, nuk është rënë dakort ndryshe nga Organi Shtetëror i Autorizuar.

Në rast se Shoqëria kërkon të ngrejë financimin e Huasë Kryesore në lidhje me pagesat e arsyeshme për Punimet e Ndërtimit sipas Marrëveshjes (ose punimeve të tjera sic është rënë dakord mes palëve), përvec Fazës A të Punimeve të Ndërtimit, shumat e "Kufirit të Huasë Kryesore me qëllim kompesimin për zgjidhjen e Marrëveshjes, që paguhet nga Qeveria e Shqipërisë, duke përfshirë një shtesë 10%" do të rishikohen sipas vullnetit të palëve, bazuar në përshkrimin e shlyerjes dhe mbushjes së afatit të Huasë së Re Kryesore.

SHTOJCA 4

PAGESAT E QEVERISË SË SHQIPËRISË-SHUMAT E HUAVE TË MËPARSHME

Shumat e Huave të mëparshme të pagueshme nga Shoqëria për Qeverinë Shqiptare dhe datat përkatëse (secila: një "Datë Pagese") të pagimit tregohen në tabelën e mëposhtme.

Data e Pagesës	Shuma e huasë së mëparshme në Euro
15 Dhjetor 2004	88,642.94
15 Qershor 2005	88,642.94
15 Dhjetor 2005	88,642.94
15 Qershor 2006	88,642.94
15 Dhjetor 2006	88,642.94
15 Qershor 2007	88,642.94
15 Dhjetor 2007	88,642.94
15 Qershor 2008	88,642.94
15 Dhjetor 2008	88,642.94
15 Qershor 2009	88,642.94
15 Dhjetor 2009	88,642.94
15 Qershor 2010	88,642.94
15 Dhjetor 2010	88,642.94
15 Qershor 2011	88,642.94
15 Dhjetor 2011	88,642.94
15 Qershor 2012	88,642.94

15 Dhjetor 2012	581,103.73
15 Qershor 2013	579,257.01
15 Dhjetor 2013	577,410.28
15 Qershor 2014	575,563.55
15 Dhjetor 2014	573,716.82
15 Qershor 2015	571,870.10
15 Dhjetor 2015	570,023.37
15 Qershor 2016	568,176.64
15 Dhjetor 2016	566,329.91
15 Qershor 2017	564,483.18
15 Dhjetor 2017	562,636.46
15 Qershor 2018	560,789.73
15 Dhjetor 2018	558,943.00
15 Qershor 2019	557,096.27
15 Dhjetor 2019	555,249.54
15 Qershor 2020	553,402.82
15 Dhjetor 2020	551,556.09
15 Qershor 2021	549,709.36
15 Dhjetor 2021	547,862.63
15 Qershor 2022	546,015.90
15 Dhjetor 2022	544,169.18
15 Qershor 2023	542,322.45
15 Dhjetor 2023	540,475.72
15 Qershor 2024	538,628.99
15 Dhjetor 2024	536,782.26
15 Qershor 2025	534,935.54
15 Dhjetor 2025	533,088.81

Në rast se Data e Pagesës për një Hua të Mëparshme bie brenda gjashtë muajve pas Datës së Fillimit, Shuma e Huasë së Mëparshme do të zvogëlohet nga Shuma e Huasë së Mëparshme e shumëzuar me perpjesetimin per (i) numrin e ditëve nga Data e Pagesës pararendëse deri në Datën e Fillimit deri (ii) 180.

Në rast se Data e Pagesës për një Shumë të Huasë së Mëparshme bie brenda gjashtë muajve pas përfundimit të afatit të kësaj Kontrate, Shoqëria do t'i paguajë Qeverisë së Shqipërisë një pjesë të Shumës së Huasë së Mëparshme e bazuar në përpjestim me (i) numrin e ditëve nga Data e Pagesës pararendëse deri në datën e përfundimit të afatit të kësaj Kontrate deri (ii) 180.

Shumat e Huave të Mëparshme do të jenë të pagueshme vetëm në Datat e Pagesës që vijojnë pas Datës së Fillimit dhe para datës së përfundimit të afatit të kësaj Kontrateje.

Shoqëria do të bëjë pagesat e Shumave të Huave të Mëparshme për Qeverinë e Shqipërisë në numrin e llogarisë në vijim:

[Të jepen numri dhe hollësitë e adresës së llogarisë së Qeverisë së Shqipërisë]

SHTOJCA 5

SANKSIONET PËR MOSPËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE KRYESORE

1. Sanksionet për mospërmbushjen e Detyrimeve Kryesore

Sanksioni për mospërmbushjen e Detyrimeve Kryesore do të llogaritet si shumë e dënimit të zbatueshëm për ditë të mospërmbushjes në tabelën në vijim për Detyrimet Kryesore dhe periudhën e

mospërmbushjes të matur me ditë nga Data e Kërkuar e Detyrimit ne varesi te zgjatjeve te lejuara te kesaj date sipas kësaj Kontrate duke përfshirë, pa kufizim në rastet e Forcës Madhore dhe cdo masë për të cilën palët kanë rënë dakord në lidhje me Rastet e Shkarkimit nga Pergjegjesia.

Detyrimi Kryesor	Data e Kërkuar e Detyrimit	Sanksioni për Mos-Përmbushje
Faza A e Terminalit të Ri	Ne pervjetorin e dytë të Datës së Fillimit	EUR 2,750.00/dita
Faza A Parkingu Makinave	Në përvjetorin e dytë të Datës së Fillimit	EUR 1,375.00/dita
Faza A e Qendrës së Re të Kargos	Në përvjetorin e dytë të Datës së Fillimit	EUR 1,375.00/dita
Rruga e re Lidhëse	Në ditën që bie 30 muaj nga Data e Fillimit, në varësi të Shpronësimit të kërkuar të Tokës dhe marrjes së të gjitha Lejeve të nevojshme	EUR 2.750,00/dita
Rimodelimi i Terminalit Ekzistues	Në ditën qe bie nëntë muaj nga Data e Hapjes së Fazës A të Terminalit të Ri	Euro 550/dita

2. Kufijtë e Sanksioneve

Periudha kohore maksimale për përllogaritjen e Sanksionit për Mospërmbushje të ndonjë prej Detyrimeve Kryesore do të kufizohet në 180 ditë.

Nëse sanksionet për mospërmbushje të Detyrimeve Kryesore janë të pagueshme nga Shoqëria në lidhje më ndonjë prej Detyrimeve Kryesore për më shumë se një qind e tetëdhjetë (180) ditë, Qeveria e Shqipërisë do të ketë të drejtën të zgjidhë këtë Kontrate sipas Pikës 26.3 (Zgjidhja e Kontrates nga Qeveria e Shqipërisë për arsye të Mospërmbushjes Specifike nga ana e Shoqërisë)

SHTOJCA 6

SANKSIONET PËR MOSPËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE SHTESË

Sipas Pikës 4.5 (Zbatimi dhe Rishikimi i Detyrimeve Shtesë të Shoqërisë), sanksioni për mospërmbushjen e Detyrimeve Shtesë do të përllogaritet si shumë e sanksionit të zbatueshëm për ditë të mospërmbushjes në tabelën në vijim për ato Detyrime Shtesë dhe periudhën e mospërmbushjes të llogaritur në ditë nga Data e Kërkuar e Detyrimit në varësi të Zgjatjeve të Lejuara të kësaj date sipas kësaj Kontrate duke përfshirë, pa kufizim në rastet e Forcës Madhore dhe cdo masë për të cilën Palët kanë rënë dakord në lidhje me Rastet e Shkarkimit nga Pergjegjesia.

Detyrimi Shtesë	Shkaku	Data e Zbatimit	Sanksioni për ditë të mos-përmbushjes
Faza B e Terminalit të Ri dhe Faza B e Parkingut të Makinave	Realizimi i datës së ngjarjes në Fazën B për Terminalin e Ri dhe Fazës B për Parkingun e	Ne pervjetorin e dyte te dites se realizimit të Datës së Shkakut	EUR 4,000.00/dita e indeksuar nga 1 Janari 2004 për inflacionin e Eurozones

	Makinave		
Zgjerimi Pistës	Zgjerimi Pistës Miratimi i paraparë në dispozitën 4.8 (d) (Zgjerimi I Pistës)	Në datën që bie 22 muaj qe nga data e lëshimit të Miratimit të Zgjatimit të Pistës	EUR 2,400.00/ dita e indeksuar nga 1 Janari 2004 për inflacionin e Eurozonës
Faza B Qendrës së Re të Kargos Ajrore	Realizimi i Datës së Ngjarjes për Fazën B të Qendrës së Re të Kargos Ajrore	Ne diten qe bie 16 muaj pas Datës përkatëse të Ngjarjes	EUR 2,400.00/ dita e indeksuar nga 1 Janari 2004 për inflacionin e Eurozones

Inxhinieri i Kualifikuar do të kontrollojë përmbushjen e Detyrimeve Shtesë nga ana e Shoqërisë nëse i kërkohet një gjë e tillë nga Organi i Autorizuar Shtetëror me shkrim. Shoqëria do t'i lejojë Inxhinierit të Kualifikuar të hyjë në Zonën e Konçesionit dhe t'i japë informacionin e nevojshëm sipas kërkesës së Inxhinierit të Kualifikuar në përmbushjen e detyrës.

Periudha maksimale për përllogaritjen e sanksionit për Mos-përmbushje të ndonjë nga Detyrimet Shtesë do të kufizohet në njëqind e tetëdhjetë (180) ditë.

Nëse sanksionet për mos-përmbushje të ndonjë Detyrimi Shtesë janë të pagueshme nga Shoqëria ne lidhje me ndonjë Detyrim Shtesë për më shumë se njëqind e tetëdhjetë (180) ditë, Qeveria e Shqipërisë do të ketë të drejtën [të ndërhyjë dhe nëse e nevojshme të zgjidhë këtë Kontrate sipas dispozitës 26.3 (Zgjidhja e Kontrates nga Qeveria e Shqipërisë për arsye të Mospërmbushjes Specifike nga ana e Shoqërisë)

SHTOJCA 7

PAGESAT PER SHERBIMET E AEROPORTIT

Pagesat per sherbimet e aeroportit të zbatueshme nga Data e Fillimit do të jenë Shërbimi Bazë në Tokë dhe Uljet Bazë dhe Ngritjet Bazë, Pagesa Bazë për Pasagjer dhe Pagesa Bazë për Kargo, Pagesa Bazë për Parkimin e Avionëve dhe Pagesa e Ndriçimit të Aerodromit (të përcaktuara më poshtë). Pagesat e Aeroportit do të rishikohen në vazhdim në përputhje me dispozitën 19, rishikimi i parë të bëhet më 1 Janar 2005: Të gjitha Pagesat e tjera të vëna nga Shoqëria shoqërive ajrore për shërbime të mbuluara nga Pagesat e Aeroportit të përfshira në këtë Shtojcë, të zbatueshme nga 1 Shtatori 2004, do t'i nënshtrohen dispozitave përkatëse të kësaj Kontrate në lidhje me rishikimin periodik dhe të ndërmjetëm të Pagesave të Aeroportit.

1. Pagesa e Shërbimit në Tokë, Uljes dhe Ngritjes

Pagesa e Shërbimit në Tokë dhe e Uljes dhe e Ngritjes do të përllogaritet në bazë të peshës minimale të ngritjes së avionit përkatës në përputhje më tabelën e mëposhtme.

Pesha minimale e Ngritjes se Avionave	Pagesa Bazë e Shërbimit në Tokë (EUR, €)	Pagesa Bazë e Uljes dhe e Ngritjes (EUR, €)
Deri 1 ton	30	25
Nga 1 deri2 ton	50	35
Nga 2 deri6 ton	120	70
Nga 6 deri10 ton	230	120

Nga 10 deri20 ton	500	200
Nga 20 deri30 ton	700	300
Nga 30 deri45 ton	1000	400
Nga 45 deri60 ton	1250	550
Nga 60 deri80 ton	1350	650
Nga 80 deri100 ton	1500	700
Nga 100 deri120 ton	1600	800
Mbi 120 ton	1700	900

2. Pagesa për Pasagjerët

Pagesa Bazë për Pasagjerët do të jetë dhjetë EUR, €10 për personat mbi 12 vjeç, dhe pesë EUR, €5 për fëmijë nga 2 deri në 12 vjeç. Pagesa për Pasagjerët do të rritet në 12.50 EUR, për pasagjerët e rritur nga fillimi i muajit në vijim të datës në të cilën Faza A e Terminalit të Ri, Faza A e Parkingut të Makinave dhe Faza A e Qendrës së Re të Kargos komisionohen dhe janë të vëna në përdorim nga Përdoruesit e Aeroportit, pasagjerët dhe trafiku kargo në përputhje me këtë Kontrate.

Pagesa për Pasagjerët do të jetë e pagueshme vetëm nga Pasagjerët që largohen nga vendi

3. Pagesa e Kargos

Pagesa e Kargos do të përllogaritet duke u bazuar në peshën e kargos ajrore të transportuar në përputhje me tabelën në vijim.Këto Pagesa zbatohen vetëm për kargot e zgjidhura ose të lidhura dhe nuk përfshijnë Pagesa të tjera që mund të mblidhen për mallra që kërkojnë një trajtim special në magazinë, si mallra që prishen, mallrat e rrezikshëm ose të dëmshëm, gjë e gjallë, eshtra njeriu ose sende të tjera. Shoqëria dhe Organi Shtetëror i Autorizuar duhet të bien dakord për mbledhjen e këtyre Pagesave mbi bazë kostoje të justifikuar dhe të arsyeshme.

Pesha (kilogram)	Pagesa Bazë e Kargos (EURO,per kg)
Deri 3	1
3 – 5	2
6 – 10	3
11 – 20	4
21 – 50	5
51 – 100	8
101 – 250	10
251 – 500	15
501 – 750	20
751 – 1000	25
1001 – 1500	35
Over 1501	50

Pagesat e postës ajrore, duke përfshirë postën e shpejtë ose me korrier, nuk janë pjesë e tarifës së kargos dhe do të vendosen sipas Kontrates ndërmjet Shoqërisë dhe shërbimit postar Shqiptar vec e vec, bazuar në marrëveshjen për postën e shpejtë ose me korrier më 1 Shtator 2004, përvec kur është rënë ndryshe dakord nga Shoqëria dhe Organi Shtetëror i Autorizuar mbi baza kostoje të justifikuar dhe të arsyeshme.

4. Pagesa e Parkimit të Avionëve

Pagesa e Parkimit të Avionëve e zbatueshme për periudhën e qëndrimit nga tre orë deri në 24

orë do të vendoset nga pesha minimale e ngritjes së avionit në fjalë në përputhje me tabelën në vijim. Asnjë Tarifë e Parkimit të Avionëve nuk do të paguhet për Avionët e parkuar në Aeroport për më pak se tre orë.

Pesha Minimale e Ngritjes Avionit	Pagesa Bazë për Parkimin e Avionit (Euro)
Deri në 1 ton	8
Nga 1 në 2 ton	12
Nga 2 në 6 ton	35
Nga 6 në 10 ton	40
Nga 10 në 20 ton	60
Nga 20 në 30 ton	80
Nga 30 në 45 ton	100
Nga 45 në 60 ton	130
Nga 60 në 80 ton	140
Nga 80 në 100 ton	150
Nga 100 në 120 ton	170
Mbi 100 ton	200

5. Pagesa e Ndriçimit të Aerodromit

Pagesa e ndriçimit të Aerodromit do të përllogaritet si maksimale e 40% të Tarifës së Trajtimit në Tokë për avionët.

6. Data e Fillimit

Data e Fillimit për Pagesat e Aeroportit do të jetë 1 Janari 2004 për qëllime të rishikimit të përllogaritjeve të Pagesave të Aeroportit në përputhje me Pikën 19 (Pagesat Per Sherbimet e Aeroportit dhe Vleresimi i Pavarur Ekonomik).

SHTOJCA 8

INXHINIERI I PAVARUR

Inxhinieri Pavarur do të kontrollojë për kryerjen dhe zhvillimin e veprimtarive të ndërtimit në Aeroport dhe rrugët përkatëse në përputhje me këtë Kontrate. Inxhinieri i Pavarur do të raportojë çdo muaj te Kryetari i Njësisë së Zbatimit të Projektit dhe nëse është e nevojshme dhe të Huadhënësit (ve) Kryesor. Shoqëria do të paraqesë menjëherë të Inxhinieri Pavarur ato të dhëna teknike të cilat Inxhinieri Pavarur mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për përmbushjen e detyrës së tij.

Inxhinieri Pavarur do të pajiset me leje nga Shoqëria të hyjë në zonën e Aeroportit dhe Rrugën e Re Lidhëse sipas nevojave për të përmbushur detyrën e tij.

Detyrat e veçanta të Inxhinierit të Pavarur

- Detyrat e Inxhinierit të pavarur përfshijnë sa më poshtë:
- Vëzhgimi dhe raportimi i kryerjes së veprimtarisë inxhinierike dhe ndërtuese, dizenjove dhe punimeve të kryera lidhur me Detyrimet Kryesore në përputhje me kushtet kryesore të kësaj Kontrate.
- Dhënia e këshillave të nevojshme teknike në lidhje me miratimet statutore që kërkohen për Shoqerinë nga Qeveria e Shqipërisë dhe Organe të tjera Shtetërore jashtë Zonës së Koncesionit.
- Dhënia e këshillave të nevojshme teknike në lidhje me miratimin e licensimin të kërkuar për Shoqërinë, duke përfshirë paraqitjen e reporteve përkatëse të nxjerra nga Inxhinieri i Pavarur për Organet Shtetërore përgjegjëse për dhënien e lejeve.
- Vëzhgimi i programit të miratuar dhe përmirësimit në veprimtaritë inxhinierike dhe ndërtuese, dizenjove dhe punimeve të kryera në lidhje me Detyrimet Kryesore.
- Lëshimi i një Certifikate Perfundimi pas mbarimit të kënaqshëm të secilit prej Detyrimeve Kryesore të treguara në Shtojcën 5 (Sanksionet për Mos-përmbushjen e Detyrimeve Kryesore) në zbatim të afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate.
- Dhënia e këshillave teknike Shoqërisë në lidhje me komunikimet me Organet Shtetërore (p.sh. Ushtria, ANTA)

- Rishikojë dhe të këshillojë në lidhje me miratimet e ndryshimeve në punime dhe kërkesat shtesë të papërcaktuara shprehimisht në këtë Marëveshje, nëse do të jetë e nevojshme.

- Vëzhgimi i kryerjes së punimeve dhe sistemeve, duke përfshirë dhe miratimin e përfundimit të manualeve dhe vizatimeve të ndërtimeve.

- Vëzhgimi i kryerjes së punimeve të ndërtimit për të garantuar përputhje me standardet e mbrojtjes kundër zjarrit të përcaktuara në Shtojcën 17 "Kodet, Standardet dhe Rregulloret".

Lista e kandidatëve për Inxhinierin e Pavarur:
Arup Ing. Engineers, USA
Halcroë, UK
Louis Berger, F
Obermeyer Engineering, Germany
Parsons Engineers, UK
Spiekermann Engineering, Germany
TPS, UK

SHTOJCA 9

GARANCIA E PËRMBUSHJES SË DETYRIMEVE TË SHOQËRISË SIPAS KËRKESËS

[Në letër me kokë të bankës]

Për:
Ministrinë e Ekonomisë të Qeverisë së Shqipërisë
Tiranë
Shqipëri
(Ministria e Ekonomisë)

dhe

Ministrinë e Transportit dhe Telekomunikacioneve të Republikës së Shqipërisë
Tiranë
Shqipëri
(Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve)

(Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve, bashkarisht, Organi Shtetëror i Autorizuar në emër dhe për llogari të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë)

[Vendi dhe Data]

Të Nderuar Zotërinj,

Garancia e Përmbushjes No. [●]

Për arsye se [emri shoqërisë] ("Shoqëria") ka hyrë në një Kontrate koncesioni me Qeverinë e Shqipërisë, të përfaqësuar nga Organi Shtetëror I Autorizuar ("Qeveria e Shqipërisë"), më [●] 2004

("Kontrate e Koncesionit") për dizenjimin, financimin, ndërtimin, administrimin dhe zhvillimin e Aeroportit Ndërkombëtarë "Nënë Tereza"-Tiranë, Republika e Shqipërisë, të përshkruar më tej në Kontraten e Koncesionit.

Për arsye se Marrëveshja e Koncesionit përmban një detyrim për Shoqërinë të paraqesë një Garanci në favour të Qeverisë së Shqipërisë në shumën tre (3) milionë Euro, Ne, [emri Bankës] ndërmarrim në mënyrë të pakthyeshme dhe të pakushtëzuar se më të marrë një njoftim me shkrim në të cilin, bazuar vetëm në gjykimin tuaj absolute Shoqëria:

(a) ka dështuar në plotësimin e Fazës A të Terminalit të Ri (sipas përkufizimit në Kontraten e Koncesionit) brenda afateve kohore dhe specifikimeve të përcaktuara në Kontraten e Koncesionit, ose

(b) ka braktisur projektin e ndërmarrë në bazë të Kontrates së Koncesionit, ose

(c) nuk ka aftësinë e duhur paguese,

do t'u paguajmë në një ose më shumë raste ose sipas udhëzimit tuaj shumat e kërkuara në njoftimin tuaj, të cilat nuk tejkalojnë shumën e tre (3) milionëve Euro (kur përllogariten me gjithë shumat e paguara mëparë).

Kjo Garanci do të jetë e vlefshme nga kjo datë në shumën e plotë të saj ,do me thënë [vendos shumën] dhe do të vazhdojë të jetë e vlefshme në lidhje me cdo njoftim me shkrim për ne siç është përshkruar mësipër dhe që nuk është dhënë më vonë se data që vjen pas përjetorit të parë (1) të Fazës A Data e Hapjes së Terminalit të Ri e arritur nga Shoqëria, datë e cila do të na komunikohet me shkrim nga Qeveria e Shqipërisë (data e mbarimit të vlefshmërise).

Kjo Garanci nuk do të jetë e vlefshme për ndonjë njoftim me shkrim të dhënë pas datës së mbarimit të afatit. Pas mbarimit të vlefshmërisë së Garancisë ajo duhet të na kthehet neve që ta anullojmë, por ne nuk do të mbajmë asnjë lloj përgjegjësie nëse shkelet kjo dispozitë dhe garancia nuk na është kthyer neve. Ky përjashtim nga përgjegjësia nuk do të përfshijë përgjegjësitë që lindin sipas Garancisë para datës së mbarimit të vlefshmërisë.

Çdo pagesë që ne duhet të bëjmë do të kryhet sa më parë dhe do të jetë e transferueshme lirisht në Euro, e çliruar nga ndonjë zbritje për efekte takse, tarife, bllokimi, pretendimi ose mbajtje në burim të çdo lloj natyre dhe nga kushdo qofshin vënë apo përçfarëdo arsye qofshin vënë.

Detyrimet tona sa më poshtë përbëjnë detyrime të drejtpërdrejta, të pakthyeshme dhe të pakushtëzuara, dhe nuk do të lejojnë krijimin e nevojës për njoftime të Shoqërisë dhe nuk do të ndalohen ose ndikohen negativisht nga ndonjë ndryshim i kushteve të Kontrates së Koncesionit të realizuara me marrëveshje mes jush dhe Shoqërisë ose në lidhje me natyrën e punimeve që do të kryhen sipas saj, dhe as nuk do të ndikohen detyrimet tona sipas Garancisë në asnjë kohë nga ndonjë lëshim i bërë Shoqërisë ose nga ndonjë mos-kërkim të drejtash, falje ose ndonjë veprim tjetër i papërmbushur ose i neglizhuar sipas Kontrates së Koncesionit ose nga ndonjë garanci tjetër e tanishme ose e mëpasshme që u jepet juve për ndonjë ose të gjitha detyrimet e Shoqërisë sipas Kontrates së Koncesionit, ose nga çlirimi ose anullimi i ndonjë garancie, ose nga pavlefshmëria ose pazbatueshmëria e Kontrates së Koncesionit, ose nga paaftësia paguese, falimentimi, shpërbërja ose ri-organizimi i Shoqërisë ose nga ndonjë mosmarrëveshje e çfarëdo lloji qoftë mes Shoqërisë dhe ju në lidhje më Kontraten e Koncesionit.

Kjo Garanci nuk është personale dhe mund t'ia transferoni ndonjë personi ose shoqërie tjetër me kusht që ju të na njoftoni me shkrim për një transferim të tillë.

Njoftimet në lidhje me këtë do të konsiderohen të dorëzuara në kohë kur (dorëzimi bëhet personalisht) ose 48 orë pasi të jetë dërguar me postë rekomande të parapaguar ose postë të rregjistruar (në rast letrash).

Kjo Garanci do të rregullohet nga Rregullat Standarte për Garancitë me Kërkesë, Botimi ICC nr. 458

Dispozitat e Nenit 20 (a) të Rregullave Standarte për Garancitë me Kërkesë, Botimi ICC nr. 458 nuk do të zbatohen për deklaratën e shkruar nga ju për ne siç u kërkua më sipër.

VULA
[emri bankës]
U vulos më _____
Në prani të:____

__ _____
Përfaqësuesi i Autorizuar

SHTOJCA 1 DERI 9
FORMA E CERTIFIKATËS

[Në letër me kokë të Qeverisë Shqiptare]

Për: [Emri dhe adresa e Bankës]

[Vendi dhe Data]

Të nderuar Zotërinj,

Garancia e Përmbushjes No. [●]
Termat e përkufizuar në Garanci kanë të njëjtin kuptim në këtë certifikatë.
U njoftojmë se Shoqëria nuk ka përmbushur detyrimet sipas Kontrates së Koncesionit në lidhje me [vendos të dhënat e mospërmbushjes nga ana e Shoqërisë duke marrë parasysh llojin e ngjarjes për të cilën është dhënë garancia që është dështimi në plotësimin e Fazës A të Terminalit të Ri brenda afatit kohor të zbatueshëm dhe në përputhje me specifikimet/ braktisja e projektit/ paaftësia paguese] dhe respektivisht bëjmë një kërkesë për pagesën e Garancisë në Euro [shuma e kërkuar].

Ministria e Ekonomisë

Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit

Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

SHTOJCA 10

LISTA E INSTITUCIONEVE FINANCIARE

Bankat Tregtare dhënëse të Garancisë së Përmbushjes sipas Kërkesës për Shoqërinë janë:
Alpha Bank;
Tirana Bank;
Banka e Kursimeve të Shqipërisë/Raiffaisen Bank
Emporiki Albania;
Banka Amerikane e Shqiperise
Cdo institucion tjeter financiar (shqiptar ose i huaj ose i perbashket) vlerësuara me A ose më shume nga ndonjë prej Standard & Poor's, Moody's Investors Service and Fitch në lidhje me huadhëniet e tyre afatgjata.

SHTOJCA 11

SIGURACIONI

Shoqëria do të sigurojë që policat e sigurimeve të specifikuara mëposhtë janë të marra dhe do të mbahen të vlefshme gjatë gjithë periudhës së Koncesionit në përputhje me Ligjet e Zbatueshme.

1. Policat e Sigurimeve që do të merren dhe do të mbahen të vlefshme nga Shoqëria do të jenë të zbatueshme për dizenjimin dhe ndërtimin e Projektit si dhe punimet, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tij për të gjitha veprimtaritë e parashikuara nga kjo Kontrate.

Polica e sigurimit në lidhje me Dizenjimin dhe Ndërtimin

Shoqëria do të sigurojë që mbulimi me policë sigurimi të specifikuar mëposhtë do të fillojë për të gjitha ambientet e reja në ndërtim si dhe punimet përmirësuese të ambienteve ekzistuese, nga data e fillimit të punimeve të ndërtimit dhe deri në dhënien e certifikatës së përfundimit nga Shoqëria.

a) Sigurimi për të gjitha rreziqet e Kontraktorit

b) Sigurimi për dëmet ndaj palëve të treta

Shoqëria do të sigurojë që Qeveria Shqiptare do të jetë i siguruari kryesor në të gjitha policat e sigurimit.

2. Sigurim për Punimet dhe Mirëmbajtjen

Shoqëria do të sigurojë që mbulimi me policë sigurimi të specifikuar mëposhtë të jetë i vlefshëm duke filluar nga data e fillimit dhe do të jetë i tillë për gjithë periudhën e Koncesionit:

a) Sigurimi për Dëmtimin e Pronës

b) Sigurimi për Ndërprerjen e Biznesit

c) Sigurim të zgjeruar kundër dëmeve të Pronarëve të Aeroportit dhe Operatorit.

Shoqëria do të sigurojë që (i) ne te gjitha policat e sigurimit Qeveria e Shqiperise do te permendet si i siguruari kryesor, dhe (ii) te ardhurat nga te gjitha policat e sigurimit do te paguhen ne nje llogari te vecante te Shoqerise, llogari e cila (duke perfshire diferencen) mund te jete objekt i Barres Siguruese te vendosur ne favor te Huadhenesit Kryesor

Shoqëria do t'i paraqesë Organit Shtetëror të Autorizuar para Datës së Fillimit hollësitë e të gjitha marrëveshjeve të sigurimit, duke përfshirë por pa u kufizuar në llojin e mbulimit, përjashtimet kryesore, shumat e mbulimit, palët e mbuluara dhe siguruesit.

Parashikimi i kostove vjetore për sigurimin e Shoqërisë në terma nominale në planin e biznesit në oferten reference 1 të ofruar, si më poshtë:

Vit i Periudhës së Koncesionit	Parashikimi i kostos së sigurimit vjetor EURO '000 (nominale)
1	819
2	900
3	937
4	959
5	981
6	1,030
7	1,064
8	1,090
9	1,115
10	1,140
11	1,166
12	1,193
13	1,220
14	1,253
15	1,287
16	1,316
17	1,347
18	1,376
19	1,406
20	1,436

Për sqarim, Organi Shtetëror i Autorizuar nuk detyrohet të kontribuojë për kostot e sigurimit të shoqerisë nëse kostoja e pranueshme e sigurimit të Shoqerisë sipas kësaj Kontrate dhe Ligjeve në fuqi në një vit të dhënë është më pak ose I barabartë me 125% të parashikimit për koston vjetore të sigurimit në tabelën e mësipërme.

SHTOJCA 12

INVESTITORI STRATEGJIK

Investitori Strategjik duhet të përmbushë këto kushte:

(a) ka pasur një xhiro mesatare vjetore prej të paktën 250 milion Euro në lidhje me veprimtaritë aeroportuale ndërkohë që ushtronte veprimtarinë në periudhën tre vjecare që përfundon

më 31 Dhjetor 2001 ose gjatë tre viteve të fundit kalendarike;

(b) ka përvojë në zbatimin e projekteve të infrastrukturës aeroportuale (ose me fushë të gjelbër ose në zhvillim) të kontraktuar për të paktën Euro 200 milion gjatë periudhës pesëvjecare që përfundon në 31 Dhjetor 2001 ose në pesë vitet e fundit kalendarike;

(c) zotëron (duke nënkuptuar pjesën e kapitalit me të drejtë të thjeshtë vote prej 15%) ose shfrytëzon një ose më shumë aeroporte me një trafik mesatar vjetor të pasagjerëve prej 10 milionë në vitet që i shfrytëzonte gjatë periudhës pesë vjecarë që përfundon në 31 Dhjetor 2001 ose gjatë pesë viteve më të fundit kalendarike, me kusht që nëse Investitori Strategjik zotëron (duke nënkuptuar pjesën e kapitalit me të drejtë të thjeshtë vote prej 15%) ose shfrytëzon një ose më shumë aeroporte, me trafik mesatar vjetor të pasagjerëve prej të paktën 5 milionë në vitet që i shfrytëzonte gjatë periudhës pesë vjecarë që përfundon në 31 Dhjetor 2001 ose gjatë pesë viteve më të fundit kalendarike;

(d) zotëron ose shfrytëzon një ose më shumë aeroporte me trafik mesatar vjetor të Kargos prej të paktën 20,000 tonë në vitet që i shfrytëzonte gjatë periudhës pesë vjecarë që përfundon në 31 Dhjetor 2001 ose gjatë pesë viteve më të fundit kalendarike; dhe

(e) zotëron (duke nënkuptuar pjesën e kapitalit me të drejtë të thjeshtë vote prej 15%) një ose më shumë aeroporte ose shoqëri aeroportuale të cilat zotërojnë leje të vlefshme akreditimi sipas ISO 9002-3 ose tjetër të ngjashme me ISO ose standatded kombëtare.

2. Investitori Strategjik duhet të jetë ose përbëhet nga persona juridikë në formën e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar ose të ngjashëm me të (të themeluar saktësisht në përputhje me ligjet e vendit ku janë të themeluar).

3. Investitori Strategjik duhet të jetë ose përbëhet nga persona juridikë të themeluar dhe rregjistruar me autoritetet përkatëse të vendit ku kanë selinë(të) e tyre.

4. Investitori Strategjik mund të jetë shoqëri ose konsorcium.

5. Në rastin e një konsorciumi të Investitorit Strategjik, anëtarët duhet të jenë shoqëri më përgjegjësi të kufizuar ose persona të ngjashëm juridik (në përputhje me ligjet e vendit ku janë themeluar).

SHTOJCA 13

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Ligj nr._____date

PËR MIRATIMIN E KONTRATES SË KONCESIONIT PËR NDËRTIMIN, VENIEN NE PUNE, OPERIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR "NËNË TËREZA",TIRANË, NDËRMJET KESHILLIT TE MINISTRAVE TE REPUBLIKES SE SHQIPERISE DHE SHOQERISE KONCESIONARE„ TIRANA AIRPORT PARTNERS„ SHPK DHE DHËNIEN E DISA STIMUJVE SHOQËRISË KONCESIONARE

Në mbështetje të Neneve 78 dhe 8 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Neneve 13 dhe 14 e Ligjit Nr. 7973, datë 26 Korrik 1995 "Për Koncesionet dhe Pjesëmarrjen e Sektorit Privat në Shërbimin Publik dhe Infrastrukturën", të propozimit të Këshillit të Ministrave, ne baze te vendimit te Keshillit te Ministrave "Per miratimin ne parim te akt-marreveshjes per dhenien ne konçesion te Aeroportit Nene Tereza" Nr 675 Date 14 Tetor 2004, Kuvendit i Republikës së Shqipërisë.

VENDOSI

Neni 1

Miratimin e Kontrates së Koncesionit për ndertimin, venien ne pune, operimin dhe mirembajtjen e Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza", Tiranë, lidhur më date 16 Tetor 2004, ndermjet Keshillit te Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministria e Ekonomisë dhe ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve, dhe shoqerise koncesonare "Tirana Airport Partner" Shpk, bashkengjitur.

Neni 2

Ministria e Ekonomisë dhe ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve, si Organi Shtetëror i Autorizuar prej saj, në mbështetje të legjislacionit në fuqi dhe kushteve të Kontrates së Koncesionit, ngarkohen me zbatimin e Kontrates së Koncesionit në emër dhe për llogari të Keshillit të Ministrave te Repuiblikës së Shqipërisë.

Neni 3

(1) Të gjitha makinerie ose materialet e ndryshme të importuara ose të blera në Republikën e Shqipërisë për dobi të Shoqërisë dhe në lidhje me pajisjen, ndertimin, administrimin e ndertimit ose përmirësimin e Terminalit Ekzistues, Sheshin e Terminalit Ekzistues dhe Aktivet Perkatese dhe Ndertimet e Reja, të përkufizuara në Kontraten e Koncesionit, gjatë periudhës së Ndertimit të Fazës A të Terminalit te Ri, te Fazës B të terminalit të Ri, Zgjatimit te Pistes dhe Rrugës së Re Hyrese, të përkufizuara në Kontraten e Koncesionit:

(j) përjashtohen nga të gjitha taksat doganore dhe taksat e importit të caktuara nga ligji nr 8449 datë 27 Janar 1999 " Per Kodin Doganor te Republikës së Shqipërisë", me ndryshimet perkatese; dhe

(ii) përjashtohen nga zbatimi i tatimit mbi vlerën e shtuar për importet që percaktohet ne ligjin nr. 7928, datë 27 Prill 1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", me ndryshimet perkatese.

(2) Shoqëria ka të drejtë të rimbursohet per TVSH e paguar prej Shoqërisë për mallra dhe shërbime të blera e te marra në Republikën e Shqipërisë gjatë periudhave të planifikuara për Ndertimin e Fazës A të Terminalit të Ri, Fazës B të Terminalit të Ri, të Zgjatimit te Pistes dhe Rrugës së Re Hyrese, sic përcaktohet në mënyrë më të hollesishme në pikën 37.15 (Përjashtimi nga Tatimet dhe Rimbursimi i Përshpejtuar i TVSH) të Kontrates së Koncesionit bashkengjitur.

Neni 4

Palet kontraktuese te njohin detyrimet e percaktuara ne nenin 11, pika 4 të ligjit nr. 7973, datë 26 korrik 1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë", i ndryshuar

Neni 5

Siç eshte percaktuar ne Kontraten e Koncesionit, projekti dhe te drejtat dhe privilegjet e dhena ne lidhje me te nuk do t'i nenshtrohen shpronesimit dhe/ose shtetezimit, duke perfshire, pa kufizim shpronesimin dhe/ose shtetezimin sipas ligjit nr. 8561, date 22.12.1999 te Republikes se Shqiperise "Per shpronesimin dhe marrjen ne perdorim te perkohshem te prones private per interesa publike", me perjashtim te rastit kur shpronesimi dhe/ose shtetezimi eshte i domosdoshem per mbrojtjen e interesave publike, si e drejte shpronesimi dhe/ose shtetezimi e dhene nga Kushtetuta e Republikes se Shqiperise dhe ligji nr. 8561, date 22 dhjetor 1999 "Per shpronesimet dhe marrjen e perkohshme te prones private per interesa pubike"

Neni 6

(a) Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve dhe ministria e Ekonomise, si Organi Shtetëror i Autorizuar, ngarkohen me detyrimin te ndihmojne shoqërinë ne dhenien e të drejtave,

autorizimeve dhe lejeve ne perputhje me pikën 2.5 (Autorizimet) të Kontrates së Koncesionit, me perjashtim te Autorizimeve te Dhena falas sipas Pikes 2.5, Shtojca 14 (Autorizimet e Dhena) te Kontrates se Koncesionit te cilat jepen falas me hyrjen ne fuqi te ketij ligji dhe ne përfitimin nga drejtat e uzufruktit dhe të drejtat e servitutit te kalimit në Zonën e Koncesionit të përcaktuar në Kontraten e Koncesionit, në zbatim të këtij ligji.

(b) Banka e Shqiperise ngarkohet me dhenien e miratimeve per hapjen e llogarive te shoqerise koncesionare jashte vendit si dhe dhenien e miratimeve per riatdhesimin e te ardhurave.

Neni 7

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit dhe ministria e Ekonomise, si Organ Shteteror i Autorizuar, autorizohen të negociojnë dhe te arrijne marreveshje me shoqerine koncesionare per ndryshimin e afateve dhe kushteve te Kontrates së Koncesionit, me kerkese te paleve te Kontrates se Konçesionit, por vetëm në qofte se ndryshimet e propozuara:

(1) u janë komunikuar si duhet, dhe janë diskutuar me të gjithë subjektet qeveritare përgjegjëse për ceshtjet e vecanta që propozohet të ndryshohen,

(2) janë në përputhje të plotë me ligjin Shqiptar në fuqi në kohën e arritjes se marreveshjes dhe me politikën publike Shqiptare dhe me interesat e brendshme dhe nderkombëtare dhe detyrimet që ekzistojne në atë kohë,

(3) nuk ndikojnë qenesisht dhe/ose negativisht në poziten financiare të Keshillit të Republikës së Shqipërisë sipas Kontratës së Koncesionit, dhe

(4) nuk ndikojnë qenësisht dhe/ose negativisht në kapacitetin e Aeroportit Ndërkombëtar Nënë Tereza-Tiranë për të përballuar pasagjerët dhë trafikun e kargos.

Ky Ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

SHTOJCA 14

AUTORIZIMET E DHENA

Autorizimet e Dhëna janë përcaktuar në Seksionin 1 të këtij Shtojce.

Disa prej Autorizimeve janë renditur në Seksionin 2 të kësaj Shtojce.

1. Autorizimet e Dhëna (Shoqërisë dhe Kontraktorëve te Shoqërisë, sipas rastit)

(A) Miratimi i Masterplanit Fillestar të Perditesuar nga Këshilli Kombëtar i Rregullimit të Territorit, duke përfshirë:

- Miratimin e truallit;
- lejen e ndërtimit;
- lejet të ndryshme (uji, energjia elektrike, telefonia, kanalizimet);
- hapja e puseve të ujit brënda Zonës së Koncesionit dhe, në qoftë se nuk është e mundur të bëhet brënda Zonës së Koncesionit, jashtë Zonës së Koncesionit, nëse është e nevojshme për zbatimin e projektit;
- prerja e pemëve; dhe
- leja e mjedisit.

(B) Miratimet për fillimin e punimeve të Fazës A të Punimeve të Ndërtimit pas marrjes së pëlqimit për kryerjen nga Inxhinieri i Pavarur (me përjashtim të Rrugës se Re Hyrese dhe Urës së Re), për aktivet dhe paisjet përkatëse, duke u bazuar në paraqitjen e rregullt të raporteve të përshtatshme të paraqitura nga nga Inxhinieri i Pavarur:

- instalimet kundra zjarrit brenda dhe rreth zonës së Konçesionit (nga Ministria e Pushtetit Lokal)
- instalimet e telekomunikacioneve dhe frekuencave të Komunikimeve me Radio (nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve)
- akt-kolaudimi i ndërtimit (nga një ekspert i licensuar, dhe të miratohet dhe nga Këshilli

Kombëtar i Rregullimit të Territorit)

(C) Lejet për shfrytëzimin e aeroportit (nga DPAC) duke përfshirë lejet, autorizimet ose miratimet e mëposhtme:

- licencat operacionale te aeroportit te bazuara ne Manualin Ekzistues te Aerodromit dhe manuale te tjera duke perfshire dhe Manualin Operacional sipas Pikes 3.1 (h);

- autorizimi për sigurinë dhe masat e sigurimit (duke përfshirë të gjitha certifikatat përkatëse);

- autorizimi për instalimin dhe përdorimin e sistemit të mbikqyrjes CCTV ;

- përditësim i rregullt i Manualit të Aerodromit dhe manualeve të tjera të kërkuara në intervale pesë vjeçare, ose në intervale sipas kërkesave të arsyeshme të Shoqërisë, azhornimi i parë të ndodhë menjëherë pas Datës së Hapjes së Fazës A të Terminalit të Ri;

Çertifikimi i paisjeve (në masën që është nën autoritetin e DPAC)

(D).Sistemet dhe Instalimet

- miratimi projekteve të sistemeve të interkoneksionit , sinjalizimit navigacional si dhe instalime të tjera teknike në lidhje vetëm me veprimtarinë e aeroportit (nga Agjensia Ndërkombëtare e Trafikut Ajror)

(E) Telekomunikacionet

Çertifikimi i paisjeve (nga Enti Rregullator i Telekomunikacioneve, Departamenti i Çertifikimit të Paisjeve, për aq sa është në kompetencat e këtij institucioni)

Të gjitha Autorizimet e Dhëna do të jenë falas për Shoqërinë.

Shoqëria do t'i paguajë DPAC një tarifë prej Euro 50,000 për vit (të përllogaritur për pjesë të vitit) në lidhje me procesimin e çështjeve rregullatore dhe të ruajë të vlefshme Autorizimet e Dhëna të rradhitura në 1 (C) më sipër, në Datën e Fillimit dhe në çdo 1 Janar në vijim gjatë Periudhës së Koncesionit, dhe e indeksuar në rradhë me Pagesat e Aerportit. Kjo Tarifë do të paguhet në [Emri Llogarisë, Numri Llogarisë dhe Banka] ose ndonjë llogari tjetër që DPAC mund të specifikojë herë pas here.

Nëse Shoqëria do të transferojë ndonjë nga veprimtaritë e parashikuara në këtë Kontrate (sipas kësaj Kontrate, Ligjit të Zbatueshëm dhe Konventave) palëve të treta, nuk do të ekzistojnë Pagesa të pagueshme nga palët e treta në lidhje me Autorizimet e Dhëna të rradhitura në Pikat (A)-(F) të këtij Shtojcai.

2. Autorizimet për përdorues të tjerë të Aeroportit ose veprimtari të tjera të Shoqërisë

Shoqëriamund të kontraktojë palë të treta për dhënien e shërbimeve në këtë paragraf 2 të kësaj Shtojce 14 (Autorizimet e Dhëna) në përputhje më këtë Kontrate, Ligjin e Zbatueshëm dhe Konventat, me kusht qe keto pale te mos veprojne ne kundershtim me kërkesat e përcaktuara në këtë Kontrate, Ligjin e Zbatueshëm, dhe nëse janë të zbatueshme, me Konventat.

(A). Liçensa për shoqëritë ajore ose veprimtari të tjera në Terminalin Ekzistues dhe, me t'u hapur, në Terminalin e Ri duke përfshirë por jo vetëm :

Autorizimi për uljen dhe ngritjen e Avionëve civil.

Autorizimi për operatorët e shoqërive ajrore të cilët transportojnë armë në ambiente të siguruara të bordit të avionëtit.

Liçensa e specializuar për pilotët dhe personelin tjetër që punon në bordin e avionit.

Autorizimet e dhëna për pilotët duke i lejuar ata të marrin të gjitha masat e sigurisë dhë rendit në bordin e avionëtit në raste të jashtëzakonshme.

Çertifikata e cilësisë së avionit

autorizimi për avionëtët që të kryejnë prova, vëzhgime dhe fluturime teknike pa ndonjë çertifikatë të cilësisë së rrugës ajrore.

Autorizimi për automjetet e qeverisë të qarkullojnë në Zonën e Koncesionit.

Equivalentimi i liçensave të marra nga personeli shqiptar në ato vende me të cilat Autoritetet Aeronautike kanë një Kontrate dhe

Shërbimet postare

(nga DPAC)

(B) Miratimi i Statusit të VIP (nga Këshilli i Ministrave)

(C) Duty Free Shops (nga Ministria e Financave)

(D) Liçensa për Hoteleri (nga Ministria e Turizmit dhe e Rregullimit të Territorit)

(E) Reklamat (nga Pushteti Vendor Përkatës ose Bashkitë)

(F) Makina me qira (nga Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit)
(G) Leja e higjenës dhe leje të tjera në lidhje me ruajtjen dhe procesimin e ushqimit. (nga Ministria e Shëndetsisë/Inspektoriati i Higjenës)
(H) Depozitat e karburantit (nga Ministria e Industrisë dhe Energjisë)
(I) veprimet bankare dhe këmbimi valutor (nga Banka e Shqipërisë)

SHTOJCA 15

ZONA E KONÇESIONIT

Zona e Konçesionit përfshin çertifikata të rregjistruara Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Krujë dhe Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë:

i) Zona Kadastrale no. 3096, Volumi 6, faqe157 pasuria no. 11/82, e ndodhur në Qereke, Krujë, datë 04.06.2003;

ii) Zona Kadastrale no. 3096, Volumi 6, faqe159, pasuria no. 11/84, e ndodhur në Qereke, Krujë, datë 14.06.2001

iii) Zona Kadastrale no. 3096, Volumi 6, faqe161, pasuria no. 11/86, e ndodhur në Qereke, Krujë, datë 04.06.2003;

iv) Zona Kadastrale no. 3096, Volumi 1, faqe71, pasuria no. 33/7, e ndodhur në Qereke, Krujë, datë 16.06.2001;

v) Zona Kadastrale no. 3183, Volumi 3, faqe125, pasuria no. 53/2, e ndodhur në Qereke, Krujë, datë 14.06.2001;

vi) Zona Kadastrale no. 3183, Volumi 4, faqe31, pasuria no. 146/15, e ndodhur në Rinas, Krujë, datë 27.02.2004;

vii) Zona Kadastrale no. 3096, Volumi 7, faqe74, pasuria no.172/1, e ndodhur në Qereke, Krujë, datë 14.06.2001;

viii) Zona Kadastrale no. 3183, Volumi 3, faqe208, pasuria no. 201/1, e ndodhur në Rinas, Krujë, datë 14.06.2001;

ix) Zona Kadastrale no. 3096, Volumi 7, faqe53 , pasuria no. 227/49, e ndodhur në Qereke, Krujë, datë 14.06.2001;

x) Zona Kadastrale no. 3096, Volumi 7, faqe73, pasuria no. 247/3, e ndodhur në Qereke, Krujë, datë 14.06.2001;

xi) Rregjistri Hipotekor no. 142, datë 28.05.2001, Instituti Zoo-Teknik, e ndodhur në Tiranë, datë 25.10.2001; dhe

xii) Vertetime shtese te gjithe shpronesimeve te tjera te pranuara ne process e siper te cilat do i shtohen listes nga Organi Shteteror i Autorizuar jo me vone se 15 dite pas Dates Efektive.

Për sqarim, ndërtesa e tanishme e administratës së “Nënë Tereza” SH.A në qendër të Tiranës e rregjistruar në rregjistrin hipotekor nr. 50, datë 4 Mars 2002, Zona Kadastrale nr. 8350 nuk do të jetë pjesë e Zonës së Konçesionit.

Këto 12 zona tregohen si një zonë e bashkuar që është e përvijuar me vijë të kuqe në Planin 1 të bashkëngjitur këtij Aneksi 15 (Zona e Koncesionit).

SHTOJCA 16

PROJEKTI TEKNIK I MIRATUAR

Projekti Teknik i Miratuar përfshin pa kufizim sa më poshtë:

Të Përgjithshme

Një plan i përgjithshëm i Aeroportit, duke përfshirë Terminalin e Ri (Fazat A dhe B), rrugët, kullën e re të kontrollit të trafikut ajror: Skicat A/001-Rev02 dhe B/001-Rev02

Skica e shfrytëzimit të tokës: Skicat A/002-Rev01 dhe B/002-Rev01

Një plan i përgjithshëm i zonës së terminalit (ndërtesa dhe vendqëndrimi avionëve), duke përfshirë Fazat A dhe B të Terminalit të Ri: Skicat A/001-Rev02 dhe B/001-Rev02

Planet e Ndërtesës së Terminalit të Ri (Fazat A dhe B), duke treguar madhësinë e secilës zonë veças : Skicat A/003-Rev 03 dhe A/004-Rev02 dhe B/003-Rev 03 dhe B/004-Rev02

Ngritjet (ajrore dhe tokësore) dhe ndërthurjet e Terminalit të Ri (Fazat A dhe B)

Skicat A/005-Rev02 dhe A/006-Rev02 dhe A/007-Rev02 dhe B/005-Rev02 dhe B/006-Rev 02 dhe B/007-Rev02

Përshkrimi i mënyrës së ndriçimit dhe specifikimi i llojit të ndriçimit për Terminalin e Ri dhe të gjitha zyrat e ambientet publike : Skicat A/008-Rev02 dhe A/009-Rev02

Perspektiva e Ndërtimit të Terminalit të Ri (Fazat A dhe B) : Skicat A/005-Rev02 dhe A/006-Rev02 dhe A/007-Rev02 dhe B/005-Rev02 dhe B/006-Rev02 dhe B/007-Rev02

Qendra e Re e Kargos (Fazat A dhe B) ngritjet / perspektiva : Skicat A/010-Rev02 dhe A/011-Rev02

Diagramet e trafikut të Pasagjerëve në Terminalin e Ri (Fazat A dhe B) : Skicat A/012-Rev01 dhe B/008-Rev01

Plani i qarkullimit të trafikut në aeroport, qe tregon kapacitetin dhe specifikimet e rrugëve dhe drejtimin e taksive, autobusëve, të vënë në dispozicion të pasagjerëve që largohen dhe parkingun për makinat e pasagjerëve dhe të personelit të aeroportit. Kjo dëshmon për ndarjen e rrugëve ajrore dhe tokësore, si dhe masat e sigurisë në kombinimin e të dyjave. Ky plan gjithashtu tregon se si do të lejohet qarkullimi në secilën fazë për ANTA, ushtrinë dhe banorët vendas (jashtë Zonës së Koncesionit).

Skica A/013-Rev01

Koncepti Tregues i përdorimit të Terminalit Ekzistues:Skica A/014-Rev01

SHTOJCA 17

KODET, STANDARDET, RREGULLORET DHE BOTIME TË TJERA

1.KODET DHE STANDARDET - TOKËSORE

Të gjitha punimet të kryera nga shoqëria në zonën e koncesionit, dhe gjithashtu duke përfshirë rrugën e re lidhëse dhe urën e re, do të bazohen në një ose më shumë nga kodet që vijojnë:

i) Instituti Amerikan i Standardeve Kombëtare (ANSI)
ii) Instituti Amerikan i Naftës (API)
iii) Shoqata Amerikane e Inxhinierëve Mekanikë (ASME)
iv) Shoqata Amerikane për Materialet Testuese (ASTM)
v) Shoqata Amerikane e Saldimit (AËS)
vi) Standardet e Korporatës British Gas (GBE)
vii) Instituti Britanik i Standardeve (BSI)
viii) Kërkimet e Rrjetit të British Telecom (BTNR)
ix) Instituti Gjerman i Standardeve (DIN)

x) Instituti Evropian i Standardeve të Telekomunikacioneve (ETSI)
xi) Standardet Evropiane (EN)
xii) Instituti i Inxhinierëve Elektrikë dhe Elektronikë (IEEE)
xiii) Shoqata Amerikane e Instrumentave (ISA)
xiv) Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO)
xv) Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve Union (ITU)
xvi) Shoqata Kombëtare e Inxhinierëve të Korrozionit (NACE)
xvii) Shoqata Kombëtare e Prodhuesve të Paisjeve Elektrike (NEMA); dhe
xviii) Instituti i Saldimit (TËI)
(xviii) CEN dhe CENELEC.

2. Rregulloret shqiptare

Të gjitha punimet të kryera nga shoqëria në zonën e koncesionit, dhe gjithashtu duke përfshirë rrugën e re lidhëse dhe urën e re, do të bazohen në një ose më shumë nga ligjet, rregullat dhe normativat e autoriteteve shqiptare në vijim:

i) Parlamenti
ii) Këshilli Ministrave
iii) Ministria e Rregullimit te Territorit dhe Turizmit
iv) Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
v) Ministria e Mjedisit
vi) Bashkitë përkatëse; dhe
vii) Organe të tjera përkatëse

3. Standardet e ICAO-s dhe Praktikat e Rekomanduara - Aerodromi

Shoqëria do të sigurojë planifikimin, dizenjimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës ajrore dhe paisjeve të aeroportit në përputhje me standardet ICAO-s dhe praktikat e rekomanduara, duke përfshirë, por pa u kufizuar në ato mëposhtë:

ICAO Aneksi 10 - Volumi I deri V
ICAO Shtojca 12 - Kërkimi dhe shpëtimi
ICAO Aneksi 14 - Volumi 1: Projekti i Aerodromit dhe Operimi
- Volumi 2: Heliportet
ICAO Aneksi 15 - Shërbimet e Informacionit Aeronautik, Standardet Ndërkombëtare dhe Praktikat e Rekomanduara
ICAO Aneksi 16 - Mbrojtja e Mjedisit
- Volumi I: Zhurma e Avionëve
- Volumi II: Gazrat e Motorëve të Avionëve
ICAO Aneksi 17 - Siguria: Mbrojtja e Aviacionit Civil Nërkombëtar kundër ndërhyrjeve të paligjshme

Manualët e planifikimit të aeroportit
9184-An/902 Pjesa 1: Plani Kryesorë
9184-AN/902 Pjesa 2: Shfrytëzimi Tokës dhe Kontrolli i Mjedisit
9184-AN/902 Pjesa 3: Udhëzime për Konsulentët / Shërbimet e Ndërtimit
Manualët e dizenjove të aerodromeve
9157-AN/901 Pjesa 1: Pistat
9157-AN/901 Pjesa 2: Korsitë, Vendqëndrimi Avionëve Dhe Gjiret Strehuese
9157-AN/901 Pjesa 3: Sipërfaqet
9157-AN/901 Pjesa 4: Mjetet Pamore
9157-AN/901 Pjesa 5: Sistemet Elektrike
Manualët e shërbimit të aeroportit
9137-AN/898 Pjesa 1: Shpëtimi dhe Zjarrrfikësit
9137-AN/898 Pjesa 2: Kushtet e Shtrimit të Sipërfaqes
9137-AN/898 Pjesa 3: Largimi dhe Kontrolli i Shpendëve
9137-AN/898 Pjesa 4: Shpërhapja eMjegullës
9137-AN/898 Pjesa 5: Largimi i Avionëve me Difekt
9137-AN/898 Pjesa 6: Kontrollimi I Pengesave
9137-AN/898 Pjesa 7: Plani i Urgjencave të Aeroportit

9137-AN/898 Pjesa 8: Shërbimi Operacional I Aeroportit
9137-AN/898 Pjesa 9: Praktikat e Mirëmbajtjes së Aeroportit
Çertifikimi
9774-An/969 Manuali I Çertifikimit të Aeroportit

Qarkoret këshilluese të aviacionit federal

AC 150/5200-31a	Plani i Urgjencave të Aeroportit
AC 150/5200-32	Njoftimi I Pranisë: Përplasje Më Shpendë/ Incident/Raport I Hyrjes
AC 150/5200-33	Tërheqës Të Kafshëve Të Egra Të Rrezikshme Në Ose Përreth Aeroportit
AC 150/5210-2a	Shërbimet Dhe Paisjet Për Urgjencat Mjeksore Në Aeroport
AC 150/5210-5b	Boja, Shënimi, Dhe Ndriçimi I Automjeteve Të Përdorura Në Aeroport
AC 150/5210-6c	Paisjet Shuarse, Të Shpëtimit Dhe Kundra Zjarrit Në Avionëtë
AC 150/5210-7c	Komunikimet Për Shuarjen E Zjarreve Dhe Shpëtimin E Avionëve
AC 150/5210-13a	Paisjet, Dhe Planet E Shpëtimit Me Ujë
AC 150/5210-14a	Zjarret n Aeroport dhe Rrobat Mbrojtëse Të Personelit Të Shpëtimit
AC 150/5210-15	Projekti I Ndërtimit Të Stacionit Të Zjarrfikësve Dhe Shpëtimit I Aeroportit
AC 150/5210-17	Programet Për Pregatitjen E Personelit Të Shpëtimit Të Avionëve Dhe Zjarrfikësve
AC 150/5210-18	Sistemet Për Pregatitjen Interaktive Të Personelit Të Aeroportit
AC 150/5210-19	Sistemet E Përparuara Të Vëzhgimit Për Pilotët (DEVS)
AC 150/5220-4b	Sistemet E Ujit Për Mbrojtjen E Avionëve Nga Zjarri
AC 150/5220-10c	Specifikimi Udhëzues Për Shpëtimin E Avionëve Me Ujë/Shkumë Dhe Automjetet Zjarrfikëse
AC 150/5220-13b	Specifikime Udhëzuese Për Sensorin E Situatës Së Sipërfaqes Së Pistës
AC 150/5220-16c	Sistemet Automatike Të Vëzhgimit Të Kohës (AËOS) Për Formatet Jo-Federale
AC 150/5220-17a	Standardet E Dizenjos Për Shpëtimin E Avionëve Dhe Paisjet E Pregatitjes Së Zjarrfikësve
AC 150/5220-18	Ndërtesat Për Ruajtjen Dhe Mirëmbajtjen E Paisjeve Dhe Materialeve Kundër Borës Dhe Akullit Aeroport
AC 150/5220-19	Specifikime Udhëzuese Për Avionëtët E Vegjël Të Shpëtimit Dhe Automjetet E Zjarrfikësve
AC 150/220-20	Paisjet E Kontrollit Të Borës Dhe Akullit Në Aeroport
AC 150/5220-21b	Specifikime Udhëzuese Për Paisjet Që Ndihmojnë Në Hyrjen E Pasagjerëve Me Të Meta Në Lëvizje Në Bordine E Avionëtit.
AC 150/5220-22	Sistemet E Ndalimit Të Paisjeve Inxhinierike (EMAS) Për Avionëtët Jashtë Kontrollit
AC 150/5230-4	Depoziatat E Karburantit Për Avionëtët, Administrimi, Dhe Shpërndarja Në Aeroporte (Materiali I Përmbledhur I Shtypur Përfshin Ndryshimet 1 Dhe 2)
AC 150/5300-7b	Rregullorja E FAA Për Transferimin E Nevojshëm Të Paisjeve Në Raste Të Ndryshimeve Ose Riparimeve Të Aeroportit
AC 150/5300-9a	Konferencat Për Projektet Aeroportuale Para-Dizenjmit, Ofertimit Dhe Ndërtimit
AC 150/5300-13	Projekti i Aeroportit (Materiali I Përmbledhur I Shtypur Përfshin Ndryshimet 1 Deri 5)
AC 150/5300-14	Projekti i Paisjeve Për Heqjen E Akullit Nga Avionëtët
AC 150/5320-5b	Sistemi Kullimit Të Aeroportit
AC 150/5320-6d	Projekti Dhe Përllogaritja E Sipërfaqeve Të Aeroportit

AC 150/5320-12c	Matja, Ndërtimi, Dhe Mirëmbajtja E Shtresave Të Sipërfaqeve Rezistente Ndaj Uljes Së Avionëtit Në Aeroport
AC 150/5320-14	Organizimi i Aeroportit Me Qëllim Kontrollin E Zhurmave
AC 150/5320-15	Adminstrimi I Mbetjeve Industriale Të Aeroportit
AC 150/5320-16	Projekti i Sipërfaqes Së Aeroportit Për Avionët Boeing 777
AC 150/5325-4a	Gjatësia E Nevojshme E Pistës Për Projektin E Aeroportit
AC 150/5335-5	Metoda E Standartizuar E Raportimit Të Fortësisë Së Sipërfaqeve Të Aeroportit Pcn
AC 150/5340-1h	Standardet Për Shënimin E Aeroporteve
AC 150/5340-4c	Detajet E Instalimit Të Sistemeve Të Ndriçimit Për Zonën E Uljes Së Avionëve Në Mesin E Pistës (Materiali i Përmbledhur i Shtypur Përfshin Ndryshimet 1 Dhe 2)
AC 150/5340-5b	Sistemi i Shënimit Të Aeroportit Me Rreth Të Ndërprerë (Materiali i Përmbledhur i Shtypur Përfshin Ndryshimin 1)
AC 150/5340-14b	Mjetet Ndriçuese Nga Perspektiva Ekonomike (Materiali i Përmbledhur i Shtypur Përfshin Ndryshimin 3)
AC 150/5340-17b	Energjia E Gatshme Për Shfrytëzim Për Sistemet Ndriçuese Të Aeroportit Jo-FAA
AC 150/5340-18c	Standardet Për Sistemet E Sinjalizimit Në Aeroporte (Materiali I Përmbledhur i Shtypur Përfshin Ndryshimin 1)
AC 150/5340-21	Mjetet Pamore Ndriçuese Të Ndryshme Të Aeroportit
AC 150/5340-23b	Hinkat Shtesë Të Erës
AC 150/5340-24	Sistemi Ndriçues i Qosheve Të Pistës Dhe Korsive (Materiali I Përmbledhur i Shtypur Përfshin Ndryshimin 1)
AC 150/5340-26	Mirëmbajtja E Paisjeve Pamore Ndihmëse Në Aeroport
AC 150/5340-27a	Kontrolli Me Radio Ajër-Tokë i Sistemit Ndriçues Të Aeroportit
AC 150/5340-28	Korsia Me Pamshmëri Të Ulët
AC 150/5340-29	Hollësitë E Instalimit Për Sistemet Ndriçuese Në Tokë
AC 150/5345-1v	Paisjet E Miratuara Të Aeroportit
AC 150/5345-3e	Specifikimet Për Kontrollin E Paneleve Të Ndriçimit Të Aeroportit L-821
AC 150/5345-5a	Çelësi Ndërprerës i Rrjetit
AC 150/5345-7d	Specifikimet Për Kabllin Elektrik Nëntokësor Për Qarqet e Ndriçimit Të Aeroportit L-824 (Materiali i Përmbledhur i Shtypur Përfshin Ndryshimin 1)
AC 150/5345-10e	Specifikimet për monitorët e regullatorit të rregullatorëve të rrymës konstante
AC 150/5345-12c	Specifikimet për faret e aeroportëve dhe heliportëve
AC 150/5345-13a	Specifikimet për rrelenë shtesë të kabinetit qëndror të kontrollit nga piloti të qarqeve të ndriçimit të aeroportit l-841
AC 150/5345-26c	Specifikimet për prizat dhe spinat, dhe bashkuesit e kabllove l-823
AC 150/5345-27c	Specifikimet për montimin e hinkave të erës
AC 150/5345-28d	Sistemet e treguesit të metodës së precizionit (papi) (materiali i përmbledhur i shtypur përfshin ndryshimin 1)
AC 150/5345-39b	Specifikimet faa për reflektorët e dritës në vijën e mesit të pistës dhe korsive markers l-853 (materiali i përmbledhur i shtypur përfshin ndryshimin 1)
AC 150/5345-42c	Specifikimet për bazat e ndriçimit të aeroportit, kutive të transformatorëve, kutive nyje dhe aksesorëve (materiali i përmbledhur i shtypur përfshin ndryshimin 1)
AC150/5345-43e	Specifikimet për paisjet e ndriçimit të pengesave
AC 150/5345-44f	Specifikimet për sinjalizimet në pistë dhe korsi (materiali i përmbledhur i shtypur përfshin ndryshimin 1)

AC 150/5345-45a	Struktuar e ndriçimit për metodën e lehtë
AC 150/5345-46b	Specifikimet për instalimet e ndriçimit të pistës dhe korsive
AC 150/5345-47a	Izolimi i transformatorëve për sistemet ndriçimit të aeroportit
AC 150/5345-49a	Specifikimet për paisjet e kontrollit me radio l-854
AC 150/5345-50	Specifikimet për ndriçimin e lëvizshëm të pistës (materiali i përmbledhur i shtypur përfshin ndryshimin 1)
AC 150/5345-51	Specifikimet për paisjet ndriçuese me një përdorim (materiali i përmbledhur i shtypur përfshin ndryshimin 1)
AC 150/5345-52	Indikatorët e përgjithshëm pamorë për rëniet e lira më avionët (gvgi)
AC 150/5345-53b	Programi i çertifikimit të paisjeve të ndriçimit të aeroportit
AC 150/5360-9	Planifikimi dhe dizenjimi i paisjeve të terminalit të aeroportit në vendodhje jo-lidhëse
AC 150/5360-11	Ruajtja e energjisë për ndërtesat e aeroportit
AC 150/5360-12b	Shenjat dhe grafikat e aeroportit
AC 150/5360-13	Udhëzimet për planifikimin dhe dizenjimin e paisjeve të terminalit të aeroportit (materiali i përmbledhur i shtypur përfshin ndryshimin 1)
AC 150/5360-14	Hyrja në aeroport e individëve me të meta fizike
AC 150/5370-2c	Siguria operacionale gjatë punimeve të ndërtimit në aeroport
AC 150/5370-6b	Zhvillimi ndërtimit dhe raporti i inspektimit – programi i grantit të aeroportit
AC 150/5370-12	Kontrolli cilësisë së ndërtimit për projektet e grantit të aeroportit
AC 150/5370-13	Ndërtimi i sipërfaqeve të aeroportit duke përdorur asfalt të nxehtë
AC 150/5370-14	Manuali i shtrimit më asfalt të nxehtë të përzier
AC 150/5380-5b	Rreziqet nga mbeturinat e rrënojave në aeroportet civile
AC 150/5380-6	Udhëzimet dhe procedurat për mirëmbajtjen e sipërfaqeve të aeroportit
AC 150/5380-7	Sistemi administrimit të sipërfaqeve të shtruara
AC 150/5390-2a	Projekti i heliporteve
AC 170-6c	Përdorimi i radionavigacionit dhe stacioneve tokësore të testimit dhe prodhuesve të sinjaleve
AC 170-9	Kriteri për njohjen e pronësisë dhe shërbimit të sistemeve dhe paisjeve të kontrollit ajror dhe interesave navigacionale të aviacionit civil.
AC 170-11	Ndryshimet e rregullores federale të aviacionit pjesa 171 (far 171) kostoja e fluturimit dhe inspektimet në tokë
AC 170-14	Vënia në funksionim i kanaleve 50 khz/y për ils/dvor/dme
AC 210-5b	Veprimtaritë fluturuese ushtarake
AC 211-2	Standardet e rekomanduara për hartat aeronautike ifr
AC 413-1	Procedurat për aplikim për licensë

SHTOJCA 18

MASTERPLANI DHE PLANI I NDËRTIMEVE

1. Masterplani i Përditësuar i Aeroportit

Shoqëria do të sigurojë dhe paraqesë një përditësim të Planit Kryesor Ekzistues të Aeroportit ("Masterplani i Përditësuar i Aeroportit") Njësisë së Zbatimit të Projektit për miratim. Masterplani i Përditësuar i Aeroportit do të përfshijë hollësitë e mëposhtme:

i) Një plan kryesorë afatgjatë dhe një plan zonimi duke përfshirë vendosjen e qendrave të funksionimit të ANTA, duke treguar natyrën e thelluar të zhvillimeve dhe të shfrytëzimit të tokës brenda dhe jashtë Aeroportit; dhe

ii) Fazat e zhvillimit, duke përfshirë treguesit e shkallës dhe vazhdimësisë së propozuar dhe

zhvillimit provizional strategjik të Aeroportit.

Masterplani i Përditësuar i Aeroportit do të përfshijë hollësitë e mëposhtme, në përputhje me Detyrimet Kryesore dhe Detyrimet Shtesë në këtë Kontrate:

i) Parashikimet e trafikut; pasagjerët dhe avionët dhe parashikimet për tonazhet e kargos, duke përfshirë periudhën e ngarkuar dhe diagramet (së bashku, "Kërkesat e Parashikuara të Trafikut Ajror");

ii) kushtet për pronësimin e tokës

iii) skicat e elementëve ajrorë, pista, rrugët lidhëse dhe vendqëndrimi avionëve;

iv) plani i zonës së terminalit, terminali dhe skicat e elementëve tokësorë;

v) infrastruktura mbështetëse; karburanti, zjarri dhe shpëtimi, nënstacionet,;

vi) qendra e kargos;

vii) Ndërtesa e Administatës së Aeroportit;

viii) Mjetet e navigimit ajror, duke u bazuar në të dhënat e marra nga ANTA, telekomunikacionet dhe ndriçimi;

ix) siguria; dhe

x) Rruga e re Lidhëse, rruga perimetër dhe rrugët e fushës ajrore.

Masterplani i Përditësuar i Aeroportit do të përfshijë një program zhvillimi me faza për Aeroportin që të plotësojë Kërkesat e Parashikuara të Trafikut Ajror gjatë periudhës së Koncesionit në përputhje me këtë Kontrate.

Masterplani i Përditësuar i Aeroportit do të përfshijë Zonën e Ndaluar për të mundësuar funksionimin e Aeroportit dhe përmbushje të Detyrimeve të kësaj Kontrate.

Shoqëria do të përcaktojë vendndodhjen e impiantit të trajtimit të ujrave të zeza në Masterplanin e Përditësuar të Aeroportit.

Masterplani i Përditësuar i Aeroportit do të përmbajë një studim për gjatësinë e pistës. Studimi do të analizojë veprimtarinë aeroportuale të tanishme dhe të ardhshme, dhe do të vlerësojë cilat janë kufizimet që ekzistojnë për momentin dhe cilat janë kushtet e nevojshme për të lehtësuar si rrugët e reja dhe shërbimet ose përmirësime të pagesave për shërbimet ekzistuese të cilat mund të arrihen nëpërmjet Zgjerimit të Pistës. Studimi gjithashtu do të analizojë dhe raportojë mbi çështjet inxhinierike paraprake dhe kostot paraprake që shoqërojnë punime të tilla.

Studimi do të specifikojë tokën e nevojshme për zgjerimin e Pistës dhe pronarët aktualë të saj.

2. Dorëzimi i Planit Kryesor te Perditesuar të Aeroportit Njësisë së Zbatimit të Projektit

Masterplani i Përditësuar i Aeroportit do të përfundohet dhe dorëzohet Njësisë së Zbatimit të Projektit për miratim Brenda katër muajve nga Data e Fillimit.

Masterplani i Përditësuar i Aeroportit do të miratohet (miratimi nuk do të pengohet pa arsye) nga Këshilli Kombëtarë i Rregullimit të Territorit brenda dy muajve nga e dorëzimit. Nëse miratimi nuk jepet brenda afatit dy-mujor, Masterplani i Përditësuar i Aeroportit konsiderohet si i miratuar përderisa Këshilli Kombëtarë i Rregullimit të Territorit nuk kundërshton me shkrim Masterplani i Përditësuar i Aeroportit me pretendime të thelbësore.

Shoqëria do të pregatisë azhornime periodike të Masterplani i Përditësuar i Aeroportit një herë në pesë vjet dhe do t'i dorëzojë për miratim në të njëjtën mënyrë si dhe për Masterplanin e Përditësuar të Aeroportit.

3. Veprimtaritë të jenë në përputhje me Masterplanin e Përditësuar tëAeroportit

Shoqëria do të zhvillojë dhe vërë në funksionim Aeroportin gjatë periudhës së Koncesionit në përputhje me Masterplanin e Përditësuar të Aeroportit të miratuar nga Njësia e Zbatimit të Projektit në varësi të dispozitave të kësaj Kontrate.

SHTOJCA 19

FAZA A E TERMINALIT TË RI

1. Faza A e Terminalit të Ri

Shoqëria do të ndërtojë dhe mbajë në funksionim, në varësi të kushteve të arsyeshme të mirëmbajtjes, ndërtesën e Fazës A të Terminalit të Ri në përputhje me Projektin Teknik të Miratuar i përshkruar në Shtojcën 16 (Projekti Teknik i Miratuar)

Shoqëria do të sigurojë që Faza A e Terminalit të Ri pas Datës së Hapjes së Fazës A të Terminalit të Ri dhe para Datës së Hapjes së Fazës B të Terminalit të Ri, të përballojë të paktën 1.0 million pasagjerë në vit, dhe barazvlerën e 500 pasagjerësh per orë sipas Standartit të Nivelit të Ngarkuar ("SBR") ose barazvlerën e trafikut të njëanshëm (500 mbërritje dhe 500 largime).

Shoqëria do të sigurojë që paisjet e nevojshme për Fazën A të Terminalit të Ri do të jenë të përshtatshme për të përballuar nivelet e mëposhtme të trafikut të pasagjerëve pas Datës së Hapjes së Fazës A të Terminalit të Ri në përputhje me Standardet:

	Nga Data e Hapjes së Fazës A të Terminalit të Ri	Katër vjet pas Datës së Hapjes së Fazës A të Terminalit të Ri
Numri i pasagjerëve në vit	850,000	1,000,000
SBR numri i pasagjerëve për orë (trafik me një drejtim)	438	500

Shoqëria do të sigurojë që Fazën A të Terminalit të Ri, do të mbahet një minimum IATA i nivelit të Shërbimit C, në lidhje më trafikun e njëanshëm të pasagjerëve. Shoqëria do të sigurojë që Terminal i Ri planifikohet dhe mbahet me synim zgjerimin e kapacitetit të Aeroportit në 3 milion pasagjerë në vit.

Shoqëria do të sigurojë që sipërfaqja e përgjithshme e Fazës A të Terminalit të Ri, të jetë të paktën 5,000 metra katrorë.

Shoqëria do të planifikojë (Fazat A dhe B) në përputhje me kërkesat për veçueshmëri dhe shfrytëzim sipas standarteve dhe praktikave të Bashkimit Evropian (duke përfshirë por pa kufizim në Marrëveshjen Schengen) dhe do të zbatojë këto standarte dhe praktika kurdo që ato të jenë të zbatueshme në Shqipëri. Shoqëria do të respektojë standardet dhe praktikat shqiptare për sigurinë, emigracionin dhe doganat.

Shoqëria do të sigurojë që aktivitetet tregtare me pakicë, baret dhe restaurantet të përshkruara në Shtojcën 16 (Projekti Teknik i Miratuar) janë të pranishme pas Datës së Hapjes së Fazës A të Terminalit të Ri.

Shoqëria do të sigurojë që salla e klasit të biznesit në Terminalin e Ri është në përdorim pas Datës së Hapjes së Fazës A të Terminalit të Ri.

2. Zyrat e Reja të Administratës

Shoqëria do të sigurojë hapësira në Terminalin e Ri ose në Terminalin Ekzistues që të plotësojnë nevojat e personelit që do të punësohen brenda Terminalit Ekzistues dhe Terminalit të Ri, përveç personelit që punon në hapësirat për kontrollin e trafikut ajror.

Shoqëria do të jetë përgjegjëse për përcaktimin e hapësirave të përshtatshme dhe të mjaftueshme si dhe kohën e transferimit të personelit nga Terminali Ekzistues pasi të konsultohet më të gjitha palët e interesuara.

Shoqëria do të projektojë hapësirat e zyrave në mënyra që të sigurojë numrin e zyrave të përbashkëta dhe individuale të nevojshme për të përmbushur detyrat e kërkuara.

Hapësira e zyrave do të përfshijë banjo, mensë, dhe elemente të tjera të nevojshme në një strukturë të tillë.

3. Të Ndryshme

Seksionet në vijim të Shtojcës 19 janë përfshirë për të dhënë më tepër hollësi të Marrëveshjes mes Palëve në lidhje me çështjet teknike dhe janë në varësi të dispozitave të tjera të kësaj Kontrate dhe të Shtojcaeve të saja.

Dispozitat e Pjesës 3 të Shtojcait 19 janë të zbatueshme dhe për Fazën B të Terminalit të Ri aty ku eshte e mundur dhe kur nuk specifikohen si të zbatueshme vetëm për Fazën A të Terminalit të Ri.

Paisjet Mekanike

Ftohja, ventilimi dhe ajri i koindicionuar

Terminali i Ri (Fazat A dhe B të Terminalit të Ri) do të ketë të instaluar në muret kryesore anësore sisteme ventilimi me tubo me fletë alumini.Ky sistem ventilimi do të përdorë një impiant ngrohje/ftohje të vendosur jashtë ndërtesës së Terminalit, pranë zonës së bagazheve, për dërgimin e ujit të ngrohtë ose të ftohtë në njësitë e ventilimit. Ventilatorët do të marrin ajër të freskët nga jashtë ose ajër nga brendësia e Terminalit, do ta fryjnë atë mbi elementet e ngrohjes dhe do ta kthejnë në dhomë.

Zyrat e Mbyllura në brendësi të Terminalit të Ri (Fazat A dhe B të Terminalit të Ri) do të pajisen me ventilatorë.

Në varësi të intensitetit të ftohjes së kërkuar, kapaciteti i këtij sistemi do të optimizohet nga Shoqëria me qëllim që të kursejë energji me kusht që të ruajë një temperaturë të caktuar në hapësirat e brendshme.

Shoqëria do të sigurojë që temperatura e dhomës gjatë punës në Verë të Terminalit të Ri (Fazat A dhe B të Terminalit të Ri) nuk do të kalojë 26°C. Temperatura e brendshme e terminalit do të rregullohet mbi bazën e temperaturës së jashtme dhe nevojës për të mbajtur një tëmperaturë të përshtatshme për të gjithë personelin që punon brenda terminalit si dhe për të gjithë katëgoritë e pasagjerëve. Sistemi i ftohjes do të projektohet pa teprica në sistem . Zonat e mbyllura të standarteve më të ulëta, siç janë magazinat, zonat me lagështirë dhe impiantet teknike, do të ventilohen pa ftohje. Aparatet për shtimin e lagështirës në ajër nuk do të konsiderohen.

Një sistem i integruar i administrimit të ndërtesës do të kontrollojë kapacitetet e sistemeve mekanike të Terminalit të Ri (Fazat A dhe B të Terminalit të Ri).

Punimet Hidraulike

Zonat sanitare do të paisen nga Shoqëria me kaseta uji të montuara në mur, urinale, lavamanë dhe aksesorët e përshtatshëm në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Furnizimi me ujë të pijshëm në instalimet hidraulike dhe për konsumatorët do të garantohet nga Shoqëria nëpërmjet një rrjeti të shpërndarjes së ujit në ndërtesë. Uji ngrohtë do të sigurohet më anë të ngrohësave elektrikë individualë.

Shoqëria do të instalojë një sistem kanalizimi në ndërtesë, për të siguruar që ujrat e zeza kullohen në linjën e jashtme të kanalizimit.

Terminali i Ri (Fazat A dhe B) do të paiset nga Shoqëria me një sistem kullimi për çatinë.

Mbrojtja nga Zjarri/ Sistemi Spërkatës

Ndërtesa e Terminalit të Ri duke qënë e një lloji të veçantë ka nevojë për një sistem të përparuar të mbrojtjes nga zjarri, ndaj Shoqëria do të instalojë një numër të mjaftueshëm shuarsish zjarri në Terminalin e Ri (Fazat A dhe B).

Terminali i Ri (Fazat A dhe B) do të paisen nga Shoqëria me një sistem mbrojtjeje spërkatës. Vetëm dhomat e mbyllura dhe zonat me rrezikshmëri të ulët zjarri mund të përjashtohen nga ky sistem.

Një numër i mjaftueshëm hidratantësh dhe shuarsish zjarri do të instalohen në vende të dukshme dhe ato të caktuara në Terminalin e Ri (Fazat A dhe B) nga Shoqëria.

Shoqëria do të sigurojë se sistemi mekanik i nxjerrjes së tymit në Terminalin e Ri (Fazat A dhe B) do të arrijë një shkallë ndërrimi të ajrit në 7 herë/për orë dhe ky sistem do të rregullohet automatikisht.

Pajisjet Elektrike

Të gjitha paisjet në vijim do të sigurohen nga Shoqëria, përveç kur thuhet shprehimisht se

dikush tjetër do t'i sigurojë ato.

Kodet/Standardet

Kodet e mëposhtme janë të zbatueshme në lidhje me Sistemet dhe instalimet elektrike:

ICAO Organizata Ndërkombëtarë e Aviacionit Civil

EN Standardet Evropiane

BS Standardet Britanike

ICE Komiteti Ndërkombëtarë Elektrik

Furnizimi me energji

Terminali i Ri (Fazat A dhe B) do të furnizohet me energji me voltazh të ulët ("LV"). Për konsumatorë kryesorë si spërkatësit, furnizimi me voltazh të mesëm mund të jetë një alternativë. Furnizimi me voltazh të mesëm ("MV") do të përputhet me përshkrimin e rrjetit të jashtëm elektrik.

Nënstacionet

Për furnizimin me LV në Terminalin e Ri (Fazat A dhe B), pikat kryesore të shpërndarjes (MDBs) dhe të nën-shpërndarjes (SDBs) do të instalohen në një ndërtesë pranë zonës së bagazheve që vijnë. Dhoma në të cilën do të instalohen MDB, SDB dhe panelet përkatëse do të mbahet e mbyllur me kyç.

Sistemet Telefonike/Intercom

Një sistem telefonik/intercom do të instalohet në Terminalin e Ri (Fazat A dhe B). Centrali kryesorë për tërë aeroportin mund të instalohet në Terminalin Ekzistues.

Sistemet e të Dhënave dhe ato Speciale

Një kabull rrjeti do të instalohet në Terminalin e Ri (Fazat A dhe B) duke filluar nga komunikimet qëndrore MDB brenda zonës së zyrave të Terminalit. Paisje qëndrore të këtyre sistemeve do të ndodhen në dhomën kryesore të komunikimeve dhe do të shpërndahen nëpërmjet kabllit të thurur për ku të jetë e nevojshme. Të gjitha paisjet aktive të nevojshme të sistemit, si serveri, ruteri, nyjet, urat dhe të ngjashme me to do të jenë siguruara.

Sistemet e Sigurisë

Për qëllime mbikqyrje, kamerat dhe monitorët për Televizionet me Rrjet të Mbyllur (CCTV) për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm do të sigurohen dhe mbahen në gjendje funksionale 24 orë në ditë.

Sistemi i Lajmërimit të Informacionit të Fluturimeve

Do të vendosen jo më pak se 25 TFT ekrane të sheshta në vendet e përshtatshme, duke përfshirë

Korridorin e Largimit,

Sallën e Largimit,

Sallën(at) e Shoqërisë (ve) Ajrore,

Zonën e marrjes së Bagazheve,

Korridorin e Mbërritjes dhe në

Zonën e Kërkimit të Bagazheve.

Sistemi i Trajtimit të Bagazheve

Sistemi i Trajtimit të Bagazheve do të sigurohet, vihet në funksionim dhe mirëmbahet nga Shoqëria ose nën-kontraktorët e saja dhe do të plotësojë kushtet minimale të mëposhtme ose më të lartat nëse ka.

Sistemi i Trajtimit të Bagazheve në Terminalin e Ri (Fazat A dhe B) do të jetë i përshtatshëm që të trajtojë së paku valixhet me gjatësi maksimale prej 1,000 mm, gjerësi 750 mm dhe lartësi 650 mm. Pesha maksimale do të jetë 50 kg për valixhe. Ky sistem është i projektuar të funksionojë në përputhje më standardet ndërkombëtare dhe me 100 % kontroll të bagazheve. Metodat për trajtimin e bagazheve me madhësi më të madhe se kapaciateti i Sistemit të Trajtimit të Bagazheve do të sigurohen nga Shoqëria.

Faza A – Nisjet

Faza A e Sistemit të Trajtimit të Bagazheve

Të gjitha pikat e kontrollit te hyres do të jenë të pajisura me dy rripa konvejeri. Rripi i parë do të ketë një paisje për të kontrolluar peshën me dy ekrane, njëri për kontrollorin dhe tjetri për pasagjerin, ndërsa rripi i dytë do të përdoret për të dërguar bagazhet në rripin kryesor të konvejerit

mbrapa sporteleve të kontrollit.

Në fund të secilit nga rripat e konvejerit do të vendoset nga një qelizë fotoelektrike në mënyrë që secila nga bagazhet të presë derisa të shfaqet një hapësirë në rripin e konvejerit kryesor, dhe më pas valixhet do të kalojnë në rripin e konvejerit kryesor. Secili rrip konvejeri kryesorë kalon nëpër një pjesë me rrula për në zonën e kontrollit. Valixhet më të mëdha mund të kontrollohen me dorë në dy tavolinat për orët me ngarkesë.

Faza A e Terminalit të Ri – Kontrolli Sigurisë me rreze-X

Të gjitha valixhet do të trajtohen si të "dyshimta" kur futen në Sistemin e Trajtimit të Bagazheve. Bagazhet nga kontrolli do të kalojnë nëpërmjet rripit të konvejerit në makinën e kontrollit. Imazhi i valixhes do të shfaqet në një ekran kompjuteri nëpërmjet të cilit kontrollori mund të vendosë nëse valixhja mund të kalojë apo është akoma e "dyshimtë". Të gjitha valixhet e "dyshimta" mund të drejtohen me dorë për kontroll të mëtejshëm me dorë ose për sqarime me pasagjerin. Valixhet që kontrollohën në këtë pikë më dorë kalohen më pas në rripin e konvejerit. Ky rrip konvejeri do të transportojë të gjitha valixhet nëpërmjet një pjese me rrula në një karusel. Në karusel valixhet do të rrotullohen derisa të hidhen në ndonjë prej karocave të cilat janë në anë të karuselit.

Faza A e Terminalit të Ri – Mbërritjet

Sistemi i Mbërritjeve do të përbëhet nga dy rripa konvejeri për bagazhet. Bagazhet mbërritëse mund të ngarkohen me dorë nga karrocat në pjesën e përforcuar të rripit të konvejerit në zonat jo-publike dhe të dërgohen në Korridorin e Mbërritjes.Në këtë zonë pasagjerët mund të tërheqin bagazhet e tyre nga karuseli.

Kontrolli i Bagazheve dhe Pasagjerëve

Shoqëria do të sigurojë dhe përdorë sistemet Smiths Heimann (ose të markave të tjera me njëjtën shkallë kapaciteti, funksionaliteti, besueshmërie dhe fortësie) për të gjitha procedurat e kontrollit të bagazheve, pasagjerëve dhe kargos. Personeli i Sigurisë së Aeroportit (kontrollorët dhe mbikqyrësit) do të pregatiten në lidhje me përdorimin e paisjeve të reja.

Tabela e mëposhtme paraqet hollësitë e paisjeve të planifikuara për kontrollin e bagazheve dhe pasagjerëve për Fazën A të Terminalit të Ri si dhe të paisjeve të cilat do të instalohen për kontrollin e kargos që do te siguroje Shoqëria.

Njësia	Zona/Lloji i Paisjes
1	Kontrolli i Bagazheve
	Sistemi EDS 10080 ose i ngjashëm për përdorim në Sistemin e Konvejerit të Bagazheve për Aeroportet, e nivelit të kontrollit 1. Sistemi kontrollon 100% dhe me saktësi të gjitha bagazhet për ekplozivë (Niveli 1). Bagazhe të padyshimta, dhe për rrjedhojë pjesa më e madhe e bagazheve kalohet nga sistemi. Kur dallohet një valixhe e dyshimtë, imazhet me rreze-X prodhohen dhe objekti i dyshimtë shënohet me një kuadrat të kuq. Imazhet transferohen me anë të një lidhje me shpejtësi të madhe të tranferimit të të dhënave, pa shkaktuar ndonjë vonesë nga depozitimi i përkohshëm, në një pikë pune për një kontroll pamor (Niveli 2). Këto imazhe mund të transferohen dhe në pikën e kontrollit me dorë (Niveli 3). Duke përfshirë 3 pika e pune për Nivelin 2 dhe 1 pikë pune për kontroll në Nivelin 3 (rikontrolli) Përfshin severin për shpërndarjen e matriksave të imazheve, administrimin dhe pregatitjen e pikës së punës.
2	Kontrolli Bagazheve të Dorës
	Njësia e kontrollit me rreze-X e llojit HI-SCAN 7555 i / MAT ose e ngjashme HI-SCAN 7555i është një njësi kompakte me rreze-X, e modeluar së fundi, me një hapje tunel prej 755 mm x 555 mm (gj x l). Kjo paisje është

	ideale për kontrollin e bagazheve të dorës, çantave, pakove e sendeve të tjera të vogla. HI-MAT Plus i ri arrin të klasifikojë materialet për të dalluar mes materialeve organike dhe atyre jo-organike duke përfshirë karakteristikat VARI-MAT, vetëm Organike dhe shpërbërje Organike Shpëjtësi e rripit 0.2 m/s Lartësia e konvejerit nga toka: 750 mm pesha e shpërndarë në mënyrë të barabartë: 160 kg Rrëshqitësi prurës, gjatësia për. 0.6 m Rrëshqitësi nxjerrës, gjatësia për. 1 m
3	KONTROLLI PASAGJERËVE
	Dalluesi i metalit modeli Portë Lloji HI-PE Multi Zone versioni panel ose i ngjashëm Shumë i ndjeshëm, i kontrolluar me mikroprocesor dalluesi metalit kontrollon pasagjerët ose vizitorët për armë të fshehura ose sende të tjera të rrezikshme 3 Njësi për kontroll pasagjerësh dhe 1 njësi për kontroll personeli.
4	KONTROLLI KARGOS
	Njësia e Kontrollit me rreze-X LLoji HI-SCAN 145180 / MAT ose i ngjashëm HI-SCAN 145180 është modeluar në mënyrë të tillë që të përmbushë nevojat e magazinave dhe transportuesve në Aeroporte (kargo në paleta me portë të ulët). HI-SCAN 145180 është një konsumator i ulët i energjisë (140 kV), një sistem kontrolli me rreze-X, me dimensione të tunelit 1450 mm gjerësi dhe 1800 mm lartësi. Është në veçanti i përshtatshëm për kontrollin e kargos ajrore të transportuar në paleta standarte Evropiane, Britanike ose Amerikane. Ka një fuqi tejshikimi deri në 30 mm çelik. Shpejtësia e rripit 0.2 m/s Lartësia e konvejerit nga toka 830 mm Pesha e konvejerit e shpërndarë në mënyrë të barabartë 1200 kg Konvejeri prurës, versioni rezistent për ngarkesa të mëdha gjatësia për. 1300 mm Konvejeri nxjerrës, versioni rezistent për ngarkesa të mëdha gjatësia për. 1300 mm

Ndriçimi

Shoqëria do të sigurojë ndriçim të përshtatshëm në Terminalin e Ri (per secilen Faze A te Terminalit te Ri dhe Faze B te Terminalit te Ri) me qëllim qe ta beje përdorimin e ketij terminali te kenaqshem dhe te pershtatshem per pasagjeret dhe përcjellësit e tyre.

Shoqëria do të sigurojë paisje orientimi në mënyrë që përdoruesit e terminalit të dallojnë destinacionet dhe hyrjet e daljet, si dhe hapësirat e veçanta, si p.sh zona e largimit, kontrolli, zona e mbërritjes, emigracioni, dogana, dhe zona tregtare. Ndihma orientuese do të jepet me anë të një sistemi lehtësisht të kuptueshëm të temperaturave të ndryshme të dritës për të theksuar zonat e sipërpërmendura.

Mbërritja, doganat, siguria, imigracioni dhe pikat e kontrollit do të trajtohen me drita spote me lente të ndryshme duke përdorur llampa HIT-CRl nga 70w deri 150w me llampa temperature të

ngjyrës së bardhë. Dritat spote do të jenë me rreze të ngushtë 12 gradë dhe drejtpërsëdrejti poshtë, duke përdorur llampa HIT-CRl nga 70w deri 150w me llampa temperature të ngjyrës së bardhë në hyrje të sallës së largimit, mbërritjes dhe zonës tregtare.

Ndriçime jo të drejtpërdrejta mund të përdoren për të dhënë ndriçim të përgjithshëm të ndërtesës së Terminalit. Dritat HIT-DE 400w mund të përdoren duke shfrytëzuar tavanin e Aeroportit si reflektor. Ndriçuesi mund të montohet në kollonat e terminalit dhe të ndriçojnë përpjetë duke dhënë ndriçim jo-të drejtpërdrejtë. Temperatura e ngjyrave te dritave te pergjithshme do te jete e bardhe dite.

Pemët jashtë Terminalit do të ndriçohen me drita që instalohen poshtë tyre. Dritat nënujore do të vendosen në elementin ujor pranë Terminalit të Ri.

Specifikimet e Ndriçimit – Ndriçimi brendshëm:

Instalimi/ Lloji	Përshkrimi	Llampa/ Fuqia	Prodhuesi/ Modeli Numri	Përmasat
Sheshi Mbërritjes, Harku i Mbërritjes dhe hyrjet për largim				
A1	Parscoop IV e bardhë	HIT-DE 400ë Fc2	ERCO 33229 34903 + Filtër e kuqe ose e ngjashme	
K	Dritë me drejtim nga jashtë	HIT-CRI 70ë G12	ERCO 81031 ose e ngjashme.	Co 185mm dia lartës 220mm reze 201mm pesha 4.50kg
L	Dritë Tesis me lente të zvogëluara me ndricim nga muri	HIT-CRI 70ë G12	ERCO 33723 ose e ngjashme.	Co 277mm dia larts 410mm reze 297mm pesha 9.00kg
M	Dritë Tesis me lente të zvogëluara me ndricim nga tavani	HIT-CRI 70ë, G12	ERCO 33721+33951 ose e ngjashme.	Co 277mm dia larts 410mm reze 297mm pasha 8.7kg
Terminali				
A	Parscoop IV e bardhë	HIT-DE 400ë Fc2	ERCO 33229 ose e ngjashme	Referohu Specifikimeve
Mbërritjet Emigracioni				
B	Dritë Yll spot për llampa të presionit të lartë	HIT-CRI 150ë G12 L110	ERCO 73531 +74476 ose të ngjashme	Referohu Specifikimeve
Zyra e Kërkimit të Bagazheve				
R	Dritë Yll spot për llampa të presionit të lartë	HIT-CRI 150ë G12L110	ERCO 73531 ose e ngjashme	Referohu Specifikimeve
Doganat				
B	Dritë Yll spot për llampa të presionit të lartë	HIT-CRI 150ë G12L110	ERCO 73531 +74476 ose e ngjashme	Referohu Specifikimeve
Pika e kontrollit				
C	Dritë Yll spot për llampa të presionit të lartë	HIT-CRI 150ë G12L110	ERCO 73531 +74474 ose e ngjashme	Referohu Specifikimeve
Sigurimi				
A	Parscoop IV e bardhë	HIT-DE 400ë Fc2	ERCO 33229 ose e ngjashme	Referohu Specifikimeve

B	Dritë Yll spot për llampa të presionit të lartë	HIT-CRI 150ë G12L110	ERCO 73531 +74476 ose e ngjashme	Referohu Specifikimeve
D	Dritë Yll spot për llampa të presionit të lartë	HIT-CRI 70ëG12L100	ERCO 73519 +74475 ose e ngjashme	Referohu Specifikimeve
F	Dritë me lente me ndricim nga muri	QT12 12v 50ë GY6,35	ERCO 22415 ose e ngjashme	co 125mm dia larts 150mm reze 140mm pesha 0.65kg
Mbërritja				
J	Dritë e drejtpërdrejtë me ndricim metalik lamp	HIT-CRI 70ë G12	ERCO 81643 +83671 ose e ngjashme	co 157mm dia larts 250mm reze 170mm pesha1.55kg
Zona Tregtare				
J	Dritë e drejtpërdrejtë me ndricim metalik lamp	HIT-CRI 70ëG12	ERCO 81643 + ose e ngjashme	co 157mm dia larts 250mm reze 170mm pesha 1.55kg

Ndriçimi Përjashta:

Instalimi/ Lloji	Përshkrimi	Llampa/ Fuqia	Prodhuesi/ Modeli Numri	Përmasat
Pylli me Pisha				
M	Dritë Tesis me lente të zvogëluara me ndricim lart	HIT-CRI 70ë, G12	ERCO 33721+33951 ose e ngjashme	co 277mm dia larts 410mm reze 297mm pesha 8.7kg
S	Drita uji të montuara në dysheme	PAR56 12v 300ë	Bega 8510 ose e ngjashme	
T	Parscoop III e bardhë	HIT-DE-CRI 150ë RX7s	ERCO 33275 +34973 ose e ngjashme	
Rruga për Këmbësorët				
N	Visor e varur e bardhë dyshemeje	HIT-CRI 35ë G8,5	ERCO 33314 +33975 ose e ngjashme	810mm x 310mm x160mm
P	Dritë Tesis me ndricim dyshemeje	HIT-CRI 35ë G8,5	ERCO 33713+33950 ose e ngjashme	co 227mm dia larts 365mm reze 247mm pesha 6.00kg

Strukturimi

Terminali i Ri do të ketë formën e një drejtkëndëshi, përafërsisht. 69 m x 96 m = 6,624 m², në Fazën A, dhe që do të zgjerohet në përafërsisht. 83 x 96 m = 7,968 m², in Fazën B.

Niveli i dyshemesë: +/- 0.0 m

Niveli i çatisë: përafërsisht15 m nga ana e përparme dhe përafërsisht 8 m nga ana e pasme.

Rrjeti strukturor për ndërtesën do të jetë përgjithësisht shumëfish i 6 m.

Çatia do të jetë strukturë çeliku, me mbulojë çeliku, të mbështetur në shtylla çeliku (të

kryqëzuara), dhe të mbështetura në elemente çeliku dhe kollona në rrjeta prej 12.0 m x 12-24 m:

Projekti strukturor do të realizohet në përputhje me Normativat Evropiane të Ndërtimit (Eurocode).

SHTOJCA 20

HAPËSIRAT OPERACIONALE PËR TERMINALIN E RI

Shoqëria do të sigurojë të paktën këto paisje për përdorim në Terminalin e Ri (Faza A dhe B e Terminalit të Ri sipas zbatueshmërisë) pas Datës së Hapjes së Fazës A të Terminalit të Ri ose në ndonjë datë më të hershme në të cilën Terminali i Ri funksionon për trafik pasagjerësh:

i) Sportele check-in dhe sistem për përdoruesit e Terminalit;

ii) Shfaqje infromacioni;

iii) Rrymë elektrike në të gjitha prizat;

iv) Ujë në të gjitha instalimet hidraulike dhe kanalizime për të gjitha instalimet e kanalizimeve;

v) Ndriçimi elektrik;

vi) Linja telefoni për të komunikuar dhe transferuar të dhëna në të gjitha instalimet përkatëse;

vii) Paisje për trajtimin e bagazheve në hapësirat e Mbërritjes dhe Largimit nga vendi;

viii) Pikë informimi për pasagjerët dhe kërkesat e publikut;

ix) Paisje dhe komoditete për doganën, emigracionin, policinë dhe Departamentin e Shëndetsisë;

x) Paisjet e Ndihmës së Shpejtë;

xi) Furnizimet përkatëse mjekësore për pajisjet e ndihmës së shpejtë;

xii) Kabinat e telefonisë publike;

xiii) banjot (meshkujt, femrat dhe personat me aftësi të kufizuara);

xiv) Entet e këmbimit valutor;

xv) Paisjet e kontrollit të bagazheve me rreze-x;

xvi)Paisjet për dallimin e metaleve (dhe eksplosivëve);

xvii) Karrocat e bagazhit;

xviii) Zonat e caktuara për publikun;

xix) Paisjet e veçanta për personat me aftësi të kufizuara;

xx) Ndriçimi në raste urgjence;

xxi) Sistemet e dallimit të zjarrit dhe impiantet ujitës; dhe

xxii) Sistemet mbështetëse IT.

SHTOJCA 21

TERMINALI EKZISTUES

1. Funksionimi i Terminalit Ekzistues

Shoqëria do të vërë në funksionim dhe mirëmbajë Terminalin Ekzistues në përputhje me këtë Kontrate.

Nëse Shqipëria bashkohet me Bashkimin Evropian dhe bëhet pjesë e Marrëveshjes Schengen, Shoqëria do të ripajisë Terminalin Ekzistues në përputhje me kërkesat për veçim dhe funksionimin

sipas standarteve dhe praktikave të Bashkimit Evropian (duke përfshirë Marrëveshjen Schengen).

Shoqëria do të përmbushë standardet dhe praktikat Shqiptare për sigurinë, emigracionin dhe doganat në vënien në funksionim të Terminalit Ekzistues (para dhe pas rimodelimit të terminalit). Shoqëria do të sigurojë që paisjet në terminalin ekzistues në Datën e Fillimit janë në shfrytëzim ose përdorim në Terminalin Ekzistues deri në Datën e Hapjes së Fazës A të Terminalit të Ri.

Mirëmbajtja e ndërtesës së Terminalit Ekzistues dhe investime të tjera të vogla do të specifikohen nga Shoqëria pas Datës së Fillimit.

2. Riperteritja Terminalit Ekzistues

Shoqëria do të mirëmbajë, dhe vërë në funksionim Terminalin Ekzistues (para dhe pas rimodelimit) dhe do të rinovojë dhe përmirësojë Terminalin Ekzistues, sipas përcaktimit në Shtojcën 16 (Projekti Teknik i Miratuar) brenda gjashtë muajve në vijim të Datës së Hapjes së Fazës A të Terminalit të Ri. Shoqëria nuk do të përdorë Terminalin Ekzistues për fluturime të rregullta ose çarter, tregtarë dhe civil pas Datës së Hapjes së Fazës A të Terminalit të Ri.

Të gjitha shpenzimet dhe kostot në lidhje me çmontimin dhe riperteritjen e Terminalit Ekzistues do të përballohen nga Shoqëria. Kulla ekzistuese e kontrollit ajror në Terminalin Ekzistues do të mbetet pronë e Organit përkatës Shtetëror. Kostot në lidhje me ripaisjen e kullës do të përballohen nga Organit përkatës Shtetëror.

3. Paisjet për Personat Shumë të Rëndësishëm "VIP"

Paisjet për VIP mund të lihen në vendndodhjen e tyre të tanishme në Terminalin Ekzistues ose të transferohen në ndonjë vend tjetër sipas marrëveshjes mes Palëve.

Salla VIP-ve do të lehtësojë mbërritjen dhe largimin për jashtë vendit, pritjen dhe trajtimin e VIP-ve. Hyrja për ata që largohen do të bëhet nga një kthese të përshtatur për këtë qëllim hyrja në të cilën do të lejohet vetëm për automjetet dhe personat, ndërsa hyrja për ata që mbërrijnë do të bëhet drejtpërsëdrejti me anë të një automjeti në zonën e caktuar të fushës së aerodromit. VIP-at që mbërrijnë në vend mund të priten dhe nga automjetet private po në zonën e caktuar. Kjo procedurë për trajtimin e VIP që shfrytëzojnë paisjet për VIP-at do të jetë në përputhje me Praktikat Pozitive të Industrisë tipike për Aeroportet e përmasave të ngjashme me atë të Tiranës, dhe do të lehtësohen në lidhje me sigurimin duke përfshirë kontrollimin dhe ndarjen nga pasagjerët e tjerë në masën e nevojshme.

Pajisjet dhe komoditetet për VIP-at do të jenë në shfrytëzim të plotë gjatë gjithë Periudhës së Koncesionit.

SHTOJCA 22

FAZA A E QENDRËS SË RE TË KARGOS AJRORE

Shoqëria do të sigurojë, vërë në përdorim dhe mirëmbajë Fazën A të Qendrës së Re të Kargos për të plotësuar nevojat e Aeroportit për përballimin e kargos në një truall në veri të Terminalit Ekzistues me hyrje nga ana veriore. Faza A e Qendrës së Kargos do të jetë në gjendje të trajtojë jo më pak së 4,500 ton ngarkesë në vit për situata të parashikuara dhe të jetë në gjendje të arrijë të trajtojë jo më pak se 6,000 tonnë vit në situate të parashikuara.

Shoqëria do të punësojë personel të pregatitur përkatësisht për trajtimin e kargos ose të kontraktojë me nën-kontraktorë.

Qendra e Re e Kargos Ajrore duhet të përfshijë të gjitha komoditetet e nevojshme për administrimin e transaksioneve me Kargo, duke përfshirë një zyrë për shpërndarjen e ngarkesave, departamentin e doganës dhe të ngjashme.

Shoqëria do të marrë masat e nevojshme për të siguruar magazinimin e kargos.

Shoqëria do të sigurojë dhe mirëmbajë paisje dhe automjete të përshtatshme për trajtimin e kargos me qëllim që të transportojë kargon nga dhe për në avion.

Qendra e Re e Kargos Ajrore duhet të përfshijë zyra të mobiluara në mënyrë të përshtatshme,

banjo, dhe ambiente e komoditete të tjera të nevojshme sipas përcaktimit në Shtojcën 16 (Projekti Teknik i Miratuar).

Qendra e Re e Kargos Ajrore do të sigurojë trajtimin e shërbimeve të kargos nga jashtë brënda dhe nga brënda jashtë, importin/eksportin, ngarkesat/ shkarkesat, platformën, magazinimin, sigurinë, doganat, zyrat.

Qendra e Re e Kargos Ajrore duhet të ketë hyrje nga toka dhe nga ana e aerodromit. Lartësia e zonës së kargos do të jetë përafërsisht 11 m. Qendra e Re e Kargos Ajrore në pjesën e magazinës dhe zyrave duhet të jetë të paktën pjesërisht me ajër të kondicionuar (HVAC) dhe në pjesën e kargos e ventiluar.

Vecoritë kryesore të ndërtesave të Qëndrës së Re të Kargos Ajrore:

Holli kryesor i kargos, salla e mallrave të dëmshëm, salla e mallrave të dëmtuar, salla veterinarie, salla e sendeve të cmuara, salla e mallrave të konfiskuar, kapaciteti maksimal i mbajtjes së peshës : 25kN/m2

Magazinat, përfshirë magazinat frigoferike;

Zyrat (zyra e pagesave të transportit, zyra e sigurimit, zyra e doganave, etj.) dhe zyra e konferencës, e pajisuer me mobilje (tavolina dhe karrige) dhe ndenjëse, ajër i kondicionuar (HVAC),

Salla e personelit: femra/meshkuj, duke përfshirë tualetin dhe banjën me 15 dollape me kyc,

Sistemi i zbulimit të zjarrit dhe i alarmit, dhe

IT dhe rrjetin e telekomunikacionit (instalimi)

Raporti e hollit/magazinës nga zyrat/sallat e personelit do të jetë përafërsisht 2:1.

Përmasat minimale kyce (Faza A):

Zona e dyshemesë së madhe: 750 m2

Përmasat: 18 x 43 metra= 774 m2

Nga kjo:

Holli/magazina: përafërsisht 520 m2

Zyrat/sallat e personelit: përafërsisht 254 m2

SHTOJCA 23

INFRASTRUKTURA NGA ANA E AERODROMIT

1. Vendqëndrimi Avionëve

Shoqëria do të zgjerojë vendqëndrimin ekzistues të Avionëve sipas përcaktimit në Planin Kryesorë të Azhornuar të Aeroportit. Projektimi dhe modeli i një zgjerimi të vendqëndrimi të Avionëve do të bëhet në përputhje me ICAO Shtojca 14 Volumi 1: Projektimi Aerodromeve dhe Veprimtaritë dhe Manualët e Projektimit të Aerodromeve Pjesa 2: Rrugët Lidhëse, Vendqëndrimet e Avionëve dhe Gjiret Mbajtëse dhe Pjesa 3: Sipërfaqet.

Shoqëria do të jetë përgjegjëse për të siguruar që të gjitha punimet me beton në lidhje me zgjerimin e vendqëndrimit të Avionëve do të ndërmerren në përputhje me një skemë të Garantimit të Cilësisë BS EN ISO 9000 ose ndonjë skemë tjetër me famë të ngjashme ndërkombëtare.

Përbërësit e ndryshëm, materialet dhe trajtimi, përzierja dhe vendosja e shtresës së betontë duhet të jenë në përputhje me standardet Britanike në vijim ose standarte të ngjashme të njohura në shkallë ndërkombëtare të përcaktuara në Shtojcën 17 (Kodet, Standardet, Rregulloret dhe Botime të tjera)

2. Rrugët Lidhëse

Shoqëria do të riparojë sipërfaqen e rrugës lidhëse D2 në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e lëvizjes sipas standarteve të pranueshme. Fortësia e rrugës lidhëse nuk duhet të jetë më e ulët se PCN e 60.

Shoqëria do të zgjerojë rrugën lidhëse E për të akomoduar të gjithë avionëtët Code D.

Planifikimi, projektimi dhe punimet e ndërtimit në lidhje me rrugët lidhëse duhet të bëhen në përputhje me kushtet e ICAO Shtojca 14: Volumi 1 dhe Manualet e Projektimit të Aerodromeve Pjesa

2 dhe 3.

Shoqëria do të përforcojë të gjitha zonat në afërsi të korsive ekzistuese në mënyrë që të zvogëlojë probabilitetin e dëmtimit të avionëve që përdorin këto zona në raste urgjence ose aksidentalisht. Këto zona mund të shfrytëzohen për hyrje ndihmëse nga njësitë e shpëtimit, zjarrfikësit dhe automjete të tjera.

3. Kullimi

Shoqëria do të ndërmarrë përmirësime të sistemit të kullimit të fushës së aerodromit në mënyrë që situata të përputhet me kërkesat e Qarkores së FAA 150/5320 – 5B (Sistemi Kullimit të Aeroportit) dhe, aty ku nevojitet, BS EN 752 ose standarte të ngjashme të njohura botërisht.

Shoqëria do të projektojë sistemin e kullimit për një periudhë 100 vjeçare dhe me një standart i cili siguron që infrastruktura e aerodromit nuk mund të përmbytet më shpesh së një herë në dhjetë vjet, dhe për Terminalin një herë në 50 vjet. Shoqëria do të mirëmbajë dhe përmirësojë sistemin e kullimit në mënyrë që fusha e aerodromit të jetë në përputhje me kushtet e standardet e nevojshme kur t'i transferohet Qeverisë Shqiptare me përfundimin e Periudhës së Konçesionit.

Shoqëria do të instalojë mbledhës karburanti/vajrash në vendqëndrimin e Avionëve dhe në të gjitha zonat e tjera të furnizimit me karburant. Mbledhësit duhet të jenë të klasit të 2-të dhe të përputhen me BS EN 858, ose standarte të ngjashme të njohura botërisht.

Shoqëria do të sigurojë gjatë gjithë Periudhës së Konçesionit që mbetjet në vendqëndrimin e Avionëve dhe nga furnizimi me karburant do të kalojnë nëpërmjet një mbledhësi para se të hidhen në lumenj dhe burimet ujore.

Shoqëria do të sigurojë se çdo zonë që do të përdoret për furnizim me karburant duhet të plotësojë kushtet e NFPA 415 (Standardet e Ndërtesave të Terminaleve të Aeroportit, Gropave të Kullimit të Karburantit, dhe rrugicat e Ngarkimit) ose standarte të ngjashme të njohura botërisht.

Shoqëria do të jetë përgjegjëse për të siguruar mbrojtjen nga pusetat dhe strukturat e tjera për kullim në mënyrë që të zvogëlojë shkallën e dëmtimit të mundshëm për avionëtët të cilët dalin nga pista/korsia aksidentalisht ose në rast urgjence.

4. Pista

Shoqëria do të sigurojë që sinjalizimet, duke përfshirë ato në ndonjë zgjerim të Pistës, të mbahen në kushtet e kërkuara nga ICAO Shtojca 14 dhe rinovohen sipas standarteve të përcaktuara në BS 3262, ose standarte të ngjashme të njohura botërisht.

Shoqëria do të sigurojë që ujrat e ndenjura nuk do të grumbullohen në pistë (duke përfshirë Zgjerimet e Pistës) dhe që të gjitha ujrat sipërfaqësore grumbullohen në sistemin e kullimit me efikasitet.

5. Zgjatimi Pistës

Zgjatimi e Pistës ekzistuese ("Zgjatimet e Pistës") të miratuara nga Palët në përputhje me pikën 4.8 do të jenë të ndërtuara në nivelin e PCN nga 60 në tokën e shpronësuar nga Qeveria Shqiptare për këtë qëllim. Shoqëria do të jetë përgjegjëse për projektimin, ndërtimin, komisionimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e Zgjatimeve të Pistës dhe pjesëve të lidhura me to në Zonën e Konçesionit, duke përfshirë korsitë shtesë dhe ndonjë pastrim, mbushje apo nivelim të truallit, dhënien e rripave shtesë pistës dhe ndriçime tokësore shtesë të fushës së aerodromit dhe devijimin e ujrave në përputhje me standardet e zbatueshme.

Në kohën e ndërtimit dhe të komisionimit të Zgjatimit të Pistës, Shoqëria do të ndërtojë gjithashtu dhe komisionojë një rrugë lidhëse që do të lidhë rrugët ekzistuese të kalimit të avionëve dhe vendqëndrimet e avionëve me koordinatat 18 të pistës së zgjeruar, përmirësojë rrugën lidhëse E që të përballojë avionëtët Code D, dhe të zgjerojë vendqëndrimin e Avionëve (me miratim të Njësisë së Zbatimit të Projektit) për të akomoduar Avionëtët Code D që parkojnë vetëm pjesën e përparme në të.

6. Brezi Jeshil i Pistës dhe Rrugëve lidhëse

Shoqëria do të sigurojë që rripat e pistës (150 metra në secilën anë të vijës qëndrore të pistës) janë të pastra nga ndonjë send që mund të rrezikojë avionëtët që përdorin aeroportin.

Shoqëria do të heqë bunkerët e betonit brenda rripave të pistës dhe rrugëve lidhëse në mënyrë që të plotësojnë kushtet sipas standarteve dhe praktikave të përcaktuara në ICAO Shtojca 14.

Shoqëria do të jetë përgjegjëse për marrëveshjet me forcat e NATO's ose Palët për ndonjë

paisje të nevojshme për ngritjen e peshave shumë të rënda dhe për heqjen e bunkerëve. Këto punime do të njoftohen dhe ekzekutohen në përputhje me praktikat e sigurimit për punimet në fushat e aerodromeve në shfrytëzim.

Shoqëria do të sigurojë që rripat dhe xhepat e pistës dhe korsive do të kenë disnivel të mjaftueshëm për të lehtësuar rrëshqitjen e ujit nga sipërfaqja. Xhepat do të kenë forcë të mjaftueshme për të zvogluar dëmtimet e Avionëve që dalin nga pista aksidentalisht ose në raste urgjence. Xhepat do të kenë kapacitet të mjaftueshëm për të lejuar hyrjen e njësive të shpëtimit dhe të zjarrfikësve ose të automjeteve të tjera.

Shoqëria do të mirëmbajë gjatë gjithë kohës sipërfaqen e fushës së aerodromit sipas kushteve të parashikuara nga ICAO Manuali Shërbimeve të Aeroportit Pjesa 2 dhe ICAO Manuali i Projektimit të Aerodromit Pjesa 3. Shoqëria do të mbajë një program mirëmbajtjeje për të gjitha sipërfaqet e aerodromit në formën e përcaktuar ndernjet GDCA dhe Kompanise perpara dates se fillimit.

Shoqëria do të mirëmbajë të gjithë brezat dhe xhepat e pistës dhe të rrugëve lidhëse në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ICAO Shtojca 14 dhe ICAO Manuali Projektimit të Aerodromeve Pjesa 2.

7. Cështje të Tjera

Pjesët e mëposhtme të Shtojcës 23 janë përfshirë për të dhënë hollësitë të tjera në lidhje me marrëveshjen mes palëve përsa u përket çështjeve teknike dhe janë në varësi të pikave të tjera të kësaj Kontrate (duke përfshirë edhe Shtojcat e saj).

(i) Gjerësia e Pistës

Nëse lëvizjet e Avionëve code E do të caktohen vazhdimisht gjatë Periudhës së Konçesionit, Shoqëria do të pajisë të dy skajet e pistës me hapësira për rrotullim për të lejuar përdorim të mjaftueshëm të gjatësisë së pistës.

(ii) Rripat e Pistës

Shoqëria do të sigurojë që pista të jetë e shtruar në një rrip piste me gjerësi 150 metra në secilën anë të vijës së mesit të pistës. Shoqëria do të largojë çdo objekt ekzistues në këtë hapësirë. Shoqëria do të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për të siguruar që asnjë objekt përveç mjeteve pamore të nevojshme për navigacion ajror ose të tjera objekte të lejueshme, të vendosen në kufirin 150 metra nga vija e mesit të pistës.

(iii) Analiza e Pengesave

Analiza e Pengesave e bazuar në ICAO Shtojcai-14, duke parashikuar një shkallë (te ardhme) saktësie të pistës deri në Cat. I, Codi 4, do të realizohet nga Shoqëria brenda 6 muajve nga Data e Fillimit.Deri në përfundimin e këtyre analizave në datën e përcaktuar, Shoqëria ruan të drejtën të besojë se zonat e lira nga pengesat sipas ICAO Shtojca 14 janë në të vërtetë të tilla përderisa të mos vihet në dijeni për ekzistencën e pengesave të tilla të cilat nuk janë njoftuar ose botuar nga DPAC në AIP dhe/ose diagramet e llojit A. Pas marrjes së njoftimit për ekzistencën e pengesave të tilla nga Shoqëria, DPAC do të botojë informacionin përkatës në AIP dhe/ose Diagramet e llojit A.

(iv) Grupimi Shtesë

Shoqeria në bashkëpunim të ngushtë më ANTËN dhe prodhuesin e instrumentave të sistemit të uljes së avjonëve duhet të pregatisin zona të përshtatshme për instalimin e ardhshëm të instrumentave të planifikuar të komponentëve të sistemit të uljes së avionëve(për shembull lokalizues, pistën e rrëshqitjes) dhe të pajisjeve meteorologjike brënda Zonës së Koncesionit

(v) Gjerësia e Rrugëve Lidhëse

Sipërfaqja e Rrugë Kalimit D2 do të rishtrohet nga Shoqëria brënda 18 muajve pas Datës së Fillimit me një shtresë bitumi për të siguruar një manovër të rehatshme në pistë.

Pista E do të zgjerohet nga Shoqëria me një gjerësi shtrimi prej 23 m për të siguruar Code E për operimin e avjonit brënda 18 muajve nga Dita e Fillimit. Këto punime për zgjerimin do të përfshijnë konstruksionin kurrizeve të përshtatshme të rrugeve lidhese me kodin E.

(vi) Rripat e Rrugëve Lidhëse

Me rritjen e trafikut ajror Kodi D dhe E, në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë, rrugët lidhëse do të pajisen plotësisht me kurrize të shtruar nga Shoqëria për të arritur në një gjerësi finale të rrugëve lidhëse duke përfshirë kurrizet prej 44 m për code E të avionëve sipas Shtojcës 14 të ICAO-s.

Shoqëria do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të garantuar që, me përjashtim të

dispozitës për kurrizet e shtruara të rrugës, asnjë objekt, përvec objekteve ndihmues pamorë të kërkuara për navigimin ajror të jetë vendosur brënda rripit të rrugës lidhëse. Skica e grupimit të rripave të rrugëve lidhëse aktualedo të kontrollohet me hollësi nga Shoqëria brënda 6 muajve nga Dita e Fillimit me qëllim që të futet ndonjë nga punimet e duhura për të cuar rripat e rrugëve lidhëse në standardet e kërkuara.

(vii) Shiritat Lidhës

Shoqëria duhet të sigurojë Shiritat lidhës të përshtatshm, aty ku janë të nevojshëm me rritjen e kodit E të trafikut dhe në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë së Rrugëve lidhëse, në kthesat e rrugëve lidhëse dhe kryqëzimet midis pistave dhe rrugëve lidhëse për të arritur hapësirën e lirë të nevojshme për rrëshqitjen e avioneve sic është përcaktuar në Shtojcën 14 të ICAO-s.

(viii) Vendqëndrimi dhe Kapaciteti i Vendqëndrimit

Zona e vendqëndrimit do të zgjerohet nga Shoqëria në lidhje me rritjen e volumit të trafikut dhe në përputhje me Praktikën e Mirë të Industrisë, ose në Jug (e cila do të ishtë zgjedhja e preferuar) ose në veri të zonës së vendqëndrimit ekzistues.

Shoqëria do të ketë të drejtë të mbyllë përkohësisht një pjesë të caktuar të Rrugës Lidhëse W/D2 herë pas here nëse është e nevojshme për të parkuar avionëtët e Code E. Nëse trafiku i Avionëve Code E do të vazhdojë rregullisht, Shoqëria do të transferojë boshtin e Rrugës Lidhëse W (Rrugën Lidhëse përkatëse W në vendqëndrimin e Avionëve) më pranë pistës përafërsisht 15 metra, me qëllim që të krijojë kapacitet shtesë për vendqëndrim avionëtësh përafërsisht 8.500 metra katrorë.

Një optimizim i zonës ekzistuese të vendqëndrimit të Avionëve duke përfshirë zbatimin e sinjalizimeve të ndryshueshme për avionëtët në mënyrë që të sigurohet një përdorim më efikas i hapësirës do të realizohet nga Shoqëria gjatë pregatitjes së Masterplanit të Përditësuar të Aeroportit. Ky process do të përfshijë gjithashtu një analizë të situatës së tanishme në fuqi/të shfuqizuar si dhe prezantimin e procedurave të ardhshme të shtyrjes apo tërheqjes së avionit.

Shoqëria do të sigurojë standardet e kërkesave afatmesme dhe afatgjata pasi të zgjerohet vendqëndrimi Avionëve në të dy drejtimet jugor e verior sipas parashikimeve të Masterplanit të Përditësuar Paraprak të Aeroportit. Këto zgjerime të vendqëndrimeve do të planifikohen dhe ndërtohen në mënyrë të pavarur dhe pa ndërhyrje në verpimtarinë e aeroportit.

(ix) Distancat e lejuara

Shoqëria do të sigurojë që avionët të ruajnë distancat minimale të lejuara në lidhje me avionët e parkuar dhe ndërtesat përreth, avionëtët në vendqëndrimet e tjera dhe objekte të tjera sipas standarteve të ICAO Shtojca 14.

(x) Fortësia e rrugeve te shtruara

Rrugët e shtruara në pistë, rrugët lidhëse dhe vendqëndrimet do të projektohen nga Shoqëria për të përballuar ngarkesat e Avionëve pa pasur deformime ose nxjerrje jashtë përdorimit. Shoqëria do të sigurojë në këto rrugë një sipërfaqe të rrafshët, të fortë dhe të qëndrueshme, e përdorshme në të gjitha stinët dhe kushtet atmosferike.

Shoqëria do të ketë të drejtë të ndërmarrë vëzhgime dhe analiza të mjaftueshme nga Shoqëria para Datës së Fillimit për të konfirmuar fortësinë e rrugëve të shtruara në, mënyrë të kënaqshme në zonat e rradhitura më poshtë:

i) Pista: PCN 60/F/C/W/T;

ii) Rrugët lidhëse ekzistuese: ose PCN 60/F/C/W/T ose PCN 60/R/C/W/T;

iii) Vendqëndrimet e avionëve në veri dhe jug të vendqëndrimit qëndror: PCN 60/R/C/W/T; dhe

iv) Vendqëndrimi qëndror: PCN 60/R/C/W/T.

Kjo pune vezhguese dhe mbikqyrese ne zonat e mesiperme nga eksperti i pavarur do te prokurohet dhe paguhet nga Qeveria e Shqiperise dhe Shoqëria dhe do te kryhet para ose jo me vone se dy muaj nga Data e Fillimit. Neqoftese keto sondazhe dhe raporti perkates vene ne dukje se forca e shtrimit eshte nen (PCN55) ne pjese te caktura ose ne te gjitha zonat e permendura me siper dhe Standardet e Kerkuara kerkojne fortesi me te madhe per operimin e avionit ne nje zone te caktuar, Qeveria e Shqiperise ose do ti marre persiper vete punimet per ndreqjen e tyre, neqoftese sondazhi eshte kryer para Dates se Fillimit ose do te paguaje Shoqerine per rregullimin e shmangieve te tilla ne keto zona perkatese, ne menyre te tille qe ato te mund te perdoren dhe te operohen per te permbushur detyrimet e Shoqerise ne kete Kontrate, neqoftese sondazhi eshte kryer para Dates se Fillimit.Keto

punime do te kryhen ne nje date te caktuar bashkarisht nga Palet. Per qartesi, ky kusht nuk krijon detyrim vazhdues per Qeverine e Shqiperise.

SHTOJCA 24

PAISJET E AERODROMIT

1. Paisjet e aerodromit

Shoqëria do të jetë përgjegjëse për sigurimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e paisjeve të përshtatshme në anën e aerodromit për të lehtësuar verpimtarinë e aeroportit duke marrë parasysh volumin e trafikut të pasagjerëve dhe të kargos si dhe llojet e avionëve që fluturojnë duke u plotësuar kushtet e nevojshme për mirëmbajtje normale.

Shoqëria do të sigurojë që paisjet e anës së aerodromit do të mbahen në kushte mirë gjatë gjithë Periudhës së Koncesionit.

2. Ndërtesa e paisjeve të anës së aerodromit

Shoqëria ndërmerr që sipas nevojës të zgjerojë ndërtesën ekzistuese të paisjeve të anës së aerodromit ose të projektojë dhe ndërojë një ndërtesë të re funksionale me skelete çeliku ("Ndërtesa e Paisjeve të anës së aerodromit") për të strehuar paisjet kurdo që nuk janë në përdorim.

Ndërtesa do të ketë përmasat e nevojshme për të strehuar automjetet e paisjeve të mirëmbajtjes.

Ndërtesa e Paisjeve të anës së Aerodromit do të jetë strukturë një-katëshe me skelete çeliku me fasada të mbyllura (me tulla dhe panele muri) në tre anë dhe derë/portë në njërën anë që të lejojë hyrjen e paisjeve dhe automjeteve. Kjo ndërtesë do të ketë zyra në njërën anë të sallës dhe magazinë në katine ndërmjetëm mbi zyrat. Lartësia e sallës do të jetë përafërsisht 7 metra me dimensine përafërsisht 25 x 15 metra. Kjo ndërtesë do të ketë zyrë dhe dhoma për personelin si dhe një servis të lëvizshëm.

Ndërtesa e Paisjeve të Anës së Aeroportit do të ndodhet në afërsi të vendqëndrimit të Avionëve , sipas parashikimit të bërë në Masterplanin e Përditësuar të Aeroportit.

SHTOJCA 25

RRUGA PERIMETËR E AEROPORTIT DHE PERIMETRI I RRETHIMIT TE SIGURISE SË AEROPORTIT

1. Rruga Perimetër nga ana e aerodromit

Shoqëria do të ndërtojë një rugë perimetër nga ana e aerodromit e cila do të jetë pjesë e sistemit të sigurimit të perimetrit të aeroportit. Drejtimi i kësaj rruge do të ndjekë drejtimin e rrethimit të perimetrit për aq sa është e mundur me qëllim që të lejojë mbikqyrjen e tërë gjatësisë së rrethimit.

Rruga e perimetrit do të jete e gjerë 3.5 metra dhe me një korsi me pendencë të mjaftueshme për të lehtësuar rrëshqitjen e zhveshjeve të sipërfaqes. Shoqëria do të sigurojë që kjo rrugë do të jetë e shtruar dhe mirëmbahet në mënyrën e duhur që të lejojë qarkullimin e automjeteve të patrullave të sigurimit.

Shoqëria do të përfundojë ndërtimin e rrugës së perimetrit nga ana e aerodromit brenda gjashtë muajve nga Data e Fillimit.

2. Rrethimi i Perimetrit

Shoqëria do të plotësojë rrethimin e perimetrit të sigurimit brenda tre muajve pas Datës së Fillimit dhe do të mirëmbajë rrethimin me qëllim që të kontrollohet hyrja në zonat me trafik të kufizuar të aeroportit sipas ICAO Shtojca 17 – Standardet Ndërkombëtare dhe Praktikat e

Rekomanduara.

Rrethimi i plotësuar i perimetrit të sigurimit do të jetë në standardet BS1722: Pjesa 10 ose një kod tjetër ndërkombëtarë të ngjashëm. Ky rrethim do të futet në tokë në thellësinë 300mm nga sipërfaqa e përfunduar. Lartësia mbi tokë e rrethimit do të jetë 2.4 metres me majat e hekurave të drejtuara nga jashtë dhe me tre rradhë tel me gjëmba.

Shoqëria do të përdorë një sistem vëzhgimi me kamera CCTV përgjatë rrethimit të sigurimit të perimetrit për të mundësuar vëzhgimin e të gjithë pjesëve të perimetrit nga një pikë kontrolli qëndrore.

Shoqëria do të përdorë një sistem ndriçimi përgjatë perimetrit të sigurimit me një nivel drite 5 lux.

Shoqëria do të krijojë dhe mirëmbajë një brez prej 3 metrash në të dy anët e rrethimit të perimetrit të sigurimit (nëse Shoqëria ka të drejtë të bëjë një gjë të tillë jashtë rrethimit të perimetrit të sigurimit) dhe Organi Shtetëror përkatës do të sigurojë ndihmën e nevojshme për të mbajtur të pastër brezin jashtë Zonës së Koncesionit. Në ato vende ku kjo gjë nuk është e mundur, do të përdoret një standard më i lartë i mjaftueshëm për rrethimin e perimetrit nga Shoqëria për të siguruar që rrethimi nuk mund të kalohet me lehtësi.

Shoqëria do të sigurojë që të gjitha hyrjet e sigurisë për automjetet, hyrjet për këmbësorët dhe crash gates janë sipas standartit të BS 1722: Pjesa 10 ose një kod tjetër ndërkombëtarë të ngjashëm.

SHTOJCA 26

SHËRBIMET KOMUNALE

1. Energjia Elektrike

Shoqëria do të sigurojë energji elektrike të vazhdueshme për furnizimin e Terminalit të Ri, qendrën e operacioneve, kullën e re të kontrollit të trafikut ajror dhe të gjitha sistemet në aerodrome me kapacitet për Fazën A të Terminalit të Ri dhe hapësirat e zyrave, me kapacitet për zgjerim në mënyrë që të përballojë kërkesat maksimale të Aeroportit në Fazën B kur Terminali i Ri do të jetë në përdorim.

Shoqëria do të sigurojë që sistemet dytësore të furnizimit me energji elektrike kanë ngarkesën e duhur për të furnizuar Aeroportin gjatë ndërprerjeve të furnizimit me energji elektrike nga burimet primare. Sistemi rezervë do të projektohet që të japë energji elektrike shtesë në rast emergjence për ndricimin e aerodromit, ndricimin në zonat publike, në ndërtesat e zjarrfikëseve dhe në pajisje të tjera për funksionimin e sigurt të Aeroportit.

Shoqëria do të sigurojë që projektimi dhe instalimi i sistemeve elektrike të Aeroportit është në përputhje me ICAO Manualin e Projektimit të Aerodromeve Pjesa 5 – Sistemet Elektrike.

2. Furnizimi me energji elektrike nga jashtë aeroportit

Shoqëria do të ndërtojë në Zonën e Koncesionit, kabina transformatorësh të reja nga 20kv deri në voltazh të mesëm /6 kV dhe voltazh të ulët /0.4kV. Projektimi i hollësishëm do të ndërmerret nga Shoqëria në vijim të fillimit të Periudhës së Koncesionit.

3. Furnizimi me Ujë

Shoqëria do të jetë përgjegjëse që furnizimi me ujë të plotësojë nevojat e aeroportit.

Shoqëria sigurojë furnizim të mjaftueshëm me ujë të pijshëm të aeroportit për Fazën A të Terminalit të Ri dhe Fazë B të Terminalit të Ri dhe hapësirave të zyrave, sëbashku me furnizimin dhe rezervimin e ujit të pijshëm dhe ujë të mjaftueshëm për zjarrfikësit dhe ujitje.

4. Sistemi i Furnizimit me Ujë

Shoqëria do të shpojë tre burime të reja uji në Aeroport në mënyrë që të sigurojë furnizim me ujë të mjaftuëshëm për kërkesat në rritje të pasagjerëve, vizitorëve dhe trajtuesve të cateringut.

Furnizimi me ujë të pijshëm për stacionin e zjrrfikësve do të bëhet më anë të një rezervuari me kapacitet prej 25,000 litra i cili mund të zmadhohet sipas nevojës gjatë Periudhës së Koncesionit duke marrë parasysh nivelin e trafikut dhe llojet e Avionëve që përdorin Aeroportin.

5. Sistemi i ujit të pijshëm

Furnizimi me ujë të pijshëm do të sigurohet nga Shoqëria për të plotësuar kërkesat deri në 2,5 l/s për Fazë B të Aeroportit duke përfshirë Terminalin e Ri.

Shoqëria do të ndërtojë një stacioni përforcimi që të plotësojë kërkesat në orët më të ngarkuara me 2,5 l/s me presion prej 5 atmosferë.

Ky stacion përforcimi do të përfshijë (por jo vetëm këto paisje) një depozitë të balancuar uji të pastër, një pikë kontrolli (duke përfshirë dhomën e mbikqyrjes), dhe të gjitha paisjet mekanike dhe elektrike të nevojshme për funksionimin e presionit me aggregate rezervë për mbrojtjen e sistemit. Do të instalohet dhe një gjenerator si burim dytësor energjie me kapacitet të mjaftueshëm për të furnizuar stacionin e përforcimit të ujit të pijshëm.

6. Ujrat e zeza

Shoqëria do të instalojë dhe mirëmbajë gjatë Periudhës së Koncesionit një impiant për përpunimin e urjave të zeza në aeroport, për të trajtuar të gjitha ujrat e zeza para se ato të shkarkohen në natyrë.

Impianti i përpunimit të ujrave të zeza do të jetë në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe me kapacitet maksimal të mjaftueshëm për Fazën A të Terminalit të Ri dhe i zgjerueshëm që të përballojë kapacitet maksimal gjatë Fazës A dhe B të Terminalit të Ri.

Impianti ipërpunimit të ujrave të zeza do të projektohet që të ketë kapacitet të trajtojë dhe ujrat e zeza nga avionëtët.

Pjesët e mëposhtme të Shtojcës 26 janë përfshirë për të dhënë hollësitë të mëtejshme për Marrëveshjen mes Palëve në lidhje me çështjet teknike dhe janë në varësi të dispozitave të tjera të kësaj Kontrate (duke përfshirë edhe këto Shtojca).

7. Sistemi i Kanalizimit të Ujrave të Zeza

Sistemi kanalizimeve do të krijohet nga Shoqëria si një sistem i ri i veçantë për kanalizimet e ujrat e zeza pa lidhje me pika kullimi sipërfaqsore.

Sistemi i kanalizimeve do të mbledhë ujrat e zeza/të ndenjura të Terminalit të Ri. Në këtë sistem do të lidhen të gjitha hapësirat e ndërtuara rishtazi në Aeroport si dhe ato të rimodeluara të Terminalit Ekzistues. Ujrat e zeza të mbledhura në Aeroport do të shkarkohen në impiantin e përpunimit të ujrave të zeza të instaluar nga Shoqëria.

Sistemi i kanalizimeve të ujrave të zeza do të përfshijë kryesisht gropa të thella kanalizimesh dhe lidhje të pjerrëta kanalizimesh në ndërtesa. Në rastet kur ekzistojnë diferenca të theksuara niveli (p.sh ndërtimet me bodrume të thella) sisteme ngritëse brënda ndërtesës do të instalohen.

Në rast zgjerimi të hapësiravë ndihmëse të Aeroportit dhe në rast se është e nevojshme, Shoqëria do të konsiderojë dhe vërë në përdorim një sistem të decentralizuar, si gropat septike.

8.Instalimi i Impianti të Përpunimit të Kanalizimeve të Ujërave të zeza të Aeroportit

Impianti i përpunimit të kanalizimeve që do të instalohet nga Shoqëria do të trajtojë në përgjithësi ujrat e zeza të Terminalit të Ri, Terminalin Ekzistues të Rimodeluar dhe hapësirat e përshkruara më sipër. Do të bëhen disa lëshime për disa zona shtesë por pa lidhje me pikat e kullimit të ujit në sipërfaqe.

Impianti i përpunimit të kanalizimeve të Aeroportit do të jetë në gjendje të përballojë sipas të dhënave të para-projektimit ngarkesë për deri në 1.5 milion pasagjerë në vit dhe duhet të zgjerohet sipas nevojave të trafikut ajror të pasagjerëve në Aeroport nëse kalohet ky nivel në mënyrë të vazhdueshme.

Impianti i ri i përpunimit të kanalizimeve do të plotësojë të gjitha kushtet dhe standardet sipas Direktivës Evropiane EU 91/271/EWG, të 21 Maj 1991 dhe ligjit të zbatueshëm.

9. Telekomunikacionet

Kompania do të jetë përgjegjëse për instalimin e duhur të telekomunikacionit dhe sistemeve IT në Zonën e Koncesionit, për ti shërbyer nevojave të Aeroportit dhe gjithashtu mund të ofrojë sisteme të tilla për Personat e tjerë, nëse bihet dakort midis Shoqërisë dhe Personave të tjerë. Qeveria e Shqipërisë do të jetë përgjegjesë për parashikimet e hyrjeve dhe lidhjeve në rrjetin nacional të telekomunikacionit dhe shtrirjen e një linje kabllore të kërkuar nga rrjeti nacional në Zonën e Koncesionit për aq kohë sa Qeveria e Shqipërisë mbetet furnizuesi i vetëm i linjës fikse të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë

SHTOJCA 27

RRUGA HYRËSE E AEROPORTIT, RRUGËT QARKULLUESE TË AEROPORTIT DHE PARKINGU I MAKINAVE FAZA A

1. Ura e re

Shoqëria do të projektojë dhe, sipas miratimit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacioneve në varësi dhe të shpronësimit të ndonjë pjese toke që nevojitet për të lidhur Rrugën Hyrëse Ekzistuese të Aeroportit me Urën e Re më të gjerë, të ndërtojë dhe lidhë me Rrugën Hyrëse në Aeroport një urë të re përmes lumit të Tërkuzës ("Ura e Re").

Ura e Re do të projektohet dhe ndërtohet në përputhje me Manualin e Projektimit të Urave dhe Rrugëve të Drejtorisë së Transportit të Mbretërisë së Bashkuar ose ndonjë standart tjetër ndërkombëtarë të pranuara. Ura e Re do të projektohet dhe do të ketë një gjerësi prej 7.5 metrash (3.75 metra në secilin drejtim).

Ura e Re do të projektohet dhe ndërtohet e përshtatshme për automjetet me peshë prej 4,500 kilogramësh në aks.

Shoqëria do të sigurojë që hyrja e vazhdueshme për në aeroport, në hapësirat ushtarake në afërsi të aeroportit dhe zonat e banuara fqinje nuk do të pengohet nga punimet e bëra nga ose në emër të Shoqërisë për ndërtimin e Urës së Re.

Parkimi makinave në rrugën e hyrëse dhe rrugët qarkulluese të Aeroportit (të përkufizuara më poshtë) gjatë veprimtarisë së Aeroportit do të jetë i ndaluar (përveçse në zonat e përcaktuara) dhe Shoqëria/Organi Përkatës Shtetëror do të jetë përgjegjës gjatë Periudhës së Konçesionit për zbatimin e këtij ndalimi.

2. Rrugët Qarkulluese të Aeroportit dhe parkingu makinave në Fazën A

Shoqëria do të ndërtojë dhe përfundojë një rrugë anësore të gjerë prej 7.5 metra që do të realizojë hyrjen për në Terminalin e Ri nga Rruga Hyrëse Ekzistuese me drejtim siç paraqitet në Skicat e Planit të Zonës së Terminalit Shtojca 16 (Projekti Teknik i Miratuar) ("Rrugët Qarkulluese të Aeroportit"). Shoqëria do të jetë përgjegjëse për shkatërrimin e ndonjë ndërtese në rrugën e propozuar të Rrugët Qarkulluese të Aeroportit. Rrugët Qarkulluese të Aeroportit do të projektohen që të lejojnë hyrjen nga zonat e karburantit dhe të mirëmbajtjes së aerodromit për në zonat e Aeroportit, dhe do të sigurojë hyrje të vazhdueshme për në zonën ushtarake dhe për në Terminali Ekzistues gjatë ndërtimit.

Shoqëria do të projektojë, ndërtojë dhe mirëmbajë Parkingun e Makinave në fazën A, që përfshin hapësirën për parking autoveturash me qëndrim të gjatë dhe të shkurtër për një minimum prej 500 autoveturash ose kamionësh në afërsi të Terminalit të Ri, që do të jetë i zgjerueshëm, dhe do të përfshijë zonat për pritjen e taksive, furgonëve dhe hipjen e zbritjen nga autobusat dhe për parkim. Pesëdhjetë për qind (50%) e këtij parkingu do të mbulohet (nga struktura mjaft të forta që t'u qëndrojnë kushteve klimaterike në Zonën e Konçesionit) që të mbrojë makinat e parkuara nga rrezatimi i drejtpërdrejtë i diellit.

Shoqëria do të sigurojë që Parkingu Makinave në Fazën A do të jetë i ndriçuar gjatë periudhës së errësirës kur të vihet në funksionim dhe do të marrë masat e nevojshme të mjaftueshme për sigurinë e publikut dhe për automjetet e parkuara. Biletat do t'u jepen shoferëve në hyrje të parkingut të makinave dhe dalja nga parkingu do të jetë lejohet vetëm me anë të një bilete të vlefshme.

3. Kontrolli mjedisor dhe projektimi urban dhe Panorama

Shoqëria do të jetë përgjegjëse për të krijuar përputhje me projektimin e rrugëve, buzëve të trotuarit, sinjalizimeve dhe paisjeve të rrugëve.

Shoqëria do të mirëmbajë standartin panoramik, të pregatisë dhe të zbatojë një Plan të Administrimit Panoramik duke detajuar propozime për pastrimin e rrugëve dhe propozimet per mirembajtjen Panoramike.

SHTOJCA 28

NDRIÇIMI TOKËSOR I AERODROMIT

Shoqëria do të projektojë dhe instalojë ndriçim në anët e rrugëve lidhëse C, D2 & W. Projektimi dhe instalimi i një ndriçimi të tillë do të jetë në përputhje me Shtojcën 14 te ICAO-s, Manualin e Projektimit të Aerodromeve te ICAO-s, Pjesa 4, Mjetet Pamore dhe Pjesa 5, Sistemet Elektrike.

Shoqëria do të sigurojë që furnizimi me energji elektrike në Aeroport është i mjaftueshëm për të plotësuar kërkesat në rritje të ndriçimit që Shoqëria do të instalojë në anët e rrugëve lidhëse.

Shoqëria zotohet të bashkëpunojë me "ANTA" për instalimin e kontrollit të ndriçimit tokësorë të aerodromit dhe një panel të ngjashëm në kullën e re të kontrollit të trafikut ajror dhe për ndonjë përmirësim të kontrollit të ndriçimit tokësorë të aerodromit dhe mbikqyrjen e sistemit në vazhdimësi.

Ndriçimi i Afrimit

E gjithë toka e nevojshme për ndriçimin e afrimit ekzistues jashtë Zonës së Koncesionit do të shpronësohet nga Qeveria e Shqipërisë dhe transferohet Shoqërisë jo më vonë se tre muaj pas Datës së Fillimit. Kjo pjesë toke shtesë do të bëhet pjesë e Zonës së Koncesionit dhe do ti transferohet Shoqërise përpara sesa Shoqëria të bëhet përgjegjëse per operimin dhe mirëmbajtjen e Ndriçimit të Afrimit dhe do të shfrytëzohët nga Shoqëria me Uzufrukt ashtu sikurse dhe pjesa tjetër e Zonës së Koncesionit sipas përcaktimit të bërë në Shtojcën 15 (Zona e Koncesionit).

Pas Datës së Fillimit, Shoqëria do të jetë përgjegjëse për operimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit të afrimit ekzistues brenda Zonës së Koncesionit. Çdo ndricim i afrimit ekzistues jashte Zonës së Koncesionit do të vazhdojë të mirëmbahet nga Organi Shtetëror perkates (ti përcaktohet Shoqvrise përpara Dates së Fillimit) derisa Shoqëria të marrë përsipër përgjegjësine per operimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit të afrimit. Kjo do të përfshijë sigurimin e tokës shtesë të përdorur Ndriçimin e Afrimit me anë të masave të mjaftueshme kurdo që të jetë e nevojshme. (për shembull, me rrethim).

Shoqëria mund të hyjë në mërrevshje të veçanta me fermerët vendas në lidhje me të ardhmen bujqesore të tokës së përdorur për Ndriçimin e Afrimit dhe që nuk ndikon në sigurinë e opracioneve të aeroportit.

Shoqëria do të mbledhë pagesat përkatëse të ndriçimit të aerodromit nga Përdoruesit e Aeroportit në përputhje me këtë Kontrate.

Përmirësimi i Ndriçimit të afrimit në të Ardhmen

Toka e përdorur për përmirësimin e ndriçimit të afrimit do të shpronësohet nga Qeveria e Shqipërisë dhe transferohet Shoqërisë para së Shoqëria të jetë përgjegjëse për funksionimin dhe mirëmbajtjen e ndriçimit të afrimit të përmirësuar. Të gjitha shpenzimet në lidhje me investime të ardhshme të nevojshme për përmirësimin e Ndriçimit të Afrimit do të përballohen nga ANTA. Për sqarim, nëse ANTA dëshiron të përmirësojë Kategorinë e Aeroportit, ANTA do të jetë përgjegjëse dhe për ndonjë instalim ndriçimi në vijën e mesit të pistës dhe shpenzimet që sjell ajo.

Pjesët e mëposhtme në Shtojcën 28 janë përfshirë për të dhënë hollësitë e mëtejshme të marrëveshjes mes palëve në lidhje me çështjet teknike dhe janë në varësi të pikave të tjera të kësaj Kontrate (duke përfshirë edhe Shtojcat).

Shoqëria do të jetë përgjegjëse për funksionimin, mirëmbajtjen, zëvendësimin dhe kurdo e nevojshme në rastet e zgjerimit të rrugëve të shtruara, të zgjerojë të gjithë ndriçimin e përdorueshëm në Aeroport.

Në truallin e aeroportit, the Shoqëria do të instalojë paisjet e ndriçimit të mëposhtme:

Ndriçimi i Pistës do të përshijë anët e pistës, fundin e pistës dhe dritat kufizuese të pistës (që ekzistojnë pjesërisht);

Ndriçimi i rrugëve lidhëse do të përfshijë ndriçimin e skajeve të rrugëve lidhëse dhe dritat kufizuese të rrugëve lidhëse(që ekzistojnë pjesërisht);

Sinjalizimet udhëzuese të rrugëve lidhëse (që ekzistojnë pjesërisht);

Ekzaminimi i hollësishëm dhe përmirësim i nevojshëm (furnizimi me energji elektrike dhe furnizimi me energji elektrike në raste urgjencash) i pasijeve të nënstacionit të ndriçimit të

aerodromit;

Instalimi i kontrollit të ndriçimit tokësorë dhe paneli i ngjashëm në kullën e re të kontrollit të trafikut ajror (sipas Shtojces 35 të kësaj Kontrate); dhe

Mbrojtja kabllore dhe tokëzimi/ rrufepritëset.

Kushtet Operacionale

Të gjitha sistemet dhe paisjet do të projektohen nga Shoqëria që të plotësojnë kushtet e ICAO për CAT I të sistemeve të ndriçimit të afrimit të saktë në pistë dhe rrugët lidhëse dhe t'i shërbejë funksionimit të pistës për mbërritjen dhe largimin në të dy drejtimet.

Standardet dhe specifikimet

Shoqëria do të sigurojë që të gjitha paisjet e dorëzuara janë të në përputhje me praktikat ndërkombëtare dhe standardet dhe të kenë besueshmëri në përdorim të provuar në aeroportet kryesore ndërkombëtare.

Hollësitë e Ndriçimit

Ndriçimet e përshtatshme për anët e pistës për CAT I të instaluara në të dyja anët e pistës do të kontrollohen dhe mirëmbahen nga Shoqëria kurdo që të jetë e nevojshme.

Ndriçimi i fundit të pistës do të instalohet nga Shoqëria në të dyja anët e pistës. Të paktën gjashtë copë drita të fundit të pistës do të instalohen. Dritat e fundit të pistës do të jenë njëdrejtimëshe dhe do të japin dritë të kuqe me intensitet të ndryshueshëm në drejtimin e pistës. Dritat e fundit të pistës do të jenë të lidhura me qarqet e dritave në anët e pistës dhe do të kontrollohen së bashku.

Ndriçimin e pragut të pistës do të instalohet nga Shoqëria në të dyja skajet kënddrejta me akset e pists dhe të vendosura 3 metra jashtë skajit të fundeve të pistëve. Ndriçimi i secilës anë do të përbëhet nga 18 copë drita njëdrejtimëshe të ngritura në mënyrë të barabartë me 3 metra distancë mes tyre. Dritat e anëve të pistës do të hyjnë në drejtim të vijës së mesit të pistës me 3.5 gradë.

Ndriçimi shumë drejtimësh i anëve të Pistës do të sigurohet nga Shoqëria në anët e rrugëve lidhëse W(C), D2 dhe E, dhe kurdo që të jetë e mundur,sistemet ekzistuese do të riparohen për këtë qëllim. Dritat e anëve të rrugëve të pistës do të jenë në distancë prej 60 m në pjesët e drejta, dhe 30 m në pjesët e shkurta dhe përafërsisht 15-5 m në kthesa.

Dritat ruajtëse të Pistës sipas konfigurimit A, do të instalohen nga Shoqëria në të gjitha pozicionet mbajtëse në përputhje me ICAO Shtojca 14. Dritat ruajtëse të pistës përbëhen nga dy çifte dritash të verdha një drejtimëshe me rele alternative të vendosura në të dyja anët e rrugës lidhëse. Të dy çiftet e dritave do të lidhen me dy qarqet alternative të anëve të pistës dhe kontrollohen së bashku me ndriçimin e anëve të rrugës lidhëse.

Shenjat drejtuese të rrugëve lidhëse do të sigurohen nga Shoqëria, në përputhje me ICAO Shtojcën 14, dhe do të përmbajnë shenja detyruese dhe informuese (shenja vendndodhj, shenja drejtimi dhe shenja destinacioni). Këto shenja do të plotësohen nga Shoqëria. Të gjitha shenjat udhëzuese të rrugëve lidhëse do të ndriçohëen nga brenda dhe do të jenë të montuara në nyja bashkuese të thyeshme me qëllim që të sigurojnë pamje të qartë për pilotët që afrohen shenjës, duke ruajtur distancën nga anët e rrugëve të asfaltuara, mbështetëset e motorrit dhe shfryrjet e tepërta të motorrëve.

Të gjitha ndërtesat dhe strukturat ekzistuese në hapësirën e aeroportit që përbëjnë pengesa sipas ICAO Shtojca 14, do të shënohen me drita pengesash nga Shoqëria (ose ANTA në rastin e strukturave dhe ndërtesave të kontrollit të trafikut ajror ose ndërtsave dhe strukturave të tjera nën kontrollin e ANTA, ose të palëve të treta).

Ndriçimi i Vendqëndrimit të Avionëve

Ndriçimi me prozhektorë i Vendqëndrimit të Avionëve do të sigurohet nga Shoqëria në zonat e vendqëndrimit të pasagjerëve dhe kargos. Ndriçimi i të gjitha vendqëndrimeve do të jetë në përputhje të ICAO-s Shtojca 14, seksioni 5.3.20 dhe të Manualit të Projektimit të Aerodromeve Pjesa 4: Mjetet Pamore.

Zona e qëndrimit të avionëve do të ndriçohet jo më pak se përafërsisht 100 m në thellësi dhe 560 m në gjatësi. Instalimet e prozhektorëve të dritës do të jetë në shtylla të ngritura (aty ku nuk janë të instaluara) në një rradhë përgjatë vendqëndrimit të Avionëve . Lartësia më e madhe e shtyllave parashikohe të jetë përafërsisht 25 m.

SHTOJCA 29

MJETET KUNDRA ZJARRIT DHE TË SHPËTIMIT DHE KONTROLLET PËRKATËSE

1. Paisjet e zjarrit dhe të shpëtimit

Shoqëria do të sigurojë paisje zjarri dhe shpëtimi në përputhje me standardet e përcaktuara në Shtojca 14 të ICAO-s dhe Manualin e Shërbimeve të Aerodromit të ICAO-s Pjesa 1.

Shoqëria do të projektojë, sigurojë dhe mirëmbajë paisjet kundra zjarrit për shpëtimin e aerodromeve të Kategorisë 7.

Shoqëria do të rrisë nivelin e paisjeve kundra zjarrit në përputhje të plotë me ICAO Shtojca 14 gjatë Periudhës së Koncesionit sipas zgjerimit të trafikut dhe të Aeroportit.

2. Stacioni Zjarrfikësve

Shoqëria do të sigurojë një stacion zjarrfikësesh në Aeroport për të strehuar paisjet, personelin dhe automjetet kundra zjarrit.

Projekti dhe vendndodhja e stacionit të zjarrfikësve do të përcaktohet në Planin Kryesorë të Azhornuar të Aeroportit.

Shoqëria do të sigurojë që vendndodhja e stacionit të zjarrfikësve dhe paisjeve kundra zjarrit do të lejojnë veprimet të ndërmerren në afatet kohore të mëposhtme; dy minuta, dhe të mos kalojnë tre minuta për të arritur secilën anë të pistës, si dhe të gjitha pjesët e tjera të qarkullimit, në kushte optimale të sipërfaqes dhe pamshmërisë.

Shoqëria do të sigurojë që stacioni zjaffrikësve do të ketë një njësi kundra zjarrit dhe shpëtues, me paisjet përkatëse për strehimin dhe mbrojtjen e automjeteve, anëtarëve të ekuipazhit dhe ato shërbime operacionale të nevojshme për të siguruar aftësine e tyre të vazhdueshme për tu përgjigjur në kohë dhe me efektivitet në raste urgjencash.

3. Kontrollet e Shpëtimit dhe Zjarrit

Shoqëria do të sigurojë që një inspektor sigurimi do të kryejë në mënyrë të rregullt kontrolle të shërbimeve kundra zjarrit dhe shpëtuese në Aeroporte, rezultatet e këtyre kontrolleve të paraqiten me kërkesë të Organit Përkatës Shtetëror.

Shoqëria do të përmirësojë procedurat e urgjencave në Terminalin Ekzistues duke siguruar dalje në raste zjarri dhe tabela të mjaftueshme menjëherë pasi të vlerësohen si duhet këto procedura, dhe ky vlerësim të fillohet menjëherë që të jetë e mundur pas Datës së Fillimit.

SHTOJCA 30

FAZA B E TERMINALIT TË RI DHE FAZA B E PARKIMEVE TE AUTOMJETEVE

1.FAZA B e Terminalit të Ri

Shoqëria do të projektojë, ndërtojë, vere ne pune, vërë në përdorim dhe mirëmbajë Fazën B të Terminalit të Ri në mënyrë që Faza A e Terminal të Ri dhe FAZA B e Terminalit të Ri të formojnë një ndërtesë dhe të mund të funksionojnë si një terminal i vetëm aeroporti me lidhje të brendshme në të gjitha nivelet. Shoqëria do të sigurojë që pas Datës së Hapjes së Fazës B të Terminalit të Ri, kapaciteti i orëve me ngarkesë i Terminalit të Ri te jete të paktën 750 pasagjerë në orë (SBR) dhe kapaciteti vjetor i Terminalit të Ri te jete të paktën 1.5 milion pasagjerë.

Shoqëria do të sigurojë që pas Datës së Hapjes së Fazës B të Terminalit të Ri, Terminali i Ri dhe funksionet e tij te jenë në përputhje me, pa kufizim, me Shtojcen 37 (Administrimi Operacional pas Përfundimit të Fazës A të Terminalit të Ri) dhe Shtojcen 17 (Kodet, Standardet, Rregulloret dhe Botimet e tjera) duke marrë parasysh rritjen e nevojshme të kapacitetit dhe të trafikut aktual nëse është e nevojshme.

Seksionet e mëposhtme të Pjesës 1 në Shtojcen 30 janë përfshirë për të dhënë hollësi te mëtejshme të marrëveshjes se palëve në lidhje me çështjet teknike dhe jane ne varesi te Pikave të tjera të kësaj Kontrate (perfshi ketu edhe shtojcat e saj).

Dispozitat e Pjeses 3 (Cështje të tjera) të Shtojces 19 do të zbatohet dhe për fazën B të Terminalit të Ri sa here te shihet e përshtatshme dhe te mos jete e percaktuar shprehimisht se jane te zbatueshme vetem ndaj Fazës A të Terminalit të Ri.

FAZA B e Terminalit të Ri – Nisjet

Sistemi i përpunimit të bagazheve do të zgjerohet me një pjesë të dytë të zonës së kontrollit me ekranizim dhe rradhitës të krijuar, sipas grafikut të mëposhtëm të qarkullimit të bagazheve:

Sistemi i Përpunimit të Bagazheve Faza B

Të gjitha pikat e kontrolli do të kenë dy rripa transportues, sipas përshkrimit në Fazën A të Terminalit të Ri. Në Fazën B, do të shtohet dhe një qendër tjetër kontrolli me një total prej 10 pikash kontrolli shtesë.

FAZA B e Terminalit të Ri – Kontrolli me rreze-X

Nga të gjitha qendrat e kontrollit, bagazhet do të dërgohen për kontrollim me makineri. Në rast të një defekti teknik bagazhet mund të transferohen nga njëri sistem në tjetrin sipas grafikut të qarkullimit. Procesi mund të përshkruhet si Faza A e Terminalit të Ri.

FAZA B e Terminalit të Ri – Sistemi i Mbërritjeve

Sistemi i mbërritjeve do të përbëhet nga rripat për bagazhet, sipas përshkrimit të Fazës A të Terminalit të Ri. Në Fazën B, do të instalohet një rrip bagazhi shtesë. Gjithsej sistemi i mbërritjes do të ketë tre rripa për bagazhet.

2. FAZA B e Parkimit te Automjeteve

Shoqëria do të projektojë, ndërtojë, vere ne pune, vërë në përdorim dhe mirëmbajë Fazën B të Parkingut të Makinave, me kapacitet për një minimum prej 250 autoveturash shtesë ose automjetesh të mëdha në afërsi të Terminalit të Ri. Faza B e Parkingut të Makinave do të jetë e hapur për përdorim nga Publiku jo më vonë se 60 ditë pas Datës së Hapjes së Fazës B të Terminalit të Ri.

Shoqëria do të sigurojë që Faza B e parkingut të Makinave do të jete e ndricuar ne te gjitha orët e errësirës, gjate perdorimit te saj dhe do të sigurojë mbrojtje të mjaftueshme për publikun dhe automjetet e parkuara. Biletat do t'u jepen drejtuesve të automjeteve në hyrje dhe dalja nga parkingu do të bëhet vetëm me paraqitjen e një bilete të vlefshme.

SHTOJCA 31

FAZA B E QENDRËS SË RE TË KARGOS

Shoqëria do të projektojë, ndërtojë, vere ne pune, vërë në përdorim dhe mirëmbajë Qendrën e Re të Kargos Ajrore të Fazës B duke siguruar kapacitetin e përgjithshëm të Fazave A dhe B të Qendrës së Re të Kargos Ajrore për të paktën 6,000 ton ngarkesë në vit në mënyrë të përcaktuar.

Shoqëria do të sigurojë që pas venies ne pune të Fazës B Qendrës së Re të Kargos Ajrore, Qendra e Re e Kargos Ajrore (Fazat A dhe B të Qendrës së Re të Kargos Ajrore) dhe funksionimi i tyre te jenë në përputhje ne cdo pike me Shtojcen 22 ("Faza A e Qendrës së Re të Kargos Ajrore"), por duke marrë parasysh rritjen e kapacitetit në ton për ngarkesën vjetore të përcaktuar në Shtojcen 31 ("Faza B Qendrës së Re të Kargos").

Faza B e Qëndrës së Re të Kargos Ajrore duhet të ndërtohet ngjitur me Qëndrën e Re të Kargos Ajrore Faza A.

Kjo qendër do të ndërtohet në një mënyrë të tillë që të mos pengoje nje funksionim te saj nga

një shoqeri e dytë e përpunimit të Kargos.

SHTOJCA 32

RRUGA E RE HYRESE

Shoqëria do të projektojë, ndërtojë dhe vere ne pune Rrugën e Re Hyrese sipas drejtimit te përshkruar në dokumentet dhe skicat e bashkëngjitura. Qeveria e Shqipërisë eshte përgjegjëse për shpronësimin e tokës, sipas skicave të bashkangjitura, dhe kompesimi i nevojshëm për Rrugën e Re Lidhëse që Shoqëria do t'i rimbursojë Qeverisë së Shqipërisë në lidhje më këtë shpronësim është deri në 2 milion EURO. Shoqëria nuk është e detyruar të fillojë punimet e ndërtimit në lidhje me Rrugën e Re Hyrese derisa e tërë toka e paraqitur në skicat e bashkangjitura te jete shpronësuar nga Qeveria e Shqipërisë.

Nje shume shtese 2 milion EURO, do te sigurohet nga Shoqeria, qe të mund te tërhiqet brenda periudhës qe shtrihet pas datës së njëvjetorit të Datës së Fillimit deri në datën e dyvjetorit pas Datës së Fillimit në lidhje me shpenzimet e marrjes së tokës ose shpenzimeve të ndërtimit të Rrugës së Re Hyrese, ose te dyja bashke.

Shoqëria do të ndërtojë dhe vere ne pune Rrugën e Re Hyrese brenda Periudhës së Detyrimeve të Kërkuara në Shtojcen 5 ("Sanksionet për Mospërmbushjen e Detyrimeve Kryesore") (në varësi të zgjatjes së afateve kohore në lidhje me rastet e Forcës Madhore dhe/ose Rastet e Shkarkimit) pas Shpronësimit të Tokës së Nevojshme, dhe marrjes së lejeve dhe miratimeve të nevojshme si dhe të drejtave në lidhje me Uzfruktin. Rruga e Re Lidhëse dhe urat do të projektohen dhe ndërtohen nga Shoqëria në përputhje me Manualin e Projektimit, raport ky i pergatitur nga Ministria e Punëve Publike, Këshilli i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit në Republikën e Shqiërisë, Maj 1997, vlefshmëria e te cilit është miratuar me shkrim nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve Departamenti Teknik, me një letër datë 7 Prill 2004 nr. Protokolli 1535 për DPAC. Rruga e Re Lidhëse do të projektohet dhe ndërtohet për një trafik prej 4 milion aksesh standarte dhe për tridhjetë vjet jetë. Urat do të projektohen dhe ndërtohen për njëqind e njëzet vjet (120) dhe sipas standarteve të përmendura më lart nen titullin "Zbatimi i Projektit", te miratuar nga Organi Shtetëror Përkatës para nënshkrimit të Kontrates.

Shoqëria do t'i transferojë Rrugën e Re Hyrese Qeverisë së Shqipërisë në këmbim të LEK 1 (një) pas përfundimit të Rrugës së Re Lidhëse në përputhje me këtë Kontrate pas konfirmimit nga Inxhinieri i Pavarur, dhe para hapjes së rrugës për trafikun normal publik.

Skicat e miratuara janë të bashkëngjitura sipas konfirmimit më letrën e Datës 7 Prill 2004 nga Drejtoria e Rrugëve.

SHTOJCA 33

MODELIMI

Shtojca 33 është përfshirë për të dhënë hollësi të mëtejshme mes Palëve në lidhje me çështjet teknike dhe është në varësi të dispozitave të tjera të kësaj Kontrate(duke përfshirë dhe Shtojcat e saj).

Artikulli	Zona/Elementi	Modelimi (nëse e nevojshme)
1	Çatia Kryesore	

Artikulli	Zona/Elementi	Modelimi (nëse e nevojshme)
	Sistemi: Rrjetë çeliku e dukshme me mbështetje çeliku të dukshme. Të gjitha metalet e dukshme dhe instalimet do të lyhen me bojë. Çatia Kalzip e paajrosur në mbështetëse çeliku trapezoide ose e ngjashme.	
	Shtresa e jashtme e çatisë: KalzipAluPlusZinc ose PLANNJA Top 40S ose e ngjashme	
	Pengesa e avullit Kalzip ose e ngjashme	
	Përbërës të tjerë: Shtresat mbajtëse dhe termike barrierë	
	Mbushja: Fibër minerale në 80kg/m3	
	Mbështetsja metalike: Plannja PS70 ose e barabartë.	Plastisol (Bardhë) si sitë ose e ngjashme
	Pjesa e jashtme e çatisë: Shufra alumini që formojnë një rrjetë nga fundi në krye të sipërfaqes së çatisë nga 45mm x 5mm trashësi.	Veshje me PVF2
2	Çatia e Brendshme/TAVANET	
	Zyrat e shoqërive ajrore	600x600 Pllaka metalike me vrima në “T” të fshehura me ndriçim fluoreshent të veçueshëm (PLC)
	Dhoma e përpunimit të bagazheve	600x600 Pllaka metalike me vrima në “T” të fshehura me ndriçim fluoreshent të veçueshëm (PLC)
	Banjot	600x600 Pllaka metalike me vrima në “T” të fshehura me ndriçim fluoreshent të veçueshëm (PLC)
	Njësitë e Shitjes në Zonën Tregtare dhe në Sallën e Largimit	12mm të trasha fibër gëlqerore e varur në mbajtëse metalike, nëse nuk bihet dakrod ndryshe me Koncesionarin/shfyrtëzuesin
	Korridori Hyrjes	600x600 Pllaka metalike me vrima në “T” të fshehura me ndriçim fluoreshent të veçueshëm (PLC)
	Zona Tregtare	1200x600mm panele metalike me vrima të fiksuara për të veshur harqet e shtyllave mbajtesë metalike
3	MURET ANËSORE KRYESORE	
	Sistemi: Mur metalik i dyfishtë, i mbushur	PVF2
	Mbajtësja e Jashtme: Plannja Profile PS60 ose e ngjashme	
	Pengesa e Avullit	
	Mbushja: Fibër Minerale “Rockëool” në 80kg/m3	

Artikulli	Zona/Elementi	Modelimi (nëse e nevojshme)
	Shtresat e brendshme: shtresa metali me vrima të prera për t'u përshtatur në module 1.2m.	PPC-bardhë ose Plannja Profile PS30 e vrimëzuar plotësisht 38.6% zonë e hapur ose e ngjashme.
4	MURET NGA ANA TOKËSORE DHE AJRORE	
	Sistemi: Shtresa të vetme xhami të fiksuara Përmasat e paneleve janë 2.4m gjerësi x 2.45m lartësi.	Me hije të gjelbër ASAHI ose e ngjashme
	Sistem Planar nga Pilkington Glass duke përdorur fiksatorë 905 të mbështetur në ndarëse të bëra me porosi dhe mbërthyese të integruara ose të ngjashme.	Xham i trashë Optifloat 12mm ose i ngjashëm.
5	Muret e brendshme (Që nuk mbajnë pesha)	
	Mure deri 4.9m të lartë mes rrjetës H/I	Mur i ngjitur ngushtë me copa gurësh natyralë bardhë + gri. E mbështetur nga korniza betoni të përforcuara.
	Muret ndarëse mes pikës së kontrollit dhe sallës së Largimit	Mur me pllakë gëlqerore 4.9m i lartë me 2 shtresa nga 12mm të trasha të mbushura me mbushje muri 80kg/m3, të lyera.
	Muret brenda Zonës Tregtare	Mur me pllakë gëlqerore 4.9m i lartë me 2 shtresa nga 12mm të trasha të mbushura me mbushje muri 80kg/m3, të lyera.
	Muret ndarëse të njësive të shitjes në Zonën Tregtare. Fasadat e njësive nga shfrytëzuesit.	Mur me pllakë gëlqerore 4.9m i lartë me 2 shtresa nga 12mm të trasha të mbushura me mbushje muri 80kg/m3, të lyera.
	Muret që krijojnë korridorin e sigurisë mes rrjetave G dhe F	Mur me pllakë gëlqerore 4.9m i lartë me 2 shtresa nga 12mm të trasha të mbushura me mbushje muri 80kg/m3, të lyera, ose Punim me tulla allcie të përforcuara pjesërisht, të lyera.
	Muret e Banjove	Pllaka qeramike
6	DRITARJA E ÇATISË ANËSORE (mes. rrjetave 1/2 to 6)	
	Sistem me kornizë alumini me guarnicione EPDM në module 1200mm. Xhami: 12 mm me hije të gjelbër të forcuar.	100x45 x1.2mm Anët të veshura më satin
7	DRITARJA E ÇATISË SË ULËT DHE KANAPEJA (mbi zonën e përpunimit të bagazheve)	
	Sistem me kornizë alumini me guarnicione EPDM në module 1200mm. Xhami: 12 mm me hije të gjelbër të forcuar.	
	Mbajtëse çeliku në qendra 1200mm	
	Kanapeja: pjesa e poshtme Planja Profile PS20 ose e ngjashme.	

Artikulli	Zona/Elementi	Modelimi (nëse e nevojshme)
	Mbushja: Rockëool 8okg/m3	
	Mbështetsja e çatisë: Kalzip 50/333 me kapëse+shtresa termike ose e ngjashme	
8	HARQET E ÇATISË MBI ZONËN E KONTROLLIT TË SIGURISË	
	Tabakë alumini me vrima me trashësi 2.0mm	Veshje me pudrim Poliester deri në ngjyrim ose shirita tavani LUXALON ose të ngjashme.
9	DYSHEMEJA	
	Ndërtesa kryesore e Terminalit: Zona Tregtare, Salla e Kontrollit, Salla e Sigurimit, Largimi, Shitjet/duty free brenda zonës së nisjeve, Mbërritja, Marrja e Bagazheve, Doganat	600 X 600 mm pllaka homogjene, gur natyral
	Zyrat e Shoqërive Ajrore	Pllaka me motive 600x600 p.sh. "Collins and Aikman" ose të ngjashme
	Dhomat E+M, dhoma e përpunimit të bagazheve	Bojë e trashë rezistente në cimento të përzier
	Banjot	Pllaka qeramike
	Salla e Hyrjes	600 X 600mm x9 trashësi, pllaka homogjene, me shtresa alumini të vëna me forcë.

SHTOJCA 34

SHËRBIMET E OFRUARA NGA QEVERIA

Shërbimet e ofruara nga Qeveria, te cilat do të jepen kur Aeroporti të jetë vene në funksionim, ne baze te nevojave te pergatitjes per fillimin e operacioneve, në sasinë dhe nivelin e rëndësisë te kerkuar ne menyre te arsyeshme për të mundësuar Shoqërinë të përmbushë detyrimet e veta sipas kesaj Kontrate, Ligjit te Zbatueshëm dhe Konventave te tjera, janë sa mëposhtë:

1. Personel për të mbledhur Pagesat fiskale nga pasagjerët, përveç kur Shoqëria do t'i mbledhë taksat në emër të Qeverisë së Shqipërisë;

2. Policë trafiku për administrimin e trafikut të automjeteve; dhe

3. Ofrues të tjerë shtetërorë të shërbimeve (të përcaktuar në këtë Kontrate)

Më poshtë janë Shërbimet e Rëndësishme të Ofruara nga Qeveria:

1. Kontrolli Trafikut Ajror, nga ANTA, për fluturimet që ngrihen dhe ulen në Aeroport dhe lëvizjen në hapësirën ajrore shqiptare;

2. Personel për kontrollin e Emigracionit dhe Imigracionit;

3 Personeli i Doganave për të vëzhguar dhe kontrolluar trafikun e pasagjerëve dhe të ngarkesave;

4. Shërbimet kundra zjarrit dhe të shpëtimit; dhe

5 .Shërbimi i Policisë kufitare, nëse kjo shihet e nevojshme për sigurinë dhe nëse kjo detyrë nuk ndërmerret nga Shoqëria apo nuk ndërmerret në nivelin e nevojshëm për të mirëmbajtur rregullin

në Aeroport.

SHTOJCA 35

ANTA

ANTA do të jetë përgjegjëse për të gjitha çështjet e kontrollit të trafikut ajror, kontrollin në fluturim, afrim dhe largim. Lëvizja e avionëve në Aeroport do të kontrollohet nga ANTA dhe Shoqëria në bazë të pikëve të miratuara të dorëzimit pas uljes në tokë dhe para ngritjes sipas Kontratave me shkrim mes ANTA dhe Shoqërisë para Datës së Fillimit.

ANTA do të ndërmarrë një program të modernizimit dhe përmirësimit të infrastrukturës dhe sistemeve të kontrollit të trafikut ajror, që përfshin sa më poshtë:

i) Ndërtimi dhe paijsa qendrave operacionale të kontrollit të trafikut ajror, duke përfshirë kontrollin e afrimit dhe të zonës;

ii) Krijimin e një pajisje të re primare për radar;

iii) Ruajtja ose rivendosja e radarëve sekondarë ekzistues;

iv) Ruajtja dhe zëvendësimi i mundshëm i komunikimeve tokë-ajër;

vii) Zëvendësimi mundshëm për përmirësimin e DVOR/DME ekzistuese;

viii) Ndërtimi dhe pajisja e kullës së re të kontrollit të trafikut ajror;

ix) Mbajtja/ përmirësimi i paisjeve meterologjike;

xi) Administrimi/pajisja me personel e ANTA në Aeroport; dhe

xii) Instalimi mundshëm i Sistemit Instrumental të Uljes (ILS) në modelin18.

SHTOJCA 36

KRITERET E PËRMBUSHJES

1. Standardet Hapësinore të Kërkuara– Terminal i Ri Faza A dhe Terminali i Ri Faza B

Shoqëria do të sigurojë që funksionimi i Fazës A të Terminal të Ri dhe Fazës B të Terminalit të Ri te jete në përputhje me Standardet e Niveleve të Shërbimit të IAT-s por jo më ulët se C.

Tabele 1

Proceset	Standardet e Kerkuara Hapësinore

Zona e radhës së Check-In-it	1.4 metra katrorë e hapësirës pa pengesa për pasagjerët në rradhë
Zona e radhës së kontrollit të sigurisë	1.0 metra katrorë e hapësirës pa pengesa në dispozicion të personave në rradhe për kontrollin e sigurisë
Zona e radhës së Imigrimit (Nisja)	1.0 metër katror për person
Zona e radhës së Imigrimit (Mbërritja)	1.0 metër katror për person

2. Niveli i Standardeve të Përmbushjes pas Datës së Hapjes së Terminalit të Ri Faza A

Përgjegjësia e Shoqërisë

Proceset e mëposhtme do të kontrollohen nga personeli i Shoqërisë, për të cilat do të zbatohen standardet e mëposhtme, në qoftëse Palët dhe Përdoruesit e Aeroportit nuk kanë vendosur ndryshe.

Tabela 2

Procesi	Standardi i Kërkuar
Check-In–Nivelet e Synuara Afatet e pritjes për pasagjerët para checking-in	95% e pasagjerëve të klasit Ekonomi presin më pak se 12 min; dhe 100% e pasagjerëve të klasit Ekonomi presin më pak se 20 min; dhe 95% e pasagjerëve të Klasit të Parë dhe Biznesit presin më pak se 5 minuta; dhe 100% e pasagjerëve të Klasit të Parë dhe Biznesit ë presin më pak se 10 minuta.
Siguria – Nivelet e Synuara Koha e pritjes për pasagjerët	95% e pasagjerëve presin më pak se 7 minuta; dhe 100% e pasagjerëve presin më pak se 10 minuta. Nëse Shoqëria do të marrë përsipër përgjegjësi për sigurinë, nivelet e mësipërme të sigurisë do të zbatohen nga Shoqëria, në të kundërt ky do të jetë një Shërbim i Ofruar nga Qeveria.
Sportelet e transferimit – Nivelet e Synuara Koha e pritjes për pasagjerët	95% e pasagjerëve të presin më pak se 6 minuta; dhe 100% e pasagjerëve të presin më pak se 10 minuta.

Procesi	Standardi i Kërkuar
Shpërndarja e bagazheve	95% e pasagjerëve të presin më pak se 15 minuta; dhe 100% e pasagjerëve të presin më pak se 30 minuta (bagazhi i fundit)

Sportelet e Check-in-it për pasagjerët e fluturimeve të ndryshme do të hapen nga Shoqëria të paktën 2 orë para orarit të nisjes së fluturimit përkatës.

Numri më i vogël i sporteleve check-in të hapura nga Shoqëria për një fluturim do të përcaktohet në varësi të numrit të pasagjerëve të rezervuar për atë udhëtim e pjesëtuar me 90 dhe e rrumbullakuar në shifrën më të përafërt.

Shoqëria do të sigurojë që pasagjerët nuk do të rradhiten jashtë perimetrit të caktuar për zonën e Check-in sipas përshkrimit në Shtojcen 16 (Projekti Teknik i Miratuar).

Shoqëria do të sigurojë që pasagjerët që mbërrijnë nuk do të presin në rradhë në zonat përjashta dhe nuk do të mbahen në avion, vendqëndrim ose autobuza para mbërritjes nga imigracioni për arsye ngarkese në zonën e imigracionit për mbërritjet. Funksionimi i imigracionit në mbërritje nuk do të pengojë përdorimin e procesit transferim/tranzit për pasagjerët ose personelin.

Përgjegjësia e Qeverisë Shqiptare

Funksionet në vijim do të kontrollohen nga personeli i Organit Shtetëror përkatës, për të cilin do të zbatohen standardet e mëposhtme në qoftëse Palët nuk kanë rënë dakort ndryshe.

Tabela 3

Procesi	Standarti (minuta)
Emigracioni (Nisja) Niveli Synuar Koha e Pritjes për Pasagjerët	95% e pasagjerëve presin më pak se 3 minuta. 100% e pasagjerëve presin më pak se 8 minuta
Emigracioni (Mbërr) Niveli Synuar Koha e Pritjes për Pasagjerët	95% e pasagjerëve presin më pak se 12 minuta. 100% e pasagjerëve presin më pak se 20 minuta
Mbledhja e Taksës në Nisje	95% e pasagjerëve presin më pak se 5 minuta. 100% e pasagjerëve presin më pak se 10 minuta
Mbledhja e Taksës në Mbërritje	95% e pasagjerëve presin më pak se 5 minuta. 100% e pasagjerëve presin më pak se 10 minuta

Njësitë e siguruara nga Qeveria e Shqipërisë në lidhje me shërbimet e dhëna nga Organi Shtetëror Përkatës do të pajisen me personel sipas marrëveshjeve për nivelet e shërbimit të nënshkruara me Shoqërisë dhe Organit Shtetëror përkatës.Për sqarim, Qeveria e Shqipërisë do të sigurojë që ato njësi kanë personelin e nevojshëm gjatë gjithë orëve duke marrë parasysh orët e

funksionimit të aeroportit dhe nivelet e trafikut. Nëse ndonjë nga Organet Shtetërore nuk do të përmbushë si duhet detyrat në lidhje me marrëveshjet për nivelet e shërbimeve mes Shoqërisë dhe Organit Shtetëror përkatës, Shoqëria nuk do t'i nënshtrohet sanksioneve përkatëse në këtë Kontrate që shkaktohen nga një mos-përmbushje si duhet e detyrave.Asnjë dispozitë e kësaj Kontrate nuk mund të pengojë personelin e ndonjë Organi Shtetëror, ose t'i vështirësojë atij kryerjen e detyrave sipas Ligjit të Zbatueshëm dhe ndonjë rregulloreje tjetër përkatëse dhe/ose praktikat gjyqësore në fuqi në Republikën e Shqipërisë ose të kërkojë pagimin e sanksioneve financiare nga ky Organ Shtetëror në lidhje me përmbushjen si duhet të detyrave të tij.

3. Vëzhgimi i Kryerjes së Detyrave dhe Raportimi i Kryerjes së Detyrave

Verifikimi i shkallës së kryerjes së detyrave sipas specifikimeve në këtë Shtojca do të kryhet nga Shoqëria me shpenzimet e saj, dhe do të fillojë dy javë pas datës së Hapjes së Fazës A të Terminalit të Ri e do të vazhdojë gjatë gjithë periudhës së Koçesionit. Shoqëria do të përgatisë një raport tremujor duke përmbledhur në të kryerjen e detyrave në kategoritë e radhitura në tabelën e mëposhtme dhe do t'ia dorëzojë këtë raport DPAC. Nëse raporti (ose metoda të tjerë objektive të matjes) identifikon përmbushje të detyrave nën nivelin e kërkuar, për të cilat është përgjegjëse Shoqëria, pasojat do te jene si me poshte:

Mospërmbushje të Vogla: Në rastet e mospërmbushjeve të vogla, Shoqëria do të marrë masat e nevojshme për të ndryshuar situatën brenda një afati dyjavor nga data e raportimit të mospërmbushjes.

Mospërmbushje Mesatare: Në rastet e mospërmbushjeve mesatare, Shoqëria do të marrë masat e nevojshme për të ndryshuar situatën brenda një jave nga data e raportimit të mospërmbushjes.

Pas ndodhjes së mospërmbushjeve mesatare, Organi Shtetëror i Autorizuar, në bashkepunim me DPAC, do të ketë të drejtën të kërkojë që Shoqëria të ndërmarrë vëzhgimin e vazhdueshëm të standarteve të papërmbushura dhe të raportojë për shkallën e përmbushjes së atyre standarteve rreth nje ore per të paktën 30 ditë. Organi Shtetëror i Autorizuar do të ketë të drejtën të emërojë një person qe të mbikqyrë shkallën e përmbushjes së detyrave nga ana e Shoqërisë për nje periudhe te pakten 30 ditore.

Mospërmbushje Madhore: Në rast të ndonjë mospërmbushje madhore, Shoqëria do të pergatisë dhe do t'i dorëzojë propozimet për ndryshimin e situatës së mospërmbushjes DPAC brenda dy ditëve nga raportimi i mospërmbushjes. Këto propozime pasi të miratohen nga DPAC do të zbatohen nga Shoqëria me menjehere.

Pas rastit te nje mospërmbushje madhore, Organi Shtetëror i Autorizuar do të ketë të drejtën të caktojë një anëtar ne Keshillin Administrativ të Shoqërisë me të drejtën per të marrë të gjitha informacionet që mund t'u jepen anëtarëve të tillë dhe duke përfshirë të gjitha raportet mbi suksesin operacional të Shoqërisë si dhe me të drejtën e mbikqyrjes te të gjitha nën-kontratave për çështjet e funksionimit dhe sigurisë. Kjo e drejtë emërimi do të jetë për 12 muaj dhe do të vazhdojë edhe me tej nëse mospërmbushje mesatare, madhore ose të përgjithshme ndodhin gjatë periudhës 12 mujore.

Mospërmbushje Totale: mospërmbushjet totale (sipas perkufizimit te tyre në tabelat e mëposhtme në Shtojcen 36), nëse nuk përmirësohen brënda periudhave të caktuara për këtë qëllim në këtë Kontrate, do të përbëjnë një shkelje thelbësore.

Për sqarim, asnjë rast i Mospërmbushjeve të vogla, Mospërmbushjeve mesatare, Mos-përmbushjeve madhore ose Mospërmbushjeve totale nuk mund të ndodhë para Datës së Hapjes së Fazës A të Terminalit të Ri.

DPAC gjatë orëve normale zyrtare dhe në një njoftim të arsyeshëm ka të drejtë që të kontrollojë të dhënat e Shoqërisë në lidhje me përmbushjen e standarteve operacionale në këtë Shtojce në qoftë se ka arsye për të besuar se këto standarte nuk do të arrihen.

Me kërkesën e DPAC, Shoqëria do ti sigurojë DPAC-së një kopje të raportit më të fundit të kryerjes së detyrave funksionale në Aeroport.

Tabelat e mëposhtme tregojnë me hollësi mospërmbushjet e Shoqërisë që përkatësisht përbëjnë Mospërmbushje të vogla, Mospërmbushje mesatare, Mospërmbushje madhore dhe Mospërmbushje totale.

Standardet e mëposhtme të përmbushjes do të zbatohen vetëm për përmbushjen nga Shoqëria të funksioneve brenda kontrollit të saj, dhe Shoqëria nuk do të jetë objekt i pasojave për mos përmbushje sipas kësaj Shtojce 36 për dështime ose pamundesi përmbushjeje për shkak të një veprimi

ose mosveprimi të palëve të treta jashtë kontrollit të Shoqërise që ka bërë të gjitha përpjekjet e arsyeshme.

Standardet e përmbushjes si më poshtë lidhur me kohën e dhënies së shërbimeve nuk do të zbatohen per Përdoruesit e Aeroportit dhe kontraktorët ekzistues të furnizimit me karburant në maseë që ata kanë përcaktuar që nuk kërkojnë një standard të tillë shërbimi në lidhje me shërbimet e vecanta të dhëna prej ose në emër të Shoqërisë.

Sektori I Operimit	Nënsektori I Shërbimit	Kategoria e Mospërmbushjes			
		E Vogël	Mesatare	Madhore	Totale
Të përgjithshme		Dështimi për të siguruar plotësisht kërkesat e Shtojces 37(Administrimi Operacional Pas Përfundimit Të Fazës A Të Terminalit Të Ri) brenda një jave nga fillimi I operimeve		Dështimi për të siguruar kërkesat e përgjithshme të Shtojces 37(Administrimi Operacional Pas Përfundimit Të Fazës A Të Terminalit Të Ri) në lidhje me mos-përmbushjen rregullta javore.	Dështim për të siguruar masat e miratuara për korrigjimin e Mos-përmbushjes Madhore
Ndërtesa e re e terminalit Pasagjerët dhe Bagazhet	Rryma e Pasagjerëve & Trajtimi I Shërbimeve dhe Bagazheve duke përfshirë proceset e mëposhtme: Check-in; Siguria; (për aq sa është marrë përsipër nga Shoqëria);Pajisjet e Transferimit; Pajisjet e kërkimit të bagazheve dhe sallat e nisjes dhe mbërritjes.	Dështimi për të përmbushur Standardet e Shërbimit, sic është përcaktuar në Tabelën 2 në Shtojca në më shumë se një nga Kategoritë e Proceseve Kryesore për më shumë se një orë në cdo javë.	Dështimi për të përmbushur Standardet e Shërbimit, sic është përcaktuar në Tabelën 2 në këtë Shtojca në më shumë se dy nga Kategoritë e Proceseve Kryesore për më shumë se një orë në cdo ditë.	Dështimi për të përmbushur Standardet e Shërbimit, sic është përcaktuar në Tabelën 2 në këtë Shtojca në më shumë se dy nga Kategoritë e Proceseve Kryesore për më shumë se një orë në cdo 8 orë.	Dështimi për të përmbushur Standardet e Shërbimit, sic është përcaktuar në Tabelën 2 në këtë Shtojca në më shumë se dy nga Kategoritë e Proceseve Kryesore për më shumë se 180 orë në cdo 6 muaj.
Kargo Ajrore dhe Posta		Dështimi për të ofruar kargon ajrore ose shërbimin postar, për aq aq është në kontrollin e Shoqërisë, për 3 ose më shumë orë në cdo një ditë	Dështimi për të ofruar kargon ajrore ose shërbimin postar, për aq aq është në kontrollin eShoqërisë, për 6 ose më shumë orë në cdo një ditë	Dështimi për të ofruar kargon ajrore ose shërbimin postar, për aq aq është në kontrollin e Shoqërisë, për 12 ose më shumë orë në cdo një ditë	Dështimi për të ofruar kargon ajrore ose shërbimin postar, për aq aq është në kontrollin e Shoqërisë, për 5 ditë të njëpasnjëshme

Sektori i Operimit	Nënsektori	Kategoria e Mospërmbushjes

	Shërbimit	E Vogël	Mesatare	Madhore	Totale
Ndërtesat	Mirëmbajtja e Ndërtesave	Dështim për të ndërrmarrë mirëmbajtjen e përgjithëshme që sjell si pasojë mos-përdorshmërinë e ndonjërës prej ndërtesave të aeroportit për 3 ose më tepër orë përvec në zonat e miratura.	Dështim për të ndërrmarrë mirëmbajtjen e përgjithëshme që sjell si pasojë mos-përdorshmërinë e ndonjërës prej ndërtesave të aeroportit për 6 ose më tepër orë përvec në zonat e miratura.	Dështim për të ndërrmarrë mirëmbajtjen e përgjithëshme që sjell si pasojë mos-përdorshmërinë e ndonjërës prej ndërtesave të aeroportit për 12 ose më tepër orë përvec në zonat e miratura.	Dështim për të ndërrmarrë mirëmbajtjen e përgjithëshme që sjell si pasojë mos-përdorshmërinë e Terminalit të Rio se Qëndrës së Re të Kargos për 2 ditë të njëpasnjëshmë ose më tepër përvec në zonat e miratura.
	Kontrolli i Mjedisit të Ndërtesave (HVAC)	Dështim për të siguruar Kontrollin e Mjedisit të Ndërtesave(HVAC) për të paktën 99.86% të kohës, e matur në baza vjetore të përsëritshme.	Dështim për të siguruar Kontrollin e Mjedisit të Ndërtesave(HVAC) për të paktën 95% të kohës, e matur në baza vjetore të përsëritshme.	Dështim për të siguruar Kontrollin e Mjedisit të Ndërtesave(HVAC) për të paktën 90% të kohës, e matur në baza vjetore të përsëritshme.	
Furnizimi me energji (Përjasht-uar periudha të përshtat-shme të mirëmbaj-tjes)		Dështim për të ofruar furnizim më energji për të paktën 99.86% të kohës, e matur në baza vjetore të përsëritura	Dështim për të ofruar furnizim më energji për të paktën 95 % të kohës, e matur në baza vjetore të përsëritura	Dështim për të ofruar furnizim më energji për të paktën 90 % të kohës, e matur në baza vjetore të përsëritura	Dështim për të ofruar furnizim më energji për më shumë se 20 orë në ne cdo dy ditë te njëpasnjësh-me
Telekomu-nikime (Përjasht-uar periudha të përshtat-shme të mirëmbaj-tjes)		Dështim për të ofruar telekomuniki-me për më shumë se 2 orë në një ditë	Dështim për të ofruar telekomunikime për më shumë se 4 orë në një ditë	Dështim për të ofruar telekomuniki-me për më shumë se 6 orë në një ditë	
Shërbimë komunale të tjera	Furnizimmi me ujë I pijshëm	Dështim për të ofruar furnizim të	Dështim për të ofruar furnizim të	Dështim për të ofruar furnizim të	

Sektori i Operimit	Nënsektori Shërbimit	Kategoria e Mospërmbushjes			
		E Vogël	Mesatare	Madhore	Totale
uji, ujrat e zeza	Jo i Pijshëm	përshtaytshëm me ujë të pijshëm dhe jo të pijshëm për më tepër se 2 orë në një ditë	përshtaytshëm me ujë të pijshëm dhe jo të pijshëm për më tepër se 4 orë në një ditë	përshtaytshëm me ujë të pijshëm dhe jo të pijshëm për më tepër se 6 orë në një ditë	
Ujrat e zeza (Përjasht-uar periudha të përshtat-shme të mirëmbaj-tjes)	Ujrat e Zeza dhe Kanalizimi i Ujrave të Zeza/Përpuni-mi i ujrave të ndënjura	Dështim për të ofruar kanale kullimi të përshtatshëm dhe përpunimin për më tepër se 2 orë në një ditë	Dështim për të ofruar kanale kullimi të përshtatshëm dhe përpunimin për më tepër se 4 orë në një ditë	Dështim për të ofruar kanale kullimi të përshtatshëm dhe përpunimin për më tepër se 6 orë në një ditë	

Sektori i Operimit	Nënsektori i Shëbimit	Kategoria e Mospërmbushjes			
		E Vogël	Mesatare	Madhore	Totale
Administrimi mjedisor		Dështim për të themeluar dhe mirëmbajtur EMP sic kërkohet nga Marrëveshja ose gjatë fazës së ndërtimit ose operimit, brenda një muaji nga mobilizimi ose fillimi i operimeve.	Dështim për të vepruar sipas masave lehtësuese të raportuara dhe miratuara në lidhje me mos-përmbushjet dytësore mjedisore brenda një muaji nga njoftimi i tyre.	Dështim për të vepruar sipas masave lehtësuese të raportuara dhe miratuara në lidhje me mos-përmbushjet mjedisore kryesore që përfshijnë infeksionet e ujrave tokësore derdhjet e karburantit, zhurmat e avionit ose emtimin e ajrit brenda një muaji nga njoftimi i tyre.	

Sektori i Operimit	Nënsektori i Shërbimit	KATEGORIA E MOSPËRMBUSHJES			
		E Vogël	Mesatare	Madhore	Totale
Aerodromi Manovrimet e Avionit, Parkimi dhe Shërbimi i Përpunimit të Avionit në tokë	Rrëshqitja dhe Parkimi – Rimorkimi dhe Kavot e Rimorkimit	Mosdhenia e sherbimeve qe shkaktojne vonesen e levizjes se me se tre avioneve per me shume se 15 minuta ne nje jave.	Mosdhenia e sherbimeve qe shkaktojne vonesen e levizjes se me se kater avioneve per me shume se 15 minuta ne nje jave.	Mosdhenia e sherbimeve qe shkaktojne vonesen e levizjes se me se kater avioneve per me shume se 15 minuta ne nje periudhe prej 8 oresh.	
	Mbushja dhe Rimbushja me karburant	Dështim për të ofruar ose vonesë në sigurimin e shërbimeve të mbushjes dhe rimbushjes që sjellin vonesën e më shumë se 2 avionëve, për më shumë se 15 minuta në një javë	Dështim për të ofruar ose vonesë në sigurimin e shërbimeve të mbushjes dhe rimbushjes që sjellin vonesën e më shumë se 4 avionëve, për më shumë se 15 minuta në një ditë	Dështim për të ofruar ose vonesë në sigurimin e shërbimeve të mbushjes dhe rimbushjes që sjellin vonesën e më shumë se 4 avionëve, për më shumë se 15 minuta në cdo 8 orë	
	Bagazhi Ngarkimi/Shkarkimi	Mos-përmbushje e Standarteve të Shërbimit të miratuara, të përcaktuaranë Tabelën 1 në këtë Shtojcanë më shumë se një nga Kategoritë e Procesit për një periudhë më shumë se një orë një herë në cdo një javë	Mos-përmbushje e Standardeve të Shërbimit të miratuara, të përcaktuaranë Tabelën 1 në këtë Shtojcanë më shumë se dy nga Kategoritë e Procesit për një periudhë më shumë se një orë një herë në cdo një ditë	Mos-përmbushje e Standardeve të Shërbimit të miratuara, të përcaktuaranë Tabelën 1 në këtë Shtojcanë më shumë se dy nga Kategoritë e Procesit për më shumë se një orë një herë në cdo 8 orë	
	Hypja/Zbritja e Pasagjerëve dhe Transportimi me Autobus	Mos-përmbushje për të siguruar hipjen /zbritjen dhe shërbimet e transportimit me autobuz, që sjellin një vonesë të më shumë se 3 avionëve për më shumë se 15 minuta në cdo një javë	Mos-përmbushje për të siguruar hipjen /zbritjen dhe shërbimet e transportimit me autobuz, që sjellin një vonesë të më shumë se 4 avionëve për më shumë se 15 minuta në cdo njëditë	Mos-përmbushje për të siguruar hipjen /zbritjen dhe shërbimet e transportimit me autobuz, që sjellin një vonesë të më shumë se 4 avionëve për më shumë se 15 minuta në cdo 8 orë	

Sektori i Operimit	Nënsektori i Shërbimit	KATEGORIA E MOSPËRMBUSHJES			
		E Vogël	Mesatare	Madhore	Totale
	Burimi I Energjisë së Avionit – 400 Hz	Mos-përmbushje për të siguruar Fuqinë Fikse në Tokë (FGP) nisja e Avionit-400 Hz fuqi, që sjell një vonesë të 3 avionëve për më shumë se 15 minuta në cdo një javë	Mos-përmbushje për të siguruar Fuqinë Fikse në Tokë (FGP) nisja e Avionit-400 Hz fuqi, që sjell një vonesë të më shumë se 4 avionëve për më shumë se 15 minuta në cdo një ditë	Mos-përmbushje për të siguruar Fuqinë Fikse në Tokë (FGP) nisja e Avionit-400 Hz fuqi, që sjell një vonesë të më shumë se 4 avionëve për më shumë se 15 minuta në cdo 8 orë.	
	Shërbimet e Avionit	Mos-përmbushje për të siguruar shërbimin e avionit, që sjell një vonesë të më shumë se 3 avionëve për më shumë se 15 minuta në cdo një javë	Mos-përmbushje për të siguruar shërbimin e avionit, që sjell një vonesë të më shumë se 4 avionëve për më shumë se 15 minuta në cdo një ditë	Mos-përmbushje për të siguruar shërbimin e avionit, që sjell një vonesë të më shumë se 4 avionëve për më shumë se 15 minuta në cdo 8 orë	
	Kthesa e Avionit	Mos-përmbushjepër të zbutur kthesat e avionit që sjell vonesën e më shumë se 3 avionëve për më shumë se 15 minutave në cdo një javë	Mos-përmbushjepër të zbutur kthesat e avionit që sjell vonesën e më shumë se 4 avionëve për më shumë se 15 minutave në cdo një ditë	Mos-përmbushjepër të zbutur kthesat e avionit që sjell vonesën e më shumë se 4 avionëve për më shumë se 15 minutave në cdo 8 orë	
Pistat, Rrugët Lidhëse, Brezi jeshil (përvec mirëmbajtjes rregulluese të programuar ose planifikuar)	Mirëmbajtja e Përgjithëshme dhe Riparimi	Mospërmbushje për të marrë përsipër mirëmbajtjen e përgjithëshme e cila sjell paperdorshmërinë e Pistave, rrugëve lidhëse ose vendqëndrimeve për 3 orë ose më tepër në cdo kohë.	Mospërmbushje për të marrë përsipër mirëmbajtjen e përgjithëshme e cila sjell paperdorshmërinë e Pistave, rrugëve lidhëse ose vendqëndrimeve për 6 orë ose më tepër në cdo kohë.	Mospërmbushje për të marrë përsipër mirëmbajtjen e përgjithëshme e cila sjell paperdorshmërinë e Pistave, rrugëve lidhëse ose vendqëndrimeve për 12 orë ose më tepër në cdo kohë.	Mospërmbushje për të marrë përsipër mirëmbajtjen e përgjithëshme e cila sjell paperdorshmërinë e Pistave, rrugëve lidhëse ose vendqëndrimeve për 1 ditë ose më tepër në cdo kohë.

Sektori i Operimit	Nënsektori i Shërbimit	KATEGORIA E MOSPËRMBUSHJES			
		E Vogël	Mesatare	Madhore	Totale
	Kullimi/Përmbytja	Përmbytje të shkaktuara nga një stuhi për një periudhë para 10 vjetësh ose më pak që sjell paperdorshmërinë e Pistave,rrugëve lidhesëse, parkingjet e makinave ose rrugëve hyrëse për 3 ose më tepër orë në cdo kohë. OSE Përmbytje të shkaktuara nga një stuhi për një periudhë para 50 vjetësh ose më pak që sjell paperdorshmërinë ndonjë ndërtese në aeroport për 3 ose më tepër orë	Përmbytje të shkaktuara nga një stuhi për një periudhë para 10 vjetësh ose më pak që sjell paperdorshmërinë e Pistave,rrugëve lidhesëse, parkingjet e makinave ose rrugëve hyrëse për 6 ose më tepër orë në cdo kohë. OSE Përmbytje të shkaktuara nga një stuhi për një periudhë para 50 vjetësh ose më pak që sjell paperdorshmërinë ndonjë ndërtese në aeroport për 6 ose më tepër orë	Përmbytje të shkaktuara nga një stuhi për një periudhë para 10 vjetësh ose më pak që sjell paperdorshmërinë e Pistave,rrugëve lidhesëse, parkingjet e makinave ose rrugëve hyrëse për 12 ose më tepër orë në cdo kohë. OSE Përmbytje të shkaktuara nga një stuhi për një periudhë para 50 vjetësh ose më pak që sjell paperdorshmërinë ndonjë ndërtese në aeroport për 12 ose më tepër orë	Përmbytje të shkaktuara nga një stuhi për një periudhë para 10 vjetësh ose më pak që sjell paperdorshmërinë e Pistave,rrugëve lidhesëse, parkingjet e makinave ose rrugëve hyrëse për 2 ose më tepër ditë në cdo kohë. OSE Përmbytje të shkaktuara nga një stuhi për një periudhë para 50 vjetësh ose më pak që sjell paperdorshmërinë Terminalit te Ri të Aeroportit ose Qëndrës së Re të Kargos për 2 ose më tepër ditë.
Ndricimi I Tokës së Aerodromit (AGL) dhe Sinjalet	Masat e Ndricimit të Operatorëve të Standarteve Cat I	Mospërmbushje e sigurimit të ndricimit të tokës së aerodromit për të paktën 99.86% të kohës, e matur në baza vjetore të përsëritura	Mospërmbushje e sigurimit të ndricimit të tokës së aerodromit për të paktën 99.86% të kohës, e matur në baza vjetore të përsëritura	Mospërmbushje e sigurimit të ndricimit të tokës së aerodromit për të paktën 99.86% të kohës, e matur në baza vjetore të përsëritura	Mospërmbushje e korrigjimit të sistemit të ndricimit të tokës së aerodromit për një kohë të arsyeshme

Sektori i Operimit	Nënsektori i Shërbimit	KATEGORIA E MOSPËRMBUSHJES			
		E Vogël	Mesatare	Madhore	Totale
					që sjell vonesa të mëdha dhe ulje të kapacitetit

Sektori i Operimit	Nënsektori i Shërbimit	KATEGORIA E MOSPËRMBUSHJES			
		E Vogël	Mesatare	Madhore	Totale
SIguria dhe Siguria Teknike	Siguria Dhe Siguria Teknike e Terminalit dhe Aerodromit	Një shkelje e një prej Kërkesave të sigurisë të Shtojces 17 të ICAO-s në një muaj DHE Një mospërmbushje e nje ose më shumë funksioneve përgjegjëse të sigurise teknike dhe sigurisë, sic janë përshkruar në Shtojcen 39 (Sistemi Drejtues I Sigurië teknike të Aeroportit) dhe Shtojca 44 (Siguria dhe Ekranizimi I Bagazheve) në një periudhë mujore.	Një shkelje e dy prej Kërkesave të sigurisë të Shtojces 17 të ICAO-s në një muaj DHE Një mospërmbushje e dy ose më shumë funksioneve përgjegjëse të sigurise teknike dhe sigurisë, sic janë përshkruar në Shtojcen 39 (Sistemi Drejtues I Sigurië teknike të Aeroportit) dhe Shtojca 44 (Siguria dhe Ekranizimi I Bagazheve) në një periudhë mujore.	Një shkelje e dy prej Kërkesave të sigurisë të Shtojces 17 të ICAO-s në një javë DHE Një mospërmbushje e tre ose më shumë funksioneve përgjegjëse të sigurise teknike dhe sigurisë, sic janë përshkruar në Shtojcen 39 (Sistemi Drejtues I Sigurië teknike të Aeroportit) dhe Shtojca 44 (Siguria dhe Ekranizimi I Bagazheve) në një periudhë mujore.	Mospërmbushje për të zbatuar Konkluzionet e e programit Të ICAO-s të kontrollimit të sigurisë të brenda një periudhe të arsyeshme OSE (Një shkelje e kërkesave të sigurisë përfshirë sigurinë teknike të pasagjerëve dhe operacioneve te avionit DHE Një mospërmbu-shje e katër ose më shumë funksioneve përgjegjëse të sigurise teknike dhe sigurisë, sic janë përshkruar në Shtojcen 39 (Sistemi Drejtues I Sigurië teknike të Aeroportit) dhe Shtojca 44 (Siguria dhe Ekranizimi I Bagazheve) në një periudhë mujore

Sektori i Operimit	Nënsektori i Shërbimit	Kategoria e Mospërmbushjes			
		E Vogël	Mesatare	Madhore	Totale
Zjarri dhe rreziku		Mospërmbushje për të siguruar nivelet e kërkuara të mbulimit sic është përkufizuar në Shtojcen 14 të ICAO-s, duke shkaktuar degradimin e operacionëve të avionëve në kategorinë në dispozicionpër një periudhë prej një ose më shumë orësh mbi një periudhë prej një muaji.	Mospërmbushje për të siguruar nivelet e kërkuara të mbulimit sic është përkufizuar në Shtojcen 14 të ICAO-s, duke shkaktuar degradimin e operacionëve të avionëve në kategorinë në dispozicionpër një periudhë prej katër ose më shumë orësh mbi një periudhë prej një muaji.	Mospërmbushje për të siguruar nivelet e kërkuara të mbulimit sic është përkufizuar në Shtojcen 14 të ICAO-s, duke shkaktuar degradimin e operacionëve të avionëve në kategorinë në dispozicionpër një periudhë prej katër ose më shumë orësh mbi një periudhë prej një jave	Mospërmbushje në ndreqjen e ndonjë mospërmbushjeje mesatare ose madhore brenda një muaji nga njoftimi I Shoqërisë pëër ekzistencën e kësaj mospërmbushjeje

Sektori i Operimit	Nënsektori i Sherbimit	Kategoria e Mospërmbushjes			
		E Vogël	Mesatare	Madhore	Totale
SHËRBIMI I KLIENTËVE DHE PËRMBUSHJA		Mospërmbushje në zbatimin e sistemit të propozuar të Cilësisë Drejtuese, takimet e AOC-së dhe ftesat për zyrëtarët e IATA-s për të drejtuar vëzhgime të cilësisë mbi baza të vazhdueshme.	Mospërmbushje në zbatimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve të shërbimit të klientëvë dhe sistemit të përmbushjes , ose raportet e palëve të treat të miratuara, brenda një periudhe prej dy muajsh	Mospërmbushje në zbatimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve të shërbimit të klientëvë dhe sistemit të përmbushjes , ose raportet e palëve të treat të miratuara, brenda një periudhe prej katër muajsh	

SHTOJCA 37

ADMINISTRIMI OPERACIONAL PAS PËRFUNDIMIT TË FAZËS A TË TERMINALIT TË RI

Shoqëria do të sigurojë që veprimtaritë e rradhitura mëposhtë te kryhen në cdo kohë të funksionimit të aeroportit sipas parashikimeve te Axhendes dy-vjecare të fluturimeve për Aeroportin dhe në përputhje me kushtet e sigurimit dhe sigurisë teknike të kësaj Kontrate, Ligjit të Zbatueshëm dhe Konventave.

Përpunimi Buzëve të Trotuarit, hyrjes së Terminalit dhe parkingut

Shoqëria do të sigurojë administrimin e Buzëve të Trotuarit të funksionimit dhe hyrjes në Terminalin e Ri dhe do të kontrollojë e mbikqyrë të gjithë zonën për të siguruar një funksionim të mjaftueshëm të buzëve të trotuarit (duke përfshirë, pa kufizim, shmangien e ngarkesave në trafikun e automjeteve, shmangien e vonesave për pasagjerët dhe parandalimin e zhurmave për pasagjerët).

Shoqëria do të respektojë standardet IATA për Nivelin e Shërbimit të Ngarkesës por jo me poshte se niveli C në të gjitha zonat.

Në bashkëpunim me policinë e aeroportit Shoqëria do të sigurojë qarkullimin e lirë të trafikut duke e vënë theksin ne ndalimin e parkimeve të paligjshme të automjeteve ne kendveshtrimin e sigurisë dhe ajo funksionale.

Shoqëria do të vërë në përdorim dhe mbikqyrë pajisjet për parkingun e makinave, do të sigurojë gadishmerine e të tëra pajsjeve dhe në rast difekti teknik të sigurojë riparimin të menjëhershëm të këtij difekti.

Shoqëria do të sigurojë që pajisjet për pasagjerët me aftësi të kufizuara te gjenden edhe në Zonën e parkingut edhe në buzët e trotuareve si dhe të sigurojë personel që të ndihmojë këta pasagjerë. Kjo perfshin parkingjet e caktuara për ta dhe pika për zbritjen e pasagjërëve të paaftë për të lëvizur si dhe hyrje të pjerrëta në trotuare të përshtatshme për pasagjerët në karroca invalidësh. Terminali Ekzsitues dhe ai i Ri do të funksionojnë në mënyrë që pasagjerët me karroca mund të lëvizin lirisht nga hapësirat e hyrjes të terminaleve deri në daljen për në vendqëndrim.

Shoqëria do të monitorojë të gjitha veprimtaritë tregtare në anën e tokës brenda Zonës së Konçesionit dhe të sigurojë që këto veprimtari nuk pengojnë funksionimin e Terminalit të Ri ose Ekzistues.

Përpunimi në Tokë

(1) Shërbimet për Pasagjerët dhe Terminalet

Shoqëria do të sigurojë që hapësirat, paisjet dhe personeli janë të mjaftueshëm për të mundësuar funksionimin e Terminalit të Ri sipas “Kriterit të Funksionimit të Terminal të Ri Faza A dhe Terminali i Ri Faza B”.

Shoqëria do të sigurojë deri në njëzet e katër orë administrim dhe mbikqyrje të funksionimit të terminalit dhe do të sigurojë që proceset e mëposhtme te kryhen brenda Terminalit sipas standartit të Nivelit të Shërbimit C të IATA.

Biletaria: Shoqëria do të sigurojë praninë e zyrave të biletarisë për të pajisur pasagjerët me bileta në përputhje me kërkesat për një shërbim të tillë.

Check-in: Shoqëria do të sigurojë praninë e mjaftueshme të sporteleve check-in, paisjeve dhe personelit me qëllim që të përputhen me Nivelin e Shërbimive IATA por jo me poshte se niveli C.

Salla e Business: Shoqëria do të krijojë dhe vërë në përdorim një sallë business të mbyllur për pasagjerët e klasit business të shoqërive ajrore.

Ngjitja dhe zbritja e pasagjerëve në avion: Shoqëria do të sigurojë praninë e personelit të mjaftueshëm për ngjitjen dhe zbritjen e pasagjerëvë në avion për të gjitha fluturimet larguese ose mbërritëse në mënyrë që të arrihet të përmbushet në kohë dhe me efikasitet largimi dhe mbërritja e pasagjerëve.

Pika e Transferimit: Shoqëria do të krijoje dhe pajisë me personel pikën e transferimit/transit dhe do të sigurojë që herët minimale të lidhjes të miratura nga shoqerite ajrore te bashkangjiten aty.

Sende të humbura dhe të gjetura: Shoqëria do të ngrejë dhe vërë në përdorim një qendër për sendet e humbura dhe të gjetura me personel të pergatitur për të përdorur sistemin botëror të gjetjes së bagazheve.

Qendra e Shërbimeve për Pasagjerët në Terminal: Shoqëria do të pajisë me personel një qendër informacioni në Terminalin e Ri për të mbikqyrur terminalin, një tryezë informacioni për përdoruesit e aeroportit, dhe një central telefonik për të dhënë informacion për klientët e brendshëm dhe të jashtëm ne te cilen te bëhen të gjitha lajmërimet për publikun.

Shoqëria do të sigurojë një personel me pergatitje të shumëfishtë (të pregatitur për të gjitha llojet e shërbimeve për pasagjerët dhe terminalin, duke përfshirë pa u kufizuar, check-in, sendet e humbura dhe të gjetura, embarkimin për pasagjerët, tryezat e informacionit, centralin e lajmërimeve publike dhe atë telefonik.) për pasagjerët e terminalit, të pergatitur për raste urgjencash dhe procedura evakuimi.

Shoqëria do të sigurojë një vëmendje të lartë për pasagjerët e paaftë fizikisht me anë të personelit të përkushtuar për të dhënë ndihmen e duhur. Për më tepër, Shoqëria do të ketë personel të pranishëm në qendrën e informacionit që merret me ankesat e pasagjerëve.

(2) Shërbimet në fushë (shërbimet tokësore të kryera nga ana e aerodromit)

Shoqëria do të sigurojë shërbimet e mëposhtme tokësore nga ana e aerodromit sipas nevojës për avionët që shfrytëzojnë Aeroportin:

Përpunimi i avionëve;

Furnizimi me karburant i Avionëve ;

Ngarkimi dhe shkarkimi Avionëve ;

Kontrolli i ngarkesës;

Heqja e Akullit;

Koordinimi i Fluturimeve dhe administrimi i ekuipazheve;

Transport në tokë; dhe

Pastrimi i avionëve, banjove dhe furnizimi me ujë

Shoqëria do të sigurojë personel të mjaftueshëm dhe të pergatitur si dhe paisjet e nevojshme për të mbuluar veprimtaritë në aerodrome. Kërkesat e trafikut do të vëzhgohen vazhdimisht nga Shoqëria për të siguruar që burime të mjaftueshme, paisje për shërbimet në tokë dhe autobuzët te jene të pranishëm.

Shoqëria do të sigurojë mbikqyrje të vazhdueshme të aerodromit për të siguruar funksionim të sigurt, të shpejtë dhe efikas.

Shërbimet e ofruara nga dhe në emër të Shoqërisë në Aeroport duhet të jenë në përputhje Marrëveshjen/t e Nivelit të Shërbimit që do të miratohet/n dhe secila shoqëri ajrore do të ketë të drejtën të shërbehet me të njëjtin standart shërbimi në të gjitha veprimtaritë e përpunimit në tokë.

(3) Embarkimi dhe zbarkimi pasagjerëve

Embarkimi: Shoqëria do të sigurojë personel të mjaftueshëm të pranishëm në hyrjet për hipjen në avionë në mënyrë që të sigurojë që pasagjerët te arrijnë në avionët përkatës në kohën e duhur dhe që avionët përkatës te jenë në gjendje të realizojnë largimin në kohë. Shoqëria do të sigurojë praninë e një numri të mjaftueshëm autobuzësh duke marrë parasysh nivelet e trafikut për hipjen në avionët e parkuar në zona të largëta.

Zbarkimi:Shoqëria do të sigurojë praninë e autobusëve në mbërritjen e avionëve, duke përfshirë praninë e personelit të nevojshëm për të siguruar zbarkimin e pasagjerëve pas parkimit te avionit.

Shoqëria do të vërë në pune Fazën A të Terminalit të Ri me katër vende parkimi për avionët në distancë të afërt me këtë terminal me qëllim që të shpejtojë embarkimin dhe zbarkimin e pasagjerëve. Ky proces do të plotësohet me shërbime me autobuze për avionët e parkuar larg nga terminali.

Shoqëria do të sigurojë personelin e nevojshëm për të shoqëruar të gjithë pasagjerët në të gjitha fazat e embarkimit në avionët përkatës dhe të gjitha fazat e zbarkimit, pasi avionët te kene parkuar ne mberritje në Terminalin e Ri. Për më tepër, Shoqëria do të sigurojë personel të specializuar për të shoqëruar pasagjerët me aftësi të zvogëluara lëvizjeje.

(4) Përpunimi Bagazheve

Shoqëria do të sigurojë që hapësira e qarkullimit brenda sallës së mbërritjes së bagazheve te jete në përputhje me standardet e Nivelit të Shërbimit të IATA-s por jo më poshte se niveli C.

Shoqëria do të sigurojë standardet e dorëzimit të bagazheve sipas Shtojces 36 (Kriteri i Përmbushjes) Për këtë qëllim, Shoqëria do të sigurojë sa mëposhtë:

Nisja e bagazheve:Shoqëria do të vërë në përdorim një sistem manual për përpunimin e bagazheve që ushqehet nga sportelet check-in. Ky sistem do të përfshijë ndertimin e nje makinerie te brendshme për kontrollin 100% të bagazheve.

Shoqëria do të vërë në përdorim në Fazën A të Terminalit të Ri gjithashtu një sistem të dytë për përpunimin e bagazheve që do të aktivizohet gjatë periudhave me ngarkesë dhe gjithashtu do te procesojë bagazhet me përmasa të mëdha (AOG).

Shoqëria do të sigurojë një ngarkues bagazhesh për të kontrolluar funksionimin.Ky sistem do të ushqehet nga sportelet check-in dhe gjithashtu do të ketë të ndërtuar në të një makineri për kontrollin me ekranizim 100% të bagazheve.

Shoqëria do të përdorë këtë sistem të dytë të bagazheve për të veçuar fluturimet me rrezikshmëri të lartë që kërkojnë masa sigurie shtesë. Sistemi do të përdoret gjithashtu si mbështetje nëse sistemi kryesor i kontrollit të bagazheve pëson probleme teknike.

Mbërritja e Bagazheve

Shoqëria do të sigurojë dy rripa për mbledhjen e bagazheve për Fazën A Terminalit të Ri. Secili nga rripat do të ketë një sistem të ndarë konvejeri.

Përpunimi i kargos dhe i postës

Shoqëria do të sigurojë qe përpunimi i kargos dhe i postës te jete realizuar sipas Manualit të Përpunimit në Aeroport AHM 300 të IATA-s dhe do të siguroje personel të mjaftueshëm për përpunimin e kargos dhe postës së tashme dhe të ardhme sipas nevojës.

Veprimtaritë e përpunimit nga ana e aerodromit

Shoqëria do të sigurojë përputhje të përhershme me Standardet dhe Praktikat e Rekomanduara sipas specifikimeve të ICAO-s Shtojca 14 Volumi I. Mbikqyrja e vazhdueshme do të realizohet nëpërmjet kontrolleve që do të ndërmerren në aerodrome. Të dhënat do të mirëmbahen dhe do t'i paraqiten për rishikim Organit Shtetëror përkatës.

Parkimi i avionëve dhe Procedurat e Pritjes

Me mundësinë më të parë gjatë Periudhës së Konçesionit Shoqëria do të pergatisë një qëndrim për avionët dhe një manual parkimi si dhe procedura standarte për përdorim të hapësirave në të dy anët e aerodromit dhe te tokës duke u siguruar qe personeli te kete procedura të qarta, të kuptueshme dhe të kontrollueshme për të përmbushur detyrat e tij. Të gjitha procedurat do të rishikohen rregullisht nga Shoqëria.

Shoqëria do të rishikojë dhe azhornojë rregullisht qëndrimin e avionit dhe manualin e parkimit të avionit në mënyrë që të sigurojë që Buletini Informativ Aeronautik (AIP) te jete në përputhje me hollësitë e qëndrimit të avionëve.

Detyra të tjera funksionale

(1) Zyra Operative e Aeroportit

Shoqëria do të vërë në funksionim një zyrë operative në aeroport e cila do të shërbejë si qendër kontrolli për aeroportin në tërësi nga ana e aerodromit dhe e tokës. Për më tepër, Shoqëria do të sigurojë që zyra operative e aeroportit te jete e paisur me sisteme dhe paisje te nevojshme per te lehtesuar funksionimin.

Shoqëria do të sigurojë që i gjithë personeli te jete i pergatitur më së miri dhe qe punonjesit e tij te jene në gjendje qe të kryejnë shumë detyra.

Situatat e emergjencës do të koordinohen nga Zyra Operative e Aeroportit. Shoqëria do të sigurojë një dhomë në Ndërtesën e Terminalit Ekzistues per t'u perdorur në rastet e mbikqyrjes të krizave gjatë një situate emergjence.

Shoqëria do të sigurojë që Zyra Operative të ketë personel gjate gjithe kohes.

(2) Zyra e Ndihmës së Shpejtë Shoqëria do të pajisë dhe mbështesë Zyrën e Ndihmës së

Shpejtë për të siguruar shërbime të shpejta mjekësore për pasagjerët dhe Përdoruesit e Aeroportit në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm.

(3) Kontrolli Mjekesor

Shoqëria do të ngrejë një pikë kontrolli mjeksor në sallën e imigracionit të mbërritjes me qëllim që të zbatojë kushtet e karantinës. Pajisja me personel e kësaj pike të kontrollit të shëndetit do të jetë përgjegjësi e Qeverisë së Shqipërisë.

(4) Doganat

Shoqëria do të negociojë një Marrëveshje për Nivel Shërbimi (SLA) me Shërbimin Doganor Shqiptar për të siguruar mjaftueshmëri të personelit të pikave doganore dhe lejimin e qarkullimit të lirshëm të pasagjërëve në terminal.

Shoqëria do të sigurojë standardet (e gjelbërta dhe të kuqe) në pikat doganore dhe në të ardhmen do të përfshijë shiritat blu kur dhe neqoftese Shqipëria hyn në Bashkimin Europian.

(5) Trajtimi i VIP Shtetërorë

Shoqëria do të sigurojë praninë në terren të personelit të nevojshëm për të trajtuar lëvizjet e VIP duke përfshirë dhe personelin për kontrollin e sigurisë.

Për sqarim, organizimi i fluturimeve VIP dhe autorizimet e personave të lejuar të hyjnë në hapësirat e VIP do të jetë përgjegjësi e Qeverisë së Shqipërisë.

SHTOJCA 38

MANUALI OPERACIONAL I AERODROMIT

Manuali i Perditesuar Operacional i Aerodromit (“UAOM”) do të pergatitet nga Shoqëria dhe do të përfshijë informacionin, procedurat dhe udhëzimet e nevojshme që personeli të përmbushë detyrat e tij në mënyrë të tillë që të sigurojë se përdorimi i Aeroportit nga avionët është i sigurt. AOM ka të paktën të dhënat e mëposhtme:

Hyrja:

Hollësitë e Statusit Ligjor, procedurat për shpërndarjen dhe cilësinë për ndryshimin e UAOM.

Administrimi Teknik:

Hollësitë e emrit dhe adresës së plotë të aeroportit, koordinatat (Pika e Referencës së Aerodromit), emri dhe posti i personelit kryesor, procedurat për shpalljen e informacionit të aerodromit, procedurat për kontrollin e punimeve, procedurat për largimin e avionëve, dhe procedurat për kontrollin e mirëmbajtjes dhe vendqëndrimit, furnizimi me karburant, etj.

Karakteristikat e Aerodromit:

Hollësitë e ndonjë pengese që mund të ndikojë në funksionim, të dhënat të përgjithshme të mbikqyrjes së aerodromit, hollësitë e rrugëve të shtruara dhe fortësia mbajtëse të pistës, rrugëve lidhëse dhe vendqëndrimeve. Të dhëna për përllogaritjen e distancave të shpallura dhe daljeve si dhe të metodave e procedurave për përllogaritjen e objekteve të përkohshem që mund të pengojnë në brezin jeshil të pistës, rrugët tranzite, të afrimit dhe të uljes.

Procedurat e Funksionimit:

Procedurat për kontrollet rutinë dhe raportet për aerodromin. Procedurat për matjen e kushteve të fërkimit të pistës dhe rrugëve të tjera të shtruara. Procedurat për kontrollin e shpendëve, të pistës, rrugëve lidhëse dhe pastrimin e vendqëndrimit.

Shërbimet e Shpëtimit dhe kundra Zjarrit (“RFFS”):

Kategoria e funksionimit të RFFS, hollësitë e paijsjeve fikëse. Numri i personelit të pergatitur, procedurat e emergjencës dhe kushtet e pergatitjes për ofrimin e shërbimit.

Shërbimet Mjeksore:

Hollësitë për ofrimin e shërbimeve mjeksore, lista e personelit dhe paisjeve të pranishme.

Ndriçimi i Aerodromit:

Një përshkrim i shkurtër i ndriçimit të aerodromit, metoda e tij e funksionimit, metoda e regjistrimit të kontrolleve dhe mirëmbajtjes. Vendndodhja dhe përdorueshmëria e ndriçimit për pengesat në dhe jashtë aerodromit. Masat e marra për furnizim me energji elektrike rezerve.

Administrimi i Trafikut Ajror:

Sistemi për administrimin e trafikut ajror në tokë. Rregullat për zgjedhjen e pistës në përdorim, rrugëve lidhëse, pista e përshtatshme për përdorim në rast incidenti ose aksidenti në aerodrome. Njoftimi i procedurave për reduktimin e zhurmave, shpallja e kërkimit dhe shpëtimit. Metodat e raportimit dhe shpërndarjes së informacionit meterologjik.

Kjo pjesë do të pergatitet ne bashkëpunim me ANTA/DPAC.

Paisjet e Komunikimit dhe Lundrimit:

Përshkrimi dhe udhëzimet për përdorim të komunikimeve ajër/tokë dhe atyre me radio tokësore funksionale që nuk mbulohen nga ATC. Përshkrimi dhe procedurat e funksionimit për mjetet e lundrimit të Avionëve .

Kjo pjesë e manualit do të pergatitet në bashkëpunim me ANTA/DPAC

SHTOJCA 39

SISTEMI ADMINISTRIMIT TË SIGURISË NË AEROPORT

Shoqëria do të pergatisë një Sistem të Administrimit të Sigurisë në Aeroport që përfshin sa mëposhtë:

- Dokumentacionin e sigurisë në lidhje me UAOM dhe me procedurat e sigurisë.
- Sistemi i mbledhjes së të dhënave dhe raportimit në lidhje me aspektet e sigurisë.
- Vlerësimi i të dhënave të aeroportit dhe përcaktimi i modelit.
- Veprimet e rekomanduara për sigurinë.
- Legjislacioni për sigurinë profesionale dhe ligjet për shëndetin sipas direktivave të BE.

Të gjithë Përdoruesit e Aeroportit do të duhet të përmbushin kushtet e paraqitura në lidhje me sigurinë sipas Kontrates se Koncesionit.

Shoqëria do të caktojë një personel sigurie për të kryer një kontroll të rregullt që të sigurohet përmbushja e kushteve të sigurisë gjatë gjithë periudhës së Konçesionit..

Sistemi i Administrimit të Sigurisë në Aeroport do të rishikohet vit për vit dhe do të perditesohet nga Shoqëria për të siguruar përmbushje të standarteve dhe praktikave kombëtare dhe ndërkombëtare.

Sistemi i Administrimit të Sigurisë në Aeroport do të jetë në përputhje me Dok. 9774 të ICAO-s në lidhje me Manualin e Çertifikimit të Aerodromeve.

SHTOJCA 40

MIRËMBAJTJA E AEROPORTIT

Mirëmbajtja e Aeroportit

Shoqëria mund të kontraktojë me ndonje palë të tretë për mirembajtjen rutinë dhe riparuese të aeroportit. Shoqëria siguron që standardet në vijim te jenë plotësuar në lidhje me të dyja llojet e mirëmbajtjes si mëposhtë:

(1) Mirëmbajtja e planifikuar parandaluese:

Shoqëria do të planifikojë intervale të mirëmbajtjes duke u bazuar në rekomandimet dhe standardet e përcaktuara nga prodhuesit individualë për të garantuar qëndrueshmërinë e sistemit. Kurdo që të jetë e mundshme, mirëmbajtja e planifikuar do të kryhet në orët me trafik të ulët ose jo-operacionale me qëllim që të minimizojë ndikimin në veprimtarinë e aeroportit.

(2) Mirëmbajtja riparuese dhe e emergjencës:

Për sistemet të cilat konsiderohen kritike për funksionimin e aeroportit dhe kanë kohe pritje më pak se gjysëm ore, Kontraktori Mirëmbajtjes do të sigurojë mbulim në terren për 24 orë.

Për sistemet jo-kritike, me kohë pritje më shumë se gjysëm ore, Kontraktori Mirëmbajtjes do të sigurojë deri në 24 orë mbulim por mbi baza "lajmërimi".

Kurdo që të jetë e mundur koha mesatare e riparimit do të jetë 2 orë.

Pjesët e ndërrimi të paisjeve do të rishikohen për të siguruar përputhje me standardin e mësipërm.

Inspektimi dhe Mirëmbajtja e Aerodromit

Sistemi i inspektimit do të sigurojë që të gjitha defektet në strukturat fizike të raportohen menjëherë dhe të riparohen sipas nevojës dhe nga ana tjeter defektet, mungesa e shërbimit ose pengesat që mund të ndikojnë në sigurinë e avionëve dhe të personelit në pistë te mund të shpallen nga aeroporti drejtpërsëdrejti menjëherë ose nga NOTAM. Për të realizuar këtë strategji një sistem kontrolli i trefishtë do të zbatohet sa mëposhtë:

Niveli 1	Kontrolle rutinë të përditshme të pistës, rrugëve lidhëse dhe vendqëndrimeve të avionëve nga personeli i funksionimit të aerodromit do të përfshijnë ndriçimin për afrimin, pistën, rrugët lidhëse dhe vendqëndrimin.
Niveli 2	Një kontroll i hollësishëm nga operacionet e aerodromit që e mbulon aerodromin në bazë javore. Ky kontroll, elementet e të cilit do të realizohen më këmbë do të mbulojë të gjitha ato që përfshihen në kontrollin e Nivelit 1 por do të përqëndrohet sidomos në: Sigurimin e instalimeve të dritave dhe shtrëngimin e vidhave të sigurisë. Ndriçimin për kushtet ose afrimin dhe kabllot lidhëse (në bazë mujore).
Niveli 3	Kontrollet e ekipit të administrimit të funksioneve duke mbuluar të gjitha zonat e aerodromit në bazë tremujore.

Mirëmbajtja e rripave të pistës

Zona që rrethon pistën do të kontrollohet gjithashtu rregullisht nga Shoqëria.

SHTOJCA 41

ADMINISTRIMI I CILËSISË

Administrimi Cilësisë

(a). Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit

Shoqëria do të pergatisë Marrëveshje të Nivelit të Shërbimit (SLAs) për të gjithë Përdoruesit e Aeroportit që do te ofrojnë shërbime në Aeroport bazuar në Standardet e kërkuara nga kjo Kontrate, Ligjet e Zbatueshme, Konventat dhe Praktikat e Mira te Industrisë, dhe do të shprehë qartë standardet e përmbushjes, tarifat e shërbimit, dhe përgjegjësitë e secilit organizëm që punon në Aeroport nga Data e

Hapjes se Fazës A te Terminalit te Ri të renditura si më poshtë:

- kontrollori i shërbimit të trafikut ajror;
- policia e imigrimit dhe emigrimit;
- policia kufitare;
- doganat
- zjarrëfikësat dhe shërbimet shpëtuese
- shërbimet meteorologjike;
- policia e trafikut
- ofrues të shërbimeve të tjera (shtetërorë ose privatë)
- sigurimi në aeroport;
- organizimi i shërbimit në tokë, nëse zbatohet;
- kontraktori mirëmbajtjes;
- shoqëritë ajrore; dhe
- të tjera

Të gjitha marrëveshjet e nivelit të shërbimit të propozuara për tu lidhur me Organet Shtetërore do t'i dergohen në format përfundimtar me përkthim në gjuhën shqipe nëse gjuha e projektit te tyre nuk është shqipja, cdo Organi Shtetëror qe preket prej tyre, jo më pak se 90 ditë para Datës së Hapjes së Fazës A të Terminalit të Ri. Marrëveshjet e Nivelit të Shërbimit do të kontrollohen cdo vit nga Shoqëria dhe Qeveria e Shqipërisë dhe Organet Shtetërore përkatëse duke përfshirë DPAC-në për të siguruar që standardet te jenë ruajtur në nivelet e kërkuara.

(b) Kontrolli i kënaqjes së klientëve

Shoqëria do të punësojë personel per administrimin e cilesise qe punon mbi baza ditore dhe u pergjigjet te gjitha ankimeve dhe rekomandimeve te klienteve.

Shoqeria do te zhvilloje takome te regullta me Perdoruesit e Aeroportit per te diskutuar ♪5do ankese ose ide per permiresimin e funksionimit te aeroportit kur kerkohet.

Personeli i Shoqërisë për administrimin e cilësisë do të drejtojë vëzhgime në Aeroport me qëllim që të vlerësojë nivelin e shërbimit të ofruar.

SHTOJCA 42

ADMINISTRIMI MJEDISOR

Shoqëria do të hartojë një plan administrimi mjedisor ("EMP") që të adresojë problemet mjedisore në Zonën e Koncesionit, dhe per te siguruar përputhje me EMP, si në vijim:

1. Zvogëlimi Nivelit të Zhurmave;

- Shpallja e programeve të vëzhgimit të zhurmës dhe procedurave të shmangies së zhurmave në bashkëpunim me të gjithë përdoruesit e aeroportit
- Komunikime me autoritetet kompetente dhe bashkësinë lokale në lidhej me zhurmat e avionëve

2. Shpallja e nje programi për cilësinë e ajrit, duke përfshirë

- Optimizimin e shërbimit në tokë / veprimtarive për të shmangur rrathët dhe si rezultat të minimizojnë konsumin e vajgurit dhe ndotjen e ajrit dhe
- Matjet e cilësisë së ajrit

3. Krijimi i një sistemi të administrimit të mbeturinave për grumbullimin, riciklimin, trajtimin dhe heqjen e mbeturinave që përmbajnë materiale të rrezikshme në bazë të praktikave më të mira gjermane dhe ndërkombëtare

4. Bashkëpunimi me Organet Shtetërore për të mbikqyrur dhe kontrolluar flutrimet e shpendëve brenda Zonës së Koncesionit

5. Prezantimi i standarteve të mjedisit të detyrueshme për të gjithë personat që funksionojnë brenda Zonës së Koncesionit si dhe kontrollet e mjedisit të përvitshme

6. Zhvillimi i një regjistri ligjor për lejet dhe miratimet me rëndësi funksionale, mjedisore dhe arkitekturale

7. Mbrojtja dhe shfaqja e trashëgimisë kulturore të rajonit nëse është e pranishme

8. Mbështetje për projektet e BE në lidhje me mjedisin e aeroporteve dhe të fqinjëve të afërt të tyre

9. Nxitja e ndjeshmërisë mjedisore te publiku i gjerë

Zbatimi i EMP dhe rezultatet do të botohen për vit nga Shoqëria në Raportin Mjedisor.

Realizimi dhe zbatimi i këtyre objektivave do të jetë në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm duke përfshirë:

- Shtojca 16, Konventa e Aviacionit Civil Ndërkombëtare (Konventa e Chicago) të ICAO-s, e nënshkruar më 7 Dhjetor 1944 në formën e tanishme

- Komunitetit Ekonomik Evropian: Direktiva e Këshillit 85/337/EEC e 27 Qershorit 1985 mbi vlërësimin e efekteve të projekteve publike dhe private në mjedis e ndryshuar me Direktivën e Këshillit 97/11/EC e 3 Mars 1997

- UNECE Konventa e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis në Kontekst Ndërkufitarë (mbledhur në Espoo / Finland, më 25 Shkurt 1991)

SHTOJCA 43

PAGESAT PËR QEVERINË E SHQIPËRISË- PJESEMARRJA NE FITIM

Datat e caktuara per pjesemarrjen ne fitim dhe shumat e planifikuara jane si vijon:

Data e Pagesës	Shuma e Planifikuar (EURO)
31 Maj 2005	0
31 Maj 2006	0
31 Maj 2007	0
31 Maj 2008	0
31 Maj 2009	120,000
31 Maj 2010	0
31 Maj 2011	0
31 Maj 2012	0
31 Maj 2013	1,095,000
31 Maj 2014	870,000
31 Maj 2015	965,000
31 Maj 2016	997,000
31 Maj 2017	1,188,000
31 Maj 2018	3,000,000

31 Maj 2019	5,250,000
31 Maj 2020	4,200,000
31 Maj 2021	4,256,000
31 Maj 2022	4,634,000
31 Maj 2023	5,652,000
31 Maj 2024	5,700,000
31 Maj 2025	6,150,000

Data e pagesës në çdo vit (e) në tabelën e mëposhtme do të zgjatet, nëse është e nevojshme, për kohen e arsyeshme qe Shoqerise i duhet për të deklaruar dhe miratuar pagesën e dividentit (në përputhje me Ligjin e Zbatueshëm dhe Dokumentat Financiare) e cila përkon me pagesën e shumës përkatëse të Pjesemarjes ne Fitim.

Shumat e mesiperme te Pjesemarjes ne Fitim mund te ndryshohen me marreveshje te Paleve perpara Dates se Fillimit.

SHTOJCA 44

SIGURIA DHE KONTROLLI I BAGAZHEVE

Në varësi të konfirmimit me shkrim nga Organi i Autorizuar Shtetëror jo më vonë se 10 ditë pas ratifikimit të kësaj Kontrate nga Kuvendi Popullor i Republikës së Shqipërisë, Shoqëria do të jetë përgjegjëse për sigurinë në Aeroport qe nga Data e Fillimit gjatë Afatit të Koncesionit në përputhje me këtë Kontrate, Ligjin e Zbatueshëm dhe Konventat. Për të garantuar sigurinë, Shoqëria do të ketë të drejtën të grumbullojë nga pasagjerët që përdorin aeroportin një tarifë sigurie ("Pagesa e Sigurisë") deri në EUR 4 për pasagjer (EUR 2 për pasagjerët që mbërrijnë dhe EUR 2 për pasagjerët që largohen) me qëllim që të mbulojë shpenzimet e arsyshme për dhënien e shërbimit të sigurisë. Shoqëria do të paguajë 25% të tarifës së sigurisë të mbledhur DPAC ne baza mujore me vonese, dhe do të ketë të drejtën të mbajë diferencën. Shoqëria do të mbajë regjistrime me shkrim të numrit të pasagjerëve dhe shumat e tarifës së sigurisë së mbledhur, dhe këto regjistrime do t'i paraqiten DPAC për inspektim sipas kërkesës së arsyeshme.

Shoqëria mund të kontraktojë për shërbimet e sigurisë ndonjë kontraktor ndërkombëtar të njohur të sigurisë së aviacionit i cili do të caktojë një administrator kontrate përgjegjës për raportimin e ndonjë shmangie nga dispozitat e kontratës ndaj administratorit te ruajtjes dhe sigurise se aeroportit me qrellim qe te merren masat perkatese. Transferimi me kontratë do të përfshijë dispozita që mundësojnë zgjidhjen në rast të mospërmbushjes së detyrimeve nga kontraktori në bazë të Ligjit të Zbatueshëm dhe Konventave.

Shoqëria do të krijojë të gjitha procedurat e nevojshme, në përputhje me ligjin e Zbatueshëm dhe ICAO Shtojca 17 dhe ECAC Dok. 30.

Funksionet e mëposhtme të Ruajtjes dhe Sigurisë në rradhët përkatëse të tabelës së mëposhtme do të përbëjnë objektin e kësaj Kontrate me organet në kollonën përkatëse të shënuara me ✓ (tik):

	Organi Përgjegjës			
Funksioni	Shoqëria ose operatori caktuar me nën-kontraktim	Policia Kufitare	DPAC	Organet e Tjera
Kontrolli Pasagjerëve				
Kotrolli me rreze -X për Pasagjerët	✓			
Procedurat e Programeve të Sigurisë, testet e Trainimit dhe të personelit (përf. azhornimet)	✓		✓	
Blerja e Paisjeve	✓			
Inspektimi Paisjeve, Testet dhe kolaudimi	✓			Organi Shtetëror përkatës ose personi tjetër që ka kompetencën
Kontrolli bagazheve të dorës dhe të tjera				
Kontrolli me rreze-X i të gjitha bagazheve, që arrijnë dhe që largohen	✓			
Blerja e Paisjeve	✓			
Inspektimi Paisjeve, Testet dhe kolaudimi	✓			Organi Shtetëror përkatës ose personi tjetër që ka kompetencën
Procedurat e Programeve të Sigurisë, testet e Trainimit dhe të personelit (përf. azhornimet)	✓		✓	
Kontrollet e Sigurisë së Dhomës së Ruajtjes së Bagazheve	✓			
Përmbajtja				Doganat
Kargo, Posta dhe sende të tjera (përfsh. Operatorët e Kargos)				
Kontrolli kargos me rreze-X (përfsh. Paketat e pranuara si bagazhe)	✓			
Blerja e Paisjeve	✓			
Inspektimi Paisjeve, Testet dhe kolaudimi	✓			Organi Shtetëror përkatës ose personi tjetër që ka kompetencën
Procedurat e Programeve të Sigurisë, testet e Trainimit dhe të	✓		✓	Shoqerite Ajrore

	Organi Përgjegjës			
Funksioni	Shoqëria ose operatori caktuar me nën-kontraktim	Policia Kufitare	DPAC	Organet e Tjera
personelit (përf. Procedurat për Dorëzimin e Bagazheve)				
Përmbajtja				Doganat
Kateringu				
Dhënia e Standarteve dhe Procedurave	✓		✓ (vetëm për operatorin e katering)	Operatori Katering
Kontrolli kateringut (brenda ndërtesës)				Operatori Katering
Jashtë ndërtesës, brenda Zonës së Koncesionit	✓			Operatori Katering
Mbikqyrja për Përmbushje të standarteve (përfsh. azhornimet)	✓		✓	Operatori Katering
Kontrolli hyrjes				
Kontrolli Pikave të Hyrjes	✓			
Dhënia e Kartave të Identitetit të Aeroportit	✓			
Miratimi Standarteve dhe Procedurave			✓	Ministria e Rendit Publik
Kontrolli dhe Vëzhgimi me CCTV i Zonës së Koncesionit	✓			
Blerja dhe instalimi i CCTV në Zonën e Koncesionit	✓			
Inspektimi Sistemit CCTV, Testet dhe kolaudimi	✓			Inxhinieri Pavarur
Trajnimi dhe Testimi Procedurave dhe Personelit	✓		✓	
Kontrolli sigurisë dhe patrullat brenda Zonës së Koncesionit (përfsh.Kontrollin e Perimetrit)	✓			
Kontrolli sigurisë dhe patrullat jashtë Zonës së Koncesionit (përfsh.Zonën me		✓		

	Organi Përgjegjës			
Funksioni	Shoqëria ose operatori caktuar me nën-kontraktim	Policia Kufitare	DPAC	Organet e Tjera
Zhvillim të Kufizuar)				
Kontrolli turmave brenda Zonës së Koncesionit	✓			
Kontrolli turmave jashtë Zonës së Koncesionit		✓		
Programi dhe Procedurat e Ndalimit të hyrjes së paautorizuar në Zonën e Koncesionit	✓	✓	✓	
Kontrolli hyrjes në vijën e kufitare me ushtrinë	✓		✓	Ministria e Mbrojtjes
Kontrolli Hyrjes te Paisjet e ANTA	✓		✓	ANTA
Siguria e Avionëve				
Kontrollet e sigurisë për prejardhjen e Avionëve	✓			Shoqerite Ajrore
Programi dhe Procedurat për Kontrollin e Sigurisë së Avionëve (perfsh. Vëzhgimin dhe azhornimin)	✓		✓	Shoqerite Ajrore
Ndalimi hyrjeve të paautorizuara		✓	✓ Për transportuesit shqiptarë	Shoqerite Ajrore
Kontrollet e sigurisë për Emergjencat				
Evakuimi Terminalit	✓	✓	✓	Ministria e Rendit Publik
Emergjencat në avionët	✓	✓	✓	Ministria e Rendit Publik/ Ministria Mbrojtjes
Planet dhe Testimi Emergjencave	✓	✓	✓	Ministria e Rendit Publik/ Ministria Mbrojtjes
Planet, ndryshimet dhe azhornimet e Emergjencave	✓	✓	✓	Ministria e Rendit Publik
Kontrollet e tjera të sigurisë				
Hetimet kriminale		✓		Ministria e Rendit Publik
Programet dhe procedurat e sigurisë VIP	✓	✓	✓	Ministria e Punëve të Jashtme/Këshilli Ministrave
Kontrolli i VIP	✓			

	Organi Përgjegjës			
Funksioni	Shoqëria ose operatori caktuar me nën-kontraktim	Policia Kufitare	DPAC	Organet e Tjera
Lejet e VIP	✓		✓	Ministria e Punëve të Jashtme
Kategoria e veçantë për Pasagjerët	✓	✓		Ministria e Rendit Publik/Shoqëritë ajrore
Armë në Bord	✓	✓	✓ (miratim hyrjeje)	Ministria e Rendit Publik/Shoqëritë ajrore
Procedurat e Sigurisë në Punësim				
Kriteri i zgjedhjes së Punonjësve	✓		✓	
Dëshmia e penalitetit e punonjësit dhe azhornimi i saj	✓		✓	Ministria e Rendit Publik/ Ministria e Drejtësisë
Vlerësimi fillestar dhe periodik i punonjësve	✓		✓ (monitorimi)	
Testet e kualifikimit, Programet e trajnimit dhe Certifikimit (përfsh. Ndryshimet dhe azhornimet)	✓		✓	
Programi I Cilësisë dhe Kontrollet e tjera				
Programi sigurimit të hapësirave	✓		✓	
Respektimi i monitorimit të Programit të Sigurisë për Hapësirat	✓		✓	Të gjithë përdoruesit e aeroportit
Programi Sigurisë së Operatorit	✓		✓	Të gjithë përdoruesit e aeroportit
Plani i sigurisë për Emergjencat Plans	✓	✓	✓	Të gjithë përdoruesit e aeroportit
Plani i sigurisë reserve	✓	✓	✓	Të gjithë përdoruesit e aeroportit
Detyra të tjera te sigurisë				
Legjislacioni ndryshime dhe azhornime	✓ (vetëm ndihmesë)		✓	Ministria e Rendit Publik/ Ministria e Mbrojtjes/Ministr-ia e Financës
Plani sigurisë së Aviacionit Civil Kombëtarë (përfsh. Azhornimet)	✓ (kontribut vetëm për aeroportet)	✓	✓	Ministria e Rendit Publik/ Ministria e Mbrojtjes/ Ministria e Financës/Doganat
Komiteti Sigurisë së Aviacionit Civil	✓ (pjesëmarrje		✓	Të gjitha aeroportet dhe përdoruesit e

	Organi Përgjegjës			
Funksioni	Shoqëria ose operatori caktuar me nën-kontraktim	Policia Kufitare	DPAC	Organet e Tjera
Kombëtar	vetëm)			aeroportit, MFA, Ministria e Mbrojtjes, Doganat/Organe të tjera shtetërore
Komiteti Sigurisë së Aeroportit "Nënë Teresa"	✓	✓	✓	Të gjithë përdoruesit e Aeroportit
Programi i Sigurisë së Aeroportit përfsh. Trainim Bashkëkohor	✓	✓	✓	Të gjithë përdoruesit e aeroportit/Ministr-ia e Rendit Publik/ Ministria e Mbrojtjes/Ministr-ia e Financës
Anketa, Inspektime dhe Teste	✓		✓	

SHTOJCA 45

NDËRTESË NDIHMËSE – NGA ANA E TOKËS

Konsiderata të Përgjithshme

Të gjitha materialet do të zgjidhen duke marrë në konsideratë faktorë te tille si çmimin, mirëmbajtjen, të dhënat e elasticitetit dhe akustikës, fortësinë dhe përshtatshmërinë për qëllimin e përdorimit.

Materialet që gjenden ne vend do të përdoren për cilësi të veçanta të projektit për aq sa do të jetë e mundur. Druri, alumini dhe/ose çeliku do të përdoren për dyert. Alumini dhe/ose çeliku do të përdoren gjithashtu për dritaret dhe ventilatorët. Dritaret, dyert dhe ventilatorët për aq sa do të jetë e nevojshmes do të vishen me materiale të ndryshme për të shmangur ndryshkun, prishjen apo dëmtimin e parakohëshëm.

Projekti Mekanik/Hidraulik

Zonat e reja sanitare do të pajisen me kaseta uji të montuara në mure, urinale, lavamanë dhe aksesorë të tjerë të përshtashëm në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Mbrojtja nga zjarri/Sistemi spërkatës

Të gjitha kushtet e nevojshme që duhen zbatuar sipas standarteve dhe rregulloreve vendase do të specifikohen nga Shoqëria gjatë Fazës së projektimit të hollësishëm të Projektit.

Ndriçimi i Përgjithshëm

Sistemi i Ndriçimit të brendshëm dhe të jashtëm do të bazohet në standardet Evropiane dhe do të përmbushë standardet shqiptare në ato raste kur ato i kalojnë standardet Evropiane.

Do të përdoret kryesisht ndriçimi fluoreshent. Ndriçimi Inkandeshent do të përdoret vetëm për qëllime dekorative.

Të gjitha dritat dhe llampat do të jenë të cilësisë së nevojshme për qëllimin e përdorimit të tyre. Ato do të plotësojnë kushtet klimaterike për përdorim në aeroport dhe në përgjithësi voltazhi i

funksionimit do të jetë 230 V, 50 Hz.

Niveli i Ndriçimit

Nivelet e ndriçimit e mëposhtme duhen arritur në të gjitha zonat e aeroportit:

Zona e zyrave	500 lux
Korridoret e zyrave	150 lux
banjot, dhomat e pastrimit dhe ndihmëse	120 lux
dhomat teknike dhe ato të makinerive	150 lux
Shkallët	100 lux
Zonat e Hyrjes	300 lux
Lobet	300 lux
Servisi	300 lux
Magazinat	200 lux

Ndriçimi i zonave publike do të përputhet me kërkesat e arkitekturës përkatëse.

Ndriçimi për emergjencat do të jetë i pranishëm në ndërtesat dhe zonat publike, serviset dhe zonat operacionale të qendrës së kargos për arsye sigurie.

Dritat e sigurisë dhe dritat e daljeve të sigurisë do të jenë të pranishme në të gjitha hapësirat e nevojshme.

Ndriçimi i Pengesave

Ndriçimi i pengesave do të realizohet në ndërtesat e aeroportit sipas kushteve të ICAO-s.

SHTOJCA 46

NDËRTESA NDIHMËSE - ANA AJRORE

Hangari i Mirëmbajtjes së Avionëve

Nëse mirëmbajtja do të realizohet rregullisht gjatë Periudhës së Koncesionit, Shoqëria do të sigurojë hapësirë të mjaftueshme me hyrje të drejtpërdrejtë nga vendqëndrimi i avioneve për në hangarin e mirëmbajtjes së avionëve. Nëse bihet dakord mes Palëve, Shoqëria, në bashkëpunim me ndonjë përdorues të ardhshëm mund të ndërtojë një ndërtesë të përshtatshme.

Ndërtesa e Ndriçimit të Aerodromit

Do të ndërtohet një ndërtesë e ndriçimit në përputhje me kërkesat e ICAO për nxjerrjen në pah të pengesave. Vendndodhja e kësaj ndërtese do të përcaktohet në Planin Kryesor të Perditesuar të Aeroportit. Funksioni kryesor i ndërtesës do të jetë të strehojë paisjet dhe instalimet e ndriçimit të fushës. Ndërtesa do të ketë ajër të koindicionuar.

Ndërtesa e Kateringut të kompanive ajrore

Një pjesë e përshtatshme toke do të vihet në dispozicion nga Shoqëria për ndërtimin e ndërtesave te përshtatshme për kateringun e kompanive ajrore nga cilido Përdorues i Aeroportit, Përdorues i Mundshëm i Aeroportit, ose palë e tretë, në kushte të arsyeshme tregëtare. Për shmangien e cdo dyshimi, Shoqëria do të sigurojë që çdo palë që ka një ndërtesë ekzistuese kateringu ne Zonën e Koncesionit në ditën para Datës së Fillimit do të pajiset me një pjesë të përshtatshme toke për të ndërtuar një ndërtesë zëvendësuese kateringu nëse kjo ndërtesë ekzistuese kateringu kërkohet të shembet nga Shoqëria (sipas kësaj Kontrate) dhe kompania ajrore do që kjo ndërtesë të jetë brenda Zonës se Koncesionit.

SHTOJCA 47

NDRIÇIMI I RRUGËVE

Shoqëria do të sigurojë ndriçim rruge për:

1. Tërë gjatësinë e Rrugës së Re Lidhëse, sipas specifikimeve në këtë Shtojca

2. Rrugën Hyrëse në Terminal (brenda 200 metrave nga kufijtë e aeroportit) dhe rrugën rrethuese të aeroportit,

3. Rrugët dytësore (rrethuese të aeroportit) që janë rruge lidhese me Fazën A Qëndrës së Re të Kargos Ajrore dhe me Fazën B të Qëndrës së Re të Kargos Ajrore, cdo ndërtesë Kateringu, cdo ndërtesë ndihmëse dhe Parkinget.

Për ndriçimin e rrugëve do të përdoren drita tipike për instalime në mjedise të jashtme te cilat nuk do të kenë më pak fuqi, lartësi dhe frekuencë sesa më poshtë:

Rruga kryesore hyrëse dhe rruga rrethuese e aeroportit:

- Drita rruge dhe shtylla 400 W, 10 m lartësi dhe 40 m distancë
- Niveli ndriçimit përafërsisht: 30 lux
- Rrugët dytësore:
- Drita rruge dhe shtylla 250 w, 10 m lartësi dhe 40 m distancë
- Niveli ndriçimit përafërsisht: 15 lux

Parkinget:

- Drita rruge dhe shtylla, mesatare 15 lux, 40 m distanca
- Niveli ndriçimit 15 lux

Këto instalime ndriçimi do të jenë për rrugët me dy korsi, me të dhënat e mësipërme dhe të vendosura vetëm në njërën anë. Për rrugët me tre e katër korsi, instalimet e ndriçimit do të realizohen me të dhënat e mësipërme por në të dyja anët e rrugës.

SHTOJCA 48

IMPIANTET I REJA TE KARBURANTIT

Impiantet e Karburantit

Shoqëria do të hartoje një propozim të hollësishëm për transferimin e depozitave ekzistuese të karburantit pas Datës së Fillimit në përputhje me këtë Kontrate. Ky propozim do të përfshihet në Masterplanin e Përditësuar të Aeroportit

Depozitat e reja të karburantit do të zhvillohen duke u mbështetur në marrëveshjet midis Shoqërisë dhe Koncesionarit të ardhshëm të karburantit në bazë të të paktën një plani biznesi pesë vjecar të Koncesionarit të ardhshëm të karburantit.

Aspektet e mëposhtme do të merren në konsideratë për zhvillimin e furnizimit të aeroportit me karburant në të ardhmen:

- shpenzimet kapitale monetare për ndërtimin e depozitave të karburantit;
- pjesëmarrje e Shoqërisë në të ardhurat ekonomike të Koncesionarit të ardhshëm të karburantit (si psh komisionet nga shitjet e karburantit).

Shoqëria mund të hyjë në Kontrata shërbimi të reja me furnizuesit e karburantit për të siguruar impjantet dhe shërbimet e furnizimit me karburant. Koncesionari i karburantit mund të ndërmarrë ndërtimin dhe mirëmbajtjen e të gjithë sistemit të furnizimit me karburant në përputhje me këtë

Kontrate, Ligjet e Zbatueshme dhe Konventat. Shoqëria do të siguroje qe Koncesionari i ardhshem i karburantit të garantoje furnizimin me karburant të mjaftueshëm për të mbështetur trafikun në aeroport dhe duke kerkuar furnzimim me karburant si dhe rezerva ne sasi te mjaftueshme.

Kapaciteti i Depozitave të Karburantit dhe furnizimi i jashtëm

Kapaciteti i Depozitave të Karburantit do të përcaktohet sipas konsumit të karburantit në një ditë të ngarkuar, rezervave të mjaftueshme me karburant dhe politikave të çmimeve.

Kapaciteti i depozitave të karburantit do të përcaktohet duke u bazuar në zhvillimin e trafikut ajror në aeroport por jo para 2006-ës.

Sistemet e funksionimit të depozitës së karburantit do të përfshijnë por pa u kufizuar ne:

- depozitimin e karburantit
- lidhjen midis furnizimit të jashtëm me karburant dhe sistemit të brendshëm hidrat
- kontrollimin e cilësisë së karburantit
- mirëmbajtjen e mjeteve të vecanta (për shembull, shpërndarësit automatik)
- akomodimin e administrates, shërbimet teknike dhe strukturat sociale.

Vendndodhja e depozitave të karburantit

Me qëllim permbushjen e këtyre funksioneve, depozita e karburantit do të ndodhet në aeroport (brenda Perimetrit të Rrethimit te Sigurisë) larg zonës së vendqëndrimit ose terminalit duke marrë parasysh standardet e sigurisë. Per kete arsye, depozitat e karburantit preferohen të vendosen në pjesën veri-lindore të hapësirës së aeroportit, në veri të Fazës A të Qëndrës së Kargos së Re Ajrore dhe të Fazës B të Kargos së Re Ajrore.

Shërbimet e furnizimit me karburant në vendqëndrim

Të gjitha vendqëndrimet e avionëve mund të furnizohen me karburant me anë të autobotëve.

SHTOJCA 49

PANORAMA

Projekt koncepti për Panoraman e Aeroportin do të bazohet në peizazhet tradicionale dhe planifikimet e bëra më parë në rajon. Planifikimi formal aksial, rrugët e gjera me pemë, përdorimi i ujit dhe pikave të modeluara për referim do të dominojnë projektin konceptual. Shkalla e madhe dhe organizimi aksial i projekt-konceptit do të reflektojnë dhe përforcojnë nivelin dhe rëndësinë qytetare të Aeroportit.

Plani kryesor aksor për aeroportin do të ketë një ishull panoramik më një vepër arti ujore, në pikën ku kalon trafiku për Rrugën e Re Lidhëse drejt Terminalit të Ri. Rrethinat në hyrjet e zonave të aeroportit ose të hyrjes në zonat e Terminalit do të kenë elementë të ngjashëm panoramikë si në hyrjen kryesore me forme ishulli përballë Terminalit të Ri.

Plani i hollësishëm panoramik do të zhvillohet gjatë Periudhës së Koncesionit por jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të Masterplanit të Përditësuar të Aeroportit.

SHTOJCA 50

AFATET KOHORE

Afatet kohore paraprake për ndërtim që janë paraqitur në tabelën e mëposhtme dhe planin-A1 (shih skicat) janë pergatitur duke u bazuar në Datën e Fillimit të parashikuar më 1 Janar 2004. Nëse Data e Fillimit është më vonë se 1 Janari 2004, datat e tabelës së mëposhtme do të shtyhen ditë për ditë dhe do të shtyhen gjithashtu në përputhje me kushtet e kësaj Kontrate.

Afatet kohore paraprake të ndërtimit

No.	Procesi/Artikulli	afati [ditë]	Data e fillimit	Data e përfundimit	Procesi kryesor
	Aeroporti Ndërkombëtare i TIRANËS –				
1	Punimet kryesore të ndërtimit të Fazës A	652	01.01.2004	01.07.2006	
2	DATA E FILLIMIT	1	01.01.2004	01.01.2004	
3	Terminali i Ri i Pasagjerëve	386	01.01.2004	30.06.2005	2
4	Projekti Terminalit	66,5	02.01.2004	05.04.2004	
	Projekti Terminalit/HOCHTIEF Aeroport:				
5	HIN/TAN	52	02.01.2004	15.03.2004	2
6	Projekti Terminalit/Trema	66,5	02.01.2004	05.04.2004	2
7	Rishikimi Projekteve	66	02.01.2004	02.04.2004	
8	Rishikimi Bazë i Planit të Projektit	6	02.01.2004	09.01.2004	2
9	Dizenjoja Arkitekturale	20	08.03.2004	02.04.2004	6AA+20 Ditë
10	Dizenjoja Strukturale	20	08.03.2004	02.04.2004	9EE
11	Dizenjoja Elektrike	20	08.03.2004	02.04.2004	10EE
12	Dizenjoja HVAC	20	08.03.2004	02.04.2004	11EE
13	Ndërtim Fillon Faza A	0	01.01.2004	01.01.2004	2AA
14	Ndërtim	337	02.01.2004	18.04.2005	
15	Pregatitja e Truallit	21	02.01.2004	30.01.2004	
16	Gërmimet	20	12.01.2004	06.02.2004	8 16EA-5
17	Themelet dhe kati përdhes	45	02.02.2004	02.04.2004	Ditë;15 17EA-5
18	Strukturat e çelikut	30	29.03.2004	07.05.2004	Ditë
19	Çatia	22	10.05.2004	08.06.2004	18 18EA+5
20	Fasadat dhe muret anësore	19,5	17.05.2004	11.06.2004	Ditë 19AA+14
21	Muret e Brendshme	21	28.05.2004	25.06.2004	Ditë 21EA-5
22	Instalimet Elektrike /Ndriçimi	110	21.06.2004	19.11.2004	Ditë;20
23	Instalimi HVAC	110	21.06.2004	19.11.2004	22AA 23EA-60
24	Instalimi i Sistemit të Kontrollit dhe Bagazheve	60	30.08.2004	19.11.2004	Ditë;22EA-60 Ditë
25	Modelimi i brendshëm	126	25.10.2004	18.04.2005	
26	Të përgjithshme	125	25.10.2004	15.04.2005	24EE 26AA+60
27	Zonat sanitare/banjot	30	17.01.2005	25.02.2005	Ditë
28	Dyqanet dhe sallat	66	17.01.2005	18.04.2005	27AA 26EE-5
29	Mobiljet	27,5	02.03.2005	08.04.2005	Ditë

No.	Procesi/Artikulli	afati [ditë]	Data e fillimit	Data e përfundimit	Procesi kryesor
30	Provat e Përfundimit	55	11.04.2005	24.06.2005	
31	Provat e Përfundimit	55	11.04.2005	24.06.2005	24;25EA-10 Ditë
32					
33	Rrethinat e Terminalit	270	31.05.2004	10.06.2005	
34	Panorama	90	31.05.2004	01.10.2004	
35	Rrugët Rrethuese dhe Parkingjet e Makinave	150	04.10.2004	29.04.2005	34
36	Ndriçimi rrugës dhe shenjat	30	02.05.2005	10.06.2005	35
37					
38	Hapja e Terminalit të Ri, Faza A	0	01.07.2005	01.07.2005	36AE+1 Day;31
39	Mbyllja e Ndërtesës së Terminalit Ekzistues	0	01.07.2005	01.07.2005	38EE
40					
41	Punimet në Aerodrom	390	02.01.2004	30.06.2005	2
42	Projektet/rishikimi projekteve	129	02.01.2004	30.06.2004	
43	Përmirësimi i Rrugëve Lidhëse	261	01.07.2004	30.06.2005	42
44	Ndriçimi Tokësorë i Aerodromit	152	01.01.2004	30.07.2004	
45	Ndriçimi i Aerodromit në Aeroport	90	01.01.2004	05.05.2004	
46	Shpronësimi I Zonës së Ndriçimit të Afrimit	0	01.01.2004	01.01.2004	
47	Rrethimi i Zonës së Ndriçimit të Afrimit	20	01.01.2004	28.01.2004	46
48	Përfundimi i Rrethimit të Përimetrit	65	01.01.2004	31.03.2004	
49	Sistemi-CCTV	87	01.04.2004	30.07.2004	48
50	Rruga e Perimetrit nga ana e aerodromit	129	02.01.2004	30.06.2004	41AA
51					
52	Ndërtesat Dytësore	514	05.01.2004	22.12.2005	
53	Terminali i Kargos	345	05.01.2004	29.04.2005	
54	Projektimi	45	05.01.2004	05.03.2004	
55	Ndërtimi	300	08.03.2004	29.04.2005	54
56	Ndërtesa e Paisjeve nga ana e Aerodromit	514	05.01.2004	22.12.2005	
57	Projektimi	35	05.01.2004	20.02.2004	
58	Ndërtimi	225	23.02.2004	31.12.2004	57
59	Terminali Ekzistues i Rimodeluar	190	01.04.2005	22.12.2005	
60	Projetkimi	65	01.04.2005	30.06.2005	
61	Ndërtimi	125	01.07.2005	22.12.2005	60EA-30 Ditë;39
62					
63	Shërbimet Komunale në Aeroport	369	01.01.2004	31.05.2005	
64	Nën-stacionet në Aeroport	265	01.01.2004	05.01.2005	
65	Projektimi	50	01.01.2004	10.03.2004	
66	Ndërtimi	80	11.03.2004	30.06.2004	65
67	Installation	140	24.06.2004	05.01.2005	66EA-5 Ditë
68	Sistemi i Furnizimit me Ujë	302	05.04.2004	31.05.2005	
69	Projektimi	60	05.04.2004	25.06.2004	
70	Ndërtimi	242	28.06.2004	31.05.2005	69
71	Sistemi Përpunimit të Ujrave të Zeza	282	03.05.2004	31.05.2005	

No.	Procesi/Artikulli	afati [ditë]	Data e fillimit	Data e përfundimit	Procesi kryesor
72	Projektimi	75	03.05.2004	13.08.2004	
73	Ndërtimi Sistemit të Kanalizimeve	164	16.08.2004	31.03.2005	72
74	Ndërtimi Impiantit të Kanalizimeve	187	13.09.2004	31.05.2005	72
75					
76	Rruga Hyrëse në Aeroport	651	01.01.2004	01.07.2006	
77	Përfundimi i shpronësimeve & Miratimi	0	01.01.2004	01.01.2004	2
78	Projektim- Rruga dhe Ura	130	02.01.2004	01.07.2004	77AA 78EA-30
79	Ndërtimi urave dhe autostradës lidhëse	399	21.05.2004	30.11.2005	Ditë
80	Ndërtimi Rrugës	551	21.05.2004	01.07.2006	78EA-30
81	Shkallëzimi	399	21.05.2004	30.11.2005	Ditë 81EA-150
82	Rrugët e Shtruara	257	05.05.2005	28.04.2006	Ditë
83	Ndriçimi rrugëve dhe sinjalizimet	40	08.05.2006	30.06.2006	82
84	Hapja e Rrugës së Re Lidhëse	0	01.07.2006	01.07.2006	83
85					
86	Ura e Re në Rrugën Ekzistuese	261	01.01.2004	31.12.2004	
87	Përfundimi i shpronësimeve & Miratimi	0	01.01.2004	01.01.2004	2
88	Projektimi	86	02.01.2004	30.04.2004	87AA
89	Ndërtimi i Urës	175	03.05.2004	31.12.2004	88

SHTOJCA 51

PLANI TRANZICIONIT

Palët duhet të miratojnë para Datës së Fillimit një plan tranzicioni të përshtatshëm për Shoqërinë që të marrë në dorëzim drejtimin e Aeroportit nga Aeroporti “Nënë Tereza” Sh.A në datën e fillimit në përputhje me këtë Marrëvshje dhe të marrin parasysh propozimet përkatëse të përcaktuara në urdhërin për Koncesionin datë 5 Dhjetor 2004

SHTOJCA 52

NJOFTIMI KUNDËRSHTIMIT

Për:
Tirana Airport Partners (TAP) Sh.p.k.
Rruga e Kavajes n. 59, Tirana Toëer, Kati V
Tirana
Republic of Albania

Tiranë, [●] 2004

Të nderuar zotërinj:

1. I referohemi Kontrates së Koncesionit (the "Kontrates së Koncesionit") të lidhur mes Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (the "Qeveria e Shqipërisë"), e përfaqësuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe Tirana Airport Partners Sh.p.k më ● 2004, dhe propozimit ("Propozimit") që Shoqëria na ka dorëzuar më ● në lidhje me Detyrimet Shtesë (një kopje e së cilës është e bashkëngjitur).

2. Përvecse kur jane perdorur shprehimisht ndryshe, termat e përdorura në këtë njoftim kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në Kontraten e Koncesionit.

3. Sipas Paragrafit 4.5 (Zbatimi dhe Rishikimi i Detyrimeve Shtesë të Shoqërisë) të Kontrates së Koncesionit, Qeveria e Shqipërisë ka të drejtën të kundërshtojë propozimin brenda 10 ditëve nga data e marrjes së propozimit.

4. Qeveria e Shqipërisë shprehet këtu në kundërshtim të propozimit. Kundërshtimi bazohet mbi mendimin e Qeverisë së Shqipërisë se propozimi nuk përputhet me [kushtet dhe afatet e Kontrates së Koncesionit OSE dispozitat e Ligjit të Zbatueshëm]. Mospërmbushja ka të bëjë, në mënyrë të vecantë, me (vendos te dhenat)

I Juaji Sinqerisht,
MINISTRI I EKONOMISË
Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

Bashkëngjitjet

SHTOJCA 53

FORMA E LETRES SE QEVERISE SHQIPTARE QE KONFIRMON SE PRONA E PALUAJTSHME BRENDA ZONES SE KONCESIONIT ESHTE SHPRONESUAR DHE ESHTE NE PRONESI TE QEVERISE SE SHQIPERISE

Per:
Tirana Airport Partners (TAP) Sh.p.k.
Rruga e Kavajes n. 59, Tirana Toëer, Kati V
Tirana
Republika e Shqiperise
Tirana, ● 2004

Të nderuar zotërinj:

1. I referohemi Kontrates së Koncesionit (the "Kontrates së Koncesionit") të lidhur mes Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (the "Qeveria e Shqipërisë"), e përfaqësuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe Tirana Airport Partners Sh.p.k më ● 2004, dhe propozimit ("Propozimit") që Shoqëria na ka dorëzuar më ● në lidhje me Detyrimet Shtesë (një kopje e së cilës është e bashkëngjitur).

2. Përvecse kur jane perdorur shprehimisht ndryshe, termat e përdorur në këtë njoftim kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në Kontraten e Koncesionit.

3. Ne perputhje me Piken 3.2 (b) (iii) (Kushtet Paraprake te Qeverise Shqiptare), Qeveria Shqiptare duhet te konfirmoje qe shpronesimi i Zones se Koncesionit eshte kryer dhe prona e paluajtshme listuar ne Shtojcen 15 (Zona e Kocesionit) eshte e lire nga Barret Siguruese dhe Pushtimi, dhe qe titulli i pronesise mbi siperfaqen ne Zonen e Koncesionit i eshte transferuar Qeverise se Shqiperise ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem.

4. Ne konfirmojme, (ne emer dhe per llogari te Qeverise se Shqiperise) qe shpronesimi i Zones se Koncesionit eshte kryer dhe prona e paluajtshme listuar ne Shtojcen 15 (Zona e Kocesionit) eshte e lire nga Barret Siguruese dhe Pushtimi, dhe qe titulli i pronesise mbi siperfaqen ne Zonen e Koncesionit i eshte transferuar Qeverise se Shqiperise ne perputhje me Ligjin e Zbatueshem.

I Juaji Sinqerisht,
MINISTRI I EKONOMISË
Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

Bashkëngjitjet

SHTOJCA 54

RAPORTIMI PERIODIK

Shoqëria do t'i dorëzojë Organit të Autorizuar Shtetëror ose Entit Shtetëror përkatës të gjitha raportet e kërkuara sipas kësaj Kontrate, Ligjit të Zbatueshëm dhe Konventave sipas afateve dhe formave të kërkuara, këto forma të jenë të miratuara nga Palët paraprakisht. Shoqëria do t'u përgjigjet menjeherë kërkesave të arsyeshme të Organit të Autorizuar Shtetëror ose Entit Shtetëror përkatës në lidhje me ato raportime.

SHTOJCA 55

VEPRIMTARITË USHTARAKE

Palët do të bien dakord në lidhje me llojshmërinë e veprimtarive ushtarake në Aeroport paraprakisht Datës së Fillimit në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Kontrate.

Llojshmëria do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- Trafikun dhe shpërndarjen e fluturimeve gjatë Kapacitetit të Shpallur të Pistës;

- procedurat e komunikimit dhe afatet e njoftimit, me kusht qe këto afate njoftimi të mos jenë më pak se 5 Ditë Pune paraprakisht për veprimtari ushtarake rutinë ose fluturime, dhe 10 ditë për veprimtari ushtarake tokësore në Zonën e Koncesionit;

- procedura e njoftimit të dëmtimit të paisjeve në anën e pistës sipas përshkrimit në Shtojcen 23 (Infrastruktura në anën e Pistës), Rruga Perimetër e Aeroportit dhe Ndricimi Tokësor i Aerodromit sipas përshkrimit në Shtojcen 28 (Ndricimi Tokësor i Aerodromit) të shkaktuara nga Veprimtaritë Ushtarake, duke përfshirë punimet rregulluese të ndërmarra nga Shoqëria;

- mënyrën e dëmshpërblimit të shpenzimeve per punime rregulluese të arsyeshme dhe/ose pagesat e nevojshme për të sjellë paisjet në anën e pistës në gjendjen e mëparshme para zhvillimit te Veprimtarive Ushtarake përkatëse, dëmshpërblime dhe pagesa pagesa keto qe do të kryhen nga Qeveria e Shqipërisë brenda afateve të pagimit të përkufizuar në këtë Kontrate;

- përdorimi i paisjeve të siguruara nga Shoqëria mbi bazën e kontratave të vecanta mes Shoqërisë dhe forcave të ushtarake të Republikës së Shqipërisë;

- procedurat e hyrjes dhe masat e sigurisë sipas Shtojces 29 (Zjarri dhe Shpëtimi dhe Kontrollet Përkatëse), Shtojca 39 (Sistemi Administrimit të Sigurisë në Aeroport) dhe Shtojca 44 (Kontrolli Sigurisë dhe i Bagazheve); dhe

- Cështje të tjera, qe gjykohen si te nevojshme nga Shoqëria dhe forcat ushtarake të Republikës së Shqipërisë në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e Shoqërisë sipas kësaj Kontrate.

SHTOJCA 56

ZONA E KUFIZUAR DHE ZONA E ZHVILLIMIT

Zona e Kufizuar, kufiri i së cilës është ngjyrosur me blu dhe Zona e Zhvillimit, nënvizuar me te verdhe, tregohen në "Zonën e Kufizuar dhe Zonën e Zhvillimit".

SHTOJCA 57

FORMA E LETRËS SË SHOQËRISË QË KONFIRMON VËRTETËSINË E DHE KORREKTËSINË E DEKLARATAVE DHE GARANCIVE TË SAJA

PËR:
Ministrin e Ekonomisë
●
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Vëmendje: Ministrit
("Ministri i Ekonomisë")

Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit
●
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Vëmendje: Ministrit
("Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit")
Tirana, ● 2004
Të nderuar Zotërinj:

1. I referohemi Kontrates së Koncesionit (the "Kontrates së Koncesionit") të lidhur mes Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (the "Qeveria e Shqipërisë"), e përfaqësuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe Tirana Airport Partners (TAP) Shpk ("Shoqëria") më ● 2004.

2. Përvecse kur parashikohet shprehimisht të ndryshme, termat e përdorura në këtë njoftim kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në Kontraten e Koncesionit.

3. Sipas Paragrafit 3.1(a) (Kushtet Paraprake të Shoqërisë) Kontrates së Koncesionit, Shoqëria duhet të konfirmojë se të gjitha deklaratat dhe garancitë e dhëna nga Shoqëria janë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet materiale sikurse të ishin dhënë në Datën e Fillimit.

4. Ne konfirmojmë se të gjitha deklaratat dhe garancitë përkatëse të dhëna nga Shoqëria sipas Paragrafit 27.2 (Shoqëria) të Kontrates së Koncesionit janë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet materiale sipas datës së këtij dokumenti..

I Juaji Sinqerisht,
Tirana Airport Partners (TAP) Shpk
Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

SHTOJCA 58

[I lënë bosh me qëllim]

SHTOJCA 59

[I lënë bosh me qëllim]

SHTOJCA 60
FORMA E LETRËS SË SHOQËRISË QË KONFIRMON DEKLARIMET FINANCIARE TË MARRA NË BAZË TË DOKUMENTEVE TË FINANCIMIT

PËR:
Ministrin e Ekonomisë
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Vëmendje: Ministrit
("Ministri i Ekonomisë")

Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Vëmendje: Ministritë
("Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit")
Tirana, ● 2004
Të nderuar Zotërinj:

1. I referohemi Kontrates së Koncesionit (the "Kontrates së Koncesionit") të lidhur mes Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (the "Qeveria e Shqipërisë"), e përfaqësuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe Tirana Airport Partners (TAP) Shpk ("Shoqëria") më ● 2004.

2. Përvecse kur janë dhënë shprehimisht të ndryshme, termat e përdorura në këtë njoftim kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në Kontraten e Koncesionit.

3. Sipas Paragrafit 3.1(c) (Kushtet Paraprake të Shoqërisë) të Kontrates së Koncesionit, Shoqëria duhet të konfirmojë së ka marrë premtime detyrueshme në bazë të Dokumentave të Financimit (të cilat janë nënshkruar dhe kanë efekt të plotë) për financimin e detyrimeve të Shoqërisë sipas Kontrates së Koncesionit.

4. Ne konfirmojmë se Shoqëria ka marrë premtime të detyrueshme sipas Dokumenteve të Financimit (të cilat janë nënshkruar dhe kanë efekt të plotë) për financimin e detyrimeve të Shoqërisë sipas Kontrates së Koncesionit. Kjo përfshin:

(a) Kontraten e Huasë mes Shoqërisë dhe [plotëso hollësitë e huadhënësit] datë ● 2004, sipas të cilës [plotëso hollësitë e huadhënësit] ka rënë dakord t'i japë Shoqërisë një shumë prej ● sipas afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate Huaje;

[(b)] [Marrëveshja e Huasë mes Shoqërisë dhe [plotëso hollësitë e huadhënësit] datë ● 2004, sipas të cilës [plotëso hollësitë e huadhënësit] ka rënë dakord t'i japë Shoqërisë një shumë prej ● sipas afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate Huaje;]

[(c)] Kontraten e Financimit të Ortakeve mes Ortakeve dhe Shoqërisë datë ● 2004, sipas të cilës Ortaket kanë rënë dakord të bëjnë investim kapitali sipas kushteve dhe afateve të Kontrates së Financimit të Ortakeve dhe në përputhje me kërkesat e Kontrates se Koncesionit; dhe

[(d)] [plotëso të dhëna të tjera përkatëse].

I Juaji Sinqerisht,
Tirana Airport Partners (TAP) Sh.P.K
Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

SHTOJCA 61
FORMA E LETRËS SË SHOQËRISË NË LIDHJE ME SIGURIMET PËR:

Ministrin e Ekonomisë
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Vëmendje: Ministrit
("Ministri i Ekonomisë")

Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Vëmendje: Ministrit
("Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit")
Tirana, ● 2004
Të nderuar Zotërinj:

1. I referohemi Kontrates së Koncesionit (the "Kontrates së Koncesionit") të lidhur mes Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (the "Qeveria e Shqipërisë"), e përfaqësuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe Tirana Airport Partners (TAP) Sh.p.k ("Shoqëria") më ● 2004.

2. Përvecse kur jane perdorur shprehimisht ndryshe, termat e përdorura në këtë njoftim kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në Kontraten e Koncesionit.

3. Sipas Paragrafit 3.1 (d) (Kushtet Paraprake të Shoqërisë) të Kontrates së Koncesionit, Shoqëria duhet të konfirmojë që ka marrë premtime të detyrueshme dhe të mjaftueshme për marrjen e policave të sigurimit nga shoqëri sigurimi të njohura, në përputhje me kërkesat e Shtojces 11 (Siguracioni) të Kontrates së Koncesionit.

4. Ne konfirmojmë se Shoqëria ka marrë premtime të detyrueshme dhe të kënaqshme për marrjen e policave të sigurimit nga shoqëri sigurimi të njohura në përputhje me kërkesat e paraqitura e Shtojces 11 (Siguracioni) të Kontrates së Koncesionit.

I Juaji Sinqerisht,
TIRANA AIRPORT PARTNERS (TAP) Sh.p.k.
Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

SHTOJCA 62
FORMA E LETRËS SË SHOQËRISË QË KONFIRMON PËRPUTHJE ME DETYRIMET E SAJA SIPAS KONTRATES SË KONCESIONIT DHE DOKUMENTEVE TË FINANCIMIT

PËR:
Ministrin e Ekonomisë
●
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Vëmendje: Ministrit
("Ministri i Ekonomisë")

Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit
●
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Vëmendje: Ministrit
("Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit")
Tirana, ● 2004
Të nderuar Zotërinj:

1. I referohemi Kontrates së Koncesionit (the "Kontrates së Koncesionit") të lidhur mes Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (the "Qeveria e Shqipërisë"), e përfaqësuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe Tirana Airport Partners (TAP) Sh.p.k ("Shoqëria") më ● 2004.

2. Përvecse kur jane perdorur shprehimisht ndryshe, termat e përdorura në këtë njoftim kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në Kontraten e Koncesionit.

3. Sipas Paragrafit 3.1(e) (Kushtet Paraprake të Shoqërisë) të Kontrates së Koncesionit, Shoqëria duhet të konfirmojë që funksionon në përputhje me të gjitha detyrimet e saja sipas Kontrates së Koncesionit dhe secilit prej Dokumenteve të Financimit.

4. Ne konfirmojmë se Shoqëria funksionon në përputhje më të gjitha detyrimet sipas Kontrates së Koncesionit dhe secilit prej Dokumenteve të Financimit.

I Juaji Sinqerisht,
TIRANA AIRPORT PARTNERS (TAP) Sh.p.k.
Nga: _____

Emri: _____
Titulli: _____

SHTOJCA 63

MARREVESHJA E LLOGARISE SE NGURTESUAR

DATE [●], 2004

QEVERIA E REPUBLIKES SE SHQIPERISE

dhe

TIRANA AIRPORT PARTNERS SH.P.K.

dhe

BANKA AMERIKANE E SHQIPERISE

_____
KONTRATA E LLOGARISE SE NGURTESUAR
_____

Kjo Kontrate lidhet me [●] 2004

NDERMJET:

(1) QEVERISE SE REPUBLIKES SE SHQIPERISE, e perfaqesuar nga Ministria e Ekonomise se Republikes se Shqiperise dhe Ministria e Transportit dhe Telekomunikacioneve e

Republikes se Shqiperise (“Qeveria e Shqiperise”);

(2) TIRANA AIRPORT PARTNERS (|TAP) SH.P.K., nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e regjistruar dhe ekzistuese sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, selia e se ciles eshte ne adresen: Rruga e Kavajes no. 59, Tirana Toëer, Kati V, Tirana, Republic of Albania (“Shoqeria”); dhe

(3) BANKA AMERIKANE E SHQIPERISE, institucion financiar i themeluar dhe qe funksionon ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise, selia e te cilit eshte ne adresen.....(Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar)

NDERSA:

(a) Qeveria e Shqiperise dhe Shoqeria kane lidhur me [●], 2004 nje kontrate koncesioni (“Kontrata e Koncesionit”) sipas se ciles Qeveria e Shqiperise i dha Shoqerise te drejten e vetme dhe ekskluzive per te kryer projektin, financimin, ndertimin, venien ne pune, mirembajtjen, funksionimin, menaxhimin dhe zhvillimin e Aeroportit Nderkombetar “Nene Tereza” afer Tiranes ne Republiken e Shqiperise ne perputhje me kushtet dhe afatet e Kontrates se Koncesionit (“Koncesioni”);

(b) Kontrata e Koncesionit eshte ratifikuar ne formen e ligjit nga Kuvendi Populllor i Republikes se Shqiperise me [●], ligj i cili ka hyre ne fuqi dhe veprim me [●], 2004 (“Ligji i Koncesionit te Aeroportit”);

(c) Kontrata e Koncesionit i kerkon Shoqerise qe t’i paguaje Qeverise nje tarife paraprake koncesioni ne shumen prej 3.000.000 EURO (“Pagesa Paraprake e Koncesionit”); dhe

(d) Shoqeria dhe Qeveria e Shqiperise kane rene dakord ne Kontraten e Koncesionit se Pagesa Paraprake e Koncesionit do te depozitohet nga Shoqeria ne nje llogari te ngurtesuar me ane te Agjentit te Llogarise se Ngurtesuar dhe do te clirohet nga Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar ne perputhje me kushtet dhe afatet e kesaj Kontrate;

TASHME, duke marre ne konsiderate premisat e mesiperme, te cilat perbejne nje pjese integrale dhe thelbesore te kesaj Kontrate, KETU ESHTE RENE DAKORD sa me poshte:

1. CAKTIMI I AGJENTIT TE LLOGARISE SE NGURTESUAR

Shoqeria dhe Qeveria e Shqiperise ne kete dokument caktojne dhe emerojne Agjentin e Llogarise se Ngurtesuar si agjent te llogarise se ngurtesuar dhe Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar me ane te ketij dokumenti e pranon kete caktim dhe emerim ne perputhje me kushtet dhe afatet e kesaj Kontrate.

2. DEKLARIMET DHE GARANCITE

cdo pale ne kete Kontrate deklaron dhe garanton ne masen e kerkuar se:

(1) eshte nje shoqeri e krijuar dhe qe funksionon ne sipas legjislacionit te vendit ku eshte regjistruar;

(2) ka kompetencat dhe autoritetin per te nenshkruar kete Kontrate dhe per te permbushur detyrimet sipas kesaj Kontrate;

(3) kjo Kontrate eshte e autorizuar dhe nenshkruar rregullisht dhe detyrimet e saj ligjore, te vlefshme dhe detyruese zbatohen ne perputhje me kushtet e saj;

(4) cdo miratim, autorizim apo udhezim i kerkuar ne lidhje me ekzekutimin e kesaj Kontrate dhe kryerjen nga ndonje prej paleve ketu, eshte marre dhe eshte ruajtur ne fuqi dhe veprim; dhe

(5) kryerja e kesaj Kontrate nuk do te shkele ose cenoje ndonje ligj te zbatueshem, rregullore, kontrate ose ndonje Kontrate tjeter.

3. LLOGARIA E NGURTESUAR

(1) Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar ka krijuar ne librat e tij llogarine e ngurtesuar nr. [●] ne emrer te Qeverise se Shqiperise (“Llogaria e Ngurtesuar”) per depozitimin e Fondeve te Llogarise se Ngurtesuar ne perputhje me Piken 4 me poshte.

(2) Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar pohon se Qeveria e Shqiperise dhe Shoqeria i kane perfunduar format e hapjes se mandatit dhe llogarise sic kerkohen nga Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar per krijimin e Llogarise se Ngurtesuar.

(3) Pervec kur parashikohet ne Piken 5 dhe 6 me poshte, cdo veprim menaxhimi dhe heqjeje ne lidhje me Llogarine e Ngurtesuar do te jete i efektshem vetem kur kryhet nga Qeveria e Shqiperise dhe Shoqeria, duke vepruar se bashku, me shkrim dhe nenshkrime te perbashketa.

4. FONDET E LLOGARISE SE NGURTESUAR

(1) Pagesa Paraprake e Koncesionit e depozituar nga Shoqeria ne, dhe e mbajtur ne, Llogarine e Ngurtesuar, duke perfshire te gjithe interesin e akumuluar mbi te, do te perbeje fondet e llogarise se ngurtesuar ("Fondet e Llogarise se Ngurtesuar").

(2) Fondet e Llogarise se Ngurtesuar do te bartin normen interesit vjetor te zbatueshem per depozita overnight ne ate mase, te llogaritur nga dhe duke perfshire daten e pageses se Tarifes Paraprake te Koncesionit ne Llogarine e Ngurtesuar, por duke perjashtuar daten ne te cilen Fondet e Llogarise se Ngurtesuar jane cliruar dhe paguar ne perputhje me Piken 5 ose Piken 6, sipas rastit ("Interesi").

5. CLIRIMI I FONDEVE TE LLOGARISE SE NGURTESUAR

Ne varesi te Pikes 6 me poshte,

(1) Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar do t'i cliroje Fondet Llogarise se Ngurtesuar brenda dy (2) diteve pune te marrjes se udhezimeve te perbashketa te shkruara nga Qeveria e Shqiperise dhe Shoqeria, udhezime te tilla te shkruara te perbashketa te jene ne formen e Abeksit A ("Njoftimi i Clirimit");

(2) ne varesi te nen-pikes (1) me siper, Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar do t'i cliroje Fondet e Llogarise se Ngurtesuar nga ngurtesimi dhe do t'i transferoje Fondet e Llogarise se Ngurtesuar (perfshire ketu edhe ndonje Interes) ne llogarine e Deloitte&Touche LLP te percaktuar ne Njoftimin e Clirimit;

(3) Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar nuk eshte i detyruar te beje ndonje pagese lidhur me Fondet e Llogarise se Ngurtesuar deri ne momentin qe merr Njoftimin e Clirimit; dhe

(4) Fondet e Llogarise se Ngurtesuar (perfshire cdo Interes) mund te clirohen vetem ne perputhje me kete Pike 5.

6. KTHIMI I FONDEVE TE LLOGARISE SE NGURTESUAR

Nese Kontrata e Koncesionit do te zgjidhet per shkak te mospermbushjes qofte nga Shoqeria, qofte nga Republika e Shqiperise, brenda gjashte (6) muajve qe nga data qe Ligji i Koncesionit te Aeroportit hyn ne fuqi dhe veprim, te kushteve te tyre respektive sipas Kontrates se Koncesionit, Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar do te cliroje, brenda [dy (2)] dite pune te marrjes se nje fature me udhezime te perbashketa te shkruara nga Qeveria e Shqiperise dhe Shoqeria (keto udhezime te perbashketa te shkruara te jene ne formen e Shtojcait B ("Njoftimi i Kthimit")), Fondet e Llogarise se Ngurtesimit nga llogaria e ngurtesimit dhe do t'i transferoje Fondet e Llogarise se Ngurtesimit (perfshire cdo Interes) tek llogaria e Shoqerise e percaktuar ne Njoftimin e Kthimit.

7. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E AGJENTIT TE LLOGARISE SE NGURTESUAR

(1) Te drejtat dhe detyrimet e Agjentit te Llogarise se Ngurtesuar do te jene teresisht te nje natyre administrative dhe jo diskrecionare. Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar eshte i detyruar te veproje vetem ne perputhje me kushtet e kesaj Kontrate dhe me udhezimet e shkruara te marra prej tij nga Qeveria e Shqiperise dhe Shoqeria ne perputhje me kete Kontrate, dhe Agjenti i llogarise se Ngurtesuar nuk do mbarte ndonje pergjegjesi qe vjen si rezultat i perputhjues me te njejtat.

(2) Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar mund te mbeshtetet plotesisht mbi vertetesine dhe autorizimin e nenshkrimit te Qeverise se Shqiperise dhe Shoqerise mbi ndonje udhezim, njoftim, clirim, fature ose dokument tjeter qe i eshte dhene Agjentit te Llogarise se Ngurtesuar ne baze te kesaj Kontrate.

(3) Qeveria e Shqiperise dhe Shoqeria bien dakord dhe heqin dore ketu nga cdo padi, pretendim, kerkese ose rekurs te ndonje lloji qe mund te kene ose mund te kerkojne kunder Agjentit te Llogarise se Ngurtesuar qe lind nga ose ne lidhje me ekzekutimin ose kryerjen e kesaj Kontrate nga Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar, pervec rasitit kur kjo padi, pretendim, kerkese ose rekurs bazohet ne mospermbushje me dashje ose neglizhence te madhe te Agjentit te Llogarise se Ngurtesuar.

(4) Qeveria e Shqiperise dhe Shoqeria me tej bien dakord qe te demshperblejne Agjentin e Llogarise se Ngurtesuar per cdo padi, pretendim, kerkese ose rekurs nga palet e treta lidhur me ndonje ceshtje ose gje te bere ose qe nuk eshte bere nga Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar per shkak te

ekzekutimit ose kryerjes nga ana e tij te kesaj Kontrate, pervec rastit kur kjo padi, pretendim, kerkese apo recurs ka ardhur per shkak te mospermbushjes me dashje ose neglizhences se madhe nga ana e Agjentit te Llogarise se Ngurtesuar.

(5) Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar bie dakord se do te njoftoje menjehere marrjen e Tarifes Paraprake te Koncesionit ne Llogarine e Ngurtesuar, nese keshtu kerkohet nga Qeveria e Shqiperise dhe Shoqeria.

(6) Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar bie dakord per ta mbajtur te fshehte te gjithe informacionin dhe dokumentet qe ai merr ne lidhje me kete Kontrate, duke perfshire kete Kontrate. Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar nuk do t'i tregoje asnje informacion te tille te fshehte ndonje pale te trete (pervec drejtoreve te tij, nepunesve, punemarresve, perfaqesuesve dhe keshilltareve te jashtem) pa miratim paraprak me shkrim nga Qeveria e Shqiperise dhe Shoqeria. Megjithate, Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar, ka te drejten, nese i kerkohet, t'i jape ndonje informacion te ditur prej tij ndonje agjencie ose autoriteti qeveritar ose rregullues deri ne masen qe i kerkohet nga ligjet e zbatueshme.

(7) Fondet e Llogarise se Ngurtesuar, duke perfshire cdo Interes, nuk mund te investohen nga Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar.

8. PAGESAT DHE SHPENZIMET E AGJENTIT TE LLOGARISE SE NGURTESUAR

(1) Duke marre ne konsiderate sherbimet e parashikuara ne kete Kontrate, Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar ka te drejten qe te marre nje pagese fikse prej 2000 EURO. Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar ketu autorizohet nga Qeveria e Shqiperise dhe Shoqeria qe ta zbrese tarifen e larpermendur nga Fondet e Llogarise se Ngurtesuar.

(2) Ne shtese te pageses se pagueshme sipas nen-pikes (1) me siper, Qeveria e Shqiperise dhe Shoqeria do t'i paguajne Agjentit te Llogarise se Ngurtesuar te gjitha shpenzimet e dokumentuara qe Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar ka patur gjate kryerjes se rolit te tij sipas kesaj Kontrate.

9. NJOFTIMET

Te gjitha njoftimet dhe komunikimet qe kerkohen nga kjo Kontrate do te jene me shkrim dhe do t'i dergohen me faks adresave te meposhtme:

(1) Nese tek Qeveria e Shqiperise:

[●]
Nr. Faksi:[●]
Per vemendje te:[●]

(2) Nese tek Shoqeria:
Tirana Airport Partners (TAP) Sh.p.k.
Rruga e Kavajes no. 59, Tirana Toëer, Kati V
Tirana
Republic of Albania
Nr. Faksi:[●]
Per vemendje te:[●] Drejtorit te Pergjithshem Ekzekutiv dhe Drejtorit Administrativ

(3) Nese tek Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar:
American Bank of Albania
Rruga Ismail Qemali No.27
Tirana
Republic of Albania
Nr. Fax.: 00 355 424 8753
Ne vemendje te: Presidentit dhe Drejtorit te Pergjithshem Ekzekutiv

10. TE PERGJITHSHME

(1) Asnje pale ne kete Kontrate nuk mund te kaloje asnje prej te drejtave dhe detyrimeve te saj ketu, pa miratimin paraprak me shkrim te paleve te tjera.

(2) Asnje pale ne kete Kontrate nuk do te jete e detyruar nga ndonje modifikim i kesaj Kontrate, perfshire transferimin e ndonje interesi ketu, pervec rastit kur ky modifikim eshte me shkrim

dhe i nenshkruar nga te gjitha palet ketu.

(3) Nga kushtet e kesaj Kontrate mund te hiqet dore vetem me miratim te shkruar te nenshkruar nga pala qe dhuron heqjen dore. Heqja dore prej ndonje pale ketu te ndonje shkelje te ndonje dispozite te kesaj Kontrate nuk do te veproje dhe nuk do te interpretohet si heqje dore nga ndonje dispozite tjeter dhe ndonje zgjatje kohe per permbushjen e ndonje detyrimi nuk do te konsiderohet si zgjatje kohe per permbushjen e ndonje detyrimi tjeter.

(4) Palet konfirmojne dhe pranojne qe Pika 36 (Zgjidhja e Mosmarreveshjeve) te Kontrates se Koncesionit) do te zbatohen rast pas rasti per kete Marreveshje.

(5) Palet konfirmojne dhe pranojne qe Pika 38 (Ligji Rregullues) te Kontrates se Koncesionit) do te zbatohen rast pas rasti per kete Marreveshje.

(6) Asnje Person qe nuk eshte pale e kesaj Marreveshje nuk do te kete ndonje te drejte sipas Ligjit te Kontratave 1999 (Te Drejtat e Paleve te Treta).

(7) Ne rast se gjykata e juridiksionit kompetent vendos se ndonje pjese e kesaj Kontrate eshte e pavflefshme ose e pazbatueshme, atehere pjeset e mbetura te kesaj Kontrate do t'i mbijetojne pavlefshmerise se ketyre kushteve te kesaj Kontrate dhe do te mbeten te vlefshme dhe te zbatueshme deri ne masen me te plote qe lejohet nga ligji.

(8) Kjo Kontrate do te nenshkruhet ne tete (8) kopje, cdonjera prej se ciles do te konsiderohet origjinale, por qe te gjitha do te perbejne nje dhe te njejten Kontrate.

11. AFATI

Kjo Kontrate do te hyje ne fuqi qe nga data qe shkruhet ketu dhe do te vazhdoje derisa Agjenti i Llogarise se Ngurtesuar te kete cliruar te gjitha Fondet e Llogarise se Ngurtesuar (perfshire cdo Interes) sipas Pikes 5 ose Pikes 6 (sipas rastit), pervec kur eshte rene ndryshe dakord nga palet.

NE PRANI TE DESHMITAREVE, te nenshkruarit kane bere qe kjo Kontrate te ekzekutohet dhe te dorezohet nga nenshkruesit e tyre perkates te autorizuar rregullisht sipas dates qe eshte shkruar siper ne fillim.

QEVERIA E SHQIPERISE (e perfaqesuar nga Ministria e Finances dhe Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacioneve)

Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____
Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

TIRANA AIRPORT PARTNERS (TAP) Sh.p.k.

Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

AMERICAN BANK OF ALBANIA

Nga: _____

Emri: _____
Titulli: _____

SHTOJCA A

FORMULARI E NJOFTIMIT TE CLIRIMIT

Per:
BANKEN AMERIKANE TE SHQIPERISE

Data: [●]

1. Ne i referohemi Kontrates se llogarise se ngurtesuar midis Qeverise se Shqiperise, [te dhenat e Shoqerise] dhe jush me date [●], 2004 ("Marreveshja e Llogarise se Ngurtesuar"). Termat e perdorur ne kete njoftim kane kuptimin qe i eshte dhene atyre ne Kontraten e Llogarise se Ngurtesuar.

2. Ne ketu japim njoftimin te referuar ne Piken 5 te Kontrates se Llogarise se Ngurtesuar si Njoftimi i Clirimit.

3. Ky njoftim ju udhezon juve qe te clironi menjehere Fondet e Llogarise se Ngurtesuar nga llogaria e ngurtesuar dhe t'i transferoni Fondet e Llogarise se Ngurtesuar (perfshire cdo interes te fituar aty) ne llogarine e Deloitte&Touche LLP nr.[●] te mbajtur nga une [●].

Juaji Sinqerisht,

QEVERIA E SHQIPERISE

Nga:

TIRANA AIRPORT PARTNERS (TAP) SHPK

Nga;

SHTOJCA B

FORMULARI I NJOFTIMIT TE KTHIMIT

Per:
BANKEN AMERIKANE TE SHQIPERISE

Data: [●]

1. Ne i referohemi Kontrates se llogarise se ngurtesuar midis Qeverise se Shqiperise, Tirana Airport Partners (TAP) Shpk dhe jush me date [●], 2004 ("Marreveshja e Llogarise se Ngurtesuar"). Termat e perdorur ne kete njoftim kane kuptimin qe i eshte dhene atyre ne Kontraten e Llogarise se Ngurtesuar.

2.Ne ketu japim njoftimin te referuar ne Piken 6 te Kontrates se Llogarise se Ngurtesuar si Njoftimi i Kthimit.

3. Ky njoftim ju udhezon juve qe te clironi menjehere Fondet e Llogarise se Ngurtesuar nga llogaria e ngurtesuar dhe t'i transferoni Fondet e llogarise se Ngurtesuar (perfshire cdo interes te fituar aty) ne llogarine e Shoqerise nr.[●] te mbajtur nga une [●].

Juaji Sinqerisht,

QEVERIA E SHQIPERISE

Nga:

TIRANA AIRPORT PARTNERS (TAP) SHPK

Nga;

SHTOJCA 64
FORMULARI I LETRËS SË HTA DHE AAEF QË KONFIRMON SE SHUMA E PËRGJITHSHME EUR 614,700 DO TË NËNSHKRUHET DHE SHLYHET PREJ TYRE NE DATËN E FILLIMIT

PËR:
Ministrin e Ekonomisë
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Vëmendje: Ministrit
("Ministri i Ekonomisë")

Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit
Tiranë
Republika e Shqipërisë
Vëmendje: Ministrit
("Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit")
Tirana, ● 2004
Të nderuar Zotërinj:

1. I referohemi Kontrates së Koncesionit (the "Kontrates së Koncesionit") të lidhur mes Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (the "Qeveria e Shqipërisë"), e përfaqësuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe Tirana Aiport Partners (TAP) ("Shoqëria") më ● 2004.

2. Përvecse kur perdoren shrehimisht ndryshe, termat e përdorur në këtë njoftim kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në Kontraten e Koncesionit.

3. Sipas Paragrafit 3.1(g) (Kushtet Paraprake të Shoqërisë) të Kontrates së Koncesionit, Shoqëria duhet të paraqesë letra nëpërmjet HTA dhe AAEF për të konfirmuar se shuma 614.700 EUR do të nënshkruhet dhe shlyhet prej tyre në Datën e Fillimit (për tremujorin e parë të vitit në vazhdim të Datës së Fillimit, si pjesë e kontributeve të tyre në kapitalin e deklaruar për shlyerje) në përputhje me Shtojcen 2 (Financimi i Siguruar i Kapitalit për Fazën A të Punimeve të Ndërtimit) të Kontrates së Koncesionit.

4. HTA dhe AAEF konfirmojnë se pjesa e tyre përkatëse e shumës EUR 614,700 do të nëshkruhet dhe shlyhet prej secilit në Datën e Fillimit (për tremujorin e pare te vitit pas Datës së Fillimit, si pjesë të secilit në kapitalin e deklaruar për shlyerje) në përputhje me Shtojca 2 (Financimi i Siguruar i Kapitalit për Fazën A të Punimeve të Ndërtimit) të Kontrates së Koncesionit.

I Juaji Sinqerisht,
[HTA, AAEF]
By: _____
Emri: _____
Titulli: _____

SHTOJCA 65
FORMULARI I LETRËS SË ORGANIT TË AUTORIZUAR SHTETËROR QË KONFIRMON VËRTETËSINË DHE SAKTËSINË DEKLARIMEVE DHE GARANCIVE TË DHËNA NGA QEVERIA E SHQIPËRISË

Për:
Tirana Airport Partners (TAP) SHPK
Tirana, ● 2004
Të nderuar Zotërinj:

1. I referohemi Kontrates së Koncesionit (the "Kontrates së Koncesionit") të lidhur mes Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (the "Qeveria e Shqipërisë"), e përfaqësuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe Tirana Airport Partners (TAP) SHPK
("Shoqëria") më ● 2004.

2. Përvecse kur perdoren shprehimisht ndryshe, termat e përdorura në këtë njoftim kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në Kontraten e Koncesionit.

3. Sipas Paragrafit 3.2(a) (Kushtet Paraprake të Qeverisë së Shqipërisë) të Kontrates së Koncesionit, Organi i Autorizuar Shtetëror duhet të konfirmojë që të gjitha deklarimet dhe garancitë e dhëna nga Qeveria e Shqipërisë janë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet materiale sikurse jane dhënë në Datën e Fillimit.

4. Ne konfirmojmë se të gjitha deklarimet dhe garancite përkatëse të dhëna nga Qeveria e Shqipërisë sipas Paragrafit 27.1 (Qeveria e Shqipërisë) të Kontrates së Koncesionit janë të vërteta dhe të sakta në të gjitha aspektet materiale prej datës së mëposhtme.

I Juaji Sinqerisht,
MINISTRI I EKONOMISË
Nga: _____

Emri: _____
Titulli: _____
MINISTRI I TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

SHTOJCA 66
FORMULARI I LETRËS SË QEVERISË SË SHQIPËRISË QË KONFIRMON SE E DREJTA E UZUFRUKTIT ËSHTË DHËNË, REGJISTRUAR DHE REALIZUAR NË FAVOR TË SHOQËRISË

Për:
Tirana Airport Partners (TAP) SHPK
Rruga e Kavajes,Nr. 59, Tirana Tower
Kati 5 Tirana Republic Of Albania
Tirana, ● 2004
Të nderuar Zotërinj:

1. I referohemi Kontrates së Koncesionit (the "Kontrates së Koncesionit") të lidhur mes Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (the "Qeveria e Shqipërisë"), e përfaqësuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe Tirana Airport Partners (TAP) SHPK
më ● 2004.

2. Përvecse kur perdoren shprehimisht ndryshe, termat e përdorura në këtë njoftim kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në Kontraten e Koncesionit.

3. Sipas Paragrafit 3.2(b)(iv) (Kushtet Paraprake të Qeverisë së Shqipërisë) të Kontrates së Koncesionit, Qeveria e Shqipërisë duhet të konfirmojë se Uzufrukti në favor të Shoqërisë në lidhje më Zonën e Koncesionit dhe aktiveve të paluajtshme, të fiksuara ose të luajtshme sipas Ligjit të Zbatueshëm për një periudhë prej 20 vjetësh i është dhënë Shoqërisë dhe është regjistruar e realizuar në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme.

4. Ne konfirmojmë se (në emër të Qeverisë së Shqipërisë) Uzufrukti në favour të Shoqërise në lidhje më Zonën e Koncesionit dhe aktive të paluajtshme, të fiksuara ose të luajtshme sipas Ligjit të Zbatueshëm për një periudhë prej 20 vjetësh i është dhënë Shoqërisë dhe është regjistruar e realizuar në Rregjistrin e Pasurive të Paluajtshme sipas kopjes se vertetimit te regjistrimit ne Regjistrin e Pasurive te Paluajtshme bashkangjitur

I Juaji Sinqerisht,

MINISTRI I EKONOMISË
Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

MINISTRI I TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

SHTOJCA 67
FORMULARI I LETRËS SË QEVERISË SË SHQIPËRISË QË KONFIRMON SE RASTET E PARAQITURA NË PARAGRAFIN 3.2(C) TË KONTRATES SË KONCESIONIT NUK KANË NDODHUR

Për:
Tirana Airport Partners (TAP) SHPK
Rruga e Kavajes,Nr. 59, Tirana Tower
Kati 5 Tirana Republic Of Albania
Tirana, ● 2004

1. I referohemi Kontrates së Koncesionit (the "Kontrates së Koncesionit") të lidhur mes Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (the "Qeveria e Shqipërisë"), e përfaqësuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe Tirana Airport Partners (Tap) ("Shoqëria") më ● 2004.

2. Përvecse nese perdoren shprehimisht ndryshe, termat e përdorura në këtë njoftim kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në Kontraten e Koncesionit.

3. Sipas Paragrafit 3.2(c) (Kushtet Paraprake për Qeverinë e Shqipërisë) të Kontrates së Koncesionit, Qeveria e Shqipërisë duhet të konfirmojë që:

(a) nuk është krijuar, propozuar, miratuar ose zbatuar asnjë lloj urdhëri apo urdhëresë kufizuese nga gjykatat e juridiksionit përkatës ose nga ndonje autoritet qeveritar ose rregullator ose Ent Shtetëror që ka jurisdiksion mbi cështjen që kufizon, ndalon ose shpall të paligjshme realizimin e transaksioneve të paraqitura në Kontraten e Koncesionit; dhe

(b) nuk është nisur dhe nuk kercenohet nga asnjë ceshtje, padi, hetim ose procedurë hetimore nga ndonjë autoritet qeveritar apo rregullator ose Ent Shtetëror që ka jurisdiksion mbi cështjen që kufizon, ndalon ose shpall të paligjshme realizimin e transaksioneve të paraqitura në Kontraten e Koncesionit.

4. Ne konfirmojmë (në emër të Qeverisë së Shqipërisë) se nuk ka ndodhur asnjë nga ndodhitë e paraqitura në paragrafin 3.

I Juaji Sinqerisht,
MINISTRI I EKONOMISË
Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____
MINISTRI I TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

SHTOJCA 68
FORMULARI I LETRËS SË QEVERISË SË SHQIPËRISË QË KONFIRMON PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE SIPAS KONTRATES SË KONCESIONIT

Për:
Tirana Airport Partners (TAP) SHPK
Rruga e Kavajes,Nr. 59, Tirana Tower
Kati 5 Tirana Republic Of Albania
Tirana, ● 2004

1. I referohemi Kontrates së Koncesionit (the "Kontrates së Koncesionit") të lidhur mes Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (the "Qeveria e Shqipërisë"), e përfaqësuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, dhe Tirana Airport Partners (TAP) SHPK
("Shoqëria") më ● 2004.

2. Përvecse kur jane perdorur shprehimisht ndryshe, termat e përdorura në këtë njoftim kanë të njëjtin kuptim me atë të dhënë në Kontraten e Koncesionit.

3. Sipas Paragrafit 3.2(e) (Kushtet Paraprake të Qeverisë së Shqipërisë) të Kontrates së Koncesionit, Qeveria e Shqipërisë duhet të konfirmojë se Qeveria e Shqipërisë dhe të gjitha Organet Shtetërore kanë përmbushur detyrimet përkatëse sipas Kontrates së Koncesionit.

4. Ne konfirmojmë (në emër të Qeverisë së Shqipërisë dhe të gjitha Organeve Shtetërore) se Qeveria e Shqipërisë dhe të gjitha Organet Shtetërore kanë përmbushur detyrimet përkatëse sipas Kontrates së Koncesionit.

I Juaji Sinqerisht,
MINISTRI I EKONOMISË
Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____
MINISTRI I TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Nga: _____
Emri: _____
Titulli: _____

SHTOJCA 69
PAGESAT PËR QEVERINË E SHQIPËRISË – PAGESA E GARANCISË SË TRANSHIT TE HUAS SHTETERORE

Shoqëria do t'i paguajë Qeverisë së Shqipërisë Pagesen e Transhit te Garancisë së Huas Shteterore. Pagesa e Garancise se Transhit te Huas Shteterore do të paguhet njëherë në vit, me keste te vonuara. Kështet vjetore të Pageses se Garancisë se Transhit së Huas Shteterore të pagueshme nga Shoqëria do të llogariten duke u bazuar në diferencën mes shkallës së interesit të pagueshëm sipas Kontrates së Tanshit te Huasë Shteterore dhe shkallës së interesit të pagueshëm sipas Kontrates që rregullon Huan fillestare Kryesore të Shoqërisë (përvec Transhit Huasë Shteterore):

SLTGF(n) = (IPL(n) - ISLT(n)) x SLT(n)

Ku:

SLTGF= Pagesen e Garancisë Transhit së Huas Shteterore për vit
SLT = shuma e Transhit te Huas Shteterore e pashlyer në kohën e llogaritjes
n = afati ne vite i transhit te Huase Shteterore
ISLT = shkalla e interesit (në %) për vit sipas Transhit te Huas Shteterore
IPL = shkalla e interesit (në %) për vit sipas Kontrates që rregullon Huanë Kryesore të Shoqërisë (përvec Transhit te Huasë Shteterore)

Llogaritja do të reflektojë diferencen e pashlyer dhe pagesat e Transhit te Huas Shteterore sipas statistikave të vitit të kontabilitetit të Shoqërisë. Data e Pagesës për Pagesen e Garancisë së Transhit te Huase Shteterore do të koincidojë me daten e pagimit te interesit sipas Kontrates së Transhit te Huas Shteterore. Detyrimet e Shoqërisë për të paguar Pagesen e Garancisë së Transhit te Huas Shteterore do të rradhiten menjëherë pas detyrimit për të paguar interesin sipas Kontrates së Huasë Shteteroe.

SHTOJCA 70

PAGESAT PËR QEVERINË E SHQIPËRISË – PAGESA FILLESTARE E KONCESIONIT

Pagesa Fillestare e Koncesionit do të paguhet nga Shoqëria për Qeverinë e Shqipërisë në numrin e mëposhtëm të llogarisë së Qeverisë së Shqipërisë:

[plotëso hollësitë e numrit të llogarisë]